



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
UNIVERZITET U JUGOISTOČNOJ EVROPI

FAKULTETI JURIDIK

DISERTACION I DOKTORATURËS

**SISTEMI JURIDIK I KOSOVËS ME THEKS TE VEÇANT LEGJISLACIONI
I SË DREJTËS CIVILE DHE EFEKTET E REFORMIM TE TYRE**

NË KËRKIM TË GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

KANDIDATI:

Isuf Y. JAHMURATAJ

MENTORI:

Prof. Dr. Alba DUMI

Tetovë, 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj më përgjegjësi të plotë se përmbajtja e tezës së doktoratës më titull: “Sistemi Juridik i Kosovës me theks te veçantë Legjislacioni i së Drejtës Civile dhe efektet e reformim te tyre” është plotësisht autentike i krijuar nga unë në mënyrë të pavarur duke respektuar rregullat akademike dhe të sjelljes etike. Deklaroj gjithashtu se ky punim nuk është prezantuar para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

Abstrakti

Ndryshimet dhe evoluimi janë prezent në çdo sferë të jetës dhe të njëjtat ndodhin në çdo moment, mirëpo nga një herë në momentin që ndodhin nuk vërehen. Edhe tek shteti, forma e shteteve, sistemi juridik i tyre kemi ndryshime dhe evoluim e te cilat janë në harmoni të plotë me ndryshimet shoqërore që janë kategori dinamike. Sistemi juridik i shtetit çdo here është në zhvillim dhe reformim të vazhdueshëm, pasi duhet të jetë në harmoni dhe hap me ndryshimet që ndodhin në sferat tjera të jetës dhe kërkesat e reja shoqërore. Çdo here një hap përpara janë ndryshimet dhe reformat shoqërore dhe me pas vine ato që ndryshojnë krahas këtyre ndryshimeve e që janë sistemi juridik, ekonomik, politik, arsimor, social.

Përmes kësaj teme që në vete përmban një hulumtim që i referohet sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile nga këndvështrimi i rëndësisë së reformimit të tyre që më pas të jenë në funksion të shtetit të së drejtës. Ajo qarë është qellim i kësaj teme i referohet gjendjes aktuale të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civili si pjesë përbërëse e tij dhe sa janë të reformuara për të qenë në funksion të shtetit të së drejtës dhe zhvillimit të fushave tjera. Ajo që do të jetë risi në këtë temë do të bëjë me identifikimin e rëndësisë që ka sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile në zhvillimin ekonomik, integrimet Evropiane, krijimin e klimës së përshtatshme për investimet e huaja dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Risit do të jenë të pasqyruara me rezultate konkrete nga hulumtimi i cili do të ndihmojë institucioneve, hulumtuesve dhe mekanizmave tjerë për veprime të mëtejme lidhur me fushën që nxjerr rezultate konkrete ky hulumtim.

Pozita politike e Kosovës ka qenë jo çdo here e njëjta, pasi ka kaluar në shumë faza e të cilat nuk i kanë përngjau njëra tjetrës, qofte për nga mënyra se si kanë ndodhur, forma, përmbajtja dhe gjitha ato që e kanë karakterizuar. Kosova nuk e kishte të mundur të bënte pjesë, në pjesën territoriale natyrore të Shqipërisë etnike që më pas të jete pjesë e ndryshimeve dhe reformave të gjithë territorit të cilit natyrisht i takonte, por ajo u aneksua nga okupuesit Serb, Turq dhe Bullgar. Territori i Kosovës u shkëput nga pjesa të cilës i takonte dhe u okupua nga mbretëria Serbe dhe me pas nga Jugosllavia. Në kuadër të Jugosllavisë Kosova ishte njësi përbërëse por me shume të drejta të kufizuara. Kufizimet ishin tek pjesët me vitale dhe ato që siguronin zhvillim dhe prosperitet për Shqiptaret. Me shume vështirësi dhe pengesa të nivelit nationalist ishte zhvilluar sistemi juridik i Kosovës i cili avanconte jo edhe me hapa të shpejt.

Sistemi juridik i Kosovës në kuadër të sistemit politik të Jugosllavisë në fillim ishte shumë i kufizuar dhe nuk kishte mandatin siç duhet të kishte. Me avancimin e Kosovës në sistemin politik dhe ekonomik

në Jugosllavi kishte avancim edhe te sistemit juridik dhe fushave të saj. Fillimi i sistemit juridik të Kosovës ishte pas vitit 1945 por jo në nivel të pavarur dhe te kënaqshëm. Një avancim më i theksuar ishte në vitet 1974 deri në 1981. Nga viti 1981, kishte rënie te pozitës dhe statusit te Kosovës në të gjitha sistemet si në atë politik, ekonomik, dhe atë të sistemit juridik. Rrënimi i sistemit politik, juridik, ekonomik dhe ai i te drejtave te njeriut ndodhi në vitin 1989 kur Kosovës ju është abroguar Kushtetuta dhe nga Serbia Kosova konsiderohej pjesë e saj.

Pasi në vitin 1989 ishte rrënuar sistemi juridik i Kosovës, dhe Serbia pretendonte qe ne çdo forme te qeveriste me Kosovën kjo ra ndesh me ndjenjat dhe iniciativën e Shqiptarëve te Kosovës. Në Kosovës ishin ndërmarr te gjitha veprimet që të ndërtohej dhe te funksiononte sistemi juridik paralel i cili do te jete mekanizëm i qytetarëve te Kosovës për zhvillim te një jete nen okupim. Nga intelektual ishin ndërmarr veprime konkrete si hartimi Kushtetutës, funksionalizimi i sistemit shëndetësor, arsimor i cili mbijetonte mbi bazën e participimit te qytetarëve dhe mërgatës shqiptare. Nga viti 1989 deri në vitin 1999 në Kosovë kishte funksionuar një sitëm juridik paralel dhe kishte arrit te kryente misionin konform kushteve te vështira te krijuara nga okupatori Serb. Kjo është periudha më e vështir e popullit dhe të drejtave të tyre në Kosovë, për faktin se çdo e drejt kishte te bënte me vullnetin politik të Serbisë e ai ishte që në çdo aspekt të shkatërrohet Kosova. Kjo gjendje ishte pasqyruar në shumë raporte vendore dhe ndërkombëtare që pasqyronin gjendjen faktike e cila ishte tejet e rendë dhe shkatërruese për Shqiptarët e Kosovës. Ishte mohimi i çdo të drejte nga ana e Shtetit Serb për Shqiptarët e Kosovës që mobilizoj Shqiptarët për ti kërkuar të drejtat e tyre qoftë përmes protestave, demonstratave, aksioneve simbolike dhe deri te lufta për liri dhe pavarësi.

Pas përfundimit te luftës në vitin 1999, ne Kosovë u instalua misioni i Kombeve te Bashkuara UNMIK, i cili funksiononte mbi Rezolutën 1244. Misioni i UNMIK-ut, kishte krijuar një situatë te re ne Kosovë dhe kishte krijuar një sistem te veçante Juridik. Sistemi juridik i krijuar nga UNMIK-u, kishte zgjatur deri në vitin 2008 kur është shpall Pavarësia e Kosovës dhe nga kjo periudhë UNMIK-ut në Kosovë ju është zbeh misioni dhe kompetenca. Nga viti 2008, Kosova ka ndërtuar një sistem juridik i cili është i bazuar në vlera universale dhe pretendime për integritime euro atlantike.

E rëndësishme te ceket është fakti se studimi dhe analiza e kësaj teme është e një rëndësie të veçante, pasi analizon sistemin juridik të Kosovës dhe legjislacionin e së drejtës Civile në aspektin historik dhe gërshetimin me rendësin e reformimit të tyre. Analiza e sistemit juridik te Kosovës e ne veçanti e legjislacionit të së drejtës civile na ofron një pasqyrë të qartë të zhvillimit të sistemit dhe vështirësive të progresit karshi problemeve në sistemin Juridik të Kosovës. Rendësi tjetër është edhe ndikimi i reformimit në sistemet tjera si në atë ekonomik, zhvillimor, politik dhe investues. Ky studim mundëson

qasje reale mbi një realitet të pasqyruar me këtë studim të veprimeve të mëtutjeshme të Kosovës drejt hapave zhvillimore. Duke parë si tejet me rëndësi për zhvillimin e çdo fushe tjetër ishte indikacion që kam përzgjedhur ta trajtoj këtë temë duke realizuar hulumtim për të arritur deri të një rezultat objektiv nga i cili do të arrihet që të kemi një pasqyrë të qartë në cilën gjendje është sistemi juridik dhe legjislativi i së drejtës civile dhe ku duhet të arrihet për të qenë në funksion të shtetit të së drejtës i cili më pas do të jetë bazë për të gjitha fushat tjera për të cilat Kosova ka nevojë të ketë avancim dhe ngritje. Për një rezultat objektiv dhe në funksion të shkencës dhe praktikës, hulumtimi do të realizohet përmes dhënies së mundësisë zbatuesve të ligjit, hartuesve të ligjit, monitoruesve, shkencës juridike që të ofrojnë mendimet e tyre përmes pyetjeve të parashtruara për sistemin juridik dhe legjislativin e së drejtës civile si mekanizma në funksion të shtetit të së drejtës. Përpos kësaj, hulumtimi do ta ketë edhe komponentin e shkencës juridike qfar ka bërë për këtë fushë dhe raportet dhe hulumtimet paraprake që në një formë kanë trajtuar këtë temë apo një pjesë të saj.

Trajtimi i kësaj teme nga ana ime është tejet me rëndësi, për faktin se gjatë kohës që kam studiuar për drejtësinë, e kam vërejt se është tema që nuk është trajtuar më parë, është e një rëndësie të madhe të kemi të dhëna konkrete e të cilat do të jenë pikë referimi edhe për institucionet kompetente për avancim dhe zhvillim të sistemit juridik dhe legjislativin të së drejtës civile. Këto që u potencuan i referohen gjendjes aktuale e që është indikacion që më ka bërë të përzgjidhi për ta trajtuar. E një rëndësie të veçantë ky hulumtim është edhe për faktin se, nga ky hulumtim do të dalin në pah pengesat, zbrastirat, problemet që janë prezent në sistemin juridik dhe legjislativ të fushës së të drejtës civile, nga të cilat po pamundësohet ndërtimi i shtetit të së drejtës e i cili është baza e ndërtimit dhe zhvillimit të çdo fushe tjetër që Kosova ka shumë nevojë të zhvillojë për të qenë në funksion të qytetarëve dhe mirëqenies.

Studimi i sistemit juridik dhe legjislativin të së drejtës civile të Kosovës është specifik pasi gjatë studimit duhet pasur parasysh edhe faktin e okupimit të Kosovës, dhe etapat kohore në të cilat ka kaluar e të cilat janë shumë interesante pasi çdo periudhë është e veçantë dhe përmban elemente tejet interesante. Andaj edhe studimi përfundimtar dhe rekomandimet do të fokusohen në atë që sistemi juridik i Kosovës dhe legjislativi i së drejtës civile të jetë ai të cilin Kosova e meriton dhe i mundëson zhvillim dhe prosperitet në të gjitha sferat e jetës.

Studimet akademike më shumë se dhjetë vite për drejtësinë përkatësisht për fushën Civile, puna profesionale që kam bërë më shumë se shtatë vite në hartim të legjislativin dhe rëndësia e objektit të kësaj teme për zhvillimin e shumë fushave në vend kanë qenë katalizator që më kanë ngacmuar për trajtim të kësaj teme. Duke e pa rëndësinë e trajtimit të kësaj teme në relacion me zhvillimin e sistemit juridik, investimeve të huaja, krijimin e besimit në drejtësinë kanë qenë arsyeje të përzgjedhjes

së kësaj teme. Nga këndvështrimi im e vlerësoj larte krijimin e një mjedisi te përshtatshëm për realizimin e te drejtave te qytetarëve përmes drejtësisë e cila duhet te jete e ndërtuar sipas vlerave më të larta universale, andaj me këtë studim do arrimë te kemi një histori at sa i përket sistemit juridik e ne veçanti legjislacionit te se drejtës civile, pengesat dhe vesh tersit dhe ne fund atë qe konsiderohet se duhet te ndryshohet për një sistem te mire juridik e që do të reflekton karshi zhvillimeve tjera.

Fjalët Kyçe: Sistem Juridik, legjislacioni, civil, reformim, juridiko civile

FALËNDERIME

Unë jam këtu ku jam, jam ky që jam, pse ishin paraardhësit e mi familjar të drejtë dhe përplot vullnet për ngritjen dhe avancimin time në aspektin profesional dhe akademik në fushën e drejtësisë. Ishin prindërit Imer dhe Florije ata që në një situatë të vështirë arritën të më rritin dhe edukojnë, pasi në përdhën kur jam rritur ka qenë vështirë të mbijetohej nga sistemi totalitar o okupatorit Serb që e mohonte prejardhjen, kulturën, territorin dhe qëllimin tonë si popull Shqiptarë.

Orientimi dhe suksesi në profesion janë kontribut i traditës, kjo nga se tradita tek i ati ishte që aji ishte Jurist dhe një jetë ja kishte kushtuar drejtësisë jo vetëm për ta përzgjedhur një profesion por edhe pse populli Shqiptar në Kosovë kishte shumë nevojë për drejtësi dhe për ata që më të vërtetë do ta ndanin drejtësinë sic e përcakton e drejta e jo sic thonjtë partia Komuniste dhe planet Serbe për shfarosje të popullit Shqiptar në Kosovë.

PËRMBAJTJE

1. HYRJE	14
<u>Problematika e punimit</u>	16
<u>Qëllimi i punimit shkencor</u>	17
<u>Pyetje kërkimore</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>Hipotezat e punimit</u>	18
<u>Metodologjia e punimit</u>	19
<u>Kufizimet dhe vështirësitë</u>	19
<u>Çfarë synohet te arrihet</u>	20

KAPITULLI I LINDJA, NDERTIMI I SHTETIT DHE SISTEMIT JURDIKE . 23

<u>1.Lindja e shtetit</u>	23
<u>2.Koncepti i shtetit, nocioni dhe zhvillimet konceptuale</u>	26
<u>3.Funksioni i shtetit</u>	28
<u>4.Shteti dhe e drejta, lidhja e perbashket dhe dallimet</u>	31
<u>5.Sistemi juridik ne kuader te shtetit dhe roli i tij</u>	37
<u>6.Fusha e te drejtes civile në kuadër të sistemit juridik të shtetit</u>	40

KAPITULLI II SYNYMET E KOSOVËS PËR SHTET DHE SISTEM JURIDIK TË SAJË..... 43

<u>1.Kosova dhe sistemi i saj juridik si njësi përbërëse e ish federatës se Jugosllavisë</u>	43
<u>2.Suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës në vitin 1989</u>	47
<u>3.Administrimi dhe sistemi juridik i Kosovës nga misioni i UNMIK-ut 1999-2008</u>	50
<u>4.Sistemi juridik i Kosovës nga viti 1989 deri në vitin 1999</u>	52
<u>5.Kosova shtet i pavarur dhe sovran drejt ndertimit te shtetit dhe sistemit juridik</u>	54

KAPITULLI III E DREJTA CIVILE PJESË E SË DREJTËS 58

<u>1.Zhvillimi historik i të Drejtës Civile</u>	58
<u>2.E drejta private dhe publike</u>	59
<u>3.Sistemi i së drejtës civile</u>	61
<u>4.Marrëdhëniet shoqërore me karakter pasuror dhe rregullimi i tyre me norma juridike</u>	62

<u>KAPITULLI IV BURIMET E SË DREJTËS CIVILE NË KOSOVË</u>	64
1. <u>Burimet e të drejtës civile</u>	64
2. <u>Burimet materiale të së drejtës civile</u>	67
3. <u>Burimet formale të së drejtës civile</u>	68
4. <u>Ligji</u>	69
5. <u>E drejta zakonore</u>	70
6. <u>Interpretimi i ligjeve</u>	70
7. <u>Praktika gjyqësore</u>	72
8. <u>Shkenca juridike</u>	72
9. <u>Burimet e të drejtës civile në Kosovë</u>	73

<u>KAPITULLI V LEGJISLACIONI I SË DREJTËS CIVILE NË KUADËR TË ISH SISTEMIT JURIDIK TË JUGOSLLAVISË DHE TË MISIONIT TË UNMIK-ut</u>	76
1. <u>Marrëdhëniet juridiko civile dhe zhvillimi i tyre në Kosovë</u>	76
2. <u>Marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë sipas sistemit juridik te Serbisë</u>	78
3. <u>E drejta civile pjesë e së drejtës pozitive në kuadër të sistemit juridik Jugosllav</u>	81
4. <u>Misioni i UNMIK-ut në funksion të ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës</u>	85
5. <u>Reformimi i legjislacionit të së drejtës civile të Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut</u>	89
6. <u>Misioni i UNMIK-ut në funksion të hartimit të Politikave në fushën e drejtësisë</u>	94
7. <u>E Drejta Civile dhe pjesët e saj</u>	97
8. <u>E Drejta Civile Pozitive</u>	98

<u>KAPITULLI VI POLITIKBERJA NE FUSHEN E LEGJISLACIONIT TË SË DREJTËS CIVILE NË KOSOVË PAS VITIT 2008 DHE EFEKTET E REFORMIMIT</u>	100
1. <u>E drejta e Republikës së Kosovës për hartim të legjislacionit dhe ndryshimi i legjislacionit të UNMIK-ut në atë të Republikës së Kosovës</u>	100
2. <u>Procedurat e hartimit të politikave dhe legjislacionit në Kosovë</u>	104
3. <u>Mbulimi i fushave të së drejtës civile me legjislacion përkatës</u>	109
4. <u>Evolimi i Legjislacionit të së Drejtës Civile krahas avancimit të sistemit juridik të Kosovës</u> ...	111

<u>5.Nevoja për Kodifikimin e së Drejtës civile në Kosovë me qëllim të kompletimit të infrastrukturës ligjore</u>	114
---	-----

KAPITULLI VII PARAFRIMI DHE HARMONIZIMI I LEGJISLACIONI I SË DREJTËS CIVILE ME STANDARTET NDERKOMBETARE 116

<u>1.Mekanizmat institucional të Kosovës për përfrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire.</u>	116
<u>2.Partneriteti Evropian i Kosovës</u>	120
<u>3.Mardhenja juridiko-civile ne Kosove ne raport me politikat dhe standartet e BE-se</u>	125
<u>4.Harmonizimi i legjislacionit obligim i shteteve para anëtarësimit në BE, rasti i Kosovës</u>	125

KAPITULLI VIII EFEKT E REFORMIMIT TË SISTEMIT JURIDIK DHE LEGJISLACIONIT TË SË DREJTËS CIVILE NË KOSOVË 129

<u>1.Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit</u>	129
<u>2.Qëllimi dhe procedura e hulumtimit</u>	130
<u>3.Rikujtojmë se hipotezat e ngritura në këtë punim janë:</u>	131
<u>4.Efekt e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë</u>	131
<u>5.Analiza e të dhënave dhe grafikonet</u>	138

6.PERFUNDIME210

7.REKOMANDIME213

8.BIBLOGRAFIA217

9.SHTOJCA.....221

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORI

UNMIK	United Nations Mission In Kosovo
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavis
BE-se	Bashkimi Evropian
RFPJ-ës	Republika Federative Popullore e Jugosllavise
OSBE-së	Organizata pwr Siguri dhe Bashkepunim Evropian
KCS	Kodi Civil i Serbise
RSS	Republika Socialiste e Serbise
KSA	Krahina Socialiste Autonome
NATO-s	North Atlantic Treaty Organization
OKB-së	Organizata e Kombeve te Bashkuara
PSSP	Perfaqesuesi Special i Sekretarit te Pergjitheshem
OJQ-t	Organizata Jo Qeveritar
MSA	Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim
SKDP	Strategjia Kombetare per te Drejtat Pronesore
PVPE	Planit parë veprim për Partneritet Evropian
MPS	Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asocimit
PSA	Procesit të Stabilizim Asocimit
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku Nr. 1 Pozita juaj?

Grafiku Nr. 2 A duhet të ketë reforma të vazhdueshme të sistemi juridik dhe legjislativi i së drejtës civile në Kosovë, për të pasur një shtet të së drejtës?

Grafiku Nr. 3 Prej vitit 1999 deri në vitin 2008, kompetencë e kujt ishte konsolidimi i sistemit juridik në Kosovë?

Grafiku Nr. 4 Me shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008, reformimi i sistemit juridik të Republikës së Kosovës, ka filluar me?

Grafiku Nr. 5 Sa është i reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me standardet e BE-së?

Grafiku Nr.6 Sa është i reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me legjislativin e BE-së?

Grafiku Nr. 7 Sa është i konsoliduar legjislativi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë?

Grafiku Nr.8 A janë në harmoni me standardet ndërkombëtare, mbrojtja, zhvillimi, trajtimi i marrëdhënieve juridike-civile në Kosovë?

Grafiku Nr. 9 Cila nga pjesët e degës së të drejtës civile ka nevojë për ndryshim dhe harmonizim të legjislativit?

Grafiku Nr.10 A ekzistojnë zbrastëritja ligjore në legjislativin e së drejtës civile?

Grafiku Nr. 11 A ekziston duplikimi i dispozitave ligjore në legjislativin e së drejtës civile?

Grafiku Nr. 12 A ekzistojnë dispozita të paqarta në legjislativin e së drejtës civile?

Grafiku Nr. 13 A ekzistojnë norma kundërtënëse (çështje të njëjta rregullohen në mënyrë të ndryshme) në legjislativin e së drejtës civile?

Grafiku Nr. 14 Sa e vështirëson realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile mungesa e dispozitave përkatëse apo kolizioni i ligjeve?

Grafiku Nr.15 Legjislativi aktual i së drejtës civile mundëson në mënyrë efektive?

Grafiku Nr. 16 Sistemi Juridik në Kosovë mund të reformohet me:

Grafiku Nr.17 Sa është legjislativi i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet shoqërore në Kosovë?

Grafiku Nr.18 Sa është legjislativi i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet ekonomike në Kosovë?

Grafiku Nr.19 Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet sociale në Kosovë?

Grafiku Nr. 20 Reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë do të ketë ndikim pozitiv në:

Grafiku Nr. 21 Sa do të ketë ndikim ndryshimi i legjislacionit të së drejtës civile në zgjidhjen e lëndëve nga marrëdhëniet juridiko civile në gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor?

Grafiku Nr. 22 Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me investimet e huaja në Republikën e Kosovës?

Grafiku Nr. 23 Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës që mundësojnë qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut për qytetarët e Republikës së Kosovës?

Grafiku Nr. 24 Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me ndryshimet shoqërore, ekonomike, integruese në Republikën e Kosovës?

Grafiku Nr. 25 Sa ka Politika të qarta sa i përket reformimit të Legjislacionit të së Drejtës Civile në Kosovë?

Grafiku Nr. 26 Sa e ka lehtësuar qasjen në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës krijimi i sistemit të noterisë, përmbarimit privat dhe ndërmjetësimit?

Grafiku Nr. 27 A duhet të ketë reformim të sistemit gjyqësor të Kosovës për mbrojtje më efektive të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile?

Grafiku Nr. 28 A duhet dispozitat juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë të bashkohen në një Kod Civil të Kosovës?

Grafiku Nr. 29 Në hartimin e politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile, sa janë të përfshirë: gjyqtarët; profesorët; avokatet; noterët; ndërmarrësit; përmbaruesit privat; studentet; ekspertet e së drejtës?

Grafiku Nr. 30 Kush duhet të përfshihet në reformimin e legjislacionit të së drejtës civile?

1. HYRJE

Tema e disertacionit “Sistemi Juridik i Kosovës me theks te veçantë Legjislacioni i së Drejtës Civile dhe efektet e reformimit të tyre” ka në fokus të saj shqyrtimin dhe analizimin e çështjeve më kryesore që ndërlidhen më sistemin juridik, legjislacionin e së drejtës civile dhe rendësin e reformimit të tyre si dhe ndikimi i reformimit të tyre, si në aspektin e rregullimit të legjislacionit vendas ashtu edhe në aspektin e praktikës, shkencore. Punimi do të trajtohet në këndvështrime të ndryshme. Pjesa e parë e punimit do të përshkruajë zhvillimin historik, ndërtimit të shtetit dhe sistemit juridikë kjo përmes metodës historike juridike, sa më detajisht pasqyrohet zhvillimi historik i lindjes së shtetit nga para historia dhe gjer në ditët e sotme. Më pas trajtohet koncepti i shtetit dhe funksioni i shtetit si një mekanizëm me refleksion rregullator në vend. Në kuadër të kësaj pjese trajtohet shteti edhe e drejta lidhjet dhe dallimet mes tyre. Trajtim në këtë pjesë gjen edhe sistemit juridik në kuadër të shtetit dhe roli i tij për shtetin dhe shoqërinë si dhe e drejta civile në kuadër të sistemit juridik të shtetit. Pjesa e dytë e punimit do të paraqesë dhe analizojë Synimet e Kosovës për shtet dhe sistem juridik të sajë. Kjo pjesë përmban dhe trajton pozitën e Kosovës dhe sistemin e saj juridik në kohën kur ka qenë njësi përbërëse e ish federatës së Jugosllavisë, suprimimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Në kuadër të kësaj pjese është edhe sistemi juridik i Kosovës nga viti 1989 deri në vitin 1999. Si dhe administrimit të Kosovës nga misioni i UNMIK-ut 1999-2008, Kosova shtet i pavarur dhe sovran drejt ndërtimit të shtetit dhe sistemit juridik. Pjesa e tretë do të trajtoj zhvillimin historik të së Drejtës Civile si degë e së drejtës dhe pjesë e sistemit juridike. Kjo pjesë e trajton të drejtën private dhe atë publike duke ardhur deri tek ajo që mundëson të njihet nga cila prej këtyre të drejtave buron e drejta civile si pjesë e së drejtës. Kjo pjesë ka të trajtuar edhe sistemin e së drejtës civile, i cili është pjesë e së drejtës civile si dhe marrëdhëniet shoqërore me karakter pasuror dhe rregullimin e tyre me norma juridike. Pjesa e katërt e temës ka të trajtuara Burimet e së drejtës civile në Kosovë, ku kandidati ka paraqitur burimet e të drejtës civile si pjesa me një rendësi të veçantë në kuadër të së drejtës civile. Gjithashtu në këtë pjesë kandidati ka trajtuar burimet materiale dhe formale të së drejtës civile si dhe burimet e të drejtës civile në Kosovë. Pjesa e pestë e temës trajton Legjislacionin e së drejtës civile në kuadër të ish sistemit juridik të Jugosllavisë dhe misionit të UNMIK-ut. Kjo pjesë në mënyrë të detajuar ka të trajtuara marrëdhëniet juridiko civile dhe zhvillimin e tyre në Kosovë, marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë sipas sistemit juridik të Serbisë, e Drejta Civile pjesë e së drejtës pozitive në kuadër të sistemit juridik Jugosllav. Në këtë pjesë zën një vend të mjaftueshëm edhe trajtimi i misionit të UNMIK-ut në funksion të ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës, klasifikimin e legjislacionit

diskriminues në Kosovë, marrëdhëniet juridiko civile dhe zhvillimin e tyre në Kosovë gjatë periudhës së misionit të UNMIK-ut dhe politikberjen në fushën e së drejtës civile gjate administrimit te Kosovës nga misioni i UNMIK-ut. Pjesa e gjashtë e temës përmban Politik bërja ne fushën e legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë pas vitit 2008 dhe efektet e reformimi. Në këtë pjesë kandidati ka trajtuar te drejtën e Republikës së Kosovës për hartim të legjislacionit dhe ndryshimi i legjislacionit të UNMIK-ut në atë të Republikës së Kosovës. Më pas kandidati në këtë pjese, një hapësirë te konsiderueshme i ka lenë trajtimin të procedurave te hartimit të politikave dhe legjislacionit në Kosovë. Ky kapitull përmban edhe pjesën që i referohet mbulimit te fushave të së drejtës civile me legjislacion përkatës. Në këtë kapitull kandidati ka parapa dhe trajtuar evolimi i Legjislacionit të së Drejtës Civile krahas avancimit të sistemit juridik të Kosovës. Kjo pjesë përfundon me nevojën për Kodifikimin e së Drejtës civile në Kosovë me qëllim te kompletimit të infrastrukturës ligjore. Pjesa e shtatë ne mënyrë të veçantë ka të trajtuar Përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit të së drejtës civile me standardet ndërkombëtar. Kjo pjesë në kuadër të vetë ka shtjelluar mekanizmat institucional të Kosovës për përafrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire, partneritetin Evropian të Kosovës, marrëdhëniet juridiko-civile ne Kosove ne raport me politikat dhe standardet e BE-se. Kjo pjesë përmban edhe harmonizimin e legjislacionit si obligim i shteteve para anëtarësimit në BE, rasti i Kosovës.

Pjesa e tete do të trajtoj Efektet e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë, përmes temave konkrete. Në këtë pjesë analizohen rezultatet e pyetësorit/anketës i cili është i përberë nga tridhjetë pyetje të realizuar me gjyqtar, avokat, profesor të së drejtës, noter, përmbarues privat, student, ndërmjetësues, ndërmarrës dhe zyrtar ligjor. Kjo është pjesa më esenciale e këtij studimi ku kandidati ndërthur metodën e anketës, statistikave dhe grafikoneve. Përmes këtij punimi është arritur të studiohet sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë si dhe efektet e reformimit të këtyre dy segmenteve, njeherit kandidati jep përfundime edhe rekomandime konkrete për reformimin, avancimin e sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë.

Metodologjia e këtij punimi është e bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë siguruar përmes metodës së studimit të dokumentacionit, dhe përdorimit të pyetësorëve. Metoda e studimit të dokumentacionit dhe pyetësorit janë përdorur gjatë procedurës së mbledhjes së të dhënave nga respondentet. Nëpërmjet metodës se studimit të dokumentacionit është mundësuar analizimi i dokumenteve, raporteve, librave dhe studimeve. Përveç nga hulumtimi në dokumentacion, një pjesë e të dhënave primare të këtij punimi janë siguruar edhe përmes pyetësorit të realizuar më respondentëve. Në pyetësorë janë përfshirë 650 respondent nga vende

të ndryshme të Kosovës të cilët janë gjyqtar, avokat, profesor, ndërmjetësues, noter, përmbarues privat, ndërmarrës dhe zyrtar ligjor. Ndërsa, të dhënat sekondare janë siguruar nëpërmjet përdorimit të literaturës bashkëkohore ekzistuese mbi sistemin juridik, shtetin. Literatura e përdorur gjatë këtij punimi mbështetet në burime të ndryshme, si akte ligjore, libra universitarë, punime shkencore, monografi dhe burime të tjera.

2.Problematika e punimit

Kur synohet që të ketë shtet të së drejtës dhe në funksion të zhvillimit dhe perspektivës për jetën e qytetarëve, rendësi të veçante dhe fundamentale ka sistemi juridik i cili në vetë përmban vullnetin e popullit se si do të rregulloj marrëdhëniet e veta me karakter juridik, ekonomik, social, etj. Pra sistemi juridik është rregullatori dhe korniza mbi të cilën zhvillohet jeta dhe raportet ndërmjet njerëzore dhe ato mes individit dhe shtetit. Vlerën e lartë që ka sistemi juridik çdo shtet është dinamik duke e reformuar, ndryshuar dhe avancuar me qëllim që të jetë në hap me ndryshimet shoqërore, ekonomike, sociale dhe integruese. Edhe Kosova një rendësi të veçante i ka kushtuar avancimit të sistemit të saj juridik, mirëpo ka pasur tejet vesh tersi për faktin se ka kaluar në fazën të ndryshme politike dhe nuk ka pasur mundësi të krijoj stabilitet dhe trashëgimi të sistemit të saj juridik. I qartë dhe i Kosovës llogaritet që është sistemi juridik ai i filluar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, mirëpo ende nuk mund të kualifikohet i kompletuar dhe i avancuar.

Pjesë e sistemit juridik dhe tejet me rendësi është legjislativi i së drejtës civile, i cili rregullon dhe mbulon të gjitha raportet shoqërore nga marrëdhëniet juridiko civile. Përmes legjislativit të së drejtës civile rregullohen raportet shoqërore që janë tejet me rendësi, ato që kanë të bëjnë me të drejtat nga marrëdhëniet juridiko civile e që përfundimi i tyre çdo herë është aspekt material. Duke qene tejet të rëndësishme, Kosova marrëdhëniet juridiko civile i ka rregulluar me legjislacionin përkatës duke filluar me të drejtat: pronësore, sendore, detyrimeve, trashëgimore dhe ato familjare. Të gjitha këto të drejta janë të rregulluara me norma përkatëse të ndara në ligje të veçanta, të cilët janë në një masë në harmoni edhe me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Sfidat dhe problemet sa i përket sistemit juridik dhe legjislativit të së drejtës civile i referohen disa aspekteve, duke filluar nga mos reformimi i mjaftueshëm për të qenë në hap me ndryshimet e shumta shoqërore, ekonomike, sociale, integruese goftë brenda vendit goftë në aspektin global. Përveç kësaj është edhe mos harmonizimi i plot me legjislativin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare të cilat e fuqizojnë sistemin juridik dhe legjislativin e së Drejtës Civile për të reflektuar në ndërtimin, fuqizimin dhe avancimin e Kosovës si shtet të së drejtës. Sfidë dhe tejet e theksuar është edhe mos zbatimi i legjislativit të së drejtës civile,

ku kjo është e njohur nga vlerësimet dhe hulumtimet që janë bërë sa i përket zbatimit të legjislacionit të së drejtës civile. Ketë e dëshmon edhe numri i madh i problemeve dhe kontesteve nga marrëdhëniet juridiko pronësore që janë prezent në Kosovë. Me pas probleme të theksuara ka edhe sa i përket marrëdhënieve detyrimeve dhe ekzekutimit të kontratave dhe vendimeve gjyqësore. Me probleme të theksuara janë edhe marrëdhëniet trashëgimore dhe ato familjare. Të cekurat që i referohen sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë, janë me refleksion direkt edhe në zhvillimin e shumë fushave dhe sektorëve tjera në Kosovë, duke filluar nga zhvillimi ekonomik, krijim te kushteve dhe ambient të përshtatshëm për investime të huaja, lehtësira në të bërit biznes, qasje në drejtësi, respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Problemet dhe sfidat në kuadër të sistemit juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile janë në lidhmëni direkt me fushat dhe sektorët tjera ku varet direkt zhvillimi dhe sukcesi i tyre. Nëse sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile nuk janë të reformuara dhe avancuara në at formë sa me qen në shërbim dhe funksion të zhvillimit ekonomik, investime te huaja, qasje në drejtësi, respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut, nuk mund të kualifikohet se sistemi Juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile është i reformuar dhe i avancuar për tu konsideruar se është në rregull. Problematikat e përmendura më sipër si dhe problematikat e tjera të identifikuara gjate hulumtimit do të elaborohen më hollësisht në kapitullin e tetë të këtij punimi.

3.Qëllimi i punimit shkencor

E para dhe obligim parësor i imi karshi temës se trajtuar ka qene që tema të trajtohet konform parimeve dhe rregullave shkencorë që versioni final të jetë në harmoni me rregullat dhe standardet e një punimi shkencor ashtu sic e ka obligim një hulumtues shkencor.

Tema e trajtuar nga kjo fushë në bazë të metodave përkatëse, pretendoj te trajtoj duke arritur të kemi një këndvështrim shkencor për rendësin e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë. Këndvështrimi shkencor do jete njëri nga qëllimet që synohet të arrihet përmes trajtimit të kësaj teme. Tema përmes këtij trajtimi arrin te ofroj një pasqyrë të qartë shkencore e cila efektin e saj e arrin duke i dhen kohës te dhëna te sakta shkencore e që janë shumë të rëndësishme për shkencën e së drejtës civile në të ardhmen.

Duke e marr parasysh pozitën politike dhe juridike të Kosovës, tema do ketë për qëllim edhe trajtimin historik ne mënyrë kronologjike të sistemit juridik e në veçanti të legjislacionet të së drejtës civile si pjese e sistemit juridik. Përmes këtij trajtimi do të arrihet të kuptohet gërshetimi i sistemit politik të Kosovës me atë juridik dhe përpjekjet për avancim e të cilat kanë qenë shumë të vështira në të kaluarën.

Qellim që hyn në ranglistë tek ato më të rëndësishme është edhe trajtimi i legjislacionit të së drejtës civile përmes së cilit qytetarëve të Kosovës ju është mundësuar mbrojtja dhe fitimi i të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile.

Pike tjetër e rëndësishme të ceket është edhe qëllimi praktik i punimit i cili do të jetë një analizë për institucionet kompetente dhe përgjegjëse për hartimin e politikave që së pari të identifikojnë problemet në këtë fushë, dhe mbi bazën e rekomandimeve të fillohet me plotësim ndryshimin e konceptit për legjislacionin e së drejtës civile me qëllim të avancimit dhe reformimit të mbrojtjes dhe fitimit të së drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile. Ato informata dhe njohuri që do të gjenden nga ky hulumtim të kenë sigurinë shkencore, praktike dhe do të bazohen në të dhëna konkrete që do të gjenerohen përmes hulumtimit ku do të jone të përshtatshme që të përdoren si të dhëna shumë të rëndësishme për pasqyrimin e gjendjes dhe drejtimin ka duhet të vazhdohet për plotësim ndryshimin e sistemit juridike dhe legjislacionin e së drejtës civile me qëllim që të arrihet në një zhvillim. Refleksioni i qëllimit të punimit është edhe tek ato fusha në të cilat pretendohet se do ketë ndryshim karshi cilësisë së legjislacionit të së drejtës civile. Kjo me faktin se do të kemi skenim të gjendjes, identifikim të pengesave dhe propozim për orientim konkret drejt zgjidhjes konkrete

5.Hipotezat e punimit

Në këtë punim trajtohen: shteti, sistemi juridik me theks te veqante legjislacioni i se Drejtes Civile dhe rendesia e reformimit te sistemit juridik dhe legjislacioni i se Drejtes Civile. Tema shtjellon shtetin, sistemin juridik te shtetit, fushen civile si pjese e sistemit juridik te shtetit. Krahas keti shqyrtimi identifikohet rendesia e reformimit te sistemit juridik dhe legjislacioni i se Drejtes Civile.

Rezultatet e pritura nga ky hulumtim do të ofrojnë të dhëna për sistemin juridik, teoritë për sistemin juridik, fusha e te drejtes civile, rendesia e reformimit te sistemit juridik dhe legjislacioni i se Drejtes Civile ne Kosove. Në këtë kontekst shtrohen edhe pyetjet kërkimore (hipotezat) si:

Hipoteza 1: Është esenciale dhe me impakt themelor reformini i sistemit juridik të Kosovës për te siguruar shtet te se drejtes?

Hipoteza 2: Sistemi juridik i Kosovës dhe legjislacioni i së Drejtës Civile është i reformuar dhe avancuar.

Hipoteza 3: Mardhenjet juridiko-civile nuk janë të zhvilluara dhe avancuara konform ndryshimeve shoqërore, ekonomike, sociale dhe sipas nevojave të investimeve dhe tregut.

6. Metodologjia e punimit

Metodologjia e këtij punimi është e bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë siguruar përmes metodës së studimit të dokumentacionit dhe përdorimit të pyetësorëve. Metoda e studimit të dokumentacionit dhe pyetësorëve janë përdorur gjatë procedurës së mbledhjes së të dhënave të gjyqtarëve, profesorëve të drejtësisë, avokatëve, noterëve, përmblyesit privat, ndërmjetësuesit, ndërmarrësit dhe zyrtarëve ligjorë. Nëpërmjet metodës së studimit të dokumentacionit është mundësuar analizimi i dokumenteve që i referohen Sistemit juridik, legjislacionit, hartimit të politikave dhe legjislacionit në Republikën e Kosovës. Përveç nga hulumtimi i dokumentacionit, një pjesë e të dhënave primare të këtij punimi janë siguruar edhe përmes pyetësorit të realizuar me gjyqtarëve, profesorëve të drejtësisë, avokatëve, noterëve, përmblyesit privat, ndërmjetësuesit, ndërmarrësit dhe zyrtarëve ligjorë. Në pyetësorë janë përfshirë 650 individë nga vende të ndryshme të Kosovës. Përzgjedhja e individëve të përfshirë në pyetësorë është bërë në mënyrë të rastisshme. Një elaborim më i gjerë për procesin e realizimit të pyetësorit më individë, bëhet në kapitullin e tetë të këtij punimi. Ndërsa, të dhënat sekondare janë siguruar nëpërmjet përdorimit të literaturës bashkëkohore ekzistuese mbi shtetin, sistemin juridik dhe politik, legjislacionin. Literatura e përdorur gjatë këtij punimi mbështetet në burime të ndryshme, si akte ligjore, libra universitarë, punime shkencore, monografi dhe burime të tjera.

7. Kufizimet dhe vështirësitë

Sistemi juridik, legjislacioni i së drejtës civile dhe rëndësia e reformimit të tyre në funksion të ndërtimit të shtetit të së drejtës në Kosovë nuk janë mjaft të trajtuara. Si rezultat i kësaj, nuk kam pasur shumë mundësi që punimin të bazoj në literaturë, studime dhe analiza të ndryshme nga kjo fushë. Andaj, punimi është mbështetur kryesisht në legjislacionin e së drejtës civile të Kosovës, me qëllim që të analizohet konform ndryshimeve shoqërore, ekonomike, sociale dhe i njëjti sa është në funksion të zhvillimit të fushave tjera, me qëllim të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Nuk ishte vetëm mungesa e literaturës, sfida tjetër ishte realizimi i fazës së hulumtimit përmes pyetësorit, me qëllim të gjenerimit të dhënave statistikore për çështjet e studiuara në punim. Hulumtimi përmes pyetësorit ka qenë një proces i gjatë dhe mjaft i vështirë, për faktin se respondentet kanë qenë të ndryshëm dhe nga profile të ndryshme, ku është dashur kohë e gjatë nga fillimi gjer në përfundim të këtij procesi. Gjate punës ka pasur vështirësi, pengesa, sfida por të njëjtat nuk kanë qenë të pa tejkaluar, mirëpo kanë marr shumë

kohë dhe angazhim, kjo ndoshta si rezultat i asaj se fusha dhe punimi që kam studiuar në këtë punim ka qenë e para dhe çdo gjë ka qenë më vështir duke mos pasur mundësi të kem një shembull për orientim.

8.Çfarë synohet te arrihet

Me anë të shtjellimit të problematikës së punimit synoj që të fokusohem në aspektin historik të sistemit juridik dhe ati të legjislacionit të së drejtës civile. Nja pjesë e analizës do të fokusohet në trajtimin e sistemit juridik dhe legjislacionit në aspektin e etapave në të cilat ka kaluar. Fokusim i rëndësishëm do të jetë edhe tek rëndësia e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile. Pjesa e rëndësishme se reformimit do të ndërlidhet me pjesët në të cilat do të ketë efekt pozitiv dhe refleksioni në zhvillimin e pjesëve të caktuara të sistemeve. Pjesë shumë me rëndësi do të jete ajo e hulumtimit nga e cila do të gjenerohen të dhëna përmes se cilave do të arrijmë të kuptojmë në detaje për sistemin juridik, legjislacionin e së drejtës, reformimin, ndikimin në fushat me të rëndësishme të shtetit të Kosovës.

Përmes studimit të sistemit juridik të Kosovës synoj që të arri të trajtoj këtë temë duke u fokusuar në aspektin historik të tij. Sistemi juridik i Kosovës është specifik, pasi historikisht ka qenë jo i pavarur por pjesë e sistemeve juridike të shteteve pushtuese. Andaj edhe kjo specifik do të trajtohet duke analizuar pozitën e sistemit juridik të Kosovës në kuadër të sistemit juridik Jugosllav. Nga kjo analizë synohet të vërehen dallimet, dhe anët pozitive dhe ato negative të sistemit juridik të Kosovës karshi ati të Jugosllavisë.

Pjesë e rëndësishme e trajtimit do të jete edhe periudha e okupimit të Kosovës nga Serbia dhe funksionimi i sistemit juridik paralel. Nga kjo periudhë do të identifikohet mënyra e funksionimit, forma e funksionimit dhe rezultatet që janë identifikuar. Kjo periudhë është shumë e rëndësishme pasi është periudhë e mbijetesës së Kosovës dhe sistemit të saj juridik, pasi okupimi ka qenë tejet i vrazhdë dhe ka penguar çdo aktivitet të zhvillohet në interes dhe dobi të popullit Shqipëtar të Kosovës.

Në mënyrë specifike tretmani dhe studimi do të fokusohet në legjislacionin e së drejtës civile në Kosovë. Në kuadër të sistemit juridik të Kosovës si njësi përbërës e saj është edhe legjislacioni i së drejtës civile të Kosovës. Krahas zhvillimit të sistemit juridik të Kosovës është zhvilluar edhe legjislacioni i së drejtës civile. Me zhvillimin e sistemit juridik dhe marrëdhënieve juridiko civile, është zhvilluar edhe legjislacioni i së drejtës civile me vështirësi pasi marrëdhëniet juridiko civile ishin të rregulluara me legjislacionin e Jugosllavisë. Përmes analizës dhe studimit të kësaj pjesë do të arrijmë të

identifikohet aspekti historik i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë, pjesët e mbuluara dhe rëndësia e rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile me dispozita përkatëse në fuqi.

Studimi do të na ofron një pasqyrë të qartë të zhvillimit dhe emancipimit të legjislacionit të së drejtës civile nga fillimi gjer në ditët e sotme. Nga kjo ne do identifikojmë edhe zhvillimin e marrëdhënieve juridiko civile ne Kosovë si njëra ndër marrëdhëniet shoqërore më të rëndësishme për zhvillim dhe ngritje të fushave tjera. Legjislacioni i së drejtës civile do të studiohet në aspektin historik, përmbajtja e tij dhe etapat e zhvillimit të tij. Është një legjislacion që është zhvilluar në disa etapa andaj çdo etapë posedon vetit e saja zhvillimore dhe konceptuale. Etapa e fillimit të rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile në Kosovë është ma së e rëndësishme pasi na mundëson të trajtojmë aspektin historik, problemet dhe sfidat e konsolidimit. Pjesë tjetër e rëndësishme është edhe zhvillimi dhe emancipimi në etapa historike gjatë periudhës historike të shtetit të Jugosllavisë. Pjesë e rëndësishme dhe që do prodhon të dhëna shumë të rëndësishme është edhe periudha e okupimit të Kosovës nga Serbia 1989 deri në 1999.

Etapa e zhvillimit të legjislacionit të së drejtës civile e cila mund të konsiderohet edhe si përuar tranzicioni është ajo e periudhës së UNMIK-ut. Nga trajtimi i kësaj periudhe na mundësohet të kemi një analizë për një periudhë kur është bërë një prerje e zbatimit të legjislacionit të së drejtës civile nga ajo që i kishte takuar sistemit të kaluar, Rregulloret e UNMIK-ut dhe ato që nuk zbatoheshin e të cilat kishin karakter diskriminues.

Efekti i kësaj teme dhe asaj çka na ofron nuk përfundon vetëm me trajtimin e sistemit juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile në aspektin politik, funksional, zhvillimor dhe reflektues karshi marrëdhënieve juridiko civile. Nga trajtimi i kësaj teme ne do arrijmë të kemi të dhëna sa i përket rëndësisë së reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë me qëllim të refleksionit në zhvillimin e sistemit juridik, ekonomik, punësisimit dhe atë të investimeve të huaja në Kosovë. Është e njohur se marrëdhëniet juridiko civile janë më të rëndësishmet në një shoqëri e cila ka fokus të drejtat e njeriut, zhvillimin ekonomik, sistemin e drejtësisë efektive dhe investimet e huaja. Nga se përmes marrëdhënieve juridiko civile shoqëria arrin të jetojë dhe të hyjë në raporte juridike. Andaj reformimi dhe zhvillimi i legjislacionit të së drejtës civile do të mundëson të kemi raporte juridike civile të nivelit të lartë. Nga ky studim arrihet të identifikohen pjesët ku janë të rregulluara mirë me legjislacion, pjesët ku ka ngecje dhe aty ku duhet të ketë ndryshime që raportet juridiko civile të rregullohen dhe të kenë refleksion në zhvillim të vendit.

Nga trajtimi i kësaj teme do të arrihet të trajtohet sistemi juridik i vendit si në aspektin historik, politik dhe atë zhvillimor. Në kuadër të sistemit juridik që është pjesa e së drejtës civile edhe kjo pjesë do të

gjej trajtim si në aspektin historik, zhvillimor dhe për nga rëndësia e tij në zhvillim. Ne fund te trajtimit te kësaj teme do te ketë te dhëna te cilat do te na informojnë ne detaje për ketë temë dhe do ti mundësohet institucioneve dhe individëve te kenë një pasqyrë te çart për ketë teme.

KAPITULLI I LINDJA, NDERTIMI I SHTETIT DHE SISTEMIT JURDIKE

1. Lindja e shtetit

Shoqëria njerëzore në fillimet e saja të para nuk kishte një organizim të jetës siç ne sot e shohim dhe e jetojmë. Fillimet e para të shoqërisë njerëzore kryesisht ishin të ndërtuara në atë formë të një jete dhe punë të përbashkët por jo të rregulluar mbi bazën e disa rregullave se si duhet të organizohej jeta, puna, sistemi i drejtësisë, ekonomia, arsimit dhe fushat tjera me interes për vendin dhe popullin e atij vendi. Duke u bazuar në faktin se ndryshimet në shoqëritë njerëzore janë evidente në çdo kohë edhe në fillimet e saja, shoqëria kishte ndryshime dhe avancime në planifikimin dhe mënyrën e organizimit të jetës. Me avancimin e shoqërisë, shoqëria filloj të organizohet në grupe të caktuara në një territor të caktuar e që kishin elemente të përbashkëta për një jetë të përbashkët dhe në këtë periudhë kemi fillimin e parë të zhvillimit të shoqërisë të bazuar në konceptin e organizimit të jetës. Me fillimin e ndarjes së shoqërisë në grupe të cilat kishin elemente të përbashkëta atëherë ishte e natyrshme që edhe territori ku do të jetonin ky grup të deshifrohet dhe të kontrollohet nga ata. Me deshifrimin e territorit të jetës për grupe të caktuara të shoqërisë atëherë erdhën si nevojë edhe rregullat dhe planifikimi për një jetë të përbashkët. Kur shoqëria filloj që organizimin e jetës ta bënte në formë të grupit ato formuan shoqëritë në kuadër të grupit dhe më pas shoqëritë u pajisen me pushtet dhe nga pushteti u shndërruan në Shtet dhe shteti funksionoj mbi bazën e konsensusit.¹

Ajo që është karakteristik e shtetit, na paraqitet në tipe dhe forma të ndryshme si shtet skllavo – pronar, feudal, kapitalist dhe proletar. Kjo ndarje dhe funksionim është i ndarë varësisht përbërjes shoqërore – ekonomik që shoqëritë e kanë përzgjedhur apo ju është imponuar nga ideologjitë e kohës. Varësisht prej tipave dhe formave të shtetit, kanë qenë të ndryshme sistemet politike, juridike, ekonomike dhe ato ekonomike, kjo për faktin se shteti ka qenë ai që ka orientuar çdo gjë varësisht orientimit që ka pasur.²

Kur trajtohet Shteti, funksionimi dhe zhvillimi i tij mund të trajtohet së paku në tri kuptime ku nga së cila mund të kemi evidentim të dhënave për një fenomen të njëjtit siç është shteti. Së pari shteti mund të trajtohet dhe të analizohet si në bashkësi njerëzish që e zhvillojnë jetën në një territor të caktuar të përbashkët e që i nënshtrohen të njëjtit pushtet sovran. Në kuadër të kësaj forme shteti na paraqitet si shteti – Komunitet. Në formën e dytë shteti mund të kualifikohet si shtet i normave juridike përmes së cilave do të rregullohet një bashkësi e veçante. Me këtë formë shteti na del si një tersi e normave

¹ Duamel, Oliver (1993) E Drejta Kushtetuese – Demokraci, Shkup, Fq. 18

² K.Salih (2002) E Drejta Kushtetuese, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Botimi i tretë. Fq. 184

juridike te nxjerrura nga vete pushteti e të cilat janë të parapara për popullsinë që janë në kuadër të këtyre normave. Me këtë formë shteti ka kuptimin e shtetit – rend. Forma e trete se si mund te trajtohet shteti është edhe forma e aparateve që formojnë organizimin e një shteti, përmes së cilave ushtrohet sovraniteti. Përmes këtyre aparateve shteti kryen funksionin normativ përmes parlamentit, funksionin ekzekutiv përmes qeverisë, dhe aparati tjetër i dhënies së drejtësisë përmes gjykatës. Në bazë të kësaj forme dhe përmbajtje shteti na paraqitet shteti - aparat.³

Organizimi Shtetëror dhe lindja e tyre, ka një histori në vete qofte si aspekt historik qe tregon nga kur është themeluar dhe kush, por është edhe aspekti i etapave brenda shoqërisë deri te shteti. Fakti që duhet pasur parasysh është se nuk kemi kalim të organizimit grupor të shoqërisë drejt në shtet, por janë disa organizime te ndërmjetme gjer të shteti. Andaj shteti në vete ka një histori, formë të funksionimit para shtetëror dhe etapa të zhvillimit gjer në këtë fazë te konceptit te shtetit. Kur i referohemi formave të funksionimit para shtetëror, kemi parasysh në radhë të parë udhëheqësin e grupit i cili ka udhëhequr grupin dhe në të njëjtën kohë ka caktuar rregullat e funksionimit të grupit. Kjo është periudha kur më së paku kemi pasur elemente të shtetit, po kryesisht ishte grupacion i njerëzve për qëllime të përbashkëta dhe krijimin e disa rregullave për jetë të përbashkët. Në këtë fazë dhe nga kjo formë e organizimit çdo gjë ishte e koncentruar tek udhëheqësi i grupit i cili kishte autorizime pa kufi në udhëheqjen, menaxhimin, sanksionimin e anëtarëve tjerë të grupit. E rëndësishme kjo përudd mund të kualifikohet vetëm se ishte fillimi i te menduarit nga njerëzit se është i nevojshme një bashkim dhe përcaktim i rregullave për një jetë të përbashkët ku do të përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet brenda grupit. Nga kjo periudhë dhe nga kjo formë e organizimit mund të kualifikohet se ka filluar të ndërtohet koncepti i shtetit si mekanizëm që përcakton territorin, rregullat dhe mënyrën e të jetuarit për ata njerëz që i përkasin atë territori. Duke u nisur nga fakti se shteti është kategori dinamike në aspektin e zhvillimit, nga kjo periudhë gjer me tani është një ndryshim dhe reformim tejet i madh që kjo formë i takon të së kaluarës dhe historisë sa i përket organizimeve të para të njerëzve për një jetë të përbashkët. Organizimi i shoqërisë në formën e Shtetit nuk ka ndonjë kohë të gjatë të funksionimit kryesisht është shekulli XX kur kemi organizime Shtetërore dhe përcaktim të elementeve përbërëse të Shtetit. Në momentin kur njerëzit kishin një jetë të përbashkët dhe kishim një zhvillim të jetës shoqërore, disa nga njerëzit shfaqnin aftësitë e udhëheqjes dhe të qënurit zëri i tyre. Këta njerëz filluan të vepronin në emër të grupit duke i përcaktuar rregullat e funksionimit për një jetëgjatësi të grupit shoqërore. Kjo formë e përfaqësimit të grupit ishte fillim i shfaqjes dhe instalimit të pushtetit politik.⁴ Organizimi dhe udhëheqja e një grupi shoqëror nga një individ në fillimet e veta mund te kualifikohet e mjaftueshme karshi zhvillimit dhe nevojave shoqërore. Me avancimin e shoqërisë dhe forcave të prodhimit, individi

³ Galgano, Francesco (2006) E Drejta Private, Tiranë. Fq. 36

⁴ Duamel, Oliver (1993) E Drejta Kushtetuese – Demokraci, Shkup. Fq. 18

nuk ishte i mjaftueshëm për udhëheqjen e grupit, pasi nuk u konsideronte i mjaftueshëm përball nevojave të grupit dhe ndryshimeve shoqërore. Si rezultat i ndryshimeve shoqërore dhe forcave të prodhimit, ishte e pa kuptimtë që të kemi kon centrimin e çdo përgjegjësie, autorizimi dhe të drejte tek një njeri. Kjo nuk ishte e mundur të vazhdohet për faktin se shteti kishte pësuar ndryshime sa i përket organizimit, funksionit dhe përbërjes. Nga grup njerëzish kemi avancim të vedijës së këtyre njerëzve dhe të njëjtit nuk e konsiderojnë që çdo gjë të varet tek një njeri, po te ketë udhëheqje mbi bazën e autorizimeve të popullit për një pjesë të caktuar që do të udhëhiqte me vendin.

Organizimi i drejtimit të shoqërisë është dinamik dhe kishte ndryshime varësisht ndryshimeve shoqërore dhe forcave te prodhimit. Nga organizimi i drejtimit nga një njëri individual kaloj në atë kolektiv dhe abstrakt ku pushteti i njërit zëvendësohet nga pushteti i Shtetit, kjo është një mënyrë tjetër e drejtimit të shoqërisë. Ideja e drejtimit nga Shteti është fuqia e bashkësisë në një formë të organizuar e cila do të reflekton ndaj çdo anëtari të sajë në kohë të përhershme, ku përmes aktivizimit të organeve të specializuara dhe kolektive do të shtinë në veprim dhe aktivizim pushtetin e Shtetit.⁵ Si në çdo aspekt edhe te drejtimi i shoqërisë zhvillimi dhe avancimi i shoqërisë është element i rëndësishëm, pasi determinon formën më të avancuar të udhëheqjes dhe drejtimit të shoqërisë. Kalimi i drejtimit dhe udhëheqjes nga individi tek Shteti tregon se shoqëria ka vlerësuar se udhëheqja nga një individ nuk është e mjaftueshme dhe kërkohet një udhëheqje më e avancuar dhe më e organizuar e që do të arrin të ketë sukses në të gjitha fushat e jetës që i përkasin shoqërisë. Me faljen e besimit një mekanizmi që quhet Shtet për udhëheqje, shoqëria kishte parasysh se edhe Shteti duhet te ketë disa kushte dhe elemente për tu konsideruar shtet. Kërkesat që të kemi avancim të shtetit ishte indikacion se kemi ngritje të vedijës së qytetarëve, ketë e tregon fakti se interesimi për shtetin, mekanizmat e tij dhe formate qeverisjes japin me kuptim se niveli i vedijës ka ndryshuar. Prandaj shteti është kategori dinamike për faktin se është ndryshimi, ngritja e vedijës së qytetarëve ajo që e bene shtetin të ndryshoj çdo dit konform ndryshimeve shoqërore.

Shtetin e karakterizojnë tri elemente që me pas mundësi të konsiderohet dhe pranohet shtet, e të cilat janë: Territori, popullsia dhe pushteti detyrues. E drejta e detyrimit është kompetencë, përgjegjës dhe privilegj i shtetit si shenje identifikuese e shtetit që vetëm ky mund të vendos rregullat dhe të kërkoj në mënyrën legjitime zbatimin e tyre e që ndryshe quhet sovranitet. Me ketë shteti na del se posedon pushtet që së pari të dekretoj rregullat e së drejtës dhe më pas pushtetin e sanksionimit për ata që nuk i respektojnë rregullat e së drejtës.⁶ Avancimi i konceptit të shtetit është i dukshëm nga fillimet e tij dhe gjer në ditët e sotme, kjo mund të vërehet edhe në formën e organizimit, qasjen në raport me

⁵ Po aty, shih Fq.18

⁶ Duamel, Oliver (1993) E Drejta Kushtetuese – Demokraci, Shkup. Fq. 19

popullsinë dhe territorin në të cilin vepron. Varësisht zhvillimit dhe avancimit shteti çdo here është bazuar në tri komponenta përbërës që mundësojnë njohjen, ekzistencën dhe zhvillimin e tij.

“ Pra Shteti mund të përkufizohet si një pushtet normativ i institucionalizuar që ushtrohet mbi një popullsi në kuadër të një territori”.⁷ Është fakt se për lindjen e shtetit ka koncepte, teori dhe mendime nga me te ndryshmet, mirëpo një është i njohur dhe e pranuar që shteti ka lind krahaz ngritjes së nivelit të ve dijes shoqërore dhe nevojës që të udhëheqin nga rregullat të cilat sigurojnë një jetë të bazuar në kufizime dhe mundësi. Ajo që është me rëndësi për shtetin, në çdo aspekt ka evoluim dhe çdo periudhë kohore ka zhvillimet e saj që i referohen organizimit, konceptit dhe reformimit të shtetit. E rëndësishme për këtë është fakti se shteti ka qenë dhe është kategori dinamike, ku në fillim ishte krejt ndryshe në çdo aspekt, ndërsa sot është më ndryshe. Kur i referohemi ndryshimeve kemi parasysh, formave të qeverisjes, territorit, sovranitetit, njësive përbërëse, pushtetin e shume elemente tjera që janë të ndryshme. Ky fakt e benë që shteti të përkufizohet në forma të ndryshme duke pasur për bazë disa elemente e të cilat janë determinues për shtetin dhe funksionimin e ti.

2.Koncepti i shtetit, nocioni dhe zhvillimet konceptuale

Evoluimi i shtetit nga fillimi qe i referohet periudhave te hershme historike dhe gjer ne ditët e sotme, ka pasur këndvështrime te ndryshme sa i përket themelimit, funksionimit dhe synimeve për shtetin. Këndvështrimet e ndryshme kanë ardhur nga mbretër, shkencëtar, filozof, sociolog dhe prijës fetar të cilët kanë pasur mendimet e tyre për konceptin e shtetit e te cilat janë të ndryshme njëra prej tjetrës. Ekziston koncepti se shteti është një institucion që posedon monopolin e dhunës së ligjshme fizike, kuptimi i këtij koncepti nuk është që shteti të përdor dhunën fizike çdo ditë ndaj njerëzve, por e ka si një mekanizëm ndaj atyre që nuk respektojnë rregullat e përbashkëta që janë të përcaktuara për rregullimin shoqëror.⁸ Në fillimet e formimit dhe funksionimit, shtetet janë identifikuar si mekanizëm i cili pas vetes ka aparatit e dhunës dhe si instrument e përdor për trajtimin e mendimeve ndryshe për shtetin dhe veprimet qe ka ndërmarr shteti. Mirëpo edhe ky koncept i mekanizmit te dhunës ka ndryshuar dhe reformuar gjer tek koncepti i sotëm që e përjashton konceptin e përdorimit të aparatit të dhunës nga shteti si mekanizëm qeverisës dhe udhëheqës. Ndryshimi i mekanizmit të kompetencës së shtetit ndaj aparatit të dhunës është në koherencë me ndryshimet shoqërore nga këndvështrimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, ku këto të drejta gjejnë zbatim nga shtetet, prandaj edhe aparati i dhunës është ndryshuar dhe gjen zbatim atëherë kur nuk cenohen të drejtat e njeriut si vlera universale të botës

⁷ Po aty, shih Fq.19

⁸ Po aty, shih Fq.19

demokratike, por mbrohen vlerat të cilat shoqëria në atë shtet i ka përcaktuar përmes vendosjes së rregullave dhe në rast të shkeljes së tyre ato të mbrohen nga aparati i dhunës si mekanizëm mbrojtës i shtetit.

Varësisht nga forma e qeverisjes kanë ekzistuar edhe konceptet për shtetin, tjetër koncept ekziston për shtetin kur shtetet janë udhëhequr nga monarkët, mbretërit, udhëheqësit diktator dhe tani udhëheqje demokratike nga parimi i pluralizmit partiak. Forma e qeverisjes së shtetit është e ndërlidhur me orientimin e shtetit, kjo pasi nga forma e qeverisjes vërehen se cilat janë vlerat e atij shteti dhe orientimin që ka. Nëse kemi të bëjmë me një shtet me monarki absolute, çdo gjë është e koncentruar tek një njeri i cili nuk e ka për bazë gjate veprimeve të tij vullnetin e popullit që është baza e funksionimit dhe zhvillimit të shtetit. Tek kjo formë çdo gjë është si mendon një njeri që në çdo aspekt është jo parimore dhe zhvillimore, pasi po mohohet mendimi ndryshe i cili mundëson zhvillim dhe mirëqenie. Kur ju referohemi shteteve me orientim të qeverisjes me sistem pluralist, kemi të bëjmë me një shtet i cili merr për bazë mendimin e popullit i cili është përcaktues pasi në vendimmarrje është zëri i tij i cili i mundëson të vendos për atë që donë dhe mendon përmes mekanizmit të votës. Pra mund të themi se është me shumë rëndësi forma e qeverisjes qfare ka shteti pasi kjo determinon orientimin dhe zhvillimin e vendit. Duke rrugëtuar në histori, koncepti për shtetin ka pësuar ndryshime të dukshme në aspektin konceptual dhe funksional, kjo dëshmohet me faktin se nga shtetet totalitare ku çdo gjë ka qene e koncentruar tek një grup i caktuar, sot kemi shtete demokratike që përmes mekanizmave përkatës, vendimmarrës është i mbar populli. Në shumicën e vendeve koncepti i qeverisjes është demokratike dhe shteti ka një ndryshim i cili është mekanizëm që funksionon mbi bazën e rregullave të cilat i vendos shoqëria përmes mekanizmave të përfaqësimit në institucione, po çdo here duke pasur parasysh vlerat universale, të drejtat e njeriut dhe krijimin e kushteve për një jetë sa më të mirë që mundëson mirëqenie. Sot koncepti i shtetit ka një ndryshim i cili i referohet çdo elementi të shtetit, duke filluar nga sovraniteti i cili tash më nuk është siç ka qene, për faktin se shtetet janë të hapura dhe i përkasin bashkësive, unioneve apo mekanizmave që ka bërë të jetë më i zbehur sovraniteti se sa ka qene ne të kaluarën kur shtetet nuk kanë qene të hapura ndaj njëra tjetrës dhe disa mekanizmave të përbashkët për siguri, ekonomi, bashkëpunim rajonal. Tani kemi një reformim të shtetit në çdo aspekt, qoftë nga aspekti i formës së qeverisjes, ku në shumë shtete të botës kemi sistem pluralist ku zëri i qytetarit dëgjohej dhe është vendimmarrës përmes mekanizmave që ai i ka fal besimin në proceset zgjedhore. Ndryshime kemi edhe në ndarjen e pushteteve ku kryesisht kemi një ndarje në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor e të cilat kontrollojnë njëra tjetrën duke kërkuar edhe raportime dhe llogaridhënie. Format e qeverisjes për shtete janë të ndryshme, nga sistemet totalitare, kemi një kalim të madh në atë demokratike në të cilat vendimmarrës është qytetari përmes mekanizmave të përfaqësimit, ku qytetari ka një lidhmëni dhe raport kontraktues me shtetin i cili ka të drejta dhe

obligime të cilat janë të përcaktuara me akte juridike të shtetit. Konceptet për shtetin janë të ndryshme, prandaj bazohen në ideologji, filozofi, shkenca sociale, fe, zhvillim ekonomik, orientim gjeo strategjik etj. Pavarësisht koncepteve për shtetin, ky duhet ndarë nga ato që i takojnë historisë dhe ato që janë për ditët e sotme. Ato që i përkasin të së kaluarës, mund të vlerësohen për nga aspekti funksional të tyre dhe mbi këtë bazë të nxjerrët një konstatim se sa kanë qenë funksionale dhe cilat ishin të metat. Ndërsa ato që i referohen gjendjes aktuale, kryesisht duhet të jenë në funksion të avancimit, zhvillimit dhe prosperitetit të shtetit i cili ju siguron të gjithë njerëzve që jetojnë në të kenë një mirëqenie siç i takon njerëzve si qeneje më e përsosur e natyrës.

3.Funksioni i shtetit

Organizimi shoqëror përmes shtetit u konsiderua si një mundësi që jeta e njerëzve të jete e organizuar në çdo sferë të jetës dhe brenda saj të ketë një organizim të mirëfilltë ku do të jenë të qarta. Përmes organizimit shtetëror shoqëria ishte me e organizuar si për çështjen e mbrojtjes nga shtetet tjera, organizimin e punës, prodhimit etj. I gjithë organizimi në kuadër të shtetit është i bazuar në rregulla dhe norma të cilat shoqëria përmes mekanizmave shtetëror i ka përcaktuar që të bëjë organizimin e jetës dhe të rregullojë raportet e tyre ekonomike, juridike, sociale, etj. Nder funksionet bazë të shtetit është ndërtimi i sistemit juridik mbi të cilin do të organizohej jeta në kuadër të një shteti nga ana e njerëzve. Ndërtimi i sistemit juridik realizohet nga mekanizmat e shtetit përmes nxjerrjes dhe aprovimit të ligjeve, të cilat do të mbulohen fusha të caktuara në kuadër të sistemit juridik të shtetit me të cilat rregullohen raportet shoqërore por nga karakteri ekonomik, juridik dhe social. Ky funksion i shtetit përmes mekanizmit të vet të legjislativit është funksioni bazë dhe themelor për shtet të së drejtës.

Në kuadër të funksionit të shtetit nuk përfundon mandati vetëm me ndërtimin e sistemit juridik, kjo është njëra ndër funksionet dhe përgjegjësit. Në kuadër të funksionit të shtetit e rëndësishme është funksioni i zbatimit të sistemit juridik përmes së cilit kemi drejtësi, barazi dhe mbrojtje të drejtave të njeriut si vlera universale të botes demokratike. Ndër funksionet bazë të shtetit është pushteti që përmes ti e imponon zbatimin e së drejtës ku realizohet rregullimi i raporteve njerëzore. Pra pushteti në kuadër të një shteti është një marrëdhënie në mes dy subjekteve-vullneteve në njërën anë shtetin dhe në njërën anë individin ku ky i fundit duhet të bindet urdhrat të shtetit për zbatim të së drejtës që mundëson zhvillim të jetës mbi bazën e vlerave të drejtësisë. Përmes zbatimit të së drejtës vije deri te funksionimi i shtetit konform rregullave dhe sistemit të vet juridik i cili ka për qëllim që të rregullojë raportet mes njerëzve.⁹

⁹ F. Berisha (2013) Hyrje në të Drejtën, Pejë. Fq. 56

Shteti në kuptimin e funksionimit dhe kompetencave që ka është kategori dinamike që nënkupton çdo herë është në zhvillim dhe reformim të vazhdueshëm me qëllim që të jete në hap me ndryshimet shoqërore e të cilat janë kategori dinamike. Me këtë kuptohet se edhe sistemi juridik në kuadër të shtetit është kategori dinamike i cili në çdo moment pëson ndryshime me qëllim të reformimit duke ju përshtatur ndryshimeve shoqërore, juridike, ekonomike dhe sociale. Pra reforma në sistemin juridik dhe atë legjislativ i referohet ndryshimit të gjendjes ekzistuese me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të asaj që ka për qëllim dhe obligim sistemi juridik i një vendi.¹⁰

Kur i referohemi funksionit, përgjegjësisë, kompetencës së shtetit, nuk mund të mos i atribuohen shtetit edhe përgjegjësia e lirive dhe të drejtat e njeriut për shtetasit e vet. Kjo për faktin se, shteti është ai i cili të drejtat e njeriut fillimisht i vlerëson dhe më pas veprimet e veta ndaj shtetasve të vet i bazon duke respektuar të drejtat e njeriut. Në bazë të ndarjes së të drejtave të njeriut në ato personale, politike, ekonomike – sociale dhe kulturore, shteti është ai mekanizmi që mundëson apo nuk mundëson që këto të drejta të njeriut të zen vendin e merituar. Nëse ju referohemi të drejtave personale, ato i referohen të gjitha fushave të mbrojtjes së integritetit fizik e personal të njeriut dhe të njëjtat është dashur kohë të fitohen dhe të avancohen për të qen sot ku janë. Dokumentet e para që ju referohen këtyre të drejtave janë Karta e Madhe e Lirive (1215), Habeas Corpus Act (1679) dhe Ligji mbi të Drejtat (1689)¹¹

Ndër të tjera, të drejtat Sociale – ekonomike dhe kulturore, brenda vetes kanë një të drejtë që është tejet me rëndësi dhe e njëjta është tejet me rëndësi në kuadër të funksionit të shtetit e ajo është E Drejta e Pronësisë. Nga e kaluara edhe sot prona private dhe e drejta e pronësisë kanë qenë hyjnore dhe janë trajtuar me një kujdes të shtuar. Fillimisht këto janë cekur në Deklaratën Frënge të lirive dhe të drejtave të njeriut e të shtetasit (1789). Një vlerësim tejet hyjnor për pronën private dhe të drejtat e pronës ishin deri pas luftës së Dytë Botërore, kur në shumë vende u instalua sistemi socialist i cili nuk e trajtoj në këtë mënyrë pronën private dhe të drejtën e pronësisë. Nga shtetet komuniste prona private u shtetëzua dhe qytetarëve ju mohua e drejta e pronësisë ku me këtë në të njëjtën kohë ju është mohuar dhe shkelur të drejtat e njeriut.¹²

Për sistemin juridik shteti ka funksionin që mbi një sitëm juridik të ndërtuar me vlera të bej ndryshimet e duhura me qëllim që sistemi juridik të jetë në hap me ndryshimet shoqërore dhe vlerat universale të botes demokratike. Shtetet që posedojnë traditë të qeverisje dhe kanë të ndërtuar një sistem juridik i cili ka një traditë e kanë shumë me lehtë të vine deri të ndryshimi dhe reformimi kjo për faktin se posedojnë një sitëm të çart juridik dhe të njëjtin kur ta reformojnë vetëm i bashkëlidhin ndryshimet e nevojshme pa pasur nevojë të kenë një ndryshim të tërësishëm mirëpo vetëm duke e përcjell

¹⁰ F. Berisha (2013) Hyrje në të Drejtën, Pejë. Fq. 46

¹¹ K.Salihu (2002) E Drejta Kushtetuese, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Botimi i trete. Fq. 134

¹² Po aty 145

kontinuitetin e ndryshimeve dhe reformimit. Funkzioni i shtetit është në shumë dimensione dhe mundëson që të mbaj aktiv të gjitha sistemet që përbejnë shtetin. Shteti në kuadër të funksionimit për sistemin juridik është tejet me rëndësi, për faktin se shteti është ai i cili mundëson që të krijohet sistemi juridik, të reformohet dhe të jete në funksion për sistemet tjera si ai ekonomik, social, integrues etj. Prandaj funksioni i shtetit është determinues për sistemin juridik në vend, pasi ky mundëson dhe garanton që të ketë sistem juridik, funksionim dhe reformim të sistemit juridik në shtet. Shteti është funksional nëse sistemin juridik e ka të ndërtuar dhe konsoliduar nga i cili varet zhvillimi i raporteve njerëzore të cilat janë të rregulluara dhe të parapara në kuadër të sistemit juridik të vendit. Sistemi juridik i shtetit është mekanizmi që mban dhe krijon lidhmëni e qytetarit me shtetin, pasi kjo mundëson që të krijon të drejtat dhe detyrimet për çdo qytetar i cili më pas i mundësohet që të zhvilloj jetën konform rregullave dhe raportet e tyre të jenë të rregulluara duke eliminuar mbizotërimin e vullnetit të individit apo të një grupi.

Shteti ka shumë funksione në kuadër të fushëveprimtaris së ti, kjo pasi është kupola e çdo fushe që zhvillohet në shtet, përpos funksionit ekonomik, mbrojtës, juridik etj, shteti ka edhe një funksion që është tejet me rëndësi ai i krijimit të sistemit juridik si një mekanizëm që i mundëson shtetit të ekzistoj, funksionoj, mbijetoj dhe jetën të zhvilloj konform rregullave që i ka vendosur për rregullimin e marrëdhënieve të qytetarëve të ti. Prandaj është sistemi juridik ai mekanizmi i vetëm në shtet i cili fillimisht ndërtohet, zhvillohet, reformohet mbi bazën e vullnetit të qytetarëve të vet e i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët ndaj njëri tjetrit dhe ato që kanë ndaj shtetit si mekanizëm që është në funksion të qytetarëve të vet. Në kuadër të sistemit juridik kemi katin më të lart të shtetit Kushtetutën e cila në vija të trasha përcakton rregullat, të drejtat dhe obligimet e qytetarëve të ati shteti. Për tu konkretizuar me të drejta dhe detyrime në fusha të caktuara është legjislacioni i cili përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet janë të bazuara në vullnetin e qytetarëve të cilët përmes mekanizmave përkatës arrin që të hartojnë dhe miratojnë legjislacionin i cili përcakton rregullat për të drejta dhe detyrime e të cilat mundësojnë një jete mes njerëzve duke i rregulluar marrëdhëniet e tyre. Duke qenë në shumë funksione, shteti arrin që të jetë edhe një koordinator i të gjitha fushave dhe mekanizmave të vetë, pa të cilin nuk do jen në mundësi të funksionimit. Ndër shumë funksione, shteti ka edhe atë të krijimit, zbatimit të së drejtës që derivon nga sistemi juridik i vendit dhe mundëson një jetë që është në funksion të krijimit të mirëqenies. Pa tendencë të nënvlerësimit, funksioni i krijimit të sistemit juridik është funksioni më i rëndësishëm për faktin se të gjitha fushat tjera varen nga themelimi, funksioni dhe serioziteti i sistemit juridik të shtetit. Ajo që i atribuohet shtetit që është sistemi juridik në të cilin përpos rregullave tjera bëjnë pjesë edhe legjislacioni i së drejtës Civile i cili përcakton rregulla, me të cilat rregullohen, kufizohen, mbrohen marrëdhëniet juridiko civile në një shtet. Nëse shikohen nga aspekti i përqindjes, marrëdhëniet juridiko civile janë

marrëdhëniet që më së shumti qytetarët janë aktiv, për faktin se çdo ditë qytetari është në një raport shoqëror me karakter nga marrëdhëniet juridiko civile. Në kuadër të funksioneve të shtetit kemi edhe krijimin, avancimin e legjislacionit të së drejtës civile si njësi përbërëse e sistemit juridik që duhet çdo herë të jetë në harmoni me sistemin juridik të shtetit. Shteti përmes mekanizmave të vetë, ku çdo herë është përfaqësuar qytetari duke krijuar, avancuar sistemin juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile arrin që të krijoj të drejtën përmes së cilës kemi mbrojtje, avancim të së drejtave të qytetarëve për të drejtat e tyre edhe ato nga marrëdhëniet juridiko civile.

Për të kryer funksionin e vet, shteti duhet që të ketë organet dhe mekanizmat e vete që i sigurojnë mbrojtje, zhvillim, avancim, integrim me qëllim të funksionimit të shtetit në interes të mirëqenies së qytetarit. Organet e shtetit për të qen në funksion dhe mandat që posedojnë, nxjerrin norma juridike me të cilat rregullohen raportet shoqërore në fusha të ndryshme, përpos kësaj kujdesen edhe për zbatimin e tyre. Pra mekanizmat përkatës shtetëror, kanë në mandat nxjerrjen e normave dhe zbatimin e tyre dhe përmes kësaj sigurohet shteti i së drejtës që është në funksion të qytetarëve të vendit.¹³

4.Shteti dhe e drejta, lidhja e përbashkët dhe dallimet

Në periudhën kur shoqëritë nuk ishin të organizuara në formën e Shtetit, formën e udhëheqjes dhe rregullimit kryesisht e kishin të bartur tek një njëri i cili kishte pushtet absolut në planifikim dhe realizim të qeverisjes dhe vendimmarrjes absolute. Tek individët tek të cilët ishte përqendruar pushteti absolut ishin prezent të gjitha funksionet duke filluar nga ajo që nxjerrjes së normave, aparatit të zbatimit të tyre dhe gjykimin për mos zbatim të tyre duke shqiptuar sanksione nga më të ndryshmet varësisht se çfarë ka vendosur një njëri që ka pasur pushtet absolute. Nga kjo shifte se e drejta ka buruar të pushteti absolut i një individi e cila mund të kualifikohet si subjektive duke mos qene e bazuar në vullnetin e shumicës dhe i gërshetuar me vlerat e të drejtave të njeriut si vlera universale të botes demokratike siç janë tani ku i kanë parasysh të drejtat dhe lirit e njeriut. Tek ato shtete ku pushteti është i koncentruar tek një njëri apo grup i vogël, nuk mund të ketë veprime që kanë për bazë lirit dhe të drejtat e njeriut, për faktin se këto shtete nuk i njohin këto të drejta si vlera që pushteti duhet të ushtrohet duke pas për bazë edhe këto vlera të botes demokratike. Fatkeqësia e këtyre shteteve është se këto janë shkelësit më të mëdhenj të drejtave të njeriut dhe kjo mundëson që të shkelen shumë vlera që i përkasin botes demokratike. Ndërsa tek shtetet që formën e qeverisjes e kanë demokratike dhe mbi bazën e ndarjes së pushteteve, në veprimet e tyre merren për bazë parimet e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut si vlera universale që i ka përcaktuar bota demokratike. Lirit dhe të drejtat e njeriut

¹³ K.Salihi (2002) E Drejta Kushtetuese, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Botimi i trete. Fq. 225

janë parime dhe rregulla që i pamundësojnë individit, grupit të njerëzve apo vet mekanizmit të shtetit që të ketë në diskrecion dhe të veproj qfar do te ketë dëshirë, pasi një gjet të tillë ja pamundësojnë direktivat dhe mekanizmat tjerë që i kane te përcaktuara lirit dhe të drejtat e njeriut.

Me organizimin e shtetit në të cilat kemi koncentrimin e madh të pushtetit sovran filloj edhe një çështje shumë e rëndësishme siç ishte ajo e shtetëzimit të së drejtës pra filloj që të drejtës ti jepet karakteri shtetëror. Kjo formë është forma e shtetit – rend e cila është në fazën e hapave te pare te zhvillimit ku formohej një numër i vogël i ligjeve. Marrëdhëniet shoqërore në shekullin 18 kishin një nënshtrim të madh ndaj të drejtës me karakter politik të përgatitura nga organi legjislativ, një fillim ishte në Francë me nxjerrjen e Kodeve të Napolonit si ai penal, civil dhe tregtar.¹⁴

Me shtetëzimin e së drejtës kemi një fuqizim të së drejtës, pasi kjo tani më është një e drejtë që buron nga vullneti i popullit përmes mekanizmave të shtetit siç është parlamenti apo organet tjera ku përmes vullnetit te popullit vendoset për krijimin e normave dhe sistemit juridik gjë që është pozitive dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. E rëndësishme të ceket është edhe fakti se tani kemi një epërsi të së drejtës mbi shtetin, pra ky është parimi i shtetit të së drejtës, sipas këtij parimi edhe vet shteti i nënshtrohet së drejtës. Faza kur shteti është fuqizuar dhe ka mandatin e qeverisjes kemi zhvleftësim te individëve që në fillim kishin marr mandatin e qeverisjes dhe pushteti ishte i koncentruar tek një individ. Me formën e qeverisjes nga monarkitë absolutë është vërejtur se forma e qeverisjes dhe udhëheqja kanë qen te bazuara vetëm në mendjen e një njeriu nga e cila ka buruar edhe e drejta dhe zbatimi i saj e që nuk kanë qen të mira dhe të përshtatshme për faktin se çdo gjë ka buruar nga mendja e një njeriu dhe vlerat e shoqërisë dhe ato të drejtave dhe lirive të njeriut nuk janë respektuar as pak.

Ne çdo moment shteti kishte një ndryshim dhe reformim brenda vetes, pasi është dukuri shoqërore dhe një gjë e tillë është e nevojshme dhe e natyrshme. Shekulli 19, ishte periudhë kur kemi pasur momentin që e drejta ka marr karakterin shtetëror pra është shtetëzuar për një rregullim të shoqërive. Kjo është realizuar përmes Kodeve dhe Ligjeve te përgatitura dhe nxjerrura nga segmentet përkatëse të shtetit duke respektuar procedurat e hartimit, konsultimit. Kjo periudhë karakterizohet edhe me konstruktimin e shtetit të së drejtës e cila kryesisht është realizuar me Kushtetutë.¹⁵

E drejta e mirëfilltë, nuk mund te kualifikohet ajo e drejte qe nuk ka lidhmëni reciproke me shtetin dhe buron nga vullneti i popullit përmes mekanizmave te shtetit siç janë ai legjislativ dhe ai i zbatimit gjyqësori. Pra e drejta është në lidhmëni me shtetin dhe historia e së drejtës ndërlihet me shtetin dhe funksionimin e tij. Andaj nga kjo ne kemi te njohur një fakt se e drejta buron nga shteti dhe funksionon

¹⁴ F. Galgano (2006) E Drejta Private, Tiranë. Fq. 38

¹⁵ F. Galgano (2006) E Drejta Private, Tiranë. Fq. 39

ne bazë të kushteve dhe rregullave të shtetit, nuk mund të ketë të drejtë pa shtet dhe nuk mund të ketë shtet pa të drejtë. Kjo lidhmëni është e natyrshme dhe funksionale pasi kjo është dëshmuar tek shtetet që kanë një stabilitet dhe sistem të së drejtës funksionale. Kuptimi i kësaj nuk është si në të kaluarën kur shtetin ka udhëhequr një njeri dhe shteti është nënkuptuar fuqia e atij njeriu që ka udhëhequr shtetin. Po kjo formë është se shteti është mekanizmi i cili mundëson planifikimin, realizimin, avancimin, kordinimin dhe llogaridhënien për sistemin juridik, çdo here në lidhmëni të ngushtë me vlerat njerëzore dhe ato të drejtave të njeriut, si mekanizma që mundësojnë barazi, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi dhe atë që është tejet me rëndësi ndarjen e pushteteve brenda shtetit në atë të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit nën parimin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies reciproke. Me zhvillimin e shoqërisë ishte e nevojshme që jeta mes tyre të zhvillohet mbi bazën e disa rregullave dhe normave ashtu siç kërkon prej tij, shoqëria e organizuar me normat që vetë i ka përcaktuar. Normat më të rëndësishme që i kanë takuar rregullimit të jetës së shoqërisë janë normat zakonore, normat e moralit dhe normat e juridike. Shoqëria në fillimet e saja për rregullimin e raporteve mes tyre kishte filluar me normat zakonore, ndërsa ato të moralit varësisht karakteristikave shoqërore ishin prezent të çdo shoqëri dhe në fund me zhvillimin dhe avancimin e shoqërisë kemi normat juridike e të cilat janë të një vlere të madhe për faktin se burojnë nga vullneti i popullit përmes mekanizmave shtetëror të cilët përfaqësojnë vullnetin e popullit.

E drejta, shteti dhe rendi shoqëror kur trajtohen nuk mund të ndahen dhe të trajtohen ndarasi, për faktin se kanë lidhmëni funksionale, përmbajtjesore, mes vete. Prandaj duke e trajtuar të drejtën, ne jemi duke e trajtuar edhe rendin shoqëror si një mekanizëm që vet shoqëria prodhon, por nuk mund të anashkalohet as shteti si një kupoll e së drejtës, rendit shoqëror, marrëdhënieve shoqërore të cilat janë në kuadër të shtetit. Duke pasur për bazë se e drejta krijohet nga shoqëria për shoqërinë, nuk mund të mos ketë e drejta elemente thelbësore të rendit shoqëror.

Në ato shtete në të cilin shoqëria në kuadër të organizimit të jetës inkorporon rregulla, parime, fetare, e drejta është me bazë fetare sic është e drejta myslimane, hindu. Në këtë rast e drejta është derivat i rendit shoqëror i cili është i bazuar në fe dhe i njëjti reflekton në të drejtën dhe mënyrën e ndërtimit, zbatimit, monitorimit të saj. Përpos kësaj, ekzistojnë vende që rendi i tyre shoqëror, individi është në qendër të shoqërisë dhe në këtë rast krijohet e drejta individuale që janë të drejtat perëndimore.¹⁶

Mbi bazën e përsëritjes dhe aplikimit të vazhdueshëm të normave zakonore për rregullimin e sjelljeve në shoqëri u krijuan dhe i mbijetuan për kohë të gjatë normat zakonore. Është aplikimi i vazhdueshëm që i ka bërë pjesë të shoqërisë për rregullimin e raporteve të tyre shoqërore normat zakonore edhe për

¹⁶ .M.Fromont (2009)Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës, Tiranë. Fq.11.

kundër faktit se janë norma shumë të vjetra edhe gjatë ditëve të sotme në disa shtete janë prezentë dhe aktive si p.sh në Britaninë e Madhe. E drejta zakonore në vete bart disa karakteristika që e bëjnë të veçante duke filluar nga vjetërsia e tyre ku prezentë i kemi pasur në shoqëritë primitive, skllavopronare e tutje dhe mbijetesa për gjatë kohës duke gjet edhe zbatim. Kjo e drejt është shumë e lidhur me shoqërinë, kjo pasi ka buruar nga vetë shoqëria dhe adaptimi i tyre është bërë nga vullneti i shoqërisë duke u konsideruar si me vlerë dhe tejet me rëndësi për zhvillimin e jetës së tyre. Veçori tejet e rëndësishme është edhe ndikimi i tyre në zhvillimin e tregtisë ku edhe sot i kemi prezent doket e mira afariste të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në tregtinë dhe të drejtën ndërkombëtare tregtare.¹⁷ Ajo që shihet te normat zakonore është organizimi i shoqërisë edhe pse pa organizim shtetëror kanë arrit të krijojnë normat zakonore përmes së cilave të krijojnë një rend shoqërorë të cilin duhet respektuar shoqëria për të pasur një jetë normale. Me këtë vije në shprehje vedija e njeriut që është e ati niveli të lartë që jetën e tij në kuadër të një shoqërie dëshiron ta bazoj në rregulla e të cilat do ti mundësonin të sillte sipas rregullave shoqërore. Edhe tani normat juridike kanë lidhmëni me normat zakonore dhe ato të moralit që i kanë takuar të së kaluarës, pasi me një modifikim dhe përshtatje të rrethanave të reja shoqërore janë konvertuar në norma juridike dhe sot i përkasin sistemit juridik të shtetit. Konvertimi dhe marrja për bazë e normave zakonore është një historiat dhe kjo e ndihmon që të kemi një sistem juridik të bazuar në vlera, pasi kjo mundëson që të ketë bartje te vullnetit të popullit për rregullimin e çështjeve nga sistemi i vete rregullimit në atë të sistemit juridik.

Përpos normave zakonore shoqëria i kishte të zhvilluara dhe ishin aktive edhe normat e moralit, mbi të cilat e kanë bazuar rregullimin jetësor dhe rregullimin e raporteve shoqërore. Morali është një botëkuptim i shoqërisë i cili ndryshon konform periudhës kohore, lokacionit dhe zhvillimit të shoqërisë. Shoqëria përmes moralit kishte përcaktuar se cilat janë veprimet e mira dhe cilat janë ato të këqija. Andaj përmes normave të moralit për ato çështje që konsiderohen të mira urdhërohet që të behën dhe zbatohen, ndërsa për ato që shoqëria i ndalon janë të përcaktuara si të këqija.¹⁸ Këto norma krijohen mbi bazën e perceptimit, traditës, kulturës dhe fesë se shoqërisë dhe janë dinamike duke ndryshuar në vazhdimësi. Shoqëria bene zbatimin e tyre jo pse ka parasysh sanksionet që mund ta godasin shoqërinë, por nuk dëshirojnë që të identifikohen si shkelës i normave të moralit pasi këto norma konsiderohen si vlera të shoqërisë. Edhe normat zakonore dhe ato të moralit kualifikohen tejet të rëndësishme në ekonomi, tregti dhe raporte kontraktuese pasi shoqëria kur hyn në këto raporte ka parasysh dhe i nënshtrohet etikës shoqërore.

¹⁷ M. Hetemi (2002) E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë. Fq. 22 - 23

¹⁸ M. Hetemi (2002) E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë. Fq. 24

Duke u bazuar në zhvillimin e shoqërisë dhe shtetit në përgjithësi, shumë të nevojshme dhe të rëndësishme janë normat juridike. Mbi bazën e nevojës dhe analizës paraprake shteti për çdo fushë të jetës përmes mekanizmave shtetëror nxjerr normat juridike përmes së cilave pretendon të rregulloj marrëdhëniet shoqërore. Norma juridike është njësi përbërëse dhe funksionale e të drejtës, pasi e drejta përbehet nga normat juridike dhe përmes tyre arrijnë tek rregullimi i fushave që e përbejnë jetën dhe veprimtarin e shoqërisë. Në kuptimin juridik e drejta është një grumbull i normave juridike, ndërsa në kuptimin politik është vullneti i klasës politike e cila realizohet përmes mekanizmave shtetëror të nxjerrjes dhe zbatimit të së drejtës.¹⁹

Forma dhe cilësia e së drejtës çdo herë ka qenë e ndërlidhur drejtpërdrejt me sistemin politik dhe qeverisës të vendit. Si mund të deshifrohet kjo, në periudhën kohore kur udhëheqjen dhe idenë e shtetit e kishte vetëm një njeri në sistemin monarkist, e drejta me të vërtetë ka buruar nga ky udhëheqës dhe është zbatuar në emër të tij dhe në këtë situatë nuk ka pasur vullnet të popullit për formën dhe cilësinë e së drejtës, pasi populli vetëm është dashur ta zbatojë për ndryshe kanë pasur sanksionet gjer edhe me marrje jete. Me avancimin e sistemit politik dhe qeverisës nga ai i monarkisë në shtete që rregullimin shtetëror e kishin të bazuar në ideologjitë e asaj kohe si ajo komuniste, socialiste përsëri nuk ka arritur në shprehje vullneti i popullit edhe pse ka pasur një avancim por jo i mjaftueshëm që populli të vendos për rregullimin e raporteve të saja shoqërore. Në sistemin politik ku shteti ishte në qendër të vëmendjes dhe çdo gjë kontrollonte edhe e drejta buronte dhe zbatohet nga shteti, përkatësisht ideologjia partiake që ishte në atë shtet. Disa autorë e kualifikojnë që e drejta ka qenë një instrument për udhëheqje nga klasa sunduese që ka qenë pakicë ndaj atyre që kanë qenë nën sundim e kanë qenë shumicë. “E Drejta në esencë është vullneti i klasës sunduese e cila e ka fituar fizionominë e së drejtës nga vetë shteti dhe i shërben atij që atë ta aplikojë ndaj klasës eksploatuese”.²⁰ Kjo formë e së drejtës nuk ka përbe asnjë element të së drejtës, pasi për çka do të jetë e drejtë ka vendosur një njëri apo grup i vogël i njerëzve dhe kryesisht kjo formë e së drejtës i ka shërbyer asaj klase politike për qëndrueshmëri në pushtet duke eliminuar mundësinë e ndryshimit përmes pakënaqësive të qytetarëve për cilësinë e qeverisjes dhe udhëheqjes.

E drejta në të kaluarën ka qenë në harmoni të plotë me sistemin politik të vendit dhe kryesisht është krijuar dhe zbatuar e drejta konform rregullave dhe parimeve politike të asaj kohe, të ndërtuara mbi ideologjitë politike. Në këtë periudhë kohore tek shtetet nuk kemi pasur një ndarje të pushteteve ashtu siç është parim dhe më pas me qene funksionale, por çdo gjë ka qenë e koncentruar te shteti i cili ka

¹⁹ M. Hetemi (2002) E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë. Fq. 25 - 26

²⁰ Po aty, shih Fq.25

kontrolluar dhe planifikuar çdo gjen në raport me rregullimin e raporteve shoqërore në çdo fushë të jetës. Kjo formë e së drejtës ka qenë nën shërbim të përgjithshëm të sistemit politik, i cili ka vepruar më së paku mbi bazën e parimeve të së drejtës, po çdo here mbi bazën e ideologjive, parimeve partiake, tekeve individuale. Kjo formë ka qenë e natyrshme për faktin se nuk ka pasur ndarje të pushtetit, ku njëri tjetrin do të kontrollonin dhe nuk do vendoste individ, po vullneti i popullit siç është sot.

Me ndryshimin e sistemeve politike dhe formës së qeverisjes në shtete është vërejtur edhe tek e drejta dhe cilësia e saj karshi qytetarit. Ndryshimet e sistemeve politike nga ato totalitare, monarkiste, komuniste tek sistemi demokratik dhe liberal, qytetari ishte në qendër të vëmendjes dhe ishte ai që ishte pjesëmarrës në vendimmarrje ku vendos për fatin e ti dhe mënyrën se si do ta zhvilloj jetën. Tani e drejta ka një kuptim tjetër dhe një cilësi tjetër e cila i atribuohet vlerave më të larta universale dhe shoqërore të cilat janë të inkorporuara në kuadër të së drejtës. Tani kemi faktin se e drejta buron nga populli i cili përmes mekanizmave shtetëror vendos për të drejtën se si do të duhej të jetë që jeta e qytetarit të jete e bazuar në rregulla ku i përcaktohen të drejtat dhe detyrimet me qellim që të kenë një mirëqenje sa ma e mirë dhe e sigurve. Në këtë periudhë kohore të drejtën e kemi në harmoni të plotë me të drejtat e njeriut si një segment shumë i rëndësishëm në funksionimin dhe efikasitetin e drejtësisë, pasi të drejtat e njeriut ofrojnë një bazë ku njeriun e mbrojnë nga abuzimet dhe diskriminimet e individit dhe grupeve të caktuara vetëm pse posedojnë forcën. Komponent tjetër shumë e rëndësishme është edhe fakti se në shtetet me sistem politik liberal dhe demokratik kemi ndarjen e pushteteve dhe kontrollimin reciprok të tyre. Me këtë kemi gjendjen kur e drejta nuk kontrollohet nga pushteti i legjislativit apo ekzekutivit mirëpo pushteti gjyqësor udhëheqë dhe jep llogari për vete veten tek dy pushtetet tjera dhe anasjelltas. Edhe ky fakt të ndarja e pushteteve është tejet e rëndësishme pasi me të drejtën nuk mund të abuzohet ndaj një grupi për qëllime të liga, por e drejta është në shërbim të rregullimit të raporteve shoqërore me karakter juridik dhe mbrojtjen e individit nga veprimet që atë do të cenonin jetën, pronën dhe të ardhmen.

Të Drejtën nga shteti nuk mund ta ndash në atë masë sa të kualifikohen se nuk kanë as një lidhmëni mes tyre, kjo pasi e drejta buron nga shteti përmes mekanizmave të tij por jo duke qene në funksion të politikës apo individit. E drejta është pjesa e shtetit që mundëson në shtet të ketë rend, rregull dhe funksionim të fushave të jetës sipas rregullave që vetë shoqëria i ka përcaktuar përmes mekanizmave të sajë.

Ajo që mund të kualifikohet si dallim mes së drejtës dhe shtetit nga e kaluar dhe sot është fakti se, sot shteti nuk është abuziv në përcaktimin e së drejtës dhe zbatimin e saj për qellim të dëmtimit të individit apo një grupit caktuar të shoqërisë pse ata kanë mendim me ndryshe ndaj pushtetit për cilësinë e

qeverisjes. Sot sistemi i drejtësisë është pushteti i tretë që është në funksion të ndërtimit të shtetit të së drejtës nga i cili përfitojnë të gjithë qytetarët e një shteti pa dallime. Një formë të tillë e kemi tek shumë shtete të cilat sistemin politik e kanë demokrat dhe liberal, për dallim nga ato që kanë sistemin diktatorial edhe pse nuk janë shumë në numër, e në të cilat ende sistemi juridik është në funksion të një individi. Është e natyrshme që e drejta nuk mund të funksionoj jashtë orbitës së mekanizmave të shtetit, po është me rëndësi që të funksionoj brenda shtetit po të jetë i pavarur dhe konform dispozitave të legjislacionit përkatës në fuqi i cili përben sistemin juridik të vendit. Në funksionimin e mirëfilltë të së drejtës është me rëndësi që fillimisht të kemi ndarje të pushtetit dhe kjo të veproj sipas parimit të kontrollit të njëri tjetrit të pushteteve. Kjo mundëson që të ketë drejtësi, llogaridhënie dhe kontroll nga e cila mundësohet të ketë sistem të ndërtuar mbi vlera dhe vullnet të popullit.

Për as një moment nuk mund të kualifikohen si të ndara shteti prej së drejtës, kjo për faktin se e drejta buron nga populli i cili është i përfaqësuar në mekanizmat e shtetit të cilët janë të ndarë duke pas për bazë ndarjen e pushteteve dhe formës së qeverisjes. Po as të bashkuar nuk mund të kualifikohen, pasi krijimi i sistemit juridik mundëson që të krijohet e drejta dhe kjo të jetë në funksion të rregullimit të raporteve njerëzore me karakter juridik, social, ekonomik, arsimor etj. Pra për të drejtën mund të konstatohet se është mekanizmi që është brenda shtetit po është në funksion të zhvillimit të disa raporteve njerëzore të përcaktuara konform rregullave që janë pjesë e sistemit juridik në vend. Nuk mund të ketë të drejtë pa shtetin, po nuk mund të ketë shtet dhe funksionim të tij pa pasur mekanizmin e së drejtës e cila mundëson krijimin e shtetit të së drejtës i cili i atribuohet vlerave universale dhe atyre të së drejtës.

5.Sistemi juridik ne kuader te shtetit dhe roli i tij

Kur flitet për shtetin kemi parasysh çdo herë sistemin juridik si njëri ndër mekanizmat më të rëndësishëm që ka shteti, për faktin se këto janë te pandara mes vete dhe funksionimi i njërës varet nga funksionimi reciprok. Kur i referohemi sistemit juridik kemi parasysh se ky është planifikim dhe derivat i shtetit dhe krijohet që shteti të ketë mundësi të funksionoj konform tij duke qene në funksion të qytetarit. Nocioni ‘Sistem’ rrjedh nga fjala Greke ‘Sisteme’ që do të thotë përbërje pjesësh, apo bashkësi elementesh. Nga kjo na rrjedh mendimi se sistemi i së drejtës është bashkësi të ndryshme të elementeve të tërësisë. Përmes sistemit juridik kemi sistematizim dhe ndarje të normave juridike që rregullojn fusha të caktuara të së drejtës.

Mbijetesën me te madhe në histori sa i përket të drejtave e kishte e Drejta Romake e cila arriti ti mbijetoj kohës për shumë shekuj. Përpos mbijetesës e Drejta Romake ka arrit të kishte influencë edhe

në rendet e ndryshme juridike botërore. Influenca e të Drejtës Romake në sistemet e ndryshme juridike botërore ka bërë që sistemet juridike të kenë një pik referimi sa i përket orientimit të tyre dhe konceptit të përzgjedhur.²¹ Duke pasur për bazë faktin se sistemet juridike me orientim kontinental i kanë bazuar në të Drejtën Romake si një burim që është konsideruar dhe konsiderohet me vlera pasi është i ndërtuar në një perandori dhe ka arrit ti mbijetoj kohës me shekuj duke u bere edhe pik referimi edhe në ditët e sotme për shumë sisteme juridike të vendeve të ndryshme që janë të kualifikuara si shtete të së drejtës. Edhe sistemi kontinental i sotëm është i bazuar dhe ka burim të drejtën Romake, nga e cila janë marrë pjesë, institucione të cilat janë modifikuar konform ndryshimeve shoqërore, sociale dhe ekonomike.²² Ky fakt na ofron informacion se sistemet juridike që i përkasin sistemit kontinental burim dhe pikë referimi kanë të Drejtën Romake. Ky fakt i ndihmon edhe studiuesit edhe praktikuesit e së drejtës së ju ofron informacion se sistemi juridik të cilit i përkasin mbi cilin koncept dhe filozofi është i ndërtuar. Duke pasur pik referimi të Drejtën Romake, sistemet juridike konsiderohen se janë të ndërtuara mbi vlera të cilat i kanë mbijetuar kohës dhe janë vlerësuar se mbrojnë, avancojnë të drejtat e qytetarit karshi të drejtave që ai ka në raporte juridike.

Sistemi juridik është grumbullim dhe unitet i normave juridike të përgjithshme të një rendi juridik, duke paraqitur tërësinë unike dhe jo kontradiktorë të këtyre normave juridike. Kjo ofron kuptimin se sistemi juridik është një grumbullim, sistematizim dhe hiarki e normave juridike që janë në fuqi në kuadër të sistemit juridik të një vendi. Në kuptim të kësaj, sistemin juridik e përbejnë normat juridike të cilat kanë një sistematizim mes veti dhe një hiarki e të cilat janë në fuqi e të cilat rregulloj fusha të caktuara.²³

Sistemin juridike përbejnë faktorët e brendshëm dhe ata të jashtëm e të cilët janë faktor tejet të rëndësishëm. Kur ju referohemi atyre të brendshëm kemi te bëjmë me strukturën e brendshme, sistemimin e normave, hiarkin e tyre ku një bashkësi e tillë na derivon sistemin juridik. Ndërsa kur i referohemi atyre të jashtëm kemi parasysh se është njëri ndër më të rëndësishmit për faktin se kemi të bëjmë më realizimin e sjelljeve të njerëzve në bazë të atyre normave juridike të cilat janë të sistemuara, ndara e të cilat prodhojnë efekt juridik. Nga kjo vërehet se elementet e jashtme dhe ato të brendshme të sistemit juridik kanë një lidhmëni mes vete dhe sistemi juridik është mekanizëm përmes së cilit arrihet të materializohet e drejta duke u zbatuar nga njerëzit me qellim të rregullimit te raporteve të tyre. Çdo herë qëllimi i sistemit juridik është që përmes normave të saj të zbatohet e drejta dhe te arrin efektin për të cilin është krijuar.²⁴

²¹ B. Rexhepi & B. Selmani (2014) E Drejta Romake ndikimi isaj ne sistemet e se drejtës bashkëkohore, Ferizaj. Fq. 68

²² K. Kryeziu (2017) E Drejta Romake, Prizren Fq. 19

²³ F. Berisha (2013) Hyrje në të Drejtën, Pejë. Fq. 309

²⁴ Po aty, shih Fq. 310

Sistemi juridik është vullneti përmes së cilit identifikohen raportet shoqërore të cilat janë të nevojshme të rregullohen me norma konkrete që të njëjtat të jene të zbatuara nga të gjithë kur kanë të bëjnë me raporte shoqërore që sistemi juridik përmes normave konkrete i ka rregulluar. Respektimi i normave juridike e mundëson që të respektohet sistemi juridik i vendit dhe të kemi shtet të së drejtës ku raportet njerëzore rregullohen me norma juridike konkrete, ku mundësohet eliminimi i pabarazisë, shkeljeve të drejtave të njeriut dhe krijimi i sigurisë juridike për të drejtat e qytetarëve të atij shteti.

Duke pasur parasysh faktin se sistemi juridik është diçka e madhe dhe abstrakte është e natyrshme që këtë e përbejnë elementet të cilat janë pjesë konstituive. Në kuadër të elementeve që e përbejnë sistemin juridik është Institucioni apo Instituti Juridik. Me këtë nënkuptohet grupimi apo tërësia e normave juridike që rregullojnë një raport të caktuar shoqëror. Kjo është njësi themelore dhe konstituive e sistemit juridik që merr pjesë aktive në ndërtimin dhe zhvillimin e sistemit juridik. Pas kësaj ndër elementet e sistemit juridik është dega Juridike. Kuptimi dhe funksioni i degës juridike është grumbullimi dhe sistematizimi i normave juridike përmes së cilave përcaktohen dhe rregullohen llojet e njëjta të marrëdhënieve shoqërore e të cilat kanë karakter të marrëdhënieve juridike. Degët juridike janë në funksion të ndërtimit dhe konstituimit të sistemit juridik të një vendi, i cili është pjesë dhe mundëson që të përbejë sistemin juridik të botës.²⁵

Kur i referohemi degëve të së drejtës të gjitha degët kanë rendësin e vet pasi përmes së cilave arrihet të jete e konstituime nga një fushë e caktuar përmes së cilave krijohet baza juridike për të rregulluar raporte shoqërore nga marrëdhëniet juridike. Kur ju referohemi degëve të së drejtës ne kemi parasysh se jemi duke folur për të Drejtën Kushtetuese, e Drejta Administrative, e Drejta Familjare, e Drejta Civile etj. Konform edhe temës që jemi duke trajtuar e Drejta Civile është ndër degët më të rëndësishme të sistemit juridik dhe më të vjetrat për faktin së përmes tyre arrihet të rregullohen marrëdhëniet njerëzore nga fusha e marrëdhënieve juridiko civile që në fund rezulton me karakterin pasurore juridik. Kur kësaj i shtojmë se raportet juridike me karakter pasuror janë në zhvillim e sipër çdo dit si rezultat i zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe social na rezulton se është nënë degët më të rëndësishme të së drejtës, për faktin se rregullon marrëdhëniet shoqërore më të rëndësishme që janë ato nga marrëdhëniet juridiko civile nga të cilat çdo here derivon aspekti pasurore juridik dhe për nga numri janë më të shumta se në raporte tjera.

Kur i referohemi sistemit juridik ai është një kategori dinamike që çdo dit është në tendencën e zhvillimit të nevojshëm, duke qene në harmoni me ndryshimet shoqërore e të cilat janë spontane dhe të pandalshme. Edhe në aspektin historik nëse shifet sistemi juridik i shteteve ka ndryshuar dhe është

²⁵ F. Berisha (2013) Hyrje në të Drejtën, Pejë. Fq. 312

reformuar mbi bazën e ndryshimeve të formës së sistemit politik dhe ndryshimeve shoqërore si kategori dinamike. Këto ndryshime, reformime dhe avancime çdo here i atribuohen ndryshimeve ekonomike, sociale, politike dhe standardeve të globalizmit si një mekanizëm me tendencë të unifikimit të sistemeve juridike dhe raporteve shoqërore. Shtetet që kanë një traditë në sistemin juridik të tyre e kanë më të lehtë ndryshimet dhe reformimin e sistemit juridik, për faktin se vetëm përcjellin risit dhe ndryshimet në nivel global dhe mbesin në trend të zhvillimit. Sfidë është tek shtetet që janë në zhvillim dhe ju mungon tradita në sistemin juridik të vendit, atëherë këto shtete kanë për obligim ndërtimin nga fillimi të sistemit juridik që është sfidë e madhe, për faktin se edhe sistemin ekonomik, politik, social e ka në zhvillim e sipër, prandaj është sfidë në vetë ndërtimi nga fillimi i sistemit juridik. Kjo i kushton që të bëjë një përzgjedhje të një formati të një sistemi konkret dhe efikas të sistemit juridik i cili do të jetë konform kushteve dhe standardeve të sistemit ekonomik, social, politik dhe procesit integruar në të cilat gjendet vendi. Konform specifikave të shtetit edhe sistemet juridike janë të ndryshme nga njëra për tjetrit, po e rëndësi është që të jetë i avancuar dhe në funksion të krijimit të shtetit të së drejtës.

Sistemi juridik është pasqyrim i formës së ndarjes së pushteteve në një shtet dhe kontrolli mes njëri tjetrit, kjo për faktin se sistemi juridik ndërtohet nga tri pushtetet dhe nuk mund të jetë i ndare jashtë orbitës së mekanizmave të shtetit. Sistemi juridik është pjesa që shteti ka përmes së cilit planifikon rregullimin e raporteve ndërmjet qytetarëve dhe ato qytetar shtet, me një kujdes të veçantë të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut si vlera mbi të cilat duhet të ndërtohet shteti dhe shoqëria. Është me rëndësi që sistemi juridik të jetë në funksion të mbrojtjes së qytetarit dhe shtetit, duke përcaktuar të drejtat dhe obligimet reciproke, nga të cilat ndërtohet demokracia dhe respektimi i vullnetit të qytetarëve.

Sistemin juridik është mekanizmi i cili e kualifikon një shtet sa do të jetë stabil, funksional, i së drejtës dhe në funksion të qytetarëve me qëllim të rregullimit të raporteve të tyre. Investimi i shtetit në ngritjen, avancimin dhe forcimin të sistemit juridik, mundësohet që të ketë shtet të së drejtës ku mbizotëron e drejta dhe vlera e të cilat mundësojnë mirëqenien dhe respektimin e të drejtave të njeriut si vlera universale të kualifikuara nga bota demokratike që janë në funksion të një jetë të bazuar në vlera.

6.Fusha e të drejtës civile në kuadër të sistemit juridik të shtetit

Shoqëria në një shtet për të pasur mundësin që të zhvillojë jetën e saj konform rregullave që raportet mes tyre të jenë të rregulluara konform rregullave dhe standardeve ka bërë të nevojshëm që shteti të ketë sistemin e saj juridik. Në kuadër të sistemit juridik bëjnë pjesë aktive disa të drejta të cilat me normat e tyre e përbejnë sistemin juridik të shtetit. Në kuadër të sistemit juridik bën pjesë edhe

legjislacioni i degës së të Drejtës Civile e cila me dispozitat që e përbejnë këtë të drejtë merr pjese dhe është njësi konstituive e sistemit juridik të shtetit duke i rregulluar marrëdhëniet juridiko civile. Si çdo e Drejtë edhe e Drejta Civile ka rrugëtimin e saj që i referohet zhvillimit dhe avancimit të saj nga niveli themelor – bazik gjer tek ky i sotmi që është mirë i konsoliduar dhe i ndarë në pjesë të veçanta. Themel i së Drejtës Civile si dhe burim i zhvillimit të saj është e Drejta Romake, kjo mund të konstatohet për shumicën e vendeve në botë. Ishte e Drejta Romake, nga e cila ka lindur e Drejta Civile dhe mund të kualifikohet si trashëgimtarë e së Drejtës Romake me ndryshimet dhe reformat e bëra konform ndryshimeve shoqërore.

E Drejta Romake njësi themelore dhe konstituive i ka pasur të drejtën publike dhe të drejtën private, të cilat edhe sot janë pjesë e sistemit juridik të vendit. Përmes së drejtës publike që e përbenin normat e saj synohej që të rregullohej raporti midis shtetasve dhe vete shteti. Në këtë rast kemi dy palë, në njërin anë shtetin në anën tjetër shtetasin, ku kjo përcakton obligimet e shtetasit karshi shtetit. Ndërsa e Drejta Private me tersin e rregullave juridike i rregullon marrëdhëniet ndërmjet personave mes vete si ata personat fizik dhe ata juridik, nga këndvështrimi i marrëdhënieve juridiko civile. Në kuadër të së Drejtës Romake e Drejta Private ndahej në të drejtën personale; të Drejtën Pronësore dhe të drejtën procedurale.²⁶ Fillimet e veta e Drejta Civile i ka në të drejtën private të së Drejtës Romake, kjo për faktin se mbijetesa për një kohë të gjatë e këtyre ka bërë që të kualifikohen si shumë të rëndësishme dhe të mundura të vazhdohen edhe në të drejtën civile. Nga kjo periudhë çdo herë ka pësuar ndryshime të theksuara e Drejta Civile si në aspektin përmbajtësor, organizativ dhe atë funksional.

E Drejta Civile historikisht ka pasur dhe është mbështetur në dy kuptime: Kuptimin objektiv dhe subjektiv. Ku në kuptimin objektiv e Drejta Civile është një tersi e normave juridike që rregullojnë raportet dhe interesat shoqërore e që i referohen karakterit pasuror. Pra me këtë kuptim kemi të bëjmë me aspektin normativ të së drejtës Civile. Ndërsa në kuptimin subjektiv e drejta Civile është vëllimi i autorizimeve që realizohen dhe janë të varura nga interesi i tij. Në këtë rast kemi të bëjmë me barazinë e palëve si dhe barazinë e vullnetit të palëve.²⁷

E Drejta Civile bën pjesë si e drejtë pozitive e së drejtës ku në kuadër të sistemit juridik të shtetit, me grupin e normave që posedon prezanton një mekanizëm juridik përmes së cilit rregullohen marrëdhëniet shoqërore me karakter pasuror, përkatësisht nga raportet e marrëdhënieve juridiko – civile, detyrimore dhe trashëgimore.²⁸ E rëndësishme të theksohet është fakti se, E Drejta Civile është

²⁶ B. Rexhepi & B. Selmani (2014) E Drejta Romake ndikimi isaj ne sistemet e se drejtes bashkëkohore, Ferizaj. Fq. 28 - 29

²⁷ A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 322

²⁸ Po aty, shih Fq. 17

pjesë themelore dhe konstituive e sistemit Juridik të shtetit, përmes normave të saj arrin që të rregulloj raportet juridike civile mes njerëzve.

Pjesa e së drejtës civile zë vend shumë tërëndësishme në kuadër të sistemit juridik të vendit, për faktin se marrëdhëniet juridiko civile zë një hapësirë të madhe në kuadër të marrëdhënieve ndër njerëzore. Pjesa e së drejtës civile mund të kualifikohet si pjesa më e rëndësishme dhe më voluminozë që e përben sistemin juridik. Përpos kësaj pjesa e së drejtës civile është pjesa më komplekse, për faktin se rregullimi i raporteve ndër njerëzore nga marrëdhëniet juridiko civile janë komplekse për faktin se kanë të bëjnë me pronën, raportet familjare, detyrimet, kompensimet, trashëgiminë dhe të drejtat sendore, të gjitha këto janë komplekse për faktin se çdo herë kemi aspekt financiar në këto marrëdhënie, prandaj fillimisht kemi interes dhe aspekt ekonomik.

KAPITULLI II SYNIMET E KOSOVËS PËR SHTET DHE SISTEM JURIDIK TË SAJË

1.Kosova dhe sistemi i saj juridik si njësi përbërëse e ish federatës se Jugosllavisë

Historia e ka argumentuar dhe e argumenton se Kosova ishte pjesë e territorit të Shqipërisë etnike të sotme. Ishte viti 1878, 1913 kur Kosova fillonte të ishte temë e diskutimit nga fuqitë e mëdha dhe Serbia e asaj kohe që të ndahet dhe aneksohet dhe më pas të bashkohet me Serbisë. Vendimmarrës për këtë ishte kongresi i Berlinit dhe konferenca e Londrës në të cilat u bë ndarja dhe copëtimi i trojeve Shqiptare, duke ndarë trojet e Shqipërisë dhe duke ju bashkëngjitur shteteve fqinje si Serbia, Greqia, Malit të Zi. Për fatin e Shqiptarëve nuk kishin vendosur Shqiptarët dhe as që ishin pyetur, për ta marrë vendim fuqitë e mëdha siç ishin Gjermania, Franca, Italia, Austro-Hungaria por çdo herë në dem të popullit dhe territorit të Shqipërisë.

Kosova nga viti 1918 kur ishte pjesë e Jugosllavisë gjer në vitin 2008 kur shpalli pavarësinë e cila u njoh me shumë se njëqind shtete ishte e okupuar dhe nuk kishte subjektivitet dhe as sistem të saj juridik. “Jugosllavia u krijua më 1918 si Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, më 1929 u emërua Mbretëria e Jugosllavisë, pa vullnetin e saj edhe Kosova ishte përfshi në këtë organizim duke mos u pyetur fare dhe kjo ishte në kundërshtim me vullnetin e popullit të Kosovës. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u pushtua nga fuqitë e Boshtit dhe më 1943 partizanët shpallën Jugosllavinë Federative Demokratike, për tu rimëruar më 1945 si Republika Popullore Federative e Jugosllavisë, e pastaj më 1963 si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë. Pas shpërbërjes, më 1992, Serbia dhe Mali i Zi themeluan Republikën Federative të Jugosllavisë, që në vitin 2003 do të emërohet Bashkimi Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi, që simbolizon fundin e Jugosllavisë”.²⁹ Shteti i Jugosllavisë nga themelimi gjer në fundin e ekzistimit të saj, kishte ndryshuar emërtimin, formën e qeverisjes, Kushtetutën dhe orientimin, por çdo herë Kosova nuk ishte njësi e barabartë me njësit tjera sic kanë qenë shtetet tjera që e kanë përberë Jugosllavinë. Në raport edhe me të drejtat që i kishin shtetet në kuadër të Jugosllavisë, Kosova nuk i ka poseduar. Çdo herë Kosova është varur në aspektin e zhvillimit nga një vendimmarrje e Jugosllavisë dhe më shumë nga ajo e Serbisë, kjo për faktin se konsiderohej dhe ishte pjesë e Serbisë dhe për këtë varej nga vullneti i Serbisë e i cili ishte shumë negativ për Kosovën.

Gjatë periudhës sa Perandoria Osmane ishte prezentë në territorin e Shqipërisë, Kosova kishte statusin si njësi e veçante administrative – juridike sipas rregullave Turke të vitit 1864. Kosova ishte njëri ndër

²⁹ www.wikipedia.org, <https://sq.wikipedia.org/wiki/Jugosllavia>, 2017, muaji 7, dita 31.

katër vilajetet e Perandorisë Osmane. Ky vilajet kishte disa specifika të veçanta dhe mekanizma të pushtetit me qëllim të funksionimit të Perandorisë Osmane në këtë territor.³⁰ Përpjekjet e Shqiptareve ishin të pareshtura për çlirim dhe pavarësi nga Perandoria Osmane e në veçanti nga viti 1910 – 1912 ku u realizuan shumë kryengritje dhe luftëra. Në aspektin e organizimit si shoqëri dhe komb për pavarësi nga Perandoria Osmane ishte edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878 – 1881. Kjo bëri të njohur qëndrimin e popullit Shqiptar për pavarësi të plotë nga porta e madhe e Perandorisë Osmane.

E dëmshme për Shqiptaret dhe për territorin e Kosovës ishte edhe Konferenca e Versajës e vitit 1919 përmes së cilës fuqitë e mëdha vendosën që 50% të territorit të trojeve etnike shqiptare të dhuronin Grekëve dhe Jugosllave. Kjo ishte periudha kur Kosova kishte një shkëputje nga territori i Shqipërisë dhe përvetësimin e saj nga Jugosllavia e asaj kohe. Nga kjo periudhë Kosova ka rrugëtuar duke qenë çdo herë pjesë e Jugosllavisë por asnjë herë e barabartë siç ishin njësit tjerë konstituive të Jugosllavisë. Duke mos qenë e barabartë, Kosova nuk kishte zhvillim ekonomik, sistem arsimor, shëndetësor, drejtësi prandaj nuk ka pasur mundësi të ketë zhvillim.

Kosova për herë të parë e kishte ndih statusin e mëvetësishëm autonom në kuadër të federatës Jugosllave që në vitin 1937 ku në Kosovë formohet Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste të Jugosllavisë.³¹ Me vetë faktin e formimit të këtij organi partiak në Kosovë në këtë periudhë dëshmohet se Kosova do të jetë pjesë e sistemit juridik të Jugosllavisë të asaj kohe. Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova ishte pjesë e organizimit dhe pjesëmarrëse në Luftën Nacional Çlirimtare si dhe kishte të formuara mekanizmat mbrojtës siç kanë qenë Komitetin Ushtarak etj.

Përpjekjet e Kosovës çdo herë kanë qenë që një ditë të bashkohet shtetit më Shqipërisë nga e cila ishte aneksuar në mënyrë të padrejtë. Një iniciativë kishte ndodhur edhe pas Luftës së Dytë Botërore në Konferencën e Bujanit në të cilën ishte shprehur vetëvendosja. Edhe pse në këtë konferencë ishte shprehur vullneti i delegatëve dhe ishte votuar që Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit të bashkëngjitet Shqipërisë. Konferenca e Bujanit kishte përfunduar me një Rezolutë e cila kishte karakterin konstituiv të vetëvendosjes për Shqiptarët e Kosovës.³² Edhe pse ishte kjo rezolute, asnjë herë nuk arriti të implementohet dhe mbeti vetëm si shprehje e vullnetit në letër.

Ishte viti 1944 – 1945 kur kishin filluar të diskutohen opsionet për të ardhmen e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Bisedimet ishin zhvilluar në kuadër të Partisë Komuniste të Jugosllavisë e cila ishte vendimmarrëse në atë kohë. Ishte tri opsione për statusin e Kosovës nga Partia Komuniste e

³⁰A. Bajrami (2014) Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë Fq.31.

³¹Po aty, shih Fq. 33.

³²Po aty, shih Fq. 36

Jugosllavisë dhe atë: Kosova t'i bashkohet Shqipërisë; Kosova të inkuadrohet në Serbi dhe Kosova të ndahet në mes të Serbisë dhe Malit të Zi. Vendimtare dhe famëkeqe ishte opsioni i cili Kosovën e bëri pjesë të Serbisë dhe kjo ishte në kundërshtim me vullnetin e popullit dhe me atë se çfarë ju kishte premtuar në konferencën e Bujanit. Përfundimisht Kosovave 10 korrik 1945, Serbet kishin organizuar dhe kamufluar një Kuvend në Prizren në të cilin u miratua një Rezolutë për bashkimin e Kosovës me Serbinë. Kjo ishte krejtësisht në kundërshtim me vullnetin e popullit dhe forma e këtij kuvendi ishte një falsifikim dhe kamuflim.³³ Duke qenë pjesë e Serbisë Kosova kishte statusin e saj në kuadër të sistemit Kushtetues të Serbisë dhe Jugosllavisë. Statusi Kushtetues i Kosovës përfshin nga viti 1945 deri në 1974 e cila ndahet në katër periudha.

Përudha e parë është nga viti 1945 deri në 1953, kjo përudhë është fillim kur Kosova përfshihet në Kushtetutën e Jugosllavisë, Serbisë dhe nxjerrjen e Statutit. Në kushtetutën e RFPJ-s të vitit 1946 Kosova kualifikohet si njësi autonome dhe konstituive e federalizmit po njëhësisht gjendet edhe në kushtetutën e Serbisë. Kjo periudhë ja ka mundur Kosovës të përfaqësohet në Kuvendin Popullor të RFPJ-ës në dhomën e kombeve. Në këtë fazë i rëndësishëm ishte edhe Statuti i Kosovës i cili ishte nxjerrë në vitin 1948 i cili mund të kualifikohet si akti i parë normativ i Kosovës. Ky dokument ka mundur që Kosova të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e krahinës, fushë veprimtarin e organeve krahinore, pushtetin lokal e çështje tjera me rëndësi për funksionimin e administratës së vendit. Statuti i kishte mundur që Këshilli Popullor të nxjerr vendime, aktvendime, rregullore, udhëzime. Ajo që kishte munguar në këtë periudhë ishte mëvetësia në aspektin e gjyqësisë, të cilat kanë qenë të formuara vetëm gjykatat e rrethëve dhe katër gjykata të qarkut, ndërsa nuk ka pasur gjykatë supreme.³⁴ Në këtë periudhë është një fillim i përcaktimit të disa kompetencave për Kosovën në fushën e qeverisjes, drejtësisë, pushtet lokal po jo krejtësisht të pavarura nga Serbia dhe Jugosllavia.

Periudha e dytë përfshin nga viti 1953 deri në vitin 1963 e cila karakterizohet me nxjerrjen e ligjit Kushtetues të RFPJ-ës dhe Ligjit Kushtetues të Serbisë. Në këtë fazë Kosova merr pozitë në Kushtetutën e Serbisë ku parashihen disa të drejta dhe detyrime. Në këtë periudhë kemi avancim të pozitës kushtetuese të Kosovës. Në këtë periudhë Kosova kishte nxjerrë edhe Statutin e dytë i cili kishte autorizime për çështje ekonomike, arsimore, kulturore, shëndetit popullor, kujdesin social, kujdesin në zbatimin e ligjeve, ruajtjen e rendit publik, zbatimin e ligjit federativ.³⁵ Kjo periudhë është karakteristike për Kosovën për faktin se i mundëson të ketë zhvillim dhe avancim në aspektin kushtetues si në atë të RFPJ-së dhe atë të Serbisë. Me këtë kemi edhe disa kompetenca në aspektin

³³.Po aty, shih Fq. 37

³⁴.Po aty, shih Fq. 17.

³⁵.A.Bajrami (1996) Aspekti kushtetues dhe politik të mëvetësisë së Kosovës, Prishtinë. Fq.254.

ekonomik, kulturor, social, arsimor. Me këtë, mund të kualifikohet se Kosova ka një avancim edhe brenda për brenda shtetit të Serbisë dhe atë të Jugosllavisë.

Periudha e trete shtrihet në vitin 1963 deri 1968/71, në këtë vit Kosova kishte nxjerr Statutin e tretë i cili i kishte siguruar një pavarësi në çështjet e ekonomisë, arsimit, banesave, buxhetin, planet shoqërore, themelimin e organizatave punuese, mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike. Në këtë periudhë shifet se ka një avancim të dukshëm të të drejtave të Shqiptarëve. Të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë ishte si rezultat i procesit të shendërrimit të njësive autonome në kategori republikane. Pavarësisht të drejtave që ju kishin dhënë Kosovës përmes Kushtetutës dhe Statuteve po asnjë herë nuk kishte vullnet që të jete e pavarur nga Serbia dhe të jete e njëjtë si shtetet tjera që e përbenin Jugosllavin.³⁶ Të drejtat dhe detyrat e krahinave në kuadër të shtetit të Jugosllavisë ishin të deleguara nga niveli qendror i Republikës. Ishte viti 1969 si rezultat i pozitës së re, krahinat krijuan pavarësinë legjislative. Kjo pavarësi legjislative ju mundësoj që të nxjerrin ligjet kushtetuese përmes se cilave përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet.

Ligji Kushtetues i Kosovës u miratua me datën 24.02.1969. Ky ligj ka pasur fuqinë e Kushtetutës dhe ka bërë ndryshime në riorganizimin dhe parimet kushtetuese. Ky avancim është vërejtur edhe tek funksioni legjislativ i cili ka qenë shumë i gjer, ku ka mundësuar që shumë fusha me interes shoqëror të rregullohen përmes ligjeve të veçanta. Kjo kompetencë i mundësoj Kosovës që shumë fusha të cilat ishin me interes për Kosovën të rregulloj përmes ligjeve të veçanta. Avancim të Kosovës në aspektin e statusit të saj në kuadër të Jugosllavisë është edhe ai përmes Kushtetutës së vitit 1974. Sipas kësaj Kushtetute, Kosova ishte njësi konstituive e federatës. Kjo kushtetutë i krijoi mëvetësi në shumë sfera njëra ndër to edhe në atë kushtetuese dhe legjislative. Sipas kësaj Kushtetute Kosova kishte kompetencë të plotë që të gjitha marrëdhëniet shoqërore të rregullonte përmes ligjeve. Përpos avancimit në fushën e legjislativit Kosova kishte dhe organet e veta si Kuvendin e Kosovës, Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, Kryesia e Kosovës, Gjykata Supreme, Gjykatën Kushtetuese, Prokurorin Publikë, bankën Popullore etj.³⁷

Vitet nëntëdhjeta ishin vite kur Jugosllavia nuk ishte ajo që kishte qenë dhe siç ishte themeluar, në këtë periudhë shumë republika filluan procesin e ndarjes dhe pavarësimin e tyre si shtete të pavarura dhe demokratike. Në këtë periudhë Serbia kishte marrë një ofensivë për ta defunksionalizuar çdo institucion dhe ta kthej Kosovën duke e bërë pjesë të Serbisë. Për ta ndal një veprim të tillë Kosova nuk kishte ndenjur indiferent karshi kësaj situatë. Kosova për ta kundërshtuar një qëllim të Serbisë për mohim të

³⁶A. Bajrami (2014) Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë Fq.42.

³⁷Po aty, shih Fq. 48-49.

te drejtave kishte marr këto veprime: Deklaratën Kushtetuese me 2 Korrik 1990; Kushtetuta e Republikës së Kosovës me 7 shtator 1990; Referendumi gjithë popullor 26-30 shtator 1991; Rezoluta e Kuvendit të Kosovës 19 tetor 1991; amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.³⁸Kjo është faza kur Jugosllavia kishte marr drejtimin e shpërbërjes duke filluar që disa shtete të dalin nga Jugosllavia dhe duke krijuar pavarësinë e tyre. Në pozitën më të keqe në këtë periudh ishte Kosova pasi kjo ishte në kuadër të Serbisë dhe daljen e kishte më të vështir se sa shtetet tjera që ishin njësi konstituive

2.Suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës në vitin 1989

Fundi i viteve 90 Jugosllavin e gjeti ne fazën e shkatërrimit dhe tendencën e te gjitha njësive konstituive te Jugosllavisë për shpërbërje dhe pavarësi. Ne pozitë me te mire dhe me te fuqishme ne kuadër te shtetit Jugosllav ishin Sllovenia dhe Kroacia. Jugosllavia kishte filluar te shkatërrohet për faktin se Serbia me ne krye Slllobodan Millosheviqin kishte tendenca te fuqizimit te Serbëve ne te gjitha republikat dhe fakti popullsi te përcaktonte sovranitetin. Serbia ishte ne fazën kur konsideronte veten lider dhe udhëheqës në Jugosllavi, e keqja e kësaj ishte se këtë politik e zhvillonte një njeri qe kishte orientime nacionaliste dhe fashiste Slllobodan Millosheviq.

Rrënimi dhe shkatërrimi i Jugosllavisë kishte filluar me Kosovën, ku me 23 mars 1989, Serbia kishte bere ndryshimet Kushtetuese me te cilat e suprimonte dhunshëm autonomi e Kosovës. Me suprimimin e autonomisë, Kosovën e vendos nën administrim dhe udhëheqje të Serbisë që në cdo aspekt ishte e pa pranueshme nga Shqiptaret. Me këtë suprimimin kishte filluar te rrënohet çdo gje që kishte te bënte me Kosovën duke filluar nga subjektiviteti Kushtetuese dhe deri te rrënimi i sistemit juridik i cili ne një far forme ishte ndërtuar dhe kishte krijuar një traditë. Me suprimimin e autonomisë, Serbia filloj qe te ndërhyt dhe instalohet në çdo sistem si në atë ekonomik, politik, arsimor dhe juridik. Duke pas për bazë qëndrimin e popullit Shqiptar dhe të udhëheqësve të asaj kohe se shteti Serb për Shqiptarët çdo herë është okupator, kishin filluar kundërshtimet dhe bojkotimi i shtetit dhe administratës Serbe pasi qëllimi i Serbisë ishte vendosja e Kosovës nen Serbi dhe krijimi i Serbisë se madhe, një koncept hegjemonist dhe fashist.

Duke pare se me veprimet e Serbisë, Kosova do dëmtohet shumë dhe do vendoset nen një okupim te plot nga shteti Serb, kishin filluar veprimet konkrete për te kundërshtuar suprimimin e Autonomisë. Edhe pse e pafuqishme ne aspektin ushtarak, ne aspektin institucional kishte filluar kundërshtimi i suprimimit me Deklaratën Kushtetuese te 2 Korrikut 1990. Në vitet 1990 ishte duke u diskutuar lidhur

³⁸.Po aty, shih Fq. 56.

me te ardhmen e Jugosllavisë dhe konceptin e saj te funksionimit, në një të anë ishte koncepti dhe forma e federatës të cilin e mbështesnin Serbo – Malazezet dhe në anën tjetër koncepti dhe forma e konfederatës të cilin e mbështesnin Slloveno – Kroatet. Në të gjitha këto bisedime rreth të ardhmes së Jugosllavisë nuk ishte përfshirë Kosova dhe as që ishte pyetur për këtë pasi llogaritej se për Kosovën pyetet dhe vendos Serbia.³⁹ Pas vlerësimit të bërë situatës dhe gjendjes së Kosovës në raport me të ardhmen e saj në kuadër të Jugosllavisë, Kuvendi i Kosovës më 2 korrik 1990 para platos së Kuvendit, 111 delegat miratuan dhe publikisht shpallen Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës (konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë). Në pikën 1 të Deklaratës Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës (konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë), përcaktohet: “ Me këtë deklaratë shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi si akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë”.⁴⁰ Me këtë deklaratë behet i njohur vullneti i Shqipëtarëve dhe kundërshtimi që i bëjnë veprimeve të njëanshme të Serbisë si një okupator klasik me tendencë të shfarosjes së Shqipëtarëve të Kosovës. Pra me këtë deklaratë kemi njëherit shumë mesazhe që japin, fillimisht avancohet pozita kushtetuese e Kosovës, kundërshtohen veprimet e Serbisë karshi Kosovës, insiston që kjo Deklaratë të inkorporohet në Kushtetutën e Jugosllavisë dhe kemi parimin e vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë. Në Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës (konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë), përcaktohet: “ Në ndërkohë, deri në aplikimin definitiv juridik të kësaj Deklarate Kushtetuese, Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës marrëdhëniet e tyre në rendin kushtetues të Jugosllavisë i mbështesin në Kushtetutën në fuqi të Jugosllavisë dhe jo në amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1989, me ç ‘rast bëhet edhe anulimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës i datës 23 mars 1989 mbi dhënien e pëlqimit në këto amendamente”.⁴¹ Me këtë pikë kemi kundërshtim të plotë të ndryshimeve kushtetuese më 23 mars 1989 me të cilat Kosovës i suprimohet autonomia.

Edhe për kundër faktit se veprimet e Serbisë ishin kundërshtuar dhe në vazhdimësi kundërshtohen nga institucionet e Kosovës, nuk kishim reflektim të Serbisë as pak që të ndalonte veprimet konkrete në okupimin e Kosovës në tersi. Veprimet e vazhdueshme të Serbisë në dem të Kosovës e obliguan Kuvendin e Kosovës që më datën 7 shtator 1990 në Kaçanik të aprovoj dhe shpall Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Kaçanikut është avancimi më i lartë që pretendohet të behet për

³⁹Po aty, shih Fq. 57.

⁴⁰Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës (konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë) (2 Korrik 1990) Kuvendi i Kosovës, Prishtinë. Shih pikën 1.

⁴¹Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës (konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë) (2 Korrik 1990) Kuvendi i Kosovës, Prishtinë. Shih pikën 4.

Kosovën në kuadër të Jugosllavisë, kjo për faktin se, me këtë Kosova pretendon të jete e barabartë si çdo republikë tjetër në Jugosllavi. Ky avancim i Kosovës është në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila përcakton:

“Republika e Kosovës është shtet demokratik i Kombit Shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare, të shtetasve të vetë; serbëve, myslimanëve, malazezëve, kroatëve, turqëve, romëve e të tjerëve që jetojnë në Kosovë. Republika e Kosovës si shtet është anëtare e Bashkësisë së Jugosllavisë. Sovraniteti në Republikën e Kosovës buron nga populli dhe i takon popullit. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror.”⁴² Nëse vlerësohen këto tri dispozita në kuadër të Kushtetutës së republikës së Kosovës janë të gjitha elementet e shtetësisë dhe të cenurit i barabartë ku pushteti buron nga populli dhe me këtë hap një dere drejt vlerave universale të cilat në atë kohë i kishte përqafuar bota demokratike. Shpallja dhe miratimi i kësaj Kushtetute për okupatorin Serb ishte vlerësuar si veprim kundër rendit kushtetues Serb dhe Jugosllav ku me pas kishin filluar përndjekjet, persekutimet dhe burgosjet e delegatëve dhe organizatorët e shpalljes dhe miratimit në Kaçanik të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me këtë deklaratë ishte atakuar drejtpërdrejt okupatori që ishte Serbia dhe konsideronte se kjo nuk ishte e drejtë.

Duke parë se okupatori Serb nuk reflektonte karshi statusit të Kosovës dhe të drejtave të Shqiptarëve edhe për kundër veprimeve nga ana e Shqiptarëve, Shqipëtarët me mekanizmat e tyre kishin filluar edhe një veprim konkret për ta kundërshtuar okupatorin Serb dhe atë duke organizuar referendum për pavarësinë e Kosovës. Në shtator të vitit 1990 kuvendi i Kosovës kishte miratuar Rezolutën mbi Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran dhe ishte marr vendim që të mbahet referendum popullor lidhur me këtë rezolutë. Me datën 26 – 30 shtator 1991 ishte organizuar referendumi dhe mbi 99 % u deklaruan për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Rezultati i këtij Referendumi ishte sinjali i fundit që populli i Kosovës dëshiron të shkëputet nga Serbia dhe Jugosllavia dhe të jete shtet i pavarur dhe sovran. Ky ishte momenti kur Kosova kishte të qartë drejtimin dhe nuk kishte kthim mbrapa drejt realizimit të drejtave të saj.

Kur shikohet aspekti kronologjik i pozitës kushtetuese të Kosovës na ofrohen të dhëna se asnjë here nuk ka pas pozitë të volitshme kushtetuese në kuadër të Jugosllavisë edhe atë pozitë jo të barabartë që kishte suprimuar në vitin 1989 nga Serbia. Duke pas për bazë se Kosova kishte probleme me statusin e saj dhe pozitën Kushtetuese kishte mbet e pa zhvilluar në aspektin e ndërtimit të sistemit juridik të saj pasi edhe këtë e kishte suprimuar Serbia me ndryshimet Kushtetuese. Ishte vullneti dhe qëndrimi i

⁴²Kuvendi i Kosovës (7 shtator 1990) Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kaçanik. Shih nenin 1, 2,3.

institucioneve te asaj kohe qe nuk u ndalen se vepruari fillimisht duke kundërshtuar veprimet e Serbisë dhe njëhirit duke kërkuar te drejtat e popullit deri në shtet të pavarur dhe Sovran ku pas shum sakrificave edhe kjo është arritur.

3.Administrimi dhe sistemi juridik i Kosovës nga misioni i UNMIK-ut 1999-2008

Për këtë periudhë kohore misioni i UNMIK-ut ka qen pushteti i plotë i cili ka pasur kompetenca te plota në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe atë gjyqësor. Edhe pse ky mision qe ne fillim ishte dizajnuar si i përkohshëm, ai kishte kompetenca te plota për ketë periudhë kohore. Misioni i UNMIK-ut ishte i shtrire ne dy drejtime, se pari ne administrimin e Kosovës dhe së dyti krijimin e kushteve për funksionalizim të institucioneve vendore të cilat do të pranoin kompetencat nga UNMIK-u dhe më pas të udhëheqin me vendin.

Administrata e UNMIK-ut për te qen funksionale lidhur me administrimin dhe krijimin e sistemit juridik të Kosovës, kishte themeluar katër shtyllat kryesore siç janë: policia dhe drejtësia, administrata civile, demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve nën udhëheqjen e OSBE-së dhe rindërtimi i zhvillimit ekonomik nën drejtim e BE-së. Në këtë periudhë ishin aktive edhe forcat politike vendore por jo te angazhuara në pushtet. Misioni i UNMIK-ut për një administrim dhe ndërtim të sistemit juridik në Kosovë ishte e nevojshme te ketë bashkëpunim edhe me forcat politike vendore te cilat synonin të qeverisin me vendin. Si një mekanizëm koordinues, konsultativ ishte themeluar Këshilli Transitor i Kosovës, përmes këtij mekanizmi synohej që të kishte koordinim dhe bashkërendim të aktiviteteve në drejtim të funksionalizimit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë.

Për të filluar ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës, misioni i UNMIK-ut kishte parapa që të fillohet nga rregullimi kushtetues i Kosovës, mirëpo këtë e kishte planifikuar dhe bërë përmes Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme të cilën e kishte shpall me rregulloren e 15 majit të vitit 2015.⁴³ Me Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme është ven themeli i ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës dhe ndërtimi i shtetit të Kosovës. Në kornizë përcaktohen institucionet e Kosovës dhe ndarja e pushteteve si ai i legjislativit, ekzekutivit, presidenti, sistemi gjyqësor. Përmes krijimit të bazës kushtetuese për këto institucione dhe mekanizma shtet ndërtues është filluar që sistemi juridik i Kosovës të filloj te merr formë edhe pse në monitorim dhe mbikëqyrje të plotë nga misioni i UNMIK-ut. Mekanizmat që krijojnë sistemin juridik në vend pas themelimit tash kishin rrolin kryesor

⁴³.Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare UNMIK 15 maj 2001).

për funksionimin e tij. Barra kryesore për këtë e kishin parlamenti, qeveria dhe sistemi gjyqësor, kjo për faktin se për të krijuar dhe funksionuar sistemin juridik kërkohet bashkërendim të aktiviteteve dhe kompetencave brenda këtyre institucioneve dhe një gje e tillë kishte ndodhur.

Që Kosova të themeloj institucionet e veta të para siç ishin parapa në Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, fillimisht ishin parapa që të mbahen zgjedhjet dhe nga këto zgjedhje të dalin organet e pavarura të Kosovës si Presidenti, Kuvendi dhe Qeveria. Dhe kështu me 17 nëntor të vitit 2001 janë organizuar zgjedhjet e para demokratike të Kosovës. për të filluar aktivitetin këto kërkohesh që këto të rrjedhin nga zgjedhjet e lira dhe demokratike që duhej të organizoheshin nga të cilat të dalin organet e reja dhe të para të Kosovës. Ndërtimi i sistemit juridik pas luftës në Kosovë kishte fillimin nga institucionet që kanë dal nga këto zgjedhje të cilat kanë filluar ndërtimin e sistemit juridik në vend. Edhe pse nga këto zgjedhje u krijuan institucionet e vendit të cilat kishin për fokus ndërtimin e sistemit juridik përsëri rroli i UNMIK-ut ishte vendimmarrës dhe monitorues për institucionet e vendit, prandaj edhe pse ishte ndërtimi dhe funksionimi i sistemit juridik ishte duke u realizuar nga institucionet vendore, misioni i UNMIK-ut ishte vendimmarrës.

Edhe pse në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme mandati i Kuvendit të Kosovës është nxjerrja e legjislacionit, nuk e ka lan vendimmarrës të plotë për faktin se pas aprovimit të legjislacionit në Kuvendin e Kosovës, Ligji i dërgohet Kryetarit të Kosovës për nënshkrim.⁴⁴ Sipas kësaj, Kryetari i Kosovës është kompetenca e fundit që nënshkruan një ligj të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Edhe pse për institucionet vendore përfundon mandati dhe kompetenca sa i përket miratimit të legjislacionit, kjo nuk përfundon këtu, në këtë periudhë pas nënshkrimit të ligjit nga Presidenti aktivizohet kompetenca e misionit të UNMIK-ut e cila është përfundimtare dhe vendimtare sa i përket hyrjes në fuqi të një Ligji. Kryetari i Kosovës pasi ta nënshkruan Ligjin që ka pranuar nga Kuvendi i Kosovës, të njëjtin ja dërgon PSSP-së për miratim dhe shpallje. Kompetenca e PSSP-es lidhur me legjislacionin është e përcaktuar në Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisje në këtë formë: ‘ Ligjet hyjnë në fuqi ditën e shpalljes nga PSSP-ja, përveç rasteve kur në mënyrë specifike vetë ligji e parasheh ndryshe’⁴⁵ Sipas kësaj që përcaktohet në Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisje, kompetenca e misionit të UNMIK-ut përkatësisht e PSSP-së është shumë e lartë dhe vendimtare sa i përket miratimit dhe hyrje në fuqi të legjislacionit. Prandaj kompetenca dhe mandati i misionit të UNMIK-ut është shumë i lartë dhe vendimtar sa i parkete ndërtimit të sistemit juridik në Kosovë kjo për faktin se kompetencat e UNMIK-ut ishin shumë të larta dhe vendimtare. Sa i përket punës dhe angazhimit barra

⁴⁴.Po aty, shih kreun 9.9.1.44.

⁴⁵.Po aty, shih kreun 9.9.1.45.

kryesore ka qen tek institucionet vendore në ndërtimin e sistemit juridik në vend, ndërsa në kuptimin Kushtetuese dhe ligjor kompetenca dhe mandati i kanë takuar UNMIK-ut i cili me kalimin e kohës ka filluar që disa kompetenca ti kaloj tek institucionet vendore të Kosovës.

Në bazë të kompetencave kushtetuese dhe atyre funksionale, misioni i UNMIK-ut për periudhën 1999 deri me 2008 kur është shpall pavarësia e Kosovës, ka pas mandat dhe kompetencë të plotë në ndërtimin e sistemit juridik në Kosovë. Kompetencat e UNMIK-ut kanë qene te shtrira në të gjitha fushat duke filluar në hartimin dhe miratimin e legjislacionit, sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Nga kompetencat dhe fushëveprimi është e qartë se sistemi juridik dhe cilësia e ti për këtë periudhë kohore i atribuohet misionit të UNMIK-ut.

Edhe për kundër faktit se në këtë periudhe Kosova ishte nën administrimin e UNMIK-ut, ishte fillimi i ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës, po çdo herë nën mbikëqyrjen e misionit të UNMIK-ut, si përgjegjës për administrimin e Kosovës dhe ndërtimin e mekanizmave institucional. Kjo periudhë ka qenë në funksion të analizës dhe ndërtimit të sistemit juridik si një mekanizëm me interes vital për vendin. Nga këto të dhëna dhe këto fakte, mund të konstatojmë se fillimi i ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës është bashkëhissetar edhe misioni i UNMIK-ut, por jo në atë masë sa kishte përgjegjësi dhe kompetencë. Kompetencat e misionit të UNMIK-ut ishin më të larta se sa kishte ofruar kontribut në ndërtimin e sistemit juridik, prandaj nuk mund të konstatohet se kësaj mision kishte kryer misionin e plotë sic kishte mandatin.

4.Sistemi juridik i Kosovës nga viti 1989 deri në vitin 1999

Nga viti 1989 e ardhmja e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë kishte ndryshim negativ sa i parkete te drejtave të Shqepëtave kjo për faktin se në këtë periudhë kishte filluar që çdo e drejt e tyre te suprimohet ne çdo aspekt. Nga viti 1989 kishte një tendencë të Serbisë që çdogjë qe kishte Kosova te gllabëronte dhe Shqiptaret te ishin te nënshtruar ndaj Serbisë dhe te shkonin drejt asimilimit dhe tërheqjes nga Kosova për tu lëshuar mundësin ardhjes së kolonve Serb. Edhe kjo periudhë kohore mund te kualifikohet si një tendencë e re e Serbisë që të ndërtoj një sistem të ri juridik në Kosovë po me çdo element te Serbisë pa as një element te vullnetit te Shqiptareve te Kosovës. Suprimimi i çdo te drejte te Kosovës nga Serbia e vendosi popullin dhe intelektualet Shqipëtar që të krijojnë një vetëmbrojtje dhe një jetë paralele duke e kundërshtuar çdo gjë te Serbisë. Ishte faza e fundit kur Kosova duhej të kundërshtonte një tendencë te asimilimit te Shqipëtarëve të Kosovës nga ai Serb, prandaj kishte një organizim për të kundërshtuar.

Nga viti 1990 kishte filluar që të ndërtohet një sistem paralel i Arsimit nga Kosova pasi me dhunë Serbia kishte nxjerr nxënësit dhe personelin nga shkollat dhe universiteti. Sistem paralel nga Kosova ishte ndërtuar edhe për shëndetësi, pasi sistemi shëndetësor ishte gllabëruar nga Serbia dhe kishte larguar nga puna personelin Shqipëtar. Në asnjë institucion Shqipëtarët nuk ishin pjesë e tij, kjo bëri që të rritet revolta e popullit Shqipëtar për të kundërshtuar shtetin e Serbisë dhe tendencën e okupimit të Kosovës në çdo aspekt.

Sistemi juridik nga viti 1989 kishte ra në duart e shtetit Serb dhe çdo gjë ishte e kontrolluar dhe planifikuar nga Serbia duke shkatërruar çdo gjë Shqipëtare. Gjyqtarët dhe Prokurorët Shqiptarë që ishin të angazhuar ishin detyruar të largohen nga puna për faktin se shteti Serb ju kishte kërkuar të i nënshtroheshin sistemit juridik të Serbisë dhe të betohen para Parlamentit Serb, kjo ishte e pa pranuar për ta dhe janë detyruar që të japin dorëheqje dhe të mbesin pa punë, përjashtim një pjesë e tyre që kishin vazhduar me sistemin juridik të Serbisë. Shqipëtarët edhe pse nuk kishin sistem juridik të tyre dhe as sistem gjyqësor, kanë qenë palë në gjykimet penale dhe ato civile, administrative dhe tregtare që janë zhvilluar në gjykatat e Kosovës po me sistem juridik të Serbisë. Gjykimet kur njëra palë ka qenë Shqiptar apo dyja është vërejtur diskriminimi, zgjatja e gjykimeve me shumë se sa ka qenë e paraparë dhe shumë padrejtësi tjera që kanë qenë në dëm të Shqiptarëve të Kosovës. Nga pushteti i asaj kohe Shqiptarëve ju është mohuar çdogjë janë llogaritur si shoqëri e klasës së dytë apo tretë pa asnjë të drejtë elementare po çdo herë me qëllim të eliminimit.

Lidhur me sistemin juridik dhe ndërtimin e tij në mënyrë paralele nga Shqiptarët kishte iniciativë por me shumë vështirësi të organizuara, për faktin se për çdo organizim të tillë ishin të penguar nga shteti Serb deri edhe në maltretim dhe burgosje të aktivisteve. Iniciativa kishte sa i përket nxjerrjes së legjislacionit me tendencë të rregullimit të disa fushave si dhe ato nga marrëdhëniet juridike civile të qytetarëve të Kosovës por të njëjtat kishin mbetur vetëm në tentativë. Çdo aktivitet paralel i Shqiptarëve të Kosovës në atëkohë është bërë në mënyrë ilegale për faktin se këto veprime nga shteti Serb ishin konsideruar se janë kundër shtetit Serb dhe rendit juridik të tij. Në fakt këto veprime ishin për mbijetesën e popullit Shqiptar të cilët ishin të detyruar të veprojnë në këtë formë për të arritur të mbijetojnë dhe të ruajë identitetin e tyre, në të kundërtën asimilimi dhe largimi nga Kosova ishte në filllet e para/

5.Kosova shtet i pavarur dhe sovran drejt ndertimit te shtetit dhe sistemit juridik

Viti 2007 për Kosovën ishte vit tejet me rëndësipër te ardhmen e popullit të saj për faktin se në këtë vit kemi prezantimin e propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës te hartuar dhe prezantuar nga i ngarkuari Marti Ahtisari. Ahtisari ishte i ngarkuar me arritjen e një marrëveshje rreth statusit përfundimtar të Kosovës. Mbi bazën e shumë takimeve dhe bisedimeve te realizuara mes delegacionit të Beogradit dhe Prishtinës kishte hartuar dhe prezantuar Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës.

Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës ishte i ndërtuar mbi vlerësimin e gjendjes ne mënyrë te detaizuar, qëndrimin e palës Serbe dhe asaj Kosovare rreth statusit të Kosovës dhe me e rëndësishmja qe përmbante ky propozim kishte te bënte me statusin e Kosovës dhe sistemin juridik dhe shteteror te Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Dokumenti i Ahtisarit ishte makete se si do duhej te jete shteti i së ardhmes së Kosovës dhe çfarë duhej të përmbante për të qen një shtet funksional dhe i pranueshëm për të gjithë komunitetet në Kosovë.

Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës tek dispozitat e përgjithshme përcakton: “Kosova do të jetë shoqëri shumetnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore”⁴⁶ Ne këtë pjese behet orientimi se ka do te shkoj Kosova dhe si duhet te krijoj qeverisjen e saj drejt një shteti ku do te ketë sundim te ligjit dhe do te jete shoqëri shumë etnike. Qe ne këtë propozim kemi orientimin se Kosova do te ketë ndarje te pushtetit dhe do ketë sistemin qeverisës parlamentar.

Bazën dhe themelin e përmbajtjes dhe orientimit te saj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës do ta ketë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. Atë se çfarë do te përmbaj Kushtetuta e Republikës së Kosovës do jete e bazuar ne Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, pasi kjo e fundit është dokumenti i cili përmban kompromisin e bashkësisë ndërkombëtare, Serbisë dhe palës Kosovare për te qen Kosova shtet i pavarur dhe sovran. Kushtetuta e Republikës së Kosovës do ta ketë bazën qe nga propozimi gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës ku përcaktohet: “ Kosova do të miratojë Kushtetutën. Kushtetuta e Kosovës do të përshkruajë dhe garantojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë, të cilët janë të domosdoshëm për tu

⁴⁶M.Ahtisari (2 shkurt 2007) Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, Prishtine. Shih nenin1par. 1.1

siguruar se Kosova qeveriset sipas standardeve më të larta demokratike, dhe e cila do të promovojë bashkëjetesën paqësore dhe prosperitetin e të gjithë banorëve saj. Kushtetuta do të përfshijë parimet dhe dispozitat e përfshira në Aneksin I të kësaj Marrëveshjeje, por nuk do të kufizohet vetëm në to”.⁴⁷ Kjo përmbajtje e kësaj dispozite është shumë e qartë për Kosovën, fillimisht i jap te drejtën që të ketë Kushtetutë dhe me pas e orienton se çfarë standardesh te përgjithshme do duhej që të ketë dhe te njëjtat te jene ne harmoni me ketë plan si një propozim i kompromisit për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Edhe për sistemin e ardhshëm gjyqësor të Kosovës, propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës do të jetë një përcaktues i qartë se si do të jetë, çfarë do të përmbaj, si do te jene te përfaqësuar komunitetet dhe mënyra e organizimit. Përcaktimi i qartë se si do të jetë sistemi i ardhshëm gjyqësor është një lehtësi shumë e madhe pasi përcakton qartë se si do duhej te përcaktohet në Kushtetutë dhe legjislacionin përkatës për organizimin e sistemit të ardhshëm gjyqësor.

Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës ka parapa edhe dispozitat kushtetuese dhe atë ne Aneksi I, te parapara janë ato që rregullojnë dispozitat Themelore; Dispozitat për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Kuvendi i Kosovës; Kryetari i Kosovës; Qeveria e Kosovës; Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë. Nga ato që përmban Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës behën te qarta dy çështje, se pari Kosova do te jete shtet po duke pas parasysh edhe elementin që Kosova do te jetë shtet i të gjithë atyre që jetojnë në Kosovë me te drejta të barabarta dhe se dyti krijon bazën e sistemin e ardhshëm juridik të Kosovës i cili do jete kornizë mbi te cilin do rregullohet jeta mes qytetareve te Kosovës.

Themelet e sistemit te ardhshëm juridik që i përcakton Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës është një garancion se Kosova do te ketë një sistem juridik te bazuar ne vlera dhe standarde ndërkombëtare e te cilat sigurojnë një shtet demokratik i ndërtuar mbi bazën e sundimit te ligjit. Nga ajo që ceket me lartë, shifet se ky dokument është fillimi i shtetësisë së Kosovës dhe fillimit të ndërtimit të sistemit të saj juridik me synime dhe orientime pro vlerave universale që i përkasin botes së civilizuar dhe demokratike. Një fakt tjetër që prodhon ky dokument është edhe ai se bën një prerje me sistemin juridik të së kaluarës dhe vendos sistemin juridik të Kosovës në një mbikëqyrje të përkohshme ndërkombëtare deri në një fazë kur do të vërtetohet se shteti i Kosovës ka

⁴⁷.Po aty, shih nenin 1 par.1.3

arrit të ndërtohet konform atyre elementeve që janë parapa në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës.

Ishte Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës dokumenti dhe vullneti që i kishte hap rrugën shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku do të bëhej Kosova shtet i pavarur dhe sovran dhe do të ndërtohej shteti i Republikës së Kosovës me të gjitha mekanizmat shtetëror të paraparë. Me datën 17 shkurt 2008 deputetet e Kuvendit të Kosovës kishin shpallur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Deklarata e pavarësisë së Republikës së Kosovës ishte nënshkruar nga të gjithë deputetet e Kuvendit të Kosovës. Në pikën 1 të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës është përcaktuar së: ‘ ‘ Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës’’.⁴⁸ Kuptimi i kësaj është se sa i përket ndërtimit të Kosovës shtet të pavarur, sovran dhe funksional gjërat kanë qenë në kontuitet dhe koordinim me bashkësinë ndërkombëtare. Edhe në deklaratën e pavarësisë shifet se është marr për bazë dhe ka qenë themel i shpalljes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran dhe planifikues se si do të jete funksionimi i shtetit duke përfshi edhe sistemin juridik.

Për të ardhur deri te shteti dhe funksionimi i tij, Kosova ka përzgjedh rrugën e integritit në familjen e madhe të Bashkimit Evropian për faktin se atje shfaq vlerat të cilat mundësojnë të ketë shtet stabil dhe qeverisje të mirë nga e cila rrjedh edhe mirëqenia e mirë për qytetaret e saj. Synimet për integrim Evropian janë të shprehura edhe në Deklaratën e pavarësisë së Kosovës dhe atë: “ Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen evropiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian sapo që të jetë e mundur dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik’’.⁴⁹ Me këtë vullneti i popullit ka shpreh orientimin ka do të shkon dhe ku do të arri mbi bazën e arsytimit të cekura e të cilat janë shumë të forta dhe domethënëse. Edhe deklarata e pavarësisë së Kosovës është njëri ndër ata shumë mekanizma për funksionimin e shtetit të Kosovës dhe ndërtimin e sistemit të tij juridik si një mekanizëm që do mundëson të ketë shtet funksional, qeverisje demokratike, respektim të drejtave të njeriut dhe me synime pro vlerave dhe standardeve Evropiane.

Deklarata e pavarësisë së Kosovës i kishte hap rrugën edhe Kushtetutës së ardhshme të Republikës së Kosovës e cila në Deklaratë theksohej se “Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundur një

⁴⁸Deklarata e Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008) Kuvendi i Kosovës, Prishtinë.

⁴⁹Po aty.

kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohej me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm”.⁵⁰ Rruga për hartimin dhe miratimin e kushtetutës së Republikës së Kosovës ishte hapur nga Deklarata e pavarësisë së Kosovës.

Deklarata e pavarësisë së Kosovës ishte vetëm ai fillimi i ndërtimit të shtetit të Republikës së Kosovës dhe akti sublim i shpalljes së pavarësisë. Pas deklaratës ishin obligimet tjera që derivonin e të cilat kishin obligim institucionet e Kosovës që ti nxjerrin dhe aprovin drejt ndërtimit të sistemit juridik në vend. Njëri ndër obligimet ishte edhe hartimi dhe aprovimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si një mekanizëm që do të përcaktonte formën e qeverisjes, dhe mekanizmat shtetëror të Republikës së Kosovës. Pas shumë angazhimeve dhe aktiviteteve profesionale dhe akademike nga ekspert dhe akademik ishte arrit që të hartohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe në seancën e jashtëzakonshme solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 9 prill 2008, Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁵¹ Me këtë institucionet e Republikës së Kosovës kishin arrit që të kryejnë njërin nga obligimet me të rëndësishme i cili derivonte nga Pakoja e Ahtisaarit dhe Deklarata e pavarësisë së Kosovës. Miratimi i kushtetutës së Republikës së Kosovës ishte themeli i ndërtimit të sistemit juridik në Republikën e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Duke pasur për bazë standardin e kërkuar, me datën 15 qershor 2008 ishte planifikuar që të hyn në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga kjo date të filloj dhe të prodhoj efekte juridike si akti me i lart i shtetit të Republikës së Kosovës. Është data 15 qershor 2008 e tutje Republika e Kosovës ka të filluar ndërtimin e sistemit juridik të saj duke e bazuar në parimin e kushtetutshmërisë dhe atë të ligjshmërisë por duke mos anashkaluar as një here edhe standardet ndërkombëtare për të cilat shteti i Kosovës është zotuar se do i inkorporoj në kuadër të sistemit të saj juridik. Hyrja në fuqi e kushtetutës së Kosovës i kishte hap rrugën edhe ndryshimit, reformimit të legjislacionit të së drejtës civile dhe atë të sistemit gjyqësor për nga karakteri organizativ dhe funksional.

⁵⁰Po aty.

⁵¹Procesverbal nga seanca e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Republikës së Kosovës (9 prill 2008) Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë.

KAPITULLI III E DREJTA CIVILE PJESË E SË DREJTËS

1.Zhvillimi historik i të Drejtës Civile

Ato qe shohim sot si gjera me rendësi dhe te cilat kanë refleksion shoqëror nuk janë të zhvilluara për një moment siç ne i shohim sot te zhvilluara dhe te suksesshme. Çdo dukuri shoqërore ka një historiat të saj i cili përshkruan rrugëtimin nga fillimi gjër ne ditët e sotme kur ne e vlerësojmë si te dobishme dhe te suksesshme. Edhe e Drejta Civile përmes se cilës rregullohen raporte shoqërore me karakter pasuror ka historinë e saj nga fillimi dhe historiatin e zhvillimit e që është e ndarë në etapa të ndryshme gjër ne ditët e sotëm kur konsiderohet njëra ndër shkencat më të rëndësishme. Ajo qe vlen te ceket dhe ku mund te fillohet te trajtohet e Drejta Civile është se kjo e drejt buron nga E Drejta Romake. Fillimisht si gjenezë E Drejta Civile ka Ligjin e 12 Tabelave. Përmes Ligjit te dymbëdhjetë tabelave Romaket kishin marr iniciativën që përmes Ligjit të mbrojnë dhe tu garantojnë të drejtat sociale, civile ne mes klasës se privilegjuar dhe atë te thjeshte.⁵²

Ligji i 12 tabelave në mënyrë të përgjithësuar ka synuar që të rregulloj të drejtat elementare sociale, civile, trashëgimore, pronësore dhe familjare të qytetarëve të asaj kohe të cilët ishin kategori e dorë së dytë. Në kuadër të ligjit të 12 tabelave, tabela e 1 është përber nga dhjetë nene ku përmes së cilave është trajtuar çështja e procedurës gjyqësore. Në kuadër të tabelës së 3 e cila përbehej nga 10 nene dhe rregullonte çështjen e dhënies së pronës në shfrytëzim. Ndërsa në tabelën e 4 trajtohej çështja e të drejtave të atit dhe të drejtat martesore. Tabela 5 në kuadër të neneve të saj trajtonte çështjen e pasurisë dhe kujdestarisë. Tabela e 6 e cila ne vete kishte 10 nene fokus kishte pronësinë dhe posedimin. Tabela e 8 që në përbërje kishte 9 nene rregullonte çështjen e pronës së paluajtshme.⁵³ Nga ato që përmbajnë disa nga tabelat në kuadër të Ligjit, shifet se qysh në atë kohë dhe në ato dokumente janë trajtuar institutet e së drejtës Civile si institute me karakter rregullativ për rregullimin e disa raporteve shoqërore me karakter pasuror. Pra fillet e së Drejtës Civile i gjejmë ne Ligjin e 12 tabelave ku nga ajo kohë ku ka qen viti 387 p.e.s mund te llogaritet udhëtimi i së Drejtës Civile dhe gjër ne ditët e sotme. Qysh në atë kohë është vlerësuar se është shumë me rendësi që qytetari të sigurohet me dispozita ligjore sa i përket të drejtave të tij lidhur me pronën, trashëgimin, familjen dhe pronën. Kjo është vlerësuar se raportet shoqërore e të cilat kanë karakterin pasuror duhet te rregullohen dhe te parashihen te drejta dhe detyrime reciproke. Ajo që duhet të potencohet është fakti se e Drejta Civile tani ka ndryshime te mëdha ne raport me kohën e fillimit të sajë. E drejta civile pas Ligjit te 12 tabelave

⁵²K. Kryeziu (2017) E Drejta Romake, Prizren Fq. 51.

⁵³Po aty. Fq.56,57,58,59.

rrugëtimin e saj e kishte realizuar në kuadër të së Drejtës Romake si baza e së drejtës Civile në shumë vende të botës.

2.E drejta private dhe publike

Kur mendojmë dhe flasim për të drejtën, mendja na shkon tek e Drejta Romake si zanafillë dhe burim i të drejtave tjera. Historia e ndërtimit të së drejtës me theks të veçante të shteteve pas rënies së Perandorisë Romake na bën të njohur se e drejta Romake ka pasur refleksion të madh dhe ka vendosur themelet e sistemeve juridike të atyre shteteve që ne sot i vlerësojmë se kanë një sistem të së drejtës të suksesshëm. E rëndësishme të ceket është se edhe në kuadër të së Drejtës Romake si dhe me refleksin edhe në të drejtën e sotme kemi pasur ndarje të kësaj të fundit në dy grupe dhe atë në të drejtë publike (*ius publicum*) dhe të drejtë private (*ius privatum*). Me të drejtën publike kemi të bëjmë me grupimin e normave juridike, përmes së cilave rregullohet aspekti juridik i shtetit si dhe raportet e qytetarit me shtetin si një raport përmes së cilit rregullohet pozita e qytetarit në një shtet. Ndërsa përmes së drejtës private në të cilën kemi grupim të normave juridike përmes së cilave rregullohet pozita juridike e qytetarit si dhe të drejtat që ne vete kanë karakter personal, pasuror.⁵⁴ Ndarja e së drejtës Romake në të drejtën Publike dhe Private e cila është e trashëguar edhe në ditët e sotme në të drejtat e shteteve tregon se kur kemi të bëjmë me të drejtën dhe normat që përbejnë atë ekziston një dallim mes atyre publike dhe private për faktin se në njërin kemi palë shtetin dhe qytetarin ndërsa në tjetrën vetëm qytetaret mes vete.

E rëndësishme të trajtohet e drejta private dhe publike është për faktin se nga e drejta private ka derivuar e Drejta Civile e cila ka marr për sipër që raportet njerëzore me karakter pasuror ti parasheh dhe rregulloj. Edhe në historinë e së drejtës private e njëjta është ndarë në tri grupe kryesore dhe funksionale. E drejta private ishte ndarë në: *Ius quod ad personas pertinet*, që është e drejta e personave. Kjo e drejtë përmes normave të saj ka trajtuar të drejtat dhe raportet personale ndërmjet qytetarëve Romak. Në atë kohë rregullimi i këtyre marrëdhënieve ju ka referuar statusit të personit fizik dhe juridik, pozitën e qytetarit të lirë dhe atë skllav si dhe marrëdhëniet ndërmjet burrit dhe gruas, raportet ndërmjet babait dhe fëmijëve si dhe kujdestarisë dhe tutorisë. Ndarja tjetër është ajo e *Ius quod res pertinet*, që është e drejta pronësore, ku përmes normave që ka në tersin e saj përmes së cilave rregullohen pronësia, posedimi, të drejtat mbi sendet e huaja, marrëdhëniet e detyrimeve, trashëgimose. Pjesë tjetër dhe e fundit e së drejtës private është *Ius quod ad actiones pertinet*, normat të cilat grumbullonte kjo e drejtë rregullonte aspektin procedural përmes së cilave aktivizohet e drejta

⁵⁴.Po aty. Fq. 20.

materiale për mbrojtjen e të drejtave subjektive të qytetarëve të vendit.⁵⁵ Kjo ndarje dhe ky degëzim nga e drejta private krijon bazën e parë të krijimit të së drejtës Civile si një e drejtë përmes së cilës do ndërtohen institute të së drejtës e të cilët kanë fokus marrëdhëniet shoqërore që në përfundimin e tyre është prezent elementi pasuror dhe financiar. Kjo ndarje i takon së kaluarës dhe historisë së të drejtës private nga e cila kanë lindur disa degë të së drejtës që sot janë të drejta pozitive në vend.

Në kuadër të së drejtës private kanë lindur dhe në të kenë bazën edhe disa degë të së drejtës përveç së Drejtës Civile edhe e Drejta Tregtare, E Drejta Pronësisë Intelektuale, E drejta e Autorit, E Drejtës Pronësisë Industriale, E Drejta e Punës.⁵⁶ Nga kjo që shifet bazë e çdo dege të së drejtës bazën e ka në të drejtën private e cila nga reformimi i saj ka arrit që përmes zhvillimit të saj të krijoj dhe ndaj çdo të drejtë të veçantë të së drejtës që është tejet e rëndësishme. Kjo ndarje vije si rezultat i forcave të prodhimit, ndryshimeve shoqërore, dhe ndryshimit të konceptit ekonomiko- social që është baza e çdo ndryshimi. Kjo ndarje bën të njohur edhe një fakt se e drejta Private çdo here ka qenë hap me ndryshimet shoqërore që kanë ndodhur e të cilat dihen se çdo here janë një hap para së drejtës, ku e drejta duhet çdo here ti përcjell dhe të ndryshoj konform tyre.

Nëse shikohet e drejta përbehet nga dy sisteme kryesore normative dhe dallimet që ekzistojnë mes tyre. Dy sistemet kryesore janë E drejta Private dhe ajo Publike. E drejta private është sistem i normave përmes së cilave rregullohen marrëdhëniet midis personave. Sipas Romakëve e drejta private ka në fokus mbrojtjen e interesave të veçanta të individëve. Kuptimi i kësaj është se përmes së drejtës private individi në raport me individin tjetër rregullon raportet shoqërore me karakter privat që ju takojnë vetëm atyre.⁵⁷ E drejta Private është baza dhe historia e zhvillimit të degëve të së drejtës e të cilat bëjnë pjesë në të drejtën private. Njëra ndër të drejtat që bën pjesë në këtë të drejtë është edhe e Drejta Civile. Kjo e drejtë përmes normave të saj rregullon marrëdhënie private që kanë karakter pasuror apo në fund marrin karakterin pasurorë.

⁵⁵Po aty. Fq. 21.

⁵⁶A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 26.

⁵⁷F. Galgano(2006) E Drejta Private, Tiranë. Fq. 40.

3.Sistemi i së drejtës civile

Si çdo gjë tjetër edhe e Drejta Civile ka historinë e saj te fillimit dhe zhvillimit e që është një pasqyrë se ka rrugëtuar gjër me tani e Drejta Civile. Në kuadër të së Drejtës Civile janë edhe disa degë të së drejtës të cilat në tersi e përbejnë të drejtën civile. Ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe sociale kanë diskutuar që të ketë ndryshime dhe reforma edhe në të drejtën Civile.

E drejta civile është e sistemuar dhe përmban ndarjet e veta e të cilat kanë në vete disa karakteristika. Janë dy forma në të cilat ndahet e drejta Civile që janë: sistemi institucional dhe pandekt. Me sistemin institucional kuptojmë qasjen e juristit romak Gaji i cili e emëroj kështu për faktin se kishte marr emrin prej pjesës së parë të Kodit të Justinianit. Sipas kësaj e drejta civile ndahet në tri pjesë: persona, sende dhe padi. Sistemi pandekt i cili ka lidhmëni me Pandestin e Justinianit dhe sipas kësaj e Drejta Civile ndahet në: reale; obligacione, familjare dhe trashëgimore.⁵⁸ Këto ndarje tregojnë zhvillimin e së drejtës Civile dhe sistematizimin e sajë, kjo ka ndodhur për faktin se si rezultat i forcave të prodhimit kemi edhe ndryshime shoqërore e të cilat janë reflektuar edhe në reformimin e së Drejtës Civile. Në të drejtën tonë e Drejta Civile përbehet nga katër pjesë: Pjesa e përgjithshme e së drejtës civile; e drejta sendore; e drejta e detyrimeve dhe e drejta trashëgimore.⁵⁹ Ndarja që i referohet këtyre pjesëve e bën me te kompletuar të Drejtën Civile për faktin se raportet shoqërore të cilat në një formë kanë elemente pasurore por janë te ndryshme janë ndarë në pjesë të veçanta. Kjo ndarje është pozitive edhe për faktin tjetër se është më e lehtë qasja e studiuesve për një pjesë të veçante, përpos kësaj edhe aspekti normativ është më i lehtë dhe i kuptueshëm.

Në Kosovë e Drejta Civile është pjesë e sistemit juridik të vendit dhe përmes sistematizimit të normave të sajë rregullon raportet shoqërore me karakter pasuror apo në fund marrin karakterin pasuror. Ndarja e pjesëve të së drejtës civile është e mbuluar me legjislacion përkatës përmes së cilit rregullohen fushat e ndara të së drejtës civile. Pjesa e përgjithshme e së drejtës civile është e normuar në pjesët tjera të së drejtës civile. E drejta Sendore është kategori ligjore dhe rregullohet me ligj të veçantë, ku ky “ ligj rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e të drejtave sendore.”⁶⁰ Edhe e drejta e detyrimeve është kategori ligjore dhe rregullohet me dispozita përkatëse ligjore, ku “Ky ligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj marrëdhënieve të detyrimeve të rregulluara me akte të tjera ligjore në lidhje me çështjet që nuk rregullohen në këto akte”.⁶¹ Edhe e drejta trashëgimore është në kuadër të sistemit juridik të vendit dhe është e sistemuar me dispozita ligjore që rregulloj marrëdhëniet juridiko

⁵⁸A. Gams(1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë. Fq. 61.

⁵⁹A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 55.

⁶⁰Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04 gusht 2009). Shih nenin 1 par. 1.

⁶¹Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 16 / 19 qershor 2012, Prishtinë). Shih nenin 1 par.

trashëgimore mes individëve, ky “Me këtë Ligj rregullohet e drejta e trashëgimisë. Me këtë Ligj rregullohen procedurat në bazë të cilave gjykata, organet tjera dhe personat tjerë të autorizuar duhet të veprojnë në çështjet trashëgimore”⁶²

4.Marrëdhëniet shoqërore me karakter pasuror dhe rregullimi i tyre me norma juridike

Me ngritjen e vedijës së njeriut është kuptuar se jeta nuk mund të zhvillohet vetëm, mirëpo duhet të ketë marrëdhënie mes njerëzve e të cilat kërkojnë që të rregullohen përmes disa rregullave qe jeta e tyre te bazohet ne te drejta dhe detyrime reciproke. Marrëdhëniet shoqërore janë shumë të gjera dhe përfshin shumë raporte dhe një hirit janë komplekse. Nga fakti se janë komplekse dhe përfshin raporte mes njerëzve është vlerësuar që në të kaluarën se marrëdhëniet shoqërore duhet të bazohen dhe rregullohen me norma. Përmes normimit marrëdhëniet shoqërore janë rregulluar dhe kanë qenë të pranuar për njerëzit si mekanizëm që ndikon në zhvillimin e jetës duke pasur raporte te rregulluara shoqërore. Në fillim kryesisht marrëdhëniet shoqërore janë normuar nga normat shoqërore të cilat shoqëria i ka caktuar dhe i ka zbatuar.

Zhvillimi shoqëror, ai ekonomik i shoqërisë e ka bere te nevojshme të krijoj normat e caktuara të sjelljes përmes së cilave do të rregullohej jeta shoqërore. Norma ka kuptimin e rregullës përmes së cilës rregullohen sjelljet e njerëzve dhe sjelljen e njerëzve ne raport me normën. Normat shoqërore përpos që rregullojnë jetën shoqërore ato njëkohësisht kufizojnë lirinë e sjelljes së individit në shoqëri, duke mos lejuar të ketë sjellje të cilat do ti dëmtonin raportet shoqërore.⁶³ Raportet shoqërore janë tejet komplekse dhe te njëjtat e kanë shumë te nevojshme te kenë standarde dhe rregulla mbi te cilat duhet te funksionojnë marrëdhëniet shoqërore. Niveli sa më i lartë i vedijës së shoqërisë duke përfshi në çdo aspekt dhe çdo fushë mundëson dhe krijon numër më të madhe të marrëdhënieve shoqërore e të cilat për te qen efikase duhet te përcaktohen dhe rregullohen me norma.⁶⁴Marrëdhëniet shoqërore janë kategori dinamike që nga e kaluara gjer me tani kanë pësuar ndryshime te theksuara. Te qenurit kategori dinamike ka qen fakti që shoqëria ka bere planifikime për normimin e tyre, në fillim si rregulla shoqërore, më pas si e drejt zakonore dhe në fund si të norma juridike.

Historikisht shoqëria marrëdhëniet e veta i ka pasur të rregulluara përmes normave zakonore, normave të moralit dhe ato Juridike. Normat zakonore hyn në grupin e normave shoqërore dhe krijimi i tyre

⁶²Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (Gazeta Zyrtare 3/2006, Data e publikimit:01.08.2006 Prishtinë). Shih nenin 1 par. 1,3.

⁶³M. Hetemi (2002) E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë. Fq. 21.

⁶⁴Po aty. Fq. 22.

është mbi bazën e përsëritjes së tyre në një kohë dhe hapësirë të caktuar. Praktikimi i tyre për kohë të gjatë i bënë shumë të pranueshme dhe të zbatueshme si dhe të trashëguara gjenerata në gjeneratë. Normat zakonore janë refleksioni i parë i shoqërisë karshi nevojës së rregullimit të raporteve shoqërore dhe mund të konstatohet se janë normat më të vjetra që i takojnë edhe kohës primitive dhe kanë pasur një lidhmëni të madhe me shoqërinë. Duke pas për bazë që janë normat e para shoqërore, normat zakonore kanë qenë burim i shumë normave juridike të cilat janë nxjerr nga sistemet juridike në vend. Duke qenë normat e para shoqërore, kanë qenë edhe bartës të shumë zhvillimeve siç kanë qenë zhvillimi i marrëdhënieve tregtare, ekonomike, civile, familjare, trashëgimore, pronësore etj.⁶⁵

Burim kryesor i së drejtës është e drejta zakonore për faktin se është iniciativa e parë shoqërore për normim të marrëdhënieve shoqërore, prandaj rëndësia e tyre është e madhe për faktin se me vete bartë historinë dhe traditën e rregullimit shoqëror. Sistemit të së drejtës i ka ndihmuar shumë e drejta zakonore pasi shumë norma vetëm i ka dhënë karakterin e normës juridike, disa tjera i ka reformuar dhe me pas i ka transferuar në norma juridike dhe ka pas një konsistencë shoqërore sa i përket rregullimit të marrëdhënieve shoqërore.

⁶⁵Po aty. Fq. 24.

KAPITULLI IV BURIMET E SË DREJTËS CIVILE NË KOSOVË

1. Burimet e të drejtës civile

Kur flitet dhe vepohet në emër të së Drejtës është e natyrshe dhe arsyeshme të mendohet dhe më pas të kërkohet nga ku buron e Drejta. Interesimi se nga ku buron e drejta çdo herë ndërlidhet me efektet që ka e drejta në jetën shoqërore dhe në raporte juridike mes njerëzve dhe rëndësia e saj në rregullimin e këtyre raporteve. Përpos që këtë e trajton interesimi i njerëzve kur ballafaqohen me të drejtën për këtë kemi interesim edhe nga aspekte tjera. Interesimi dhe debati që ngritet rreth burimit të së drejtës është edhe nga këndvështrimi shkencor pra shkencë juridike e debaton dhe trajton nga ku e ka burimin e drejta. Përpos kësaj edhe praktika gjyqësore dëshiron të jetë e njoftuar me burimin e së drejtës nga se vendos përmes së drejtës për raporte njerëzore me karakter shoqëror. Është e natyrshe që nga këndvështrimi shkencor i kësaj çështje kemi teori dhe mendime të ndryshme të cilat i kundërvihen njëra tjetrës duke pretenduar në arsyetimet e tyre e në harmoni me fakte.

Kur trajtojmë burimet e së drejtës, vërejmë sa janë komplekse dhe të shumta sa që duhet të kemi parasysh të gjitha elementet, se të gjitha janë pjesë përberëse e së drejtës varësisht prej shteteve dhe orientimeve të tyre. Karakteristika e të qenurit të ndryshme është se varet si krijohet e drejta dhe ku krijohet, ndikimet fetare dhe ideologjike prandaj burimet e së drejtës janë të ndryshme dhe posedojnë karakteristika të ndryshme. E drejta është ajo se në çfarë bazohet dhe çfarë ka burim, kjo është determinuese për të drejtën dhe formën e saj.

Tek burimet e së drejtës, kur zakonet janë burim i së drejtës, është karakteristik se të drejtat ku nuk kanë saktësi, dhe janë të palëvizshme. Këto të drejta ju atribuohen shoqërive statike dhe të qëndrueshme të cilat ruajnë disa parime, dhe zakone të cilat me gjenerata janë kultivuar dhe konsideruar me vlera shoqërore. Jurisprudenca duke qenë burim i së drejtës, është karakteristik se mundëson që e drejta të ketë zhvillim dinamik dhe empirik në krahasim me legjislacionin, kjo për faktin se jurisprudenca zhvillohet rast për rast dhe krijohet precedenti i cili shërben në të ardhmen për rastet e njëjta. Karakteristikat e të qenurit burim i së drejtës ligjet është se e drejta është kategori tejet dinamike e cila ndryshon, reformohet varësisht ndryshimeve të ligjeve. Kjo e drejtë është tejet e qartë pasi shpesh cdo detaj dhe kjo një herit është e lëvizshme. Duke shkurtruar globalizimit, kjo nënkupton se edhe e drejta duhet që të jetë në hap me kohën, prandaj si burim i së drejtës është edhe e drejta ndërkombëtare dhe karakteristik e kësaj është tendenca e të qenurit prezent në të drejtën vendore e asaj të huajës. Në

kohen e globalizmit dhe liberalizimit kjo është prezentë por cdo here duke e pasur për bazë mos cenimin dhe rrezikimin e së drejtës vendore.⁶⁶

Në kuadër të mendimeve kemi koncepte se shkaqet qe nxisin krijimin e së drejtës ndërsa të tjerët kanë konceptin se janë faktet shoqërore e nën ndikimin e faktorëve përkatës arrin të krijojnë të drejtën. Lidhur me këtë kemi edhe mendimin se materializimi dialektik është faktor i krijimit të së drejtës është lufta klasore si nxitës i prodhimit dhe forcave të prodhuese. Siç ndodh tek teoritë te kundërshtohen edhe teoria materialiste e së drejtës kundërshtohet me arsyetimin se shkaqet e së drejtës janë jashtë sferës materiale dhe atë pikërisht në ide dhe vetëdije.⁶⁷ Mendimet dhe teoritë për burimet janë ndërtuar konform rrethanave shoqërore, sistemit politik, gërshetimit me aspektin filozofik, andaj kemi edhe mendime ndryshe lidhur me burimet e së drejtës. Forcat e prodhimit llogariten si katalizator të shumë proceseve dhe ndryshimeve andaj edhe në procesin e burimit të së drejtës mund të konsiderohen si faktor shumë i rëndësishëm.

Kuptimi dhe domethënia e burimeve të së drejtës është i ndërlidhur dhe done të thotë burim i normave juridike. Nga kjo rrjedh kuptimi se ku buron norma juridike, ku bazohet kjo normë dhe nga kush vihet ne jete. Historia e njeh konceptin e ndarjes së burimeve të së drejtës dhe atë në burimet materiale dhe formale. Kuptimi i burimit material është i ndërlidhur drejtpërdrejt me forcën, fuqinë dhe vullnetin e klasës sunduese apo udhëheqëse të një vendi. Përpos kësaj kemi edhe burimet e së drejtës në kuptimin formal e që kuptimi i saj është forma se si manifestohet ky vullnet i klasës sunduese.⁶⁸ Siç kemi një ndarje të së drejtës në fusha të saj e të cilat në vete kanë objektin e tyre kanë edhe burimet e tyre. Edhe e drejta Civile ka të drejtat e saja mbi të cilat është mbështetur dhe mbi bazën e reformimit tani bazohet.

Sistemi juridik i një vendi gjegjësisht te një shteti konkret ne vete ka të inkorporuara veçorit e përgjithshme të sistemit juridik dhe veçorit e posaçme, çka e ndryshon nga të tjerët si një sistem juridik i veçantë.⁶⁹ Sistemi juridik i çdo shteti bart me vete dhe ka të inkorporuara shumë karakteristika të atij vendi që e bëjnë të dalluar nga sistemet juridike të vendeve tjera. Në kuadër të sistemit juridik si elemente dalluese mund te themi se janë aspekti ekonomik – social, politik, zhvillimor dhe pjesa e traditës dhe kulturës se atij populli. Këto janë elemente të cilat e përcjellin në çdo kohë sistemin Juridik të një vendi.

Nga burimet formale të së drejtës civile na rrjedh e drejta pozitive e së drejtës civile në një vend, e Drejta Civile pozitive e çdo shteti përbehet nga tërësia e normave të së drejtës që ekzistojnë në

⁶⁶M.Fromont (2009)Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës, Tiranë. Fq.11

⁶⁷Po aty. Fq. 52

⁶⁸A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë. Fq. 63.

⁶⁹S. Blagojević (1980) Sistematizacija prava – njen osnov I cilj, Pravno misao, Sarajevo. Fq.11, 12.

momentin aktual në shtetin konkret. Burimet pozitive të së drejtës civile në vete përshkruajnë dhe pasqyrojnë nivelin ekzistues të marrëdhënieve ekonomike dhe të kushteve tjera shoqërore si dhe ato kulturore që luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e legjislacionit pozitiv të një shteti.⁷⁰

Rreth asaj se cilat janë burimet pozitive të së drejtës civile ekzistojnë mendime të ndryshme, kemi mendime të ndryshme rreth asaj se cilat burime pozitive të së drejtës civile duhet që të jenë të zbatuara në kuadër të një sistemi juridik. Ndryshimet na dalin lidhur me burimet e së drejtës civile edhe të forma e rregullimit të sistemit juridik të shteteve, varësisht kësaj kemi edhe ato çka janë burime pozitive të së drejtës civile. Në shumicën e vendeve si burime formale në të gjitha të drejtat civile konsiderohen ligji dhe e drejta zakonore, ndërsa burimet tjera formale si praktika gjyqësore, doktrina juridike janë ende në diskutim nga autor që fushën e studimit të tyre e kanë tek burimet e së drejtës civile.⁷¹ Edhe në kuptimin juridik dhe praktik jo çdo shtet mund të ketë burimet e së drejtës civile të njëjta, kjo ngase shtetet janë në faza të ndryshëm të zhvillimit. Te qenurit të ndryshëm të burimeve të së drejtës civile i ndihmon shumë shkencës dhe praktikës në krahasimin e tyre dhe nxjerrjen e rekomandimeve të rëndësishme për reformimin e sistemit juridik të vendeve.

E drejta Romano – Gjermane i trajton dhe ju përcakton vendin e tyre në rendin juridik të shtetit këto burime formale të së drejtës civile: ligji; e drejta zakonore; praktika gjyqësore; doktrina; principet (parimet) gjeneralë të së drejtës.⁷² Në lidhje me burimet e së drejtës civile kemi edhe mendimin e profesorit Varbonnier, për të cilin burime të vërteta të së drejtës civile janë ligji dhe e drejta zakonore, ndërsa praktika gjyqësore dhe doktrina janë thjesht autoritare sepse ato nuk kanë të njëjtin rol krijues.⁷³ Burimet e së drejtës civile janë kategori dinamike ku ndryshimet dhe avancimet janë prezentë në çdo kohë dhe hapësirë. Dinamika e zhvillimit dhe ndryshimit është e ndërlidhur me zhvillimin ekonomik – social, ekonomin e tregut dhe proceset integruese. Këta faktor që në vete janë dinamik janë përcaktues edhe të ndryshimeve tek burimet e së drejtës civile, andaj për këtë burimet e së drejtës civile janë në relacion me ndryshimet shoqërore, ekonomike, politike dhe integruese.

⁷⁰S. Bobcev (1993) Istorija na Bulgarskoto pravo, Burgas. Fq. 70.

⁷¹Ch.Larroument (1984) Droit Civil - Introduction a l'etude du droit prive, Tome I, Paris. Fq. 121.

⁷²D. Rene (1982) Les grands systemes de droit civil contemporains, Delloz, Paris. Fq. 106.

⁷³J. Carbonnier (1982) Droit Civil, 1 - Introduction, les Personnes, Themis, Paris. Fq. 111.

2. Burimet materiale të së drejtës civile

Te studiohen dhe te shtjellohen burimet e së drejtës civile është sfiduese dhe shumë komplekse për faktin se ka shumë dhe çdo njëra ka rendësin e vet në kuadër të sistemit juridik të një vendi. Ndarjen e burimeve e ka diktuar aspekti i zhvillimit shoqëror, ekonomik, historik dhe ai juridik. Burimet e së drejtës janë në koherencë dhe në harmoni mes vete.

Shkenca dhe praktika njih ndarje të burimeve të së drejtës civile në ato materiale dhe ato formale. Në kuptimin material të burimeve të së drejtës civile i jepet aspektit të forcës së shtetit, e cila përmes mekanizmave të saj arrin të krijojë dhe imponojë të drejtën.⁷⁴ Në të kaluarën shteti ka qenë forca kryesore sa i përket krijimit të së drejtës dhe zbatimit të saj. Në sistemet e kaluara juridike ku çdo gjë ka qenë e koncentruar tek shteti, shteti të drejtën e ka krijuar ekskluzivisht për qëllim të mbrojtjes së vetë dhe kjo formë i ka mundësuar që të mbijetojë dhe të ketë qasje superiore në çdo sferë të jetës. Në të kaluarën çdo gjë ka derivuar nga shteti dhe ka shërbyer për mbrojtjen e ideologjive, parimeve dhe pozicioneve të ndryshme shoqërore. Në të kaluarën forca e shtetit ka arritur të krijojë të drejtën në cilësinë e autoritetit absolut që ka pasur. Nëse i referohemi të drejtës në kuptimin e klasës sunduese dhe asaj të sunduar e drejta është vullnet dhe mundësi e klasës sunduese që ka krijuar fizionominë e së drejtës nga shteti dhe i shërben për ta zbatuar ndaj klasës sunduese.⁷⁵ Në të kaluarën e drejta ka buruar drejtpërdrejt nga shteti dhe ka përdorur për qëllim të tij duke i mbajtur nën kontroll synimet dhe aspiratat e një pjese të shoqërisë. Kuptimi material i së drejtës civile ka ndryshuar me ndryshimin e konceptit të shtetit. Krahas ndryshimit të formës së funksionimit të shtetit ka ndryshuar edhe forma e burimit material të së drejtës.

Kur çdo gjë ka qenë e koncentruar tek shteti dhe me shtetin kanë udhëhequr individ apo grup i ngushtë tek këta ka qenë e koncentruar forca që e kanë diktuar edhe mënyrën e bërjes së drejtësisë. Qëllimi i kësaj mënyre për ta pasur nën kontroll bërjen dhe zbatimin e së drejtës është bërë për faktin se kjo ka mundësuar të siguron qëndrimin afatgjatë në krye të shtetit duke bërë ndarjen e drejtësisë. Burimet materiale të së drejtës të koncentruara tek forca e shtetit ku përmes mekanizmave të saj arrin të shtyjë krijimin e të drejtës dhe transformimin e saj në burime formale të së drejtës është e ndryshme edhe në aspektin kohor. Roli i shtetit si mekanizëm për burim material të së drejtës është i ndryshëm që nga koha e shteteve të para, atyre të sistemit totalitar dhe atyre tani demokratike.

Koncepti i shtetit sot është i ndryshëm nga ai që ka qenë më parë ku çdo gjë ka qenë e koncentruar tek një grup i ngushtë dhe ideologjia partiake ka qenë politik bërja në shtet. Sot shteti është mekanizëm që

⁷⁴A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 113.

⁷⁵M. Hetemi (2002) E drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë. Fq. 25.

funksionon për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut i bazuar në vlerat më sublimë. Për dallim nga e kaluara tani ajo forca e shtetit si burim material i së drejtës civile është një koncept i politik bërjes së shtetit dhe krijimin e së drejtës që do të rregullon sjelljen e raporteve njerëzore në marrëdhëniet juridiko civile.

3. Burimet formale të së drejtës civile

Nga burimet materiale të së drejtës na derivojnë burimet formale të së drejtës civile të cilat kanë lidhmëni reciproke mes vete. Burime formale të së drejtës civile janë ato format përmes së cilave na paraqiten normat e së drejtës civile.⁷⁶ Përmes burimit formal të së drejtës civile arrihet të bëhet materializimi i së drejtës civile në normë konkrete e cila më pas është mekanizëm që rregullon marrëdhëniet juridike civile mes njerëzve. Në kuadër të sistemit juridik, burimet e së drejtës civile janë çdo herë në funksion të sistemit juridik dhe janë në lidhmëni reciproke.

Lidhur me burimet formale të së drejtës civile ka mendime të ndryshme sa i përket përbërjes, ekzistojnë mendime se në kuadër të burimeve formale të së drejtës civile nuk ka mundësi që të jenë Ligji, e drejta zakonore, praktika juridike dhe shkenca juridike. Burimet formale të së drejtës civile ndryshojnë nga shteti në shtet, nuk janë të njëjta prandaj edhe studimi i tyre është i ndarë për çdo shtet. Shtetet që të drejtën civile e kanë të kodifikuar, kanë mendimin se burim i së drejtës civile është vetëm Ligji dhe e drejta zakonore.

Sa i përket burimeve formale të së drejtës civile edhe autorët Evropianë kanë mendimin e tyre, të cilët konsiderojnë se burim formal i së drejtës civile janë: Ligji, konventat ndërkombëtare, e drejta zakonore, praktika gjyqësore, parimet e së drejtës dhe shkenca juridike.⁷⁷ Ky është një mendim gjithëpërfshirës sa i përket burimeve formale të së drejtës civile dhe nuk përjashton asnjërin. Autorët që burimet e së drejtës civile i ndajnë në të shkruara dhe të pashkruara, ligjin, të drejtën zakonore dhe jurisprudencën i konsiderojnë burime të së drejtës civile, ndërsa doktrina nuk mund të kualifikohet si burim i së drejtës apo nuk është burim i drejtpërdrejtë i së drejtës civile.⁷⁸

Në kuadër të mendimeve kemi edhe atë kur thuhet se në kuadër të burimeve formale të së drejtës jurisprudenca dhe doktrina kualifikohen si autoritet në lëmin e interpretimit, ndërsa burime të së drejtës civile janë e drejta e shkruar dhe e drejta zakonore.⁷⁹ Profesori Durantoni thekson se e drejta e një

⁷⁶A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë. Fq. 73.

⁷⁷M. Miaille (1982) Une introduction critique au droit, Paris. Fq. 239.

⁷⁸A. Écail & F. Terre (1979) Droit civil, Introduction Generale, Paris. Fq. 244.

⁷⁹J. Chevallier & L. Beach (1975 - 1979) Droit civil, Paris. Fq. 4.

populli nuk është vetëm ajo se çka është e shkruar dhe e shpallur por është më zgjnimisht ku përfshin të drejtën zakonore dhe ato që me kalimin e kohës janë ushtruar dhe janë krijuar si zakone.⁸⁰

Në periudha të ndryshme kohore dhe nga studiues të ndryshëm na ofrohen mendime të ndryshme sa i përket përbërjes së burimeve formale të së drejtës civile. Pikëpamjet e ndryshme lidhur me burimet e së drejtës civile e sjellin një kuptim shumë të mirë të asaj se burimet e së drejtës janë dinamike. Mirëpo duhet ta kemi parasysh se është e pamundur që sistemin juridik të një vendi të përbejnë vetëm një kategori e burimeve, unë mendoj se janë të gjitha ato që e përbejnë burimet e së drejtës civile. Mund të ketë rengime sa i përket burimeve, mirëpo çdo njëra është në relacion me krijimin e së drejtës në mënyra të ndryshme.

Në kuadër të sistemit juridik të vendit, burimet formale të së drejtës civile përbejnë të drejtën pozitive që është në kuadër të sistemit juridik. Ku me të drejtën pozitive në kuadër të një sistemi juridik kuptohet grupi i normave të së drejtës civile por që janë të zbatuara në atë moment.⁸¹Lidhmërija mes burimeve formale të së drejtës civile dhe të drejtës pozitive civile në kuadër të sistemit juridik të shtetit është shumë e madhe dhe e pamundur të funksionojnë si të ndara.

4.Ligji

E drejta civile fillimisht është e mbështetur në burimin e së drejtës së shkruar që është Ligji. Ligji është në hiarkin më të lartë të burimeve të së drejtës civile në të gjitha ato vende ku ka sistem juridik dhe fusha të së drejtës. Përpos që është burim i së drejtës civile ligji krijon edhe të drejtën pozitive e cila është ajo e drejtë që gjen zbatim në atë moment kur është në fuqi.

Burimet materiali dhe ato formale të së drejtës civile kanë një lidhmëni reciproke mes vete. Kjo për faktin se burimi material ishte fuqia e shtetit e cila përmes mekanizmave të saj arrin që të përcaktoj se qfar është e drejt. Përcaktimi se qfar është e drejt shteti e proklamon përmes ligjeve, ku përmes tyre arrin që të krijoj të drejtën si një mekanizëm që rregullon fusha të caktuara e në këtë rast atë të së drejtës civile. Nga kjo shifet se Ligji si burim formal i së drejtës civile buron nga burimi material i së drejtës që është forca e shtetit.

⁸⁰M. Duranton (1834) Cours de Droit Français, Tome I, Paris. Fq. 20.

⁸¹A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 117.

5.E drejta zakonore

Në kuadër të burimeve formale të së drejtës civile një vend të rëndësishme zënë edhe e drejta zakonore. Ajo se qfar është me rëndësi të ceket është fakti se e drejta zakonore është më e vjetër se ligji, mirëpo ligji ka avancuar dhe sot e kemi burimin kryesor të së drejtës civile. E drejta zakonore ka lindur në periudha të ndryshme kohore dhe në faza të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë. E rëndësishme të ceket është se e drejta zakonore ka gjetur zbatim dhe respektim pa mekanizmin shtetëror të zbatimit. Nga kjo del se e drejta zakonore ka buruar nga populli dhe nga praktikimi i saj në një kohë të gjatë ka arritur që të jetë burim i së drejtës civile.

Te drejtën zakonore e përbejnë norma të cilat krijohen duke gjetur përsëritje të vazhdueshme në të njëjtën mënyre nga njerëzit në kohë të caktuar dhe më pas për këtë është krijuar mendimi se se janë norma për të cilat qytetaret kanë obligim të zbatojnë me përpikmeri.⁸² Prandaj të drejtën zakonore e krijon populli në një formë të heshtur dhe me kalimin e kohës kjo arrin dhe bëhet burim i së drejtës civile dhe shërben për rregullimin e marrëdhënieve juridike civile.

Edhe nëse sistemi juridik i një vendi është i kompletuar dhe fushën e së drejtës civile e konsideron se e ka të mbuluar me legjislacionin përkatës, përsëri e drejta zakonore gjen respektim dhe aplikim, kjo ndodh atëherë kur ndonjë pjesë nuk është e mbuluar me dispozita përkatëse ligjore gjen aplikim e drejta zakonore. Në fakt tjetër nuk mund të mohohet sa i përket kontributit të së drejtës zakonore, kjo është burim i shpeshtë i legjislacionit përkatës në fuqi, i cili gjatë hartimit merr ndonjë pjesë, mekanizëm që konsiderohet i rëndësishëm.

6.Interpretimi i ligjeve

Normat juridike janë instrument që ligjvënësi i përcakton për të rrëgallur një çështje të caktuar shoqërore. Edhe normat juridiko civile hartohen për të rregulluar institutet e së drejtës civile përmes së cilave do të rregullohen raportet juridiko civile mes njerëzve. Zbatimi i normave juridiko civile bëhet nga zbatuesit e ligjit që janë gjyqtarët të cilët në mënyrë të drejtpërdrejt bëjnë zbatimin e tyre në praktikë. Në raste të caktuara gjyqtarët hasin në vështirësi sa i përket zbatimit të normës për faktin se nuk arrin të kuptojnë vullnetin dhe atë se çka ka dashur të thotë ligjvënësi me këtë normë. Në këto raste vjen në shprehje interpretimi i normës juridike nga ana e gjyqtarit.

Ndryshimet shoqërore janë një hap përpara sistemit juridik të vendit, prandaj duhet të kemi parasysh edhe faktin e ndryshimeve shoqërore me rastin e interpretimit të normës juridike civile. Ndryshimet

⁸² P. Const (1964) Les sources du droit en science comparative et notions de droit civil ompare, Athenes. Fq. 15.

shoqërore paraqesin situata të reja e të cilat nuk ka qen e mundur të parashihen nga ligjvënësi.⁸³ Ky fakt na bën të njohur një çështje që legjislacioni i së drejtës civile duhet të jete në hap me ndryshimet shoqërore për ndryshe do të kenë probleme ata që zbatojnë të drejtën përkatësisht dispozitat ligjore të së drejtës civile.

Janë të njohura disa mënyra të cilat përdoren me rastin e interpretimit të ligjeve e të cilat na ofrojnë të dhëna të ndryshme. Ajo që është më e shpeshta është interpretimi zyrtar që e bëjnë institucionet shtetërore me qëllim të zbatimit të ti siç është rasti me gjykatat. Përpos kësaj kemi edhe interpretimin e ligjeve që bëhet nga organi që e ka aprovuar dhe nxjerrura ligjin. Ky interpretim na mundëson të kemi të qartë vullnetin dhe atë se qfar ka menduar ligjvënësi me rastin e aprovimit të ligjit. Ky interpretim arrin të ofroj njëpasqyrë të çart tek zbatuesi dhe do të ndihmon shumë në përcaktimin e të drejtës në mënyrën më të mirë të mundshme.⁸⁴

Interpretimi i ligjit është jashtëzakonisht një punë specifike dhe përplot përgjegjësi në kuptimin e asaj nga kush bëhet dhe për qfar bëhet. Ndër interpretimet më specifike dhe të rëndësishme është ai gjyqësor. Aq shumë vlerësohet i rëndësishëm sa ka dy botëkuptime të ndryshme lidhur me këtë mënyrë të interpretimit. E para i referohet atëherë kur me rastin e interpretimit gjyqësor, gjyqtari duhet të identifikoj dëshirën e ligjvënësit. Ky koncept është bazuar në shkollën e të drejtës natyrore, se e drejta është një sistem natyror objektivisht i dhënë, i përsosur, të cilin ligjvënësi vetëm duhet ta shpreh, e gjyqtari, sipas kësaj, vetëm duhet ta gjej dëshirën e ligjvënësit.⁸⁵ Sipas kësaj gjyqtari me rastin e interpretimit të ligjit çdo here duhet të jete në harmoni me vullnetin e ligjvënësit.

Kësaj teorie ju kundërvu një teori tjetër e quajtur shkolla e së drejtës së lirë të gjyqtarëve. “Sipas kësaj teorie nuk është e rëndësishme të dihet çka deshiligjdhënësi kur nxori ndonjë dispozitë, por qfar dispozite do të nxjerrë sikur të jetonte me kohen, në kushtet kur shqyrtohet kontesti konkret”.⁸⁶ Sipas kësaj teorie gjyqtarin e vendos në pozitën që në raste të tilla kur i mungon dispozita përkatëse ligjore, e drejta zakonore, praktika gjyqësore zgjedh kontestin që ka para vetes sipas rregullës që do ta caktonte sikur të ishte ligjvënës.

Nëse i referohemi ndryshimeve të shumta dhe të shpejta shoqërore jo rrallë here kemi situata kur gjyqtari gjendet para situatës kur para vetes ka një kontest i cili as që është i paraparë në kuadër të dispozitave ligjore. Andaj këto situata i obligojnë gjyqtarët që të zgjidhin kontestin në kuptim të praktikës gjyqësore dhe kjo shpesh ka karakter kreativ dhe krijues të së drejtës. Prandaj kjo pjesë është shumë e rëndësishme së hyn në kategorinë e burimeve të së drejtës civile.

⁸³.A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë. Fq. 85

⁸⁴.Po aty, Fq. 86

⁸⁵.Po aty, Fq. 86

⁸⁶.Po aty, Fq. 86

7.Praktika gjyqësore

Praktika gjyqësore hyn tek burimet e së drejtës pasi kjo rrjedh drejtpërdrejt nga zbatimi i së drejtës në praktik. Kjo formë e burimit të së drejtës ndihmon shumë sistemit juridik të vendit pasi në raste të caktuara krijon mundësin e zgjidhjes së kontesteve duke u bazuar në praktikat e së kaluara. Edhe kjo formë e burimeve të së drejtës nuk mbetet pa u vlerësuar dhe jo çdo here është një formë e pranuar si burim. Ekzistojnë teori që cakun se sistemi gjyqësor është ai i cili vetëm duhet te zbatoj të drejtën dhe jo të hartoj atë përmes praktikës gjyqësore. Kjo ngase të zgjedhurit e popullit kanë këtë kompetencë dhe gjitha pushtetet tjera janë në varësi të legjislativit. Kësaj teorie i kundërvihet teoria e cila thekson se jo çdo kontest është e mundur të ketë dispozita përkatëse në kuadër të legjislacionit dhe të ketë mundësi të zgjidhet përmes saj.

Në kuadër të sistemit gjyqësor, kushtetuta dhe ligjet kanë dhen atë përkufizimin e asaj se qfar kanë kompetencë dhe përgjegjësi gjykatat. “Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.⁸⁷ Kjo bazë e detyron gjykatën që në rastet e zgjidhjeve te kontesteve të ketë parasysh vetëm Kushtetutën dhe ligjin. Praktika e ka dëshmuar se në fushën civile gjë e tillë jo çdo herë është e mundur, për faktin se ekzistojnë konteste që kanë të bëjnë me ndryshime shoqërore e të cilat ende nuk janë pjesë e dispozitave ligjore. Ndoshta jo në mënyrë të drejtpërdrejt po në një far forme Gjykata supreme si një mekanizëm kryesor në kuadër të sistemit gjyqësor është në pozitën e krijimit të praktikës gjyqësore. Gjykata Supreme e Kosovës “përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës”.⁸⁸

Nuk mund të kërkohet që gjykata të ketë rrol pasiv sa i përket zbatimit te ligjit, kjo për faktin se duhet te përcjellin ndryshimet shoqërore e te cilat kanë interferim ne raportet juridike civile mes njerëzve.

8.Shkenca juridike

Ndryshimet shoqërore që kanë konotacion në marrëdhëniet juridike civile tek qytetaret janë trajtim fillestar i shkencës juridike. Gjate trajtimit të tyre ndërtohen teori të ndryshme e të cilat i kundërvihen shpesh njëra tjetrës duke pretenduar se njëra është më e plotë dhe më e suksesshme. Kryesisht teoritë që arrin me qen në pozitën udhëheqëse, arrin të argumentojnë me fakte atë që mendojnë dhe

⁸⁷.Kuvendi i Republikës se Kosovës, Kushtetuta e Republikës se Kosovës, 2008, neni 102, paragrafi 1,2,3

⁸⁸.Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI V / Nr. 79 / 24 Gusht 2010, Kuvendi i Republikës se Kosovës, Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat, 2010, neni 22, paragrafi 1, nenparagrafi 1.3

kundërshtojnë atë që mendojnë se nuk ka bazë shkencore dhe praktike. Teoritë dhe atë që i prodhon shkenca juridike janë ndër burimet më të mëdha që konsultohen dhe inkorporohen me rastin e hartimit të politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile.

Shkenca juridike është njëra ndër burimet e së drejtës që arrin në mënyrë direkte apo indirekte përmes inkorporimit në dispozita ligjore të jetë burim i së drejtës. Ajo që vlen të ceket është fakti se shkenca juridike llogaritet si burim shumë i besuar i së drejtës civile. Kjo për faktin se kjo arrin të krijoj mendime përfundimtare shkencore për një fenomen shoqëror nga fusha e marrëdhënieve juridiko civile e cila është një hap para rregullimit ligjor dhe e njëjta ka nevojë të vendoset në korniza të sistemit juridik dhe të rregullohet me dispozita përkatëse.

9. Burimet e të drejtës civile në Kosovë

Pozitën politike që kishte ndër vite Kosova dhe problemet në këtë aspekt ja diktonte edhe sistemin juridik dhe burimin e së drejtës në përgjithësi dhe atë në veçanti të së drejtës civile në Kosovë. Në mënyrë kronologjike kur shikohet Kosova nga perandoria Osmane ishte pjesë e saj si në aspektin politik, juridik dhe ekonomik dhe kjo i ka diktuar që mos të ketë një sistem juridik të saj Kosovës dhe më pas edhe burime të së drejtës civile. Pozita e Kosovës në Perandorinë Osmane ishte e nivelit të pushtimit dhe nuk kishte një pavarësi Kosova të kishte një zhvillim nga aspekti juridik dhe atë të burimeve të së drejtës civile.

Edhe për kundër faktit se territori i Kosovës ishte i pushtuar dhe administruar nga perandoria Osmane, raportet juridiko civile të qytetarëve të saj ishin të rregulluara anë për anë sipas rregullave të dëshiruara, pasi ishin rregulla kryesisht të Perandorisë Osmane. Burimet juridike në të cilat është bazuar e drejta civile në këtë periudhë kanë qenë të ndara në dy lloje. Llojin e parë e kanë përberë e drejta osmane e sheriatit dhe të legjislacionit, e cila synonte të rregullonte marrëdhëniet juridiko civile në vilajetin e Kosovës. Ndërsa pjesën e dytë të burimeve të së drejtës civile e përbente e drejta zakonore e vendasve.⁸⁹ Nga kjo shifet se marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë kanë një traditë dhe histori në vetë të bazuara në rregulla e të cilat burimin e kanë pasur në burime të rëndësishme dhe të arsyeshme në atë kohë. Pavarësisht se këto burime nuk kishin të bënin me vullnetin e popullit të vilajetit të Kosovës e rëndësishme është fakti se rregullimi i marrëdhënieve juridiko civile ka qenë i bazuar në rregulla. Në të gjitha vendet Myslimane ku ishte prezentë Perandoria Osmane dhe në disa jo myslimane ishte në zbatim e drejta e Sheriatit si një e drejtë që ka prejardhjen nga perëndia. Kjo e drejtë ishte influencuese edhe tek e drejta zakonore, kjo shembull vërehet tek Kodi Civil Serb i cili me vonë

⁸⁹E. Statovci (2009) Marrëdhëniet Pronësore Juridike në Sendet e Paluajtshme në KSA të Kosovës, Prishtinë. Fq. 110-111.

zbatohet edhe në Kosovë. Influencë kishte edhe në teorinë juridike ku vërehej bartje e shumë instituteve juridike si p.sh pengun, të drejtën e parablerjes etj.⁹⁰

Në këtë periudhë Kosova përpos që burim të së drejtës civile kishte të drejtën e sheriatit në atë kohë ishte zhvilluar edhe e drejta shtetërore që është e drejta kanunare. Kanunet ishin të nxjerrura nga Sulltani dhe ajo që ishte specifike e tyre ishte se nxirreshin kryesisht për një trevë dhe përmbanin veçori juridike të një treve të caktuar. Përpos kësaj burim i së drejtës civile ishin Mexheleni dhe Mejelle.⁹¹ Koha na ofron të dhëna se gjër në vitin 1912 marrëdhëniet juridiko civile janë rregulluar duke u bazuar në të drejtën e sheriatit të drejtën osmane shtetërore si dhe të drejtën zakonore të vendasve.

Duke e respektuar dhe besuar në teorinë se e drejta buron nga shpirti i një populli dhe i nënshtrohet ndikimeve shoqërore të asaj popullate na del se çdo popull dëshiron që e drejta të jetë burim i vullnetit të tyre. Kjo vërtetohet edhe me Shqiptaret të cilët gjatë periudhës së perandorisë Osmane edhe pse kishin burime të së drejtës civile të rregulluara nga perandoria kishin krijuar të drejtën zakonore. E drejta zakonore Shqiptare siç thotë Savinji është si një ‘Organizëm i gjallë’. E drejta zakonore ishte edhe një sistem juridik paralel karshi atë Osman, andaj këtë duhet të kuptuar si një sistem që ka buruar nga vullneti i popullit për rregullimin e marrëdhënieve Juridiko civile.

Te dhënat na ofrojnë të dhëna se ndërmjet viteve 1912 – 1913 dhe 1918 lidhur me zbatimin e së drejtës për marrëdhëniet juridiko pronësore, mund të ndahen në dy periudha kohore. Në pjesën lindore të Kosovës prej viteve 1912/13 deri me 1915 zbatohet e drejta Turke (Mexhelle, ligje dhe e drejta e sheriatit), parimet e Kodit Civil të Serbisë dhe dispozitat tjera, që kishte nxjerr Serbia dhe e drejta zakonore e vendasve. Në pjesën perëndimore të Kosovës, gjente zbatim e drejta turke, parimet e Kodit Civil Serb dhe e drejta zakonore e vendasve. Ndërsa periudha e dytë nga viti 1915 deri më 1918 në pjesën lindore të Kosovës e së cilës bie nën Bullgarin kurse ajo perëndimore nën Austri zbatohet e drejta zakonore e vendasve në mënyrë të heshtur veprimeve edhe në bazë të së drejtës së sheriatit. Nga kjo që na ofrohet në këtë periudhë kohore behet me dije se burim i së drejtës civile në këtë periudhë kohore në Kosovë ishte e drejta e sheriatit, ligjet e perandorisë dhe e drejta zakonore e banorëve.

Pas lufte se dyte botërore kishim një ngadhnim të revolucionit Socialit i cili kishte ideologjinë mbi të cilën do të mbështeste zhvillimin ekonomik social, forcat e prodhimit dhe rregullimin e raporteve juridike. Nder hapat e parë që është ndërmarr ka qenë çështja e juridiksionit dhe kontinuiteti i sistemit

⁹⁰.Po aty, Fq. 111.

⁹¹.Po aty, Fq. 112 – 113.

të vjetër juridik. Kjo çështje kishte marr drejtim ku me datën 25 tetor 1946 ishte nxjerr Ligji më të cilin ju është marr fuqia juridike të gjitha dispozitave juridike që kanë vlejtur më 6 prill 1941 dhe janë shpallur të paekzistueshme të paqena të gjitha dispozitat që janë nxjerrë në kohën e okupacionit armiqësor.⁹²

⁹²,Po aty, Fq. 160.

KAPITULLI V LEGJISLACIONI I SË DREJTËS CIVILE NË KUADËR TË ISH SISTEMIT JURIDIK TË JUGOSLLAVISË DHE TË MISIONIT TË UNMIK-ut

1. Marrëdhëniet juridiko civile dhe zhvillimi i tyre në Kosovë

Marrëdhëniet shoqërore si ndërveprime mes njerëzve karakterizohen me gjera të përbashkëta që ju ndërlidhen për një jetë të përbashkët. Zhvillimi njerëzor çdo herë i paraprin marrëdhënieve shoqërore dhe reformave që e karakterizojnë një shoqëri. Janë ndryshimet në forcat e prodhimit, sistemin politik, ekonomik, social ato që reflektojnë karshi ndryshimeve shoqërore. Shoqëria çdo herë është në zhvillim e sipër pasi një gjë e tillë është e natyrshme se pari dhe e nevojshme pasi kjo pasqyron tendencën e shoqërisë për zhvillim sa më të mirë. Nga zhvillimi i shoqërisë kemi zhvillim edhe të raporteve brenda shoqërisë dhe të njëjtën kohë edhe rregullim të raporteve shoqërore nga të cilat varet jeta normale dhe zhvillimore.

Duke pasur parasysh se marrëdhëniet shoqërore çdo herë janë një hap përpara të drejtës, kjo na bënë të kuptojmë se e drejta lind dhe zhvillohet nga marrëdhëniet shoqërore dhe varësisht marrëdhënieve dhe zhvillimit shoqëror kemi edhe zhvillimin e së drejtës. Në kuadër të marrëdhënieve shoqërore bëjnë pjesë edhe marrëdhëniet juridiko civile të cilat varësisht ndryshimeve dhe zhvillimit shoqëror reflektojnë. Njeriu si pjesë e shoqërisë çdo ditë hynë në marrëdhënie Juridiko civile nga mëngjesi kur fillon ditën duke e blerë gazetën bukën, biletën e autobusit andaj në të gjitha këto situata njeriu vihet në marrëdhënie civile Juridike.⁹³ Marrëdhëniet juridiko civile mund të kualifikohen ato marrëdhënie të cilat janë të rregulluara dhe të parapara me norma konkrete të së drejtës Civile. Për të drejtën Civile është e rëndësishme vetëm rregullimi normativ i një marrëdhënie shoqërore, pasi përmes kësaj arrihet të rregullohen marrëdhëniet shoqërore përkatësisht ato juridiko civile.⁹⁴

Marrëdhëniet shoqërore ishin prezent edhe tek shoqëria Kosovare dhe atë në një nivel të lartë të zhvillimit, kur kemi parasysh problemet politike që kishte populli i Kosovës dhe okupimet e vazhdueshme. Në kuadër të marrëdhënieve shoqërore tjera që i përbenin ato shoqërore siç ishin ato marrëdhëniet ekonomike, politike, arsimore dhe juridike. Në kuadër të marrëdhënieve shoqërore dhe zhvillimit të tyre vend të rëndësishëm kishin zënë edhe marrëdhëniet juridiko civile. Marrëdhëniet juridiko civile kanë një traditë të gjatë në Kosovë, mirëpo të përcaktuara dhe të rregulluara me norma

⁹³.A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë. Fq. 5

⁹⁴.Po aty, Fq. 6.

konkrete jo edhe gjate, pasi nuk kishte njëkohërencë ne sistemet e saja juridike dhe nuk e ka pasur te mundur te ndërton dhe zhvillon normimi e marrëdhënieve juridiko civile.

Mungesa e shtetit, ja ka pamundësuar Kosovës te ketë sistemin e saj juridik e ne kuadër te tij edhe normimin e marrëdhënieve juridiko civile. Me ketë pamundësi është manifestuar edhe me mungesën e kontinuitetit dhe zhvillimit progresiv te legjislacionit qe ka rregulluar marrëdhëniet juridiko civile. Shtetet okupuese çdo here kanë krijuar një sistem te tyrin Juridik te cilin ju kane diktuar edhe Shqipëtave në Kosovë e i cili ka qen diskriminues dhe jo përnjë zhvillim te shoqërisë Kosovare. Mungesa e sistemit juridik shtetëror, ka lind nevojën qe edhe Kosovaret te ndërtojnë disa rregulla juridike te fuzionuara në Kanun. Kanuni përmbledh ato dispozita te cilat kanë buruar nga e drejta zakonore e vendit dhe si një sistem paralel juridik me ata te okupatoreve pasi këtyre nuk ju kanë besuar. E drejta zakonore Shqiptare fillet e saja i ka qe nga shoqëria fisnore përkatësisht parashtetore. Ne baze te përmbajtjes dhe formës se saj e drejta zakonore na ofron kuptimin si një karakteristik për shoqërit pa shtet.⁹⁵ E drejta zakonore në kuadër të saj me anë të pjesëve që ka poseduar mund te kualifikohet si një sistem i plotë juridik. Me ketë është rregulluar jeta e njeriut nga lindja gjer në vdekje duke i përfshi te gjitha marrëdhëniet shoqërore te cilat është dashur të normohen. Ndër të tjera ne kuadër të saj janë rregulluar edhe marrëdhëniet juridiko civile si marrëdhënie në kuadër të raporteve shoqërore. Kjo e drejte kërkonte një forcë qe do ta implementonte pasi mungonte aparati shtetëror aji i cili do e zbatonte me përpikëri dhe konform nevojës. Zbatimin e kësaj të drejte kryesisht e kishin zbatuar këta mekanizma siç janë kuvendet, gjyqet e pleqve, forca e opinionit publik ose individual.⁹⁶ Në kuadër të së Drejtës zakonore Shqiptare kemi veçorit e unitetit dhe diversitet, unike mundë të kualifikohet pasi ka qene prezent dhe e zbatueshme për te gjithë popullin në ter territorin e vendit. Diversiteti është prezent pasi në disa krahina kemi pasur Kanunet që kanë pasur një përmbajtje dhe veçori lokale. Andaj e drejta zakonore Shqiptare është më specifike dhe brenda saj kemi veçori që mundësojnë të kemi edhe krahasime.⁹⁷

Në të drejtën zakonore Shqiptare vend të rëndësishëm kanë zen edhe marrëdhëniet Juridiko Civile te rregulluara me dispozita përkatëse në kuadër të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Kanuni ka mundësuar të kemi një histori at në mardheniet juridiko civile edhe pse jo institucionale por te mjaftueshme për traditë në marrëdhënie Juridiko civile. Kosova ka qen zbatuese e Kanunit gjer në periudhën kur është filluar me normimin e marrëdhënieve juridiko civile nga shteti i Jugosllavisë e te cilat kanë qene obliguese edhe për Kosovën. Edhe për kundër faktit të rregullimit të raporteve juridiko civile nga ana

⁹⁵A. Luarasi (2001) Historia e Shtetit dhe e se Drejtës në Shqipëri, Tiranë. Fq. 231.

⁹⁶Po aty, Fq. 232.

⁹⁷Po aty, Fq. 233.

e sistemit Juridik Jugosllav, zbatimi i dispozitave të kanunit ka vazhduar nga qytetaret e Kosovës dhe në disa rajone për disa institute të së drejtës civile përdoret edhe sot e kësaj dite.

Edhe pse në kuadër të një sistemi jo të pavarur juridik, me kushtetutën e vitit 1946, kishte arrit të fillonte që marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë të kenë një fillim të mbare sa i përket normimit, kjo erdhi si rezultat i nxjerrjes së Kushtetutës, Statutit dhe akteve tjera juridike që i mundësuan Kosovës të ketë një fillim të rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile.

2.Marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë sipas sistemit juridik të Serbisë

Pas luftërave ballkanike të vitit 1912 – 1913 Serbia kishte filluar që në çdo aspekt ta vendos Kosovën nën juridiksionin e sajë. Menjëherë pas vitit 1912 në Kosovë sa i përket rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile ishte filluar që të zbatohet KCS duke i zëvendësuar Mexhelet. Edhe çështja e zbatimit të së drejtës dhe obligimet e ligdhënësit të ri Serbisë ishin rregulluar në Traktatin e Stambollit ndërmjet Serbisë dhe Turqisë me 1-14 mars 1914, ku në nenin V të të cilit është parashikuar: “ Të drejtat e pronësisë mbi palujtshmeritë, në viset e cesuara, që individët ose personat e ndryshëm juridik i kanë fituar në bazë të ligjeve turke para se këto vise t’i pushtonte Serbia, do të respektohen dhe as kush nuk do të mund të privohet prej pronësisë së ve përveç në interesin publik, të konstatuar me rregull dhe me një kompensim pararendës juridik dhe të drejtë”.⁹⁸

Rregullimi i marrëdhënieve juridiko civile në Kosovë në këtë periudhë ishte tejet i vështirë për faktin se nuk ishte i lehtë pranimi i sistemit juridik të Serbisë dhe ndryshimi nga ai i Turqisë. Edhe pse Serbia kishte tendencë që të zbatonte të drejtësinë e saj sa i përket rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile kishte rezistencë dhe mos pranim. Periudha kohore nga viti 1912 deri në 1918 kemi pasur zbatim të së drejtës Turke, KCS, dispozita tjera që kishte nxjerr shteti Serb si dhe e drejta zakonore. Nga viti 1915 kishte zbatim edhe të së drejtës Bullgare dhe asaj Austriake për faktin se ishin okupuar nga këto dy shtete në atë kohë ku kishte zgjatur deri në vitin 1918.

Pas vitit 1918 ishte krijuar një realitet i ri sa i përket edhe sistemit juridik dhe atë politik e ekonomik në Serbi. Duke pasur për bazë se Kosova ishte pjesë e Serbisë çdo ndryshim kishte refleksion edhe në Kosovë. Këto ndryshime ishin evidente edhe në sistemin juridik e të cilat nuk ishin te lehta të absorboheshin nga Shqiptarët e Kosovës. Hezitimi i pranimi të sistemit juridik ishte mbi bazën e dy arsyeve e para se sistemi juridik i Serbisë ishte i një shteti i cili e kishte okupuar dhe synonte që çdo

⁹⁸G. Tedeschi (Nr.1/1969) Le centenaire de la Mejelle, Revue internationale de droit compare, Paris. Fq. 127.

gjë ti impononte dhe e dyta ishte se ishte krijuar një traditë e zbatimit të së drejtës Turke dhe asaj Zakonore prandaj çdo ndryshimishte sfidues. Ne kemi edhe mendimin e prof. Blagojeviq i cili shkruan “ E krijuar pas Luftës së Parë Botërore, Jugosllavia e vjetër gjatë gjithë kohës të ekzistimit të sajë, ka ruajtur, në lëmin e së drejtës civile, sistemet pozitive juridike civile që ishin të krijuara në territoret e caktuara që hynë në përbërjen e shtetit të ri të krijuar”.⁹⁹

Shteti okupues i Serbisë nuk dëshironte që gjerat me rendësi lidhur me Kosovën ti lente rastësisë, por u jepte karakterin juridik. Ketë e kishte aplikuar edhe në rastin e shtrirjes së juridiksionit të vet në territorin e Kosovës të cilën e kishte okupuar. Për shtrirjen e juridiksionit kishte nxjerr Dekretligj mbi zgjerimin e juridiksionit të Kushtetutës dhe të gjitha Ligjeve të Mbretërisë së Serbisë më 30. Qershor 1919, (“Sluzbene novine” nr.68/1919) dhe me një ligj tjetër mbi zgjerimin e juridiksionit të të gjitha ligjeve të Mbretërisë së Serbisë në viset e çliruara dhe të bashkuara në rrjedhën e luftërave ballkanike me 30 Qershor 1922, (“Sluzbene novine” nr.142/1922). Sipas dispozitave të këtij ligji, sic shkruan prof. Statovci ishte planifikuar që të gjitha dispozitat ligjore të Mbretërisë së mëparshme të Serbisë, të hynë në fuqi dhe të zbatohen e të cilat do të vlejnin edhe për qarqet e Prizrenit, Zveqanit, Kosovës.¹⁰⁰

Tendenca e shtetit Serb ishte që shtrirja e juridiksionit në Kosovë të behet sa më parë për faktin se një shtrirje e juridiksionit dhe pranimi i ti nuk do ti krijonte probleme shtetit Serb me popullatën Shqiptare. Pas vitit 1918, Serbia lidhur me hartimin dhe nxjerrjen e legjislacionit të fushës për rregullimin e marrëdhënieve juridiko – civile ishte koncentruar në reformën agrare. Fusha e reformës agrare ishte rregulluar me ligjet e viteve 1919 dhe 1931, këto ligje ishin reformë radikale që kanë ber shumë ndryshime dhe nuk kanë qen te pranuar mirë nga populli Shqipëtar. Përpos këtyre e dëmshme dhe shumë te rrezikshme ishin dispozitat që rregullonin kolonizimin e viseve të çliruara dhe të bashkuara Mbretërisë së Serbisë në të cilat bënte pjese edhe Kosova.¹⁰¹ Ajo se qfar është bërë në atë kohë shifet se ka qen ni imponim nga shteti Serb duke mos u marrë për bazë vullneti i popullit Shqipëtar në as një mënyrë, po çdo herë vetëm duke ju servuar gjera në dëm të tyre dhe në dobi të shtetit Serb. Ajo se qfar dhe si është vepruar në atë kohë shifet se edhe për atë kohë ka qen kundër parimeve të Kushtetutës dhe ligjore, po një gjet e tillë nuk e ka vlerësuar shteti serb, vetëm e vetëm te ketë shtrirje dhe kontroll juridiksioni i tij në territorin e Kosovës.

Edhe pse kishte një mobilizim dhe tendencë që Serbia te shtrinte juridiksionin e saj në Kosovë ishte e kundërshtuar nga popullsia vendase e cila nuk kishte hequr dorë së zbatuari të drejtën zakonore. Në kuadër të kësaj edhe sistemi juridik i Serbisë përkatësisht legjislacioni për organizimin e sistemit gjyqësor dhe ai për rregullimin e marrëdhënieve juridiko – civile nuk e ndalonin po zbatimin e saj e

⁹⁹B. Blagojevic (nr.1-2/ 1986) Razvoj naslednog prava, Arhiv za pravne i drustvene nauke, Beograd. Fq. 167.

¹⁰⁰E. Statovci (nr.3/1976) Ca ceshtje mbi burimet e së drejtës civile dhe mbi rregullimin e disa marrëdhënieve civile - juridike në KSA të Kosovës, Prishtinë. Fq. 315.

¹⁰¹M. Obradoviq (1981) Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1919 – 1941, Prishtinë. Fq. 108

kishin të përcaktuar edhe në kuadër të dispozitave ligjore. Kryesisht dispozitat që kanë rregulluar këtë çështje ishin në kuadër të dekreteve për vendosjen e gjykatave, Kodin Civil etj. Lidhur me zbatimin e së drejtës zakonore Shqiptare në kuadër të sistemit juridik të Serbisë ka shkruar edhe Profesor Brestovci ‘‘Kushtet specifike të jetës materiale bënë të mundshme që e drejta zakonore të ruhet dhe të zbatohet. Ajo shërbeu si burim në rregullimin e marrëdhënieve civile – juridike, deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore’’.¹⁰² Me këtë që cek profesori na bën të njohur se e drejta zakonore Shqiptare nuk ka pushuar se funksionuari në momentin kur shteti Serb ka imponuar sistemin e vete juridik, po në kuadër të këtij të fundit ka qenë i inkorporuar dhe ka pas karakterin e burimit të së drejtës në raste të caktuara. Këtë çështje ka trajtuar edhe KCS i cili në nenin 10 ka përcaktuar se mund të zbatohet zakoni atëherë kur çështja nuk është e rregulluar me dispozita përkatëse ligjore apo këto të fundit e udhëzojnë në të.

Nga ato që cekën se si është hy në jetë sistemi juridik i shtetit Serb për pjesën e territorit të Kosovës shifet se ka qenë shumë sfiduese dhe tejet e vështirë. I gjithë procesi është kryer kohë pas kohe duke mos e mohuar të drejtën zakonore si pjesë të sistemit juridik dhe burim të së drejtës. Prandaj edhe marrëdhëniet juridiko civile në atë kohë nuk kanë gjetë ndonjë mbështetje të qartë dhe të madhe në sistemin juridik të vendit.

Periudha e luftës së dytë botërore nga viti 1941, Kosovën e kishte gjetë të ndarë dhe të administruar nga Gjermanet, Italianet, Bullgaret. Këto shtete çdo herë insistonin që të zbatoheshin drejta e tyre nga sistemi juridik i shteteve të tyre. Kjo formë e imponimit ishte ndryshim i madhe dhe kishte hezitime dhe pengesa në zbatimin e sistemeve të huaja juridike. Prandaj në këtë periudhë gjetë zbatim të madhe e drejta zakonore. Në atë kohë ishin themeluar komisionet që kishin funksionin për pajtim dhe qubeshin ishlhate e të cilët kishin mandat të vendosnin për çështje nga marrëdhëniet juridiko – civile sipas së drejtës zakonore. Me përfundimin e luftës së dytë Botërore ishte i nevojshëm një veprim juridik i cili do të determinonte dhe të bënte prerjen e zbatimit të së drejtës e cila ishte krijuar nga shtetet okupuese. Në fillim të muajit shkurt të vitit 1945 Kryesia e KACKJ kishte nxjerrë Vendim për shkëputjen dhe pavlefshmërinë e dispozitave juridike të miratuara nga okupatori dhe bashkëpunëtorët e tyre.¹⁰³ Ky veprim i asaj kohe ka qenë shumë i dobishëm për faktin se është dashur të bëhet një prerje e sistemit juridik të okupatorëve pasi ai ka prodhuar efekt juridik për kohën sa ka qenë aktiv dhe ndalimi i tij pas luftës së Dytë Botërore dhe ndalimin e prodhimit të efektit juridik.

Ndryshimi i sistemit politik dhe atij juridik në Kosovë ka reflektuar që mos të kemi një shtet juridik stabil dhe të qëndrueshëm. Kjo me faktin se kryesisht sistemin juridik e kanë ndërtuar dhe udhëhequr

¹⁰²E. Statovci (nr.3/1976) Ca çështje mbi burimet e së drejtës civile dhe mbi rregullimin e disa marrëdhënieve civile - juridike në KSA të Kosovës, Prishtinë. Fq. 332.

¹⁰³D. Georgiev Pop (nr.1-2/1986) Razvoj gradjanskog prava, Beograd. Fq. 127.

okupuesit për qëllime të tyre dhe jo në funksion të qytetarëve dhe jetës së tyre. Ndryshimet shoqërore në Kosovë kanë qenë në vazhdimësi dhe kjo ka qenë e dukshme, dukshmëria ka qenë e evidente edhe pse me hapa të ngadalësuar.

3.E drejta civile pjesë e së drejtës pozitive në kuadër të sistemit juridik Jugosllav

Sistemi juridik krahas atë ekonomik, social dhe politik në vetë është zhvilluar dhe ka arritur të ndryshojë varësisht ndryshimeve shoqërore. Varësisht ndryshimeve shoqërore edhe sistemi Juridik së bashku me degët e saja juridike ka evoluar. Sistemin Juridik e përbejnë tërësia e degëve juridike në kuadër të një shteti.¹⁰⁴ Edhe e Drejta Civile si njëra ndër degët e së drejtës është pjesë e Sistemit juridik të një vendi e cila zë vend të rëndësishëm në sistemin juridik. E rëndësishme mund të kualifikohet pasi me të drejtën civile kemi rregullim të raporteve njerëzore mirëpo çdo herë me karakter pasurorë. Kur i referohemi karakterit pasuror, respektivisht të marrëdhënieve juridiko civile, marrëdhënieve juridiko – sendore, marrëdhënieve juridiko- detyimore dhe marrëdhënieve juridiko – trashëgimorepërveç karakterit pasuror përfshihen edhe të drejtat e personalitetit si të drejta personale jo pasurore.¹⁰⁵ Zhvillimi i së Drejtës Civile është i ndërlidhur çdo herë me zhvillimin e sistemeve tjera siç janë ai ekonomik, politik, shoqëror. Kjo i mundëson të Drejtës Civile të jetë dinamike në zhvillimin e saj dhe instituteve juridike që ka brenda saj.

Kosova historikisht është përball me probleme politike që i kanë pamundësuar zhvillimin e sistemit të saj Juridik e në kuadër të tij edhe të Drejtës Civile. Ballafaqimi i Kosovës me probleme politike nuk i ka mundësuar të ketë një traditë të lartë në zhvillimin e të Drejtës Civile. Pas vitit 1912, Kosova kishte probleme politike duke u sulmuar dhe okupuar dhe më pas duke ja diktuar edhe sistemin e tyre juridik. Kishte shumë iniciativa dhe organizime paraprake që ishte vlerësuar dhe vendosur që Kosova pas çlirimit do të bashkohet Shqipërisë, mirëpo njëgjë e tillë nuk ndodhi. Kosova në kuadër të sistemit Juridik Jugosllav ishte bërë pjesë pasi ishte okupuar në kuptimin politik dhe ushtarak. Me 31.01.1946 Krahu Autonomë e Kosovës ishte vendosur të jete pjesë e Republikës Popullore të Serbisë dhe njëhirit element konstituiv i federatës Jugosllave.¹⁰⁶ Kosova pasi ishte përfshirë në kuadër të Kushtetutës së vitit 1946, kishte filluar rrugëtimin drejt konstituimit të sistemit të saj Juridik. Në fillim nuk ishte shprehëdhënësi sistemi Juridik, pasi Kosova ishte pjesë e Republikës Popullore të Serbisë. Me Kushtetutën e 1946, kishte filluar një periudhë e re për Kosovën, pasi pretendohet të shkëputet e

¹⁰⁴.A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 56.

¹⁰⁵.Po aty, Fq. 17, 18

¹⁰⁶.Slushbeni list FNRJ nr.86/1946, 25.10.1946

kaluara qe bënte pjese ne sistemet tjera juridike dhe te fillohet te konstituohet ne atë te Jugosllavisë përmes Serbisë.

Pas luftës se dytë botërore, Jugosllavia kishte orientim te bënte rregullimin e ri ekonomik dhe shoqëror e që shpije në një rend juridik të saj. Pasi ishin krijuar rrethana te reja në Jugosllavin e pas luftës së dytë botërore, ligjvënësi nxori Ligjin mbi pavlefshmërinë e dispozitave juridike të nxjerra para 6 prillit 1941 dhe gjatë kohës së pushtimit armiqësor. Me këtë u parandalua një kaos i mundshëm juridik pasi u be një prerje mes juridiksionit dhe kontinuitetit të sistemit të vjetër juridik¹⁰⁷. Ky ligj kishte krijuar situatën juridike përmes se cilës kishte ber prerje me dispozitat dhe rregullat ligjore te krijuara me pare nga okupatorët. Përmes këtij Ligji kishte lejuar te zbatohen disa dispozita juridike por me disa kushte.

Pas luftës se dytë Botërore Kosova mbeti pjesë e Jugosllavisë respektivisht e Serbisë kjo ishte parapa edhe në Kushtetutën e RFP të Jugosllavisë të datës 31 janar 1946, ku Kosova figuronte si njësi krahinore në kuadër të Serbisë. Kosova në atë kohë me datën 23 maj 1948 kishte nxjerr Statutin e saj i cili ishte në harmoni me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1947. Në bazë të Statutit Kosova nuk kishte të drejtë të nxirrte Ligje, kishte te drejt të nxirrte vetëm vendime, aktvendime, rregullore dhe udhëzime. Të gjitha këto akte i nxirrte organi i quajtur Këshilli Ekzekutiv Krahinor i cili funksiononte në bazë të Kushtetutës së Serbisë.

Në fillim ishte kuptimi që çështja e legjislacionit të jetë kompetencë ekskluzive e nivelit federativ dhe as pak mos te zbret me poshtë. Mirëpo ishin ndryshimet ekonomike dhe shoqërore si dhe zhvillimi i hovshëm i Jugosllavisë që i detyroj te bëjnë një ndryshim ne këtë aspekt. Në vitin 1963 ishte nxjerrë Kushtetuta e RSFJ-së, ajo e Serbisë dhe Statuti i dhe nga ky moment barazohen emërtimet e krahinave autonome. Edhe pas kësaj faze funksioni legjislativ mbeti kompetencë të federatës e cila nxirrte ligje të plota, themelore dhe të përgjithshme.¹⁰⁸ Me këtë ndryshim kemi një avancim te pozitës se njërive dhe krahinave ne raport me çështjet e legjislacionit.

Ndryshimet e rrethanave ekonomike, shoqërore ishin bazë për vërejtje për kompetencat ligjvënëse. Përmes rrezolucionit mbi bazën KAKM politike të legjislacionit të federatës kërkohej që legjislacioni federativ duhet të realizoj parimin kushtetues që Federata të rregulloj vetëm ato çështjejanë me interes të përbashkët të kombeve të Jugosllavisë të përcaktuar me kushtetutë.¹⁰⁹ Nga vlerësimi qe ishte bere ishte konsideruar si shume e rëndësishme qe njërive autonome tu bartet kompetenca e nxjerrjes se ligjeve. Kjo u mundësua me amendamentin e kushtetutës XVI dhe XVIII të Kushtetutës së RSFJ të

¹⁰⁷ Slushbeni list FNRJ, 25.101946, nr. 86/1946

¹⁰⁸ K.Salihi (1984) Lindja, zhvillimi pozitit dhe aspektet e autonomitetit te Krahines Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavi, Prishtinë. Fq.47.

¹⁰⁹ Slushbeni list FNRJ nr.32/68,

vitit 1963 ku përcaktohet për herë të parë se njësit autonome të kenë legjislacionin e vet. Kosova për herë të parë ka gëzuar të drejtën ligjdhënëse, këtë të drejtë e realizon me nxjerrjen e Ligjit kushtetues të vitit 1969. Me këtë Kosova kishte të drejtë të nxjerrte ligje në mënyrë të pavarur.¹¹⁰

Deri në vitin 1971 kur janë bërë ndryshimet Kushtetuese, çështje e kompetencës legjislative ishte komplekse dhe jo mirë e deshifruar, kjo për faktin se një kompetencë ishte ende te federata, një pjesë tjetër te shtetet tjera një pjesë derivonte nga ligjet e federatës. Kjo situatë, ishte shumë e komplikuar, por me ndryshimet kushtetuese të vitit 1971 ishte vlerësuar se shteteve anëtare dhe krahinave duhet tu bartet kompetencë më e madhe sa i përket aspektit legjislativ.

Avancimi që ishte bërë me Kushtetutën e 1974 kryesisht i referoheshin mundësisë së pjesëmarrjes së Kosovës në hartimin e së drejtës së sajë. Edhe pse ky avancim nuk i siguroj Kosovës të drejtën e nxjerrjes së ligjeve nga e drejta e detyrimeve, pronësisë pasi kjo ishte kompetencë e federatës. Nga kjo periudhë është filluar që Kosova të ndërtoj sistemin e sajë juridik. Edhe pse kishte avancim të shumë të drejtave me Kushtetutën e vitit 1974, kishte një ndarje të kompetencave legjislative ndërmjet federatës, republikave dhe krahinave e të cilat ishin mbështetur në parimet kushtetuese, të cituara sipas Prof Fatmir Fehmiut:

- a. “Në realizimin e të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në këtë kushtetutë, organet federative përcaktojnë politiken dhe nxjerrin ligjet, dispozitat dhe aktet e përgjithshme federative,
 - b. Në lëmenjtë që janë rregulluar me ligjin federativ, republikat dhe krahinat autonome në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të veta, mund të nxjerrin ligjin që domethënë jo vetëm nëse nuk ekzistojnë ligje të tilla, por nëse ekzistojnë, nuk janë rregulluar çështjet për të cilat janë të interesuar republikat dhe krahinat autonome të cilat mund të kenë drejtë që ti rregullojnë;
 - c. Nëse në lëmin që rregullohen me ligjin federativ ligji i tillë nuk është nxjerrë, republikat përkatësisht krahinat autonome, mund të nxjerrin ligjet e veta nëse kjo është në interes për realizimi e tyre;
 - d. Republikat socialiste dhe krahinat marrin pjesë në përgatitjen dhe nxjerrjen e ligjeve federative nëpërmjet kuvendeve të veta dhe nëpërmes të delegacioneve në Kuvendin e RSFJ’’.¹¹¹
- Rregullimi i kompetencës legjislative sipas Kushtetutës së vitit 1974 nuk ka dhen mundësin që të ketë një kompetencë të pavarur legjislative, me këtë vetëm është deshifruar me ne detaje se në cilat pjese kanë kompetencë dhe në cilat kanë varësi dhe bashkëpunim të obligueshëm.

¹¹⁰.Ligji kushtetues i KSA të Kosovës (Gazeta zyrtare e KSAK nr. 6/690)

¹¹¹F. Fehmiu (1988) Ndarja e kompetencave legjislative midis Federatës e RS e KSA dhe projektamendimet kushtetuese, Ndarja e kompetencave legjislative midis Federatës e RS e KSA dhe projektamendimet kushtetuese, Prishtinë. Fq 56.

Lidhur me kompetencën e Kosovës sipas Kushtetutës së Federatës ka shkruar edhe Prof Statovci “neni 281 i Kushtetutës së RSFJ, neni 300 i Kushtetutës së RSS, Kushtetuta e KSA të Kosovës përcakton se Krahina rregullon marrëdhëniet e detyrimeve dhe ato kontraktuese, pronësore juridike, marrëdhëniet reale, pasurore, familjare, kujdestarisë dhe trashëgiminë”.¹¹² Shumë ligje kishin mbetur pa u nxjerrë për shkak se legjislacioni federativ dhe ai republikan në shumë raste ishte bazë për nxjerrjen e ligjeve krahinore.

Kur analizohet sistemi politik dhe ai juridik i Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore shifet se ka pasur një rregullim kompleks sa i përket kompetencës legjislative në mes federatës, republikave dhe krahinave. Përmes kompetencës legjislative është bërë kontrolli i politikave të caktuara të cilat është dashur të jene në harmoni me Kushtetutën Federative, ligjet federative dhe ato të krahinave me ato të republikave. e rëndësishme te ceket është fakti se nga fillimi gjer në vitet 1974 ka pasur avancim të kompetencës legjislative dhe kjo ka ndikuar që të ketë krijim të sistemit juridik të republikave dhe krahinave në mënyrë të pavarur. Për Kosovën avancimi i sistemit juridik ishte më i vështirë dhe shumë i kompleksuar për faktin se një kompetencë përpos federatës kishte edhe krahina e Serbisë e cila jo rrallë ka krijuar pengesa për mos zhvillim dhe ndërtim të sistemit juridik të Kosovës. Kur i referohemi sistemit juridik përkatësisht fushës së të drejtës civile në atë kohë ka qen e mbuluar me këto ligje: Ligjin mbi trashëgiminë, ligji mbi marrëdhëniet banesore, Ligji mbi bashkëpronësinë në banesë, Ligji për shpronësimin, Ligji për kadastrën etj. Sistemi juridik i asaj kohe, marrëdhëniet juridiko civile i kishte rregulluar me legjislacion përkatës dhe synim kishte që çdo fushë të rregullonte përmes dispozitave përkatëse ligjore.

¹¹²E. Statovci (nr.3/1976) Ca çështje mbi burimet e së drejtës civile dhe mbi rregullimin e disa marrëdhënieve civile - juridike në KSA të Kosovës, Prishtinë. Fq. 335.

4.Misioni i UNMIK-ut në funksion të ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës

Misioni i UNMIK-ut në funksion të ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës Lufta e vitit 1998 – 1999 në Kosovë kishte dëmtuar çdo gjë dhe kishte stopuar po ashtu çdo gjë duke qen një vazhdimësi e viteve represive paraprake nga shteti Serb. Për zgjidhjen e çështjes së Kosovës ishte organizuar konferenca e Rambujes në të cilën u diskutua gjer e gjate për zgjidhjen e çështjes së Kosovës ku në fund rezultojë me nënshkrimin e marrëveshjes nga ana e palës Kosovare ndërsa pala Serbe nuk kishte nënshkruar Marrëveshjen. Mos nënshkrimi nga ana e palës Serbe kishte hap rrugën Aleancës Veri atlantike NATO-s që të ndërmerr fushatën bombarduese kundër Serbisë për të ndalur luftën dhe pastrimin etnik që kishte filluar Serbia kundër Shqiptarëve të Kosovës. Fushata e NATO-s kishte filluar me datën 24.03.199 dhe kishte plotë 78 ditë ku kishte kapitulluar Serbia. Me 10 qershor 1999 ishte nënshkruar marrëveshja tekniko – ushtarake midis ushtrisë Jugosllave dhe NATO-s përmes së cilës shënohej fundi i bombardimeve të NATO-s ndaj qaceve Serbe.

Përfundimi i luftës në Kosovë ishte moment kur u vendos që Kosova të administrohet nga Kombet e Bashkuara ku nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999 miratuan rezolutën 1244.¹¹³ Me anë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit Kombet e Bashkuara vendosin që nën mbikëqyrjen e OKB-së, të një pranie civile ndërkombëtare Kosovën të vendosin nën administrim ndërkombëtar. Administrimi i përkohshëm në Kosovë ishte Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në momentin e vendosjes nën administrim ndërkombëtar ishte e nevojshme të ketë një prerje të sistemit juridik me atë të së kaluarës që i takonte sistemit Juridik Serb dhe një prerje tjetër sa i perket zbatimit të legjislacionit në Kosovë gjatë administrimit ndërkombëtar të Kosovës dhe kjo ndodhi.

Duke pas për bazë faktin se misioni i UNMIK-ut kishte për qëllim administrimin dhe krijimin e sistemit juridik të Kosovës, kishte ndërmarr veprime konkrete për këtë drejtim. Funksioni dhe autorizimet e UNMIK-ut për ndërtimin e sistemit juridik i buronin në Rezolutën 1244 nga e cila buronin autorizimet. UNMIK-u. Me të filluar punën misioni i UNMIK-ut, kishte nxjerr Rregullore NR. 1999/1 UNMIK/rreg/1999/1 25 qershor 1999. Përmes kësaj rregulloreje misioni i UNMIK-ut kishte përcaktuar Autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë UNMIK-ut. Në këtë Rregullore ishte përcaktuar që: “Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”.¹¹⁴ Përmes kësaj Rregulloreje arrihet që të përcaktohet kompetenca

¹¹³.<http://www.unmikonline.org/Documents/Res1244ENG.pdf>.

¹¹⁴.Rregullore nr. 1999/1 për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare UNMIK, 25 qershor 1999). Shih nenin 1 par 1.1.

ekskluzive e legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Kjo ishte shumë e rëndësishme të përcaktohet për faktin se de facto dhe jure me Kosova nuk ishte pjesë e sistemit juridik të Serbisë, prandaj kjo e përcaktonte orientimin e sistemit juridik në vend. Në kuadër të kësaj rregullore kishte ndodh edhe një çështje shumë e rëndësishme e cila kishte të bene me përcaktimin e ligjit në fuqi në Kosovë. Në këtë Rregullore ishte përcaktuar që: “ Ligjet e Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në territorin e saj para datës 24 mars 1999 do të vazhdojnë të zbatohen në Kosovë nëse nuk bien në kundërshtim me standardet e përmendura në nenin 2, me përmbushjen e mandatit të dhënë UNMIK-ut me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose me këtë rregullore a çdo rregullore tjetër të nxjerrë nga UNMIK-u”.¹¹⁵ Përcaktimi i këtij fakti ka qenë shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm për sistemin juridik të cilin misioni i UNMIK-ut ka filluar të ndërtoj. Përcaktimi i këtij fakti ka bërë të mundur që të ketë lehtësira edhe për organet e zbatimit të ligjit të cilat kanë pasur të qartë se cilin legjislacion duhet të zbatohet. Përcaktimi i ligjit në fuqi ka qenë i nevojshëm edhe për një fakt tjetër nga se legjislacionin që ka trashëguar Kosova nga ish sistemi dhe ai i okupatorit Serb në disa pjesë ka qenë diskriminues dhe nuk ka mundur të ketë trajtim të barabartë të qytetarëve në ato raste kur është kërkuar zbatimi i legjislacionit.

Në kuadër të fusheveprimtarisë së Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ishte edhe funksioni Legjislativ në Kosovë. Me datën 12 dhjetor 1999, misioni i UNMIK-ut kishte nxjerrë Rregulloren Nr. 1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë. Përmes kësaj rregulloreje Misioni i UNMIK-ut, kishte vendosur atë prerjen me sistemin juridik të së kaluarës dhe zbatimin e legjislacionit të së kaluarës. Kjo ishte e nevojshme pasi disa ligje ishin me karakter diskriminues dhe nuk u përshtatshin me rrethanat e reja që kishin ndodhur në Kosovën e pas luftës.

Duke parë si shumë e rëndësishme çështjen e zbatimit të ligjit në Kosovë pas instalimit të misionit të UNMIK-ut në Kosovë, ky i fundit kishte nxjerrë rregullore të veçantë që i dedikohej ekskluzivisht kësaj çështje. Me datën 12 dhjetor 1999 UNMIK-u kishte nxjerrë Rregulloren Nr. 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë e cila në mënyrë specifike përcakton se cili do të jetë ligji në fuqi në Kosovë. "Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989".¹¹⁶ Përmes kësaj Rregulloreje, Misioni i UNMIK-ut, ka bërë të ditur se ky mision është organ Legjislativ dhe Rregulloret që nxjerr sipas procedurave përkatëse të parapara janë të

¹¹⁵.Po aty, Shih nenin 3.

¹¹⁶.Rregullore Nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, UNMIK, 12 dhjetor 1999.

zbatuara në Kosovë. Po ashtu përmes kësaj Rregulloreje, Misioni i UNMIK-ut bënnjë prerje sa i përketë zbatimit të legjislacionit të ish sistemit juridik të Serbisë dhe atë deri me 22 mars 1989. Ketë datë për këtë legjislacion e ndërlidh me karakterin diskriminues të legjislacionit të ish sistemit juridik të Serbisë që ishte kundër Kosovës dhe qytetarëve të sajë nga viti 1989 deri në 1999.

Rregullorja Nr. 1999/24 kishte një përjashtim sa i përketë përcaktimit të Ligjit në fuqi në Kosovë. Kjo rregullore kishte përcaktuar "Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj"¹¹⁷. Me anë të këtij përjashtimi është menduar se mund të ketë situata juridike kur do të ketë çështje për të cilat do të mungonte kuadri ligjor për rregullim të sajë andaj është krijuar mundësia që për një çështje e cila nuk është e rregulluar me kuadër ligjor të zbatohet legjislacioni pas datës 22 mars 1989 por mos të jetë diskriminues.

Misioni i UNMIK-ut ishte i përcaktuar që ishte i përkohshëm me qëllim që fillimisht të administronte në përgjithësi me çdo resor dhe më pas të krijonte mekanizmat vendor që më pas do ju bartë kompetencat e plota. Edhe në kuadër të Rezolutës 1244, është përcaktuar: “ Organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve; d) Bartjen e përgjegjësi të veta administrative institucioneve që do të themelohen, duke mbikëqyrur dhe përkrahur konsolidimin e institucioneve të përkohshme lokale të Kosovës dhe të aktiviteteve të tjera për ndërtimin e paqes”.¹¹⁸ Kjo çka përcaktohet në kuadër të Rezolutës është indikator që misioni i UNMIK-ut duhet të ndërtoj një sistem juridik të Kosovës i cili do të vinte pas zgjedhjeve. Prandaj bazë për ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës është Rezoluta 1244, pasi përcakton prerjen juridike me ish sistemin dhe obligimin e misionit të UNMIK-ut për ndërtim të institucioneve të përkohshme të Kosovës dhe ndërtimin e sistemit juridik të saj.

Lidhur me ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës, misioni i UNMIK-ut, kishte ndërmarr veprime konkrete duke nxjerr Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të cilën Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm përmes Rregullores nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë kishte shpallur Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme. Ky veprim nga UNMIK-u lidhur me këtë ishte nxjerrë: “ Me qëllim të krijimit të një

¹¹⁷ Rregulloren Nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë UNMIK, Misioni i Kombeve të bashkuara në Kosovë

¹¹⁸ Rezoluta 1244, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, mbledhja e 4011-të,1999. Shih, piken 11, a), b).

vetëqeverisjeje kuptimplote në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare dhe krijimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në fushat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore përmes pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhjet e lira dhe të drejta”.¹¹⁹

Ajo që i referohet ndërtimit të institucioneve dhe nga to sistemin juridik të vendit është e përcaktuar edhe në preambulën e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme e cila përcakton: “Duke pasur parasysh përpjekjet e ndërmarra nga UNMIK-u dhe arritjet e SPPA-së, duke përfshirë kontributin e çmueshëm të popullit të Kosovës, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të vetëqeverisjes në Kosovë, themelohen institucione të përkohshme të vetëqeverisjes në fushën ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore me anë të pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhje të lira dhe të drejta”.¹²⁰ Në përmbajtjen e kësaj shifet se misioni i UNMIK-ut ka qenë i fokusuar në krijimin e bazës juridike kushtetuese nga e cila të buronin institucionet e përkohshme dhe nga to të krijohet sistemi juridik i vendit me disa kufizime dhe rregulla specifike. Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme ishte akti i parë juridik përmes së cilës Kosova kishte filluar të ndërtonte identitetin e saj juridik sa i përket rregullimit të brendshëm. Kjo mundësoi që fillimisht të organizohen zgjedhjet e para nga të cilat përmes vullnetit të popullit u krijuan institucionet në kuadër të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit.

Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme kishte përcaktuar kompetencat dhe kufizimet e të gjitha organeve të cilat ishin përfshi në këtë Kornizë. Ajo që i referohet nxjerrjes së legjislacionit dhe krijimit të sistemit juridik ju ishte bartë Kuvendit të Kosovës i cili përmes procedurave të parapara dhe mekanizmave përkatës kishte kompetencën e nxjerrjes së ligjeve. Kuvendi i Kosovës kishte përgjegjësi që të “Miraton ligjet dhe rezolutat në fushat e përgjegjësisë së institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, siç është parashtruar në kreun 5”.¹²¹ Përmes kësaj përgjegjësie, Kuvendi si pushtet legjislativ filloj që të krijoj legjislacionin përkatës përmes së cilit do të mbulohen fushat në të cilat ka kompetencë. Ky është fillimi kur Kosova hedh hapin e krijimit të së drejtës së saj e në funksion të ndërtimit të sistemit juridik të saj. Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme një mundësi dhe përgjegjësi ja bart edhe Qeveria të cilës ja mundëson që: Qeveria mund t’i propozojë Kuvendit projektligje me iniciativën e vet dhe me kërkesën e Kuvendit”.¹²² E rëndësishme të ceket për këtë është se në kuadër të kësaj Kornize për herë të parë i mundësohet institucioneve të përkohshme të Kosovës që të hartojnë politika dhe legjislacion për të rregulluar fushat e ndryshme. Kjo mundësi dhe përgjegjësi që të propozoj politika dhe legjislacion e mundëson që të fillohet me ndërtimin e

¹¹⁹Rregullore nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare, UNMIK). Fq.1.

¹²⁰Kornizën Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, Rregullore nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare, UNMIK). Shih, Preambulën, Fq.3.

¹²¹Kornizën Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, Rregullore nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare, UNMIK). Shih, Kreun 9.1.26 Pjesa 1.

¹²²Kornizën Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, Rregullore nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare, UNMIK). Shih, Kreun 9.3.2 Pjesa 3.

sistemit juridik të Kosovës. Sistemi juridik i Kosovës fillet e veta i ka që nga kjo periudhë edhe pse kishte disa kufizime të cilat ja japin kompetencën për disa çështje misionit të UNMIK-ut. Po me kalimin e kohës kemi bartje të kompetencave të plota nga misioni i UNMIK-ut tek institucionet vendore e që është tejet e rëndësishme për vendin.

Tek pjesa e legjislativit përkatësisht shpalljen dhe hyrjen e ligjeve në fuqi, misioni i UNMIK-ut e kishte rezervuar për Përfaqësuesin special të Sekretarit të përgjithshëm në Kosovë i cili kishte ketë kompetencë: “Ligjet hyjnë në fuqi ditën e shpalljes nga PSSP-ja, përveç rasteve kur në mënyrë specifike vetë ligji e parasheh ndryshe”.¹²³ Ky është ai kufizimi përmes së cilit misioni i UNMIK-ut mban primatin e ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës, pasi nga ai varet shpallja dhe hyrja në fuqi e gjitha ligjeve. Nga ky fakt mund të themi se pavarësisht kompetencave dhe përgjegjësive të institucioneve të vendit të përcaktuara në Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme është misioni i UNMIK-ut ai i cili është politik bërës dhe vendimmarrës sa i përket hartimit të politikave dhe legjislacionit.

5.Reformimi i legjislacionit të së drejtës civile të Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut

Misioni i UNMIK-ut fillimisht kishte përcaktuar cili do të jetë legjislacioni në fuqi në Kosovë, më pas kishte krijuar bazën ligjorë për funksionimin e organeve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës dhe fillimin e krijimit të politikave dhe legjislacionit.

Marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë kishin të trashëguar një legjislacion nga ish sistemi e një pjesë e së cilit ishte kualifikuar si ligj I zbatueshëm nga misioni i UNMIK-ut dhe një pjesë tjetër vlerësohet se duhej të nxjerrje dhe aprovohet për të pasur mundësi të mbulohet fusha e së drejtës civile në kuadër të sistemit juridik. Misioni I UNMIK-ut në vazhdimësi kishte bere nxjerrjen e Rregulloreve përmes së cilave synonte të rregullonte marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë. Ndër veprimet e para që ndërlidhen me marrëdhëniet juridiko civile e që do të kenë refleksion në reformimin dhe krijimin e infrastrukturës ligjore nga fusha e së drejtës civile është nxjerrja e Rregullores NR. 1999/10 Për shfuqizimin e legjislacionit diskriminues lidhur me çështjet banesore dhe të drejtat mbi pronën. Ky fakt na ofron dëshmi se nga ish sistemi dhe ai i okupatorit ka pasur legjislacion diskriminues ndaj Shqiptarëve të Kosovës. Mbi të gjitha është shumë e rëndësishme që nga misioni i UNMIK-ut është

¹²³Kornizën Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, Rregullore nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare, UNMIK). Shih, Kreun 9.1.45 Pjesa 1.

bërë vlerësimi paraprak I këtij legjislacioni diskriminues dhe më pas është shfuqizuar. Dhe ky është një fakt se në ndërtimin e sistemit juridik për Kosovën është vlerësuar aspekti i harmonisë së legjislacionit me parimet fundamentale të të drejtave të njeriut. Ajo se qfar është përcaktuar në këtë rregullore e që i referohet shfuqizimit të ligjeve diskriminuese është e përcaktuar se: Ligjet e mëposhtme, që bien në kundërshtim me standardet e përmendura në nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, shfuqizohen në Kosovë: “Ligji për Ndryshime dhe Shtesa në Kufizimin e Transaksioneve të Pasurisë së Patundshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 22/91 e datës 18 prill 1991); Ligji për Kushtet, Mënyrat dhe Procedurat e Dhënies së Tokës Bujqësore Qytetarëve që Dëshirojnë të Punojnë dhe Jetojnë në Territorin e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 43/91 e datës 20 korrik 1991)”.¹²⁴ Pozitive nga ky veprim juridik duke e shfuqizuar legjislacionin diskriminues është pozitiv edhe për faktin se mundëson hartimin e legjislacionit për marrëdhëniet juridiko civile dhe ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës mbi baza të shëndosha dhe vlera juridike universale.

Ajo që i referohet marrëdhënieve juridiko civile, pronësore misioni i UNMIK-ut kishte bërë vlerësime dhe skenim të situatës. Duke pas për bazë që pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë shumë banor të saj kishin lëshuar vendin dhe pronat e tyre kishin mbetur pa përkujdesje nga pronarët kishte nxjerr Rregulloren NR. 1999/23 për themelimin e drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore. Përmes kësaj Rregulloreje, Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore ndër të tjera do të ketë kompetencë: “ (a) Bëjë inventarin e shtëpive të braktisura në pronësi private, shtetërore dhe shoqërore; (b) Mbikëqyrë përdorimin ose dhënien përkohësisht me hua të pronave të tilla të braktisura për qëllime humanitare; të ardhurat nga qiraja e pronës së braktisur private dhe shoqërore regjistrohen në një llogari të veçantë në ruajtje për pronarin e vërtetë nga e cila shumë hiqen shpenzimet përkatëse; (c) Jep udhëzime për UNMIK-un, duke përfshirë CIVPOL-in, UNHCR-in dhe KFOR in për çështje specifike të të drejtave mbi pronën; (d) Bëjë hulumtime për përcaktimin e politikave dhe legjislacionit të rekomanduar lidhur me të drejtat mbi pronën”.¹²⁵ Në kuadër të kësaj Rregulloreje është përcaktuar edhe kompetenca e Komisionit për kërkesa pronësore dhe Banesore, “Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (“Komisioni”) është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jotregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtron Drejtoria, derisa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të

¹²⁴Rregullore nr. 1999/10 për shfuqizimin e legjislacionit diskriminues lidhur me çështjet banesore dhe të drejtat mbi pronën (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 13 tetor 1999). Shih nenin 1.

¹²⁵Rregullore Nr. 1999/23 për themelimin e drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 15 nëntor 1999). Shih nenin 1.

Përgjithshëm të gjykojë se gjykatat lokale janë në gjendje të kryejnë funksionet që i janë besuar Komisionit.”¹²⁶

Nga kjo shifet se misioni i UNMIK-ut përkatësisht Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm çështje nga marrëdhëniet juridiko civile dhe ajo pronësore i shikon me një kujdes të shtuar, së pari krijon bazën ligjore shumë shpejt nga fillimi i punës së misionit të UNMIK-ut dhe e dyta krijon mekanizma për trajtimin e këtyre çështjeve pronësore e interes të madh për qytetarët e Kosovës. Në kuadër të këtij trajtimi ne shikojmë misionin e UNMIK-ut në aspektin e krijimit, reformimit të legjislacionit dhe politikave si dhe ndërtimin e sistemit juridik të vendit.

Në kuadër të ndërtimit të institucioneve të vendit ishte shumë e rëndësishme edhe ndërtimi i mekanizmave në kuadër të sistemit të drejtësisë. Departamenti i Drejtësisë ishte themeluar përmes Rregullores nr. 2000/15 për themelimin e departamentit administrativ të drejtësisë. Kjo rregullore në kuadër të saj përcaktonte se: “ Departamenti është përgjegjës për udhëheqjen e përgjithshme të çështjeve që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues”.¹²⁷ Për herë të parë ky është mekanizmi që është themeluar lidhur me çështjen e drejtësisë e i cili ndër përgjegjësit dhe kompetencat kishte: ” Propozon rregullore lidhur me zhvillimin, organizimin dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe të shërbimit korrektues”.¹²⁸ Përmes kësaj përcaktohet se nga ku mund të rrjedh iniciativa ligjore për fushën e së drejtës. Ky mekanizëm është ai i cili mundëson që të ketë planifikim dhe hartim të politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës.

Periudha e pas luftës në Kosovë ishte periudhë kur duhej të bëhej një prerje me të kaluarën dhe një plan për të ardhmen dhe kjo në çdo sferë të jetës. Edhe me legjislacion ishte një situatë e njëjtë, kërkohet të bëhej një prerje me atë të ish sistemit të së kaluarës dhe ndërtimin e një legjislacioni që i referohet të së ardhmes. Misioni i UNMIK-ut pasi ishte funksionalizuar në Kosovë e kishte përcaktuar se cili legjislacion do të jetë i zbatuar në Kosovë dhe atë e përcaktoj me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë.

Fushën të cilën misioni i UNMIK-ut e kishte vlerësuar si të nevojshme për të pasur bazë ligjore është edhe ajo e pengut. Rregullimi i këtij instituti nga e drejta civile ishte tejet irëndësishëm për faktin se kjo ndërlidhej me qarkullimin juridik, sistemin bankar dhe atë të krijimit të sigurisë juridike në qarkullueshme rin juridike. Me datën 07 shkurt 2001 ishte nxjerr Rregullorja 2001/5 për Pengun. Ajo

¹²⁶Po aty, shih nenin 2.

¹²⁷Rregullores nr. 2000/15 për themelimin e departamentit administrativ të drejtësisë (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 21 mars 2000). Shih nenin 1 par 1.2.

¹²⁸Po aty, shih nenin 2 par 2.

që rregullonte dhe ishte qellim i kësaj rregulloreje është krijimi i infrastrukturës ligjore që do të rregullonte pengun që nga fillimi gjer në fund duke filluar nga Kolaterali, Detyrimet e Siguruara nëpërmjet pengut, Pengjet dhe Barrët, Marrëveshja e Pengut, të drejtat dhe mbrojtjet e pengdhënësit dhe pengmarrësit, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me kolateralin , të drejtat e palëve të treta etj.¹²⁹ Nxjerrja e kësaj rregulloreje mundësoj që marrëdhëniet juridiko civile me karakter pasuror të kenë një mekanizëm mbështetës dhe sigures.

Për të pasur një qarkullim juridik të sigurt ishte tejet I nevojshëm, prandaj ndër legjislacionin e parë që u krijua ishte kjo rregullore për pengun. Lidhur me pengun nuk ishte e mjaftueshme që të ketë rregullim ligjor vetëm te asaj që ishte rregulluar me këtë rregullore. Sa i përket pengut ishte vlerësuar si e nevojshme që të ketë një zyre ku do të bëhej regjistrimi I pengut. Një gjë e tillë kishte ndodhur duke e nxjerrë Rregulloren nr. 2001/32 për themelimin e zyrës së regjistrimit të pengut. Ajo që rregullonte kjo rregullore kishte të bënte që “ Zyra është përgjegjëse për pranimin, dorëzimin dhe arkivimin e të dhënave përkitazi me pengun e pronës së luajtshme dhe ofrimin e mundësive publikut për kërkim të pengut si dhe për mbajtjen e të gjitha shënimeve përkatëse konform Rregullores nr. 2001/5”.¹³⁰

Pjesë tjetër që i referohet marrëdhënieve juridiko civile me karakter pasuror ishte edhe shitblerja e patundshmërisë që kishte filluar në Kosovë pas lufte. Duke pas për bazë se në kuadër të këtyre shitblerjeve kemi pas edhe palë shitëse nga komuniteti Serb. Misioni I UNMIK-ut ishte shumë i kujdesshëm që në kuadër të këtyre shitblerjeve kur palë ishte nga komuniteti Serb te monitoronte dhe te vlerësonte mos kjo shitblerje nuk është duke u realizuar mbi bazën e vullnetit po mbi ndonjë presion, apo forma tjera e të cilat janë të ndaluara gjatë raporteve kontraktuese.

Për të pas në kontroll këtë çështje misioni I UNMIK-ut kishte nxjerr Rregulloren nr. 2001/17 mbi regjistrimin e kontratave për shitblerjen e patundshmërive në zonat e veçanta gjeografike të Kosovës. Kjo rregullore kishte për qellim: “ Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, mundet, pas konsultimeve me Administratorin Komunal, të caktojë zonat e veçanta gjeografike brenda Kosovës, ku të gjitha kontratat për shitblerjen e pronës banesore që behën në zonat e caktuara duhet të regjistrohen te Administratori komunal, para se të vërtetohen në Gjykatë”.¹³¹ Kjo rregullore kishte krijuar njëmekanizëm te sigurisë tek komuniteti Serb me rastin e shitjes se pasurisë së tyre pas luftës në Kosovë. Me vete faktin se ishte nxjerrë kjo rregullore te ofron mendimin se ka qen mos siguria saipërketqarkullueshmeris së patundshmërisë dhe eliminimin e veprimeve kundërligjore përkatësisht

¹²⁹Rregullorja 2001/5 për Pengun, (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 7 shkurt 2001)

¹³⁰Rregullore nr. 2001/32 për themelimin e zyrës së regjistrimit të pengut (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 6 nëntor 2001). Shih, nenin 1 parag 1.2.

¹³¹Rregullore nr. 2001/17 mbi regjistrimin e kontratave për shitblerjen e patundshmërive në zonat e veçanta gjeografike të Kosovës, (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 22 gusht 2001). Shih nenin 1 par 1.1.

falsifikimet e ndryshëm. Kjo rregullore është hartuar për të pasur në funksion që “ Me rastin e caktimit të zonave të veçanta gjeografike, PSSP do t’i marrë parasysh rekomandimet e Administratorit komunal, të cilat duhet të bazohen në kriteret e mëposhtme: (a) çështjet e sigurisë që dalin nga shitja e pronës në pronësi të minoriteteve; (b) dëshmitë për ekzistimin e dukurisë së shitjes sistematike të pronës së minoriteteve me çmime joreale dhe (c) shitja e pronës banesore në zonat ku e drejta pronësore e bashkësive minoritare është problem i veçantë”.¹³² Ajo që ishte sfiduese pas lufte në lidhje me marrëdhëniet juridiko civile me karakter pasuror e që kishte të bënte me shitblerjen e komuniteteve veçanërisht me atë të komunitetit Serb. Prandaj kërkohej për hire të sigurisë juridike dhe eliminimit të dukurive kundërligjore të ketë një bazë ligjore që do të eliminonte dukurit kundërligjore në këtomarrëdhënie kontraktuese. Sprov për sistemin juridik ka qen dhe është trajtimi i pronës së minoriteteve dhe refugjatëve të cilët janë larguar nga Kosova gjate dhe pas lufte.

E pa mbuluar kishte qen edhe pjesa që i referohej hipotekës, e cila ishte shumë e rëndësishme për faktin se mundëson teqarkullueshmeri juridike dhe krijim të sigurisë juridike në transaksionet juridike. Lidhur me rregullimin e hipotekës ishte nxjerrë Ligji nr. 2002/ 4 për hipotekat nga Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, e cila pas aprovimit nga Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm, ishte shpallur me Rregullore nr. 2002/21 për shpalljen e ligjit mbi hipotekat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ky ligj ishte njeri ndër ata ligje që do të kompletin legjislacionin e së drejtës civile për të pasur mundësi që të rregullohen marrëdhëniet juridiko civile sipas legjislacionit përkatës në fuqi e I cili do të ishte njësia themelore e ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës. Ajo se çfarë do të rregullonte ky ligj ishte të “ përcakton mjetet për krijimin e hipotekave, efektet e tyre ndërmjet palëve në një kontrate të tillë, efektet e tyre ndaj personave të tretë, dhe mjetet me anë të të cilave, hipotekat e shoqërive tregtare mund të ekzekutohen nëpërmjet procedurave jashtë-gjyqësore në rast të mos përmbushjes sipas kushteve të dokumentit të hipotekës”.¹³³

¹³²Po aty, shih nenin 1 par 1.1.

¹³³Ligji nr. 2002/ 4 për hipotekat, (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti I / NR.8 / 15 Dhjetor 2006). Shih nenin 1 par 1.1.

6.Misioni i UNMIK-ut në funksion të hartimit të Politikave në fushën e drejtësisë

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që kishte, UNMIK-u e kishte te rezervuar pjesën që i referohej drejtësisë në Kosovë që të njëjtin ta krijonte dhe ndërtonte nga fillimi. Përgjegjësia lidhur me drejtësinë në Kosovë nga ana e UNMIK-ut kishte të bënte me krijimin e infrastrukturës ligjore, emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokuroreve si dhe krijimin e mekanizmave që do të jene në funksion të së drejtës.

Sistemi gjyqësor në fillimet e funksionalizimit të misionit të UNMIK-ut ishte jo funksional dhe nuk kishte filluar punën. Ishte përgjegjësi e misionit të UNMIK-ut që të bënte funksionalizimin e sistemit gjyqësor dhe ati prokurorial të Kosovës. Iniciativa e parë e UNMIK-ut lidh me këtë çështje kishte të bënte me funksionalizimin e sistemit gjyqësor në Kosovë përmes Rregulloren nr. 1999/6 për rekomandimet mbi strukturën dhe administrimin e shërbimit të gjyqësisë dhe të prokurorisë. Komisioni teknik këshillëdhënës për gjyqësi dhe prokurori ka funksion “për të këshilluar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë në Kosovë; vlerëson nevojat për momentin dhe për të ardhmen në lidhje me numrin, nivelet dhe kategoritë e organeve gjyqësore; pas këshillimeve të duhura të përbashkëta me Komisionin Këshillëdhënës Gjyqësor dhe me Këshillin Special të Përbashkët për Çështje Legjislative bën rekomandime për rithemelimin sa më të shpejtë të Gjykatës së Lartë të Kosovës; vlerëson nevojat për momentin dhe për të ardhmen në Kosovë në lidhje me prokurorinë”.¹³⁴ Nga ky akt shifet se kemi fillim të vlerësimit të gjendjes në sistemin e drejtësisë përmes një mekanizmi sic është ky komision i cili me pas do e këshillon Përfaqësuesin special të Sekretarit të Përgjithshëm se cilat veprime duhet të ndërmerren për të funksionalizuar sistemin gjyqësor të Kosovës. Në këtë fazëçfarë ishte Kosova ishte shumë e nevojshme që sa më parë të funksionalizohet sistemi gjyqësor për faktin se do të ndikonte në parandalimin e veprimeve negative dhe do të mundësonte që qytetarët të kenë qaje në drejtësi për të kërkuar të drejtat e tyre të cilat ju garanton legjislacioni përkatës në fuqi.

Misioni i UNMIK-ut nuk ndalet së vepruari sa i përket ndërtimit të sistemit gjyqësor dhe atë duke krijuar fillimisht bazën ligjore përmes nxjerrjes së Rregulloreve. Hap shumë i rëndësishëm në kuadër të kësaj iniciative është themelimi i Komisionit këshillëdhënës gjyqësor i cili ka në mandat dhe përgjegjësi për të “ këshilluar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve dhe prokuroreve, sipas nevojës, si dhe me ankesat eventuale, nëse ka, kundër çdo gjyqtari ose prokurori”.¹³⁵ Ku komision konform dispozitave përkatëse të rregullores

¹³⁴Rregulloren nr.1999/6 për rekomandimet mbi strukturën dhe administrimin e shërbimit të gjyqësisë dhe të prokurorisë (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 7 shtator 1999). Shih nenin 5 par 1.

¹³⁵Rregullorja nr.1999/7 për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtareve dhe prokuroreve nga detyra, (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 7 shtator 1999).Shih nenin

ka këtë funksion: “përmes shpalljes publike, fton profesionistët vendës të Kosovës për të konkurruar për të punuar si gjykatës ose prokurorë. Komisioni shqyrton kërkesat e paraqitura të individëve dhe rekomandimet e arsyetuara për kandidatët ia paraqet me shkrim Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm; në shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve, anëtarët e Komisionit duhet të udhëhiqen nga qëllimi i UNMIK-ut për të krijuar një sistem gjyqësor dhe prokurori profesionale, të pavarur, të paanshme dhe shumetnike”.¹³⁶ Kjo politik e UNMIK-ut lidhur me emërimin e gjyqtarëve dhe prokuroreve dhe përcaktimin e kushteve për tu emëruar në këto pozita është edhe një hap më tutje sa i përket funksionimit dhe fillimit të punës së sistemit gjyqësor të Kosovës. Prandaj ky është njëri ndër veprimet konkrete që përmes politikës së hartuar nga UNMIK-u është realizuar funksionimi i sistemit gjyqësor përmes së cilit është kontribuar në ndërtimin e sistemit juridik të vendit.

Në kuadër të sistemit gjyqësor ishte vlerësuar se duhet të ketë edhe ndihmës gjyqtarë (gjyqtarë prototë) të cilët do të jene pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës. Këta gjyqtar ishin parapa me Rregulloren nr.1999/18 për emërimin dhe shkarkimin e ndihmësgjyqtareve nga detyra. Pra me këtë vlerësohej si shumë e rëndësishme që në kuadër të sistemit gjyqësor të ketë edhe persona me nivel të lartë të integritetit moral dhe personal e të cilët do të kontribuonin në sistemin gjyqësor.

Në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës ishte planifikuar që të ketë gjyqtar dhe prokuror nga shtetet e ndryshme të botës të cilët do të emëroheshin nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe kishin “autorizime dhe përgjegjësi t’i ushtrojnë funksionet e detyrës së tyre, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e tyre për zgjedhjen dhe marrjen e përgjegjësisë për rastet e reja penale dhe të pazgjedhura brenda juridiksionit të gjykatës, në të cilën ai apo ajo është emëruar”.¹³⁷ Angazhimi i gjyqtarëve dhe prokuroreve ndërkombëtar ishte tejet i dobishëm për faktin se niveli i lëndëve ishte në rritje e sipër dhe kontribuonin në zgjidhjen e tyre brenda afatit kohor të përcaktuar me legjislacion përkatës në fuqi. Përpos kësaj fakti tjetër pozitiv ishte edhe ai se nga këta gjyqtar ishin bartur shumë përvoja ndërkombëtare e të cilat ishin tejet të rëndësishme në ngritjen e nivelit të lartë të sistemit gjyqësor.

Ndërtimi i sistemit juridik në vend e kërkonte që të themeloheshin edhe disa mekanizma të cilët do të ishin në funksion të ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Lidhur me këtë ishte themeluar Departamenti administrativ i drejtësisë. përmes këtij Departamenti misioni i UNMIK-ut kishte krijuar këtë mekanizëm qeverisës e i cili ishte: “ përgjegjës për udhëheqjen e përgjithshme të çështjeve që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues”.¹³⁸

1.

¹³⁶Po aty, shih nenin 5

¹³⁷Rregullore nr. 2000/6 mbi emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe prokurorëve ndërkombëtarë(Gazeta Zyrtare, UNMIK, 15 shkurt 2000). Shih nenin 1 par 1.2.

¹³⁸Rregullores nr. 2000/15 për themelimin e departamentit administrativ të drejtësisë(Gazeta Zyrtare, UNMIK, 21 mars 2000). Shih nenin 1 par 1.2.

Në kuadër të ndërtimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë ishte e nevojshme që të ketë edhe një mekanizëm i cili do të qeveriste me sistemin gjyqësor të vendit e i cili do të jetë shtylla e tret e pushtetit. Në vitin 2001 UNMIK-u kishte nxjerr Rregulloren nr. 2001/8 për themelimin e këshillit gjyqësor dhe të prokurorisë të Kosovës. Përmes këtij akti ishte themeluar mekanizmi i cili do të ketë: “ përgjegjësi për ta këshilluar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndihmësgjyqtarëve (gjyqtarëve porotë), sipas nevojës, si dhe për të dëgjuar ankesat kundër cilitdo gjyqtar, prokuror ose ndihmësgjyqtari nëse ka të tilla.....”¹³⁹

Krijimi i mekanizmit të këshillit gjyqësor dhe prokurorial ishte hap me të cilin kishte avancim të politik bërjes në fushën drejtësisë kjo për faktin se ky mekanizëm ishte më i kompletuar dhe krijonte një bazë të mirë për ndërtimin e sistemit gjyqësor të Kosovës. Fakt tjetër është edhe ai se përmes këtij mekanizmi misioni i UNMIK-ut kishte filluar që në disa pozita politikbërëse ti angazhonte edhe vendoret. Angazhimi i vendorëve në hartimin e politikave dhe qeverisjes në sistemin e drejtësisë është fillimi i bartëve të kompetencave tek institucionet vendore sa i përket hartimit dhe qeverisjes me sistemin e drejtësisë. Këshilli gjyqësor dhe prokurorial në kuadër të funksioneve kishte atë për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve e të cilët më pas i emëronte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Këshilli kishte funksion edhe sa i përket aspektit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve një mekanizëm për të kontrolluar sjelljet dhe veprimet e pahijshme të gjyqtarëve.

Në kuadër të sistemit juridik ishte themeluar edhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës. Kjo dhomë ishte në funksion të zgjidhjes së kontesteve nga procesi i privatizimit të pronës shoqërore në Kosovë që kishte filluar dhe udhëhiqej nga Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës. Ky agjencion ishte themeluar me Rregulloren nr. 2002/13 mbi themelimin e dhomës së posaçme të gjykatës supreme të Kosovës për çështje që lidhen me agjencinë e mirëbesimit të Kosovës. Kjo Rregullore fillimisht përcakton themelimin e dhomës së posaçme, përbërjen e saj, kompetencën lëndore dhe më pas procedurën.

¹³⁹Rregulloren nr. 2001/8 për themelimin e këshillit gjyqësor dhe të prokurorisë të Kosovës (Gazeta Zyrtare, UNMIK, 6 prill 2001). Shih nenin 1 par 1.2.

7.E Drejta Civile dhe pjesët e saj

E drejta ka historinë e saj dhe në kuadër të saj edhe proceset e zhvillimit nëpër të cilat ka kaluar nëpër kohë. Përpos kësaj e drejta tradicionalisht ka pasur edhe ndarje me të cilat është identifikuar. Ndarja kryesore dhe me e theksuar është ajo ndarja në të drejtën publike dhe atë private.

Me të Drejtën publike nënkuptohet një sistem i normave juridike përmes së cilave rregullohen marrëdhëniet mes individit dhe organit shtetëror. Përmes kësaj kemi një rregullim të raporteve mes subjekteve të së drejtës me shtetin. E drejta private përmes normave juridike që i përmban rregullon raportet dhe marrëdhëniet midis individëve çdo herë me karakter pasuror.¹⁴⁰

Nga fakti se në kuadër të së drejtës private kemi rregullim të raporteve mes individëve, e drejta civile është pjesë e së drejtës private. E drejta private në kuadër të saj ka edhe degë tjera të së drejtës dhe atë Të Drejtën Civile, E Drejta Tregtare, E Drejta e Autorit, E Drejta e Konsumatorit, E Drejta e Sigurimeve.

Në kuadër të disiplinave shkencore – juridike e drejta civile ka pasur epërsinë dhe çdo herë është llogaritet ndër më të vjetrat, gjer vonë në Romë shkencë që i ka takuar asaj juridike është identifikuar me shkencën civile – juridike.¹⁴¹ Rëndësia është vendos tek E drejta Civile pasi ka rregulluar marrëdhëniet me të rëndësishme mes njerëzve ato të cilat kanë pasur karakter pasuror. Karakteri pasuror ka qenë dhe është tejet i rëndësishme për faktin se është var mirëqenia dhe ekzistenca e njeriut andaj çdogjë lidhur me këtë është vlerësuar lartë.

Fushën që mbulon E Drejta Civile është e natyrshme dhe shumë e nevojshme që të ketë ndarje. Ndarjet mundësojnë të ketë fokusim më të detajuar për çdo fushë veç e veç. Për të Drejtën Civile teoria juridike i njeh dy sisteme në të cilat renditen institutet juridike civile në një tersi të përbashkët. Andaj këto dy sisteme janë: Sistemi Institucional i të Drejtës Civile dhe Sistemi Pandekt i të Drejtës Civile.

Sistemi institucional i së drejtës civile ndahet në tri pjesë dhe atë: Persona, Sendë, Padi. Ky ishte një sistem mbi të cilin u zhvillua edhe Kodi Civil Francez. Ndërsa sistemi Pandekt i së drejtës civile ndahet në katër pjesë dhe atë; e Drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve, E Drejta Familjare dhe e Drejta Trashëgimore.

Në të drejtën e sistemit tonë juridik e drejta civile përbehet nga katër pjesë: Pjesa e Përgjithshme e së drejtës civile, E Drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve dhe E Drejta Trashëgimore.¹⁴² E Drejta Familjare nuk bën pjesë në këtë pjesë pasi raportet familjare nuk konsiderohen se kanë elemente

¹⁴⁰A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 60

¹⁴¹A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë. Fq. 16

¹⁴²A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 53, 54, 55

pasurore – juridike sicjanë raportet juridiko civile qe posedojnë elementin pasuroro juridik. Edhe pse disa teori e vlerësojnë se edhe tek raportet familjare është elementi pasuror përkatësisht tek pjesa e kontratës martesore.

8.E Drejta Civile Pozitive

Jeta shoqërore është shumë komplekse dhe gjatë saj ndodhin shume raporte shoqërore përmes se cilave kryhen shkëmbimet te cilat kërkojnë te kenë një rregullim normativ. Andaj rregullimi i raporteve shoqërore përmes normave juridike kemi krijim te se drejtës. E Drejta buron nga vullneti i popullit dhe është një grumbullim dhe sistematizim i normave përmes së cilave rregullohen marrëdhëniet shoqërore. Marrëdhënietshoqërore te cilat kanë te bëjnë me raportet juridiko civile, vjen ne shprehje e drejta civile e cila rregullon këto raporte. E Drejta Civile fillimisht është degë pozitive e së drejtës në të cilën bëjnë pjese të gjitha dispozitat juridike përmes se cilave rregullohen marrëdhëniet shoqërore me karakter pasuror, ose ato marrëdhënie shoqërore qe ne fillim nuk kanë pasur karakter pasuror po ne fund kanë marr karakterin pasuror.¹⁴³

Ne Kosovë e Drejta Civile ka një histori dhe ka një te kaluar me specifike pasi zhvillimi i saj është var dhe është zhvilluar varësisht sistemit juridik te shteteve pushtuese qe kanë qen ne Kosove. Deri ne vitin 1912 Kosova ishte e okupuar nga Perandoria Osmane dhe sistemi juridik i kësaj Perandorie ishte i instaluar edhe ne Kosove. Pas luftërave Ballkanike te viteve 1912 – 1913 kishte ndryshuar pozita e Kosovës, tani Kosova bënte pjese ne Serbin jugore dhe i përkiste juridiksionit te Serbisë.

Në vitin 1914 Turqia dhe Serbia përmes Traktatit te Stambollit, përkatësisht ne nenit V ishin parashikuar “ Të drejtat e pronësisë mbi paluajtshme rite, në viset e cenuara, që individët ose personat e ndryshëm juridik i kanë fituar në bazë të ligjeve turke para se këto vise t’i pushtonte Serbia, do të respektohen dhe askush nuk do të mund të privohet prej pronësisë së vet përves në interes publik, të konstatuar me rregull dhe me një kompensim pararendës juridik dhe të drejtë”.¹⁴⁴ Përmes kësaj shteti Serb ishte zotuar se do të bej respektimin e asaj qe ishte rregulluar me sistemin turk sa i përket raporteve juridiko civile. Serbia përmes Dekretligjeve insistonte te bënte ndryshime dhe te impononte sistemin e saj juridik duke i rrënuar edhe ato aktet Turke edhe pse ishte zotuar se do ti respekton raportet juridike qe janë krijuar duke u bazuar ne ligjet Turke. Insistimi i serbis që përmes së drejtës së saj të depërtonte dhe të rregullonte raportet juridiko Civile ishte një proces i ngadalshëm por i sigurt pasi duke nxjerrë dekrete me te cilat e fuste ne zbatim Kushtetutën e Mbretërisë së Serbisë e 5 qershorit 1903 dhe me

¹⁴³Po aty. Fq. 21.

¹⁴⁴F. Berisha (2013) Hyrje në të Drejtën, Pejë. Fq. 127.

pas ato dispozitat e Kodit Civil të vitit 1844 dhe ligjeve tjera që rregullonin marrëdhëniet juridiko civile.¹⁴⁵ Pas viteve 1912, tendenca e Serbisë ka qenë që përçudofushë të jetës në Kosovë të shtrin të drejtën e saj. Edhe në rregullimin e marrëdhënieve juridiko civile ishte kjo tendencë dhe kishte arritur të ja del.

Në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, Kosova kishte pësuar një okupim prej katër viteve nga okupator të ndryshëm siç ishin Italianët, Gjermanët, Bullgaret dhe Austro-hungarezët. Çdo herë nga popullsia vendase për marrëdhëniet juridiko civile nuk kishte vullnet të zbatohet e drejta e huaj por zbatohet e drejta zakonore si një e drejtë që kishte bazën në traditën e vendit.

¹⁴⁵A. Aliu (2013) E drejta Civile, Prishtinë. Fq. 152, 153.

KAPITULLI VI POLITIKBERJA NE FUSHEN E LEGJISLACIONIT TË SË DREJTËS CIVILE NË KOSOVË PAS VITIT 2008

1.E drejta e Republikës së Kosovës për hartim të legjislacionit dhe ndryshimi i legjislacionit të UNMIK-ut në atë të Republikës së Kosovës.

Viti 2008 ishte vendimtar për Kosovën pasi në këtë vit Kosova shpalli pavarësinë dhe u bë shtet i pavarur dhe Sovran. Me 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Kosovës, deputetet e Kosovës shpallen Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. “Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.”¹⁴⁶ Nga kjo datë e tutje kemi rënie të kompetencave dhe përgjegjësi të Misionit të UNMIK-ut në Kosovë. Kjo është periudha kur fillon bartje e kompetencave të plota në institucionet vendore si bartëse të proceseve të ardhshme.

Viti 2008 është viti kur për herë të parë Kosova ka Kushtetutën e saj dhe mbi bazën e saj është edhe ndarja e pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Me këtë kemi edhe fillimin e ndërtimit të sistemit juridik të Kosovës, si një sistem juridik i cili bazohet në Kushtetutën e vendit dhe parimet më të mira ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar se do të inkorporoj në kuadër të sistemit të saj Juridik. Ndërtimi i sistemit juridik në Kosovë është ndarë si kompetenca të veçanta tek institucionet përkatëse. Ndërtimi i sistemit juridik mundësohet përmes hartimit dhe plotësim ndryshimit të legjislacionit e i cili më pas gjen zbatim tek institucionet përkatëse. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka parapa edhe kompetencën e iniciativës legjislative dhe institucionet gjegjëse për hartimin e legjislacionit. “Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushe veprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.¹⁴⁷ Mundësia e shprehur në këtë dispozitë e tregon konceptin e mirë që ka të paraparë Kushtetuta e vendit sa i përket qeverisjes dhe mënyrës se qeverisjes me një koncept të gjithë përfshirjes po me ndarje të pushteteve dhe kontrollim të njëra tjetrës.

¹⁴⁶Deklarata e Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008) Kuvendi i Kosovës, Prishtinë.

¹⁴⁷Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008). Shih nenin 79.

Në vitin 2008 kemi ndryshime te shumta shoqërore, politike dhe zhvillimore në Kosovë e te cilat janë si rezultat i shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Qeveria e Republikës së Kosovës si njëri ndër sponsorizuesit e legjislacionit kishte filluar punën e sponsorizimit të legjislacionit i cili ishte vital për ndërtimin e shtetit të ri të Kosovës. Në bazë të kompetencës së vetë, Kuvendi i Kosovës kishte filluar me nxjerrjen e legjislacionit i cili ishte shumë me rendësi për disa mekanizma institucional që i takonin ndërtimit të shtetit të Kosovës.

Ndër veprimet e para që janë ndërmarr nga institucionet e Kosovës është edhe zëvendësimi i legjislacionit të nxjerrë nga misioni i UNMIK-ut me legjislacion tani nga institucionet e Republikës së Kosovës. Periudha pas shpalljes së pavarësisë së vitit 2008, ishte fillimisht periudhë e ndërtimit të sistemit të ri juridik të Republikë së Kosovës, me pas ishte ndryshim i legjislacionit nga ai i UNMIK-ut në atë të Kosovës. Pra këto ndryshime shoqërore në këtë periudhë janë reflektuar edhe në ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe Miratimit të Kushtetutës, ishte krijuar baza e plotë që Republika e Kosovës të filloj të ndërtoj sistemin e saj juridik në kuadër të së cilit edhe plotësimin, ndryshimin dhe hartimin e legjislacionit të së drejtës civile. Kur i referohemi bazës së përgjithshme në kuadër të Kushtetutës së Kosovës për hartimin e legjislacionit, kemi parasysh nenin 4 i cili përcakton: “Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë”¹⁴⁸. Me këtë nen përcaktohet qartë forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës, ku Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ, Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit, Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar, Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat, Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Sa i përket epërsisë së Kushtetutës, kjo rregullohet me nenin 16, paragrafi 1, ku përcakton: “ Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.”¹⁴⁹. Me këtë përcaktim që benë Kushtetuta e Republikës së Kosovës fillimisht e përcakton se në Republikën e Kosovës, kushtetuta është akti juridik më i larti dhe njëherit i obligon aktet tjera që duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën. Pra sipas kësaj, Kushtetuta rregullon në parim dhe në vija të përgjithshme çdo fushë, ndërsa aktet tjera që rregullojnë fushat më në detaje dhe specifike duhet të jenë në pajtim me kushtetutën si aktin më të lartë në vend. Nga kjo

¹⁴⁸Po aty, Shih nenin 4 par 1.

¹⁴⁹Po aty, shih nenin 16 par 1.

dispozitë kuptojmë se në Republikën e Kosovës me miratimin e Kushtetutës, kemi hiarki të akteve nga Kushtetuta e tutje më poshtë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka parapa dhe rregulluar çështjen e zbatimit të së Drejtës Ndërkombëtare në Kosovë. Neni 19, paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton: “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vete zbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji. 2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.”¹⁵⁰. Me këtë përcaktim në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fillimisht është një vlerë e lartë juridike dhe kushtetuese, për faktin se Marrëveshjet ndërkombëtare behënpjesë e sistemit juridik në vend, me këtë tregohet serioziteti dhe përkushtimi i Shtetit të Republikës së Kosovës që të jetë serioz në marrëveshjet ndërkombëtare duke filluar nga negocimi dhe gjer te implementimi i tyre.

Sistemi juridik i vendit është tejet i avancuar ku ka te rregulluar përmes Kushtetutës edhe Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet “ Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.”¹⁵¹ Duke ju referuar kësaj që rregullon neni 22 i kushtetutës, fillimisht behet i njohur qëndrimi i shtetit të Kosovës që orientimin e ka drejt vlerave universale të të drejtave të njeriut si mekanizma që sigurojnë trajtim dhe barazi. Përpos kësaj me vlerë shumë të lartë është edhe përcaktimi i këtyre mekanizmave ndërkombëtar sa i përket të drejtave të njeriut që të gjejnë zbatim të drejtpërdrejt

¹⁵⁰Po aty, shih nenin 19 par 1, 2.

¹⁵¹Po aty, shih nenin 22.

në kuadër të sistemit juridik. Ajo se çfarë është tejet standard i lartë në këtë është epërsia dhe prioriteti i këtyre mekanizmave në raport me dispozitat përkatëse ligjore.

Lidhur me kompetencën e Kuvendit të Kosovës, Kushtetuta e ka përcaktuar edhe këtë kompetencë, në nenin 65, përcaktohet: “Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;”¹⁵². Përmes këtij përcaktimi, Kuvendi i Kosovës është organi i vetëm kompetent dhe përgjegjës që miraton ligje sipas procedurave të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi. Me këtë kuptojmë se organi i vetëm që mund të nxjerr ligje është Kuvendi, të cilit i lindin edhe te drejtat e mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit dhe interpretimit të tij. Në bazë të formës së qeverisjes dhe ndarjes së Pushtetit në Kosovë, kuvendi ka fuqinë legjislative e cila ka burimin në vullnetin e popullit përmes përfaqësimit të tyre të deputeteve në kuvend. Pjesa që i referohet miratimit të Ligjeve, sipas nenit 80, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet: “1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.”¹⁵³. Përpos kësaj, Kushtetuta e Kosovës përcakton edhe Legjislacionin me Interes Vital dhe mënyrën e votimit në Kuvend që është më ndryshe se sa tek miratimi i rregullt i ligjeve tjera, ku në nenin 81, paragrafi 1, përcaktohet: “Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:”¹⁵⁴.

Kompetencë dhe përgjegjësi sa i përket hartimit të legjislacionit ka edhe Presidenti i Republikës së Kosovës, neni 84, paragrafi 4 dhe 5, përcaktojnë: “shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;”¹⁵⁵. Kompetenca e Presidentit është në dy drejtime, në atë të dekretimit të ligjit dhe procedimi për publikim në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe tjetra mundësia që ligjin të kthej prapa për rishqyrtim nëse janë prekur apo dëmtuar interesat e përgjithshme të vendit.

Sa i përket sponsorizimit dhe miratimit të legjislacionit, është Kompetent edhe e Qeveri si ekzekutivi i vendit, në bazë të nenit 93, paragrafi 3, përcakton: “propozon Kuvendit projektligje dhe akte të

¹⁵²Po aty, shih nenin 65.

¹⁵³Po aty, shih nenin 80 par 1.

¹⁵⁴Po aty, shih nenin 81 par 1.

¹⁵⁵Po aty, shih nenin 84 par 1, 2.

tjera;’’¹⁵⁶. Qeveria e Republikës së Kosovës si ekzekutivi i vendit ka mandat që Kuvendit nga dikasteret e saja ti propozoj projektligje për miratim. Kjo mundëson që Qeveria për ato resorë që kanë të nevojshëm legjislacionin, i propozon kuvendit projektligje dhe të njëjtat e aprovohen nga Kuvendi dhe më pas e zbaton nga Qeveria dhe institucionet përkatëse. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka parapa edhe Gjykatën Kushtetuese, ku neni 12, paragrafi 1, përcakton: ‘‘Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.’’. Nga ajo se çfarë na përcakton kushtetuta, Gjykata Kushtetuese është organi i vetëm i cili ka në kompetencë interpretimin e Kushtetutës dhe harmonizimin e Ligjeve me Kushtetutën.

Republika e Kosovës çështjen e nismës legjislative e ka parapa dhe rregulluar përmes ligjit përkatës dhe atë Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 23 / 26 tetor 2011, Prishtinë Ligji nr. 04/-I-025 për Nisma Legjislative. Neni 1 dhe 2 i këtij Ligji përcakton: ‘‘Ky ligj ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat për nismat legjislative. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin nismën për të propozuar ligje, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët e Kuvendit, dhe nga më së paku dhjetëmijë (10.000) qytetarë.’’¹⁵⁷ Me këtë ligj kemi të rregulluar çështjen kush mund të merr nismë legjislative dhe cilat kushte duhet të plotësohen. Neni 9 i Ligjit nr. 04/-I-025 për Nisma Legjislative, përcakton: ‘‘ Qeveria e Republikës së Kosovës ka të drejtë të nismës për të propozuar ligje, nga fushë veprimtaria e saj, sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe me Rregullat e Punës së Kuvendit.’’. Kjo është baza ligjore që i mundëson Qeverisë të ketë nisma legjislative nga fushe veprimtaria e saj.

2.Procedurat e hartimit të politikave dhe legjislacionit në Kosovë

Hartimi i politikave dhe legjislacionit në Kosovë është i planifikuar, strukturuar në legjislacionin përkatës në fuqi i cili rregullon në mënyre të detaizuar procesin nga fillimi gjer në fund të politikave dhe Legjislacionit. Politikat nënkuptojnë veprimet që ndërmer Qeveria, të cilat në një mënyrë apo tjetrën ndikojnë në përmirësimin dhe avancimin e një fushe të caktuar shoqërore. Hartimi i politikave në kuadër të Qeverisë është procesi i shndërrimit të qëllimeve të Qeverisë në propozime konkrete. Nga kjo kuptojmë se, hartimi i politikave është procesi i cili ministrive ju mundëson që ti shndërrojnë prioritetet dhe premtimet e Qeverisë në propozime konkrete për implementim. Politikat Qeveritare në Kosovë, rregullohen dhe materializohen përmes këtyre dokumenteve: strategjitë, Plani Vjetor i Punës

¹⁵⁶Po aty, shih 93 par 3.

¹⁵⁷Ligji nr. 04/-I-025 për Nisma Legjislative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 23 / 26 Tetor 2011, Prishtinë). Shih neni 1, 2.

së Qeverisë, Koncept Dokumentet, Memorandumet Shpjeguese dhe Planet e Veprimit. Përmes këtyre dy dokumenteve Qeveria e Republikës së Kosovës i planifikon, përcakton, dhe synon ti rregulloj fushat të cilat kanë nevojë që të rregullohen përmes politikave Qeveritare.

Çështjen e trajtimit të politikave në nivel Qeveritar e rregullon Rregullorja nr. 09/2011 e punës së qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila përcakton: ‘‘ Analiza e politikave përfundon me përgatitjen e një koncept dokumenti ose memorandumit shpjegues i cili dorëzohet në mbledhjen e Qeverisë ose në një Komision Ministror. Në rastet e përcaktuara nga Ministria e Financave, sipas nenit 31, koncept dokumentit ose memorandumit shpjegues duhet t’i bashkëngjitet vlerësimi i ndikimit financiar.’’¹⁵⁸ Në këtë dokument vihen themelet e rregullimit, planifikimit dhe realizimit të politikave Qeveritare si mekanizma që ju paraprin disa veprimeve dhe ligjeve konkrete. Si mekanizma konkret në kuadër të analizave të politikave, Rregullorja e Qeverisë i parasheh Koncept dokumentin ose memorandumit shpjegues, këta janë dy dokumente përmes së cilave Qeveria bën analizimin e politikave dhe ofron opsione për ndryshimin, plotësimin e mekanizmave përkatës.

Rregullorja e qeverisë në mënyrë shumë të detajuar ka të rregulluar koncept dokumentin si mekanizëm Qeveritar për analizimin e politikave, dhe nxjerrja e tij ka një qëllim. ‘‘Qëllimi i koncept dokumentit është që t’i mundësojë Qeverisë shqyrtimin e përgjithshëm të objektivave dhe karakteristikave kryesore të një propozimi si dhe opsioneve të ndryshme për zgjidhjen e çështjes përkatëse. Qeveria mund ta aprovojë apo t’i ndryshojë rekomandimet e dhëna në koncept dokument. Organi propozues nuk mund të iniciojë hartimin e legjislacionit ose elaborimin e hollësishëm të rekomandimeve përderisa Qeveria të ketë nxjerrë një vendim lidhur me koncept dokumentin e dorëzuar’’¹⁵⁹. Nga përmbajtja e kësaj shifet se është mekanizëm përmes së cilit Qeveria i shqyrton objektivat e saj duke dhënë edhe opsionet për zgjidhje konkrete.

Koncept dokumenti gjatë trajtimit dhe analizimit të politikave, si opsion i rekomanduar mund të derivon hartimi i projektligjit përkatës i cili do të rregulloj një fushë të caktuar. Hartimit të legjislacionit çdo herë i paraprin hartimi i koncept dokumentit si mekanizëm paraprak përmes së cilit behet analizimi i politikave dhe ofrohen opsione konkrete. ‘‘Koncept dokumentet zakonisht do t’i paraprijnë projektligjeve të reja, ndryshimit dhe plotësimin të ligjeve ekzistuese, akteve të rëndësishme nënligjore si dhe propozimeve të tjera që kanë ndikim të konsiderueshëm social, ekonomik ose ndikim tjetër. Koncept dokumentet gjithashtu do t’u paraprijnë propozimeve me kosto të lartë të zbatimit ose që ndërliken me prioritete të rëndësishme të Qeverisë ose të një ministrie.’’¹⁶⁰. Me këtë dëshmohet se koncept dokumenti është dokumenti fillestar para se të fillohet me hartimin e projektligjit. Ky

¹⁵⁸Rregullorja nr. 09/2011 e punës së qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare publikuar më 07.09.2011). Shih, nenin 28 par 3.

¹⁵⁹Po aty, Shih, nenin 29 par 1.

¹⁶⁰ Po aty, Shih, nenin 29 par 2.

dokument mundëson që të ketë cilësi të lartë në hartimin e legjislacionit për faktin se koncepti dokumenti trajton në detaje një politikë të caktuar, prandaj “në konceptin e dokumentit duhet të përcaktohen si vijon: Çështjet kryesore të trajtuara; Objektivat dhe ndërlidhja e propozimit me prioritetet e Qeverisë; Opsioni i rekomanduar; Arsytimi i propozimit; Elementet kryesore të politikës së propozuar (përmbajtja, instrumentet e politikave, kosto, procedurat administrative) ; Përmbledhje të shkurtra të opsioneve të tjera të shqyrtuara; Pasojat e të gjitha opsioneve të shqyrtuara (përfitimet dhe pasojat negative, kosto buxhetore, përshtatshmëria administrative dhe e zbatimit si dhe kostot dhe pasojat tjera) ; Vlerësimi i ndikimit financiar për secilin opsion: Konsultimi (kush është konsultuar dhe përmbledhje të shkurtra të përgjigjeve); Mënyra e komunikimit të politikës së re për publikun; Sfondi dhe analiza (në aneks) – një përshkrim më i hollësishëm i analizës, duke përfshirë faktet esenciale, sipas nevojës; Projekt vendimi i Qeverisë.”¹⁶¹. Ministrat sponsorizojnë legjislacionin përkatës për fushën që ato mbulojnë dhe kanë fuqi veprimtari. Kompetencë dhe përgjegjësi e përcakton legjislacioni përkatës që rregullon hartimin e legjislacionit, i cili përcakton se Ministria “propozon projektligje nga fushëveprimi i ministrisë dhe përcakton orientimin politik të punës së ministrisë”¹⁶². Lidhur me hartimin e politikave dhe legjislacionit, kemi një ndarje edhe brenda Ministrive, “Ministria e Drejtësisë ka këto kompetenca: i. zhvillon politikën brenda fushës së saj të përgjegjësisë, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë; zhvillon dhe zbaton politika për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në pajtim me ligjin në fuqi;”¹⁶³. Përmes kësaj shtojce të rregullores, bëhet përcaktimi i qartë se Ministria e Drejtësisë është kompetente dhe përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit nga fusha e drejtësisë.

Miratimi i konceptit dokumentar nga Qeveria, i hap rrugën Ministrisë përkatëse që të fillojë me hartimin e projektligjit përkatës. Nga kjo fazë politike qeveritare fillon që të materializohet përmes hartimit të projektligjit për fushën që ka trajtuar koncepti dokumentar. Hartimi i legjislacionit në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës është i përcaktuar dhe rregulluar me legjislacionin përkatës i cili në mënyrë të detajuar përcakton çdo procedurë nga fillimi deri kur aprovohet në Qeveri. “Brenda një muaji nga miratimi i konceptit dokumentar nga Qeveria, ministrat përkatës caktojnë personin përgjegjës për përgatitjen e projektit fillestar të projektligjit ose aktit nënligjor. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë bazuar në Programin Legjislativ cakton afatin kohor për përfundimin e projektit fillestar të projektligjit ose aktit nënligjor.”¹⁶⁴. Kur opsioni i rekomanduar është hartimi i legjislacionit dhe kështu aprovohet

¹⁶¹ Po aty, Shih, nenin 29 par 1

¹⁶²Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, neni 8, paragrafi 1, nenparagrafi 1.3.

¹⁶³Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (Gazeta zyrtare, data e publikimit 22.03.2011). Shih, Shtojcen 1.

¹⁶⁴ Rregullorja nr. 09/2011 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare publikuar më 07.09.2011). Shih, nenin 38 par 5.

në Qeveri, Ministria e Drejtësisë përgatit planin legjislativ dhe i njëjti i dërgohet Qeveris. “ Plani Vjetor i Punës do të përfshijë aktivitete legjislative dhe jo-legjislative. Aktivitetet legjislative do të përmbliken në një shtojcë të veçantë (Programi Legjislativ) të planit vjetor të punës me qëllim të lehtësimit të menaxhimit dhe monitorimit të iniciativave legjislative të Qeverisë”¹⁶⁵.

Pasi që te ketëpërfunduar draftin e parë të Projektligjit, Zyrtari përgjegjës Projektligjin e dërgon për në konsultime paraprake. “Organi i cili ka përgatitur materialin (“organi propozues”) është përgjegjës për të siguruar që të gjitha organet e larta të administratës shtetërore, dhe ato tjerat te parapara që tu dërgohet projektligji për konsultime me publikun, në veçanti, organi propozues duhet të konsultohet me: Ministrinë përkatëse për Financa, Ministrinë përkatëse për Integritet Evropiane, Sekretariatit, e Qeveris, Zyrën për Planifikim Strategjik, Zyrën Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, Zëdhënësin e Qeverisë dhe Zyrën për Komunikim Publik, Ministrinë përkatëse për drejtësi, Ministrinë përkatëse për administratë publike, Ministrinë përkatëse për vetëqeverisje lokale, Këshillin Konsultativ për Komunitete, Avokati i Popullit, Ministrinë përkatëse për Komunitete dhe Kthim, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë.”¹⁶⁶ Në këtë fazë këto institucione kanë mundësin që të ofrojnë komentet, sugjerimet dhe propozimet konkrete për projektligjin e dërguar në konsultime paraprake. Komentet, sugjerimet dhe propozimet konkrete te pranuar, institucioni sponsorizues është përgjegjës që të shqyrtoj një nga një të gjitha komentet dhe ato që janë të arsyeshme dhe e kompletojnë projektligjin, inkorporohen në kuadër të dispozitave përkatës të Projektligjit. Përmes kësaj forme të konsultimit, institucioneve u jepet mundësia që të jenë të njoftuar me projektligjin të cilin Ministria është duke e përgatitur po një herit i jep mundësi që nga fushëveprimi i institucionit, institucioni të jep komente.

Ministria pasi te ketë konsoliduar projektligjin me inkorporimin e komenteve nga konsultimet paraprake, projektligjin e vendos në konsultime me publikun. Konsultimet me publikun janë më të gjera dhe përfshin institucionet, OJQ-t dhe grupet e interesit. Janë të përcaktuara disa forma të konsultimeve me publikun ‘për mbledhjen e mendimeve të shoqërisë civile dhe publikut rreth çështjeve të draft ligjet. Në vijim janë disa prej këtyre metodave dhe teknikave të ndryshme të konsultimit: Konsultimet me shkrim; Takimet publike; Konferencat; Takimet me Grupe të Fokusit/Interesit; Punëtoritë; Intervistat / takimet sy-në-sy; Hulumtimet e opinionit; Votimi diskutues; Panelet me qytetarë; Stendat në rrugë”¹⁶⁷. Kjo është mënyrë më e gjerë e konsultimeve me publikun, për faktin se kemi numër më të madh të institucioneve të cilat kanë mundësi të ofrojnë komente dhe propozimekonkrete.

¹⁶⁵ Po aty, shih nenin 47 par 3.

¹⁶⁶Po aty, shih nenin 7.

¹⁶⁷Udhëzues për procesin e konsultimeve publike, Nr. 062/2011 Datë: 26.09.2011,

Ministria me të pranuar komentet, sugjerimet, këshillat, propozimet konkrete, të njëjtat i trajton dhe shqyrton dhe mbi bazën e arsyeshme ris së tyre të njëjtat i inkorporon në kuadër të dispozitave përkatëse të projektligjit. Ministria çdo koment të çdo institucioni e vendos në tabelë dhe ofron arsyetimin për inkorporimin e tyre në projektligj apo mos inkorporim të tyre në projektligj, kjo tabelë i bashkëngjitet Memorandumit Shpjegues i cili është dokument që se bashku me projektligjin dërgohet për në Qeveri për aprovim. Kur te kemi të gatshëm projektligjin, Ministria bën vlerësimin e ndikimit buxhetor të projektligjit dhe me pas nxjerr deklaratën financiare. njëjtë është edhe vlerësimi sa i përket përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e BE-së dhe në fund nxjerrët Deklarata e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Ministria para se te procedoj Projektligjin për aprovim në Qeveri, Projektligjin e dërgon në Ministrin e Financave dhe kërkon që të vlerësojnë dhe më pas të lëshojnë Deklaratën financiare me të cilën dëshkohet se ekziston planifikimi buxhetor. Njëjtë dërgohet edhe në Ministrin e Integritit për të vlerësuar përputhshmërinë e Projektligjit me legjislacionin e BE-së dhe kërkohet që të lëshohet deklarata e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. Kur kemi të përfunduara edhe këto dy veprime, atëherë kemi përgatitjen e Memorandumit Shpjegues për projektligjin i cili përfshin dhe përcakton: Çështjen kryesore të trajtuar; Objektivat dhe ndërlidhja e tyre me prioritetet e Qeverisë; Opsioni i rekomanduar; Arsyetimi i propozimit, duke përfshirë një shpjegim të nivelit të përafrimit me legjislacionin e BE-së; Elementet kryesore të legjislacionit ose politikës së propozuar (përmbajtja, instrumentet e politikave, kosto, procedurat administrative); Listën e plotë të akteve ligjore të BE që duhet të përfshihen në projekt aktin ligjor si burime informuese (nëse është e aplikueshme); Vlerësimi i ndikimit financiar të opsionit të propozuar; Konsultimi (kush është konsultuar dhe përmbledhje të shkurtra të përgjigjeve); Mënyra e komunikimit të politikës së re për publikun; Projekt vendimi i Qeverisë; të dhëna të tjera analitike të nevojshme për t'ua lejuar ministrave që të marrin një vendim të informuar.¹⁶⁸

Kur i kemi te përfunduara te gjitha këto procedura për hartimin e projektligjit, Ministria e përgatit projektligjin dhe ja bashka ngjetkëto dokumente: Projektligjin ne tri gjuhë, Memorandumin shpjegues, Deklaratën financiare nga Ministria e Financave, Deklaratën e Ministrisë se Integritit dhe pas aprovimit nga ana e Ministrit, Projektligji procedohet për në Qeveri që të aprovohet dhe me pas te procedohet për në Kuvendin e Kosovës për miratim.

¹⁶⁸Rregullorja nr. 09/2011 e punës së qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare publikuar me 07.09.2011). Shih, nenin 30.

Nga ato veprime dhe procedura qe parashihen për hartimin e politikave dhe legjislacionit në Kosovë, kuptojmë se është një proces transparent ku përfshihen të gjithë aktorit dhe grupet e interesit, ekzistojnë mekanizma që gjatë procesit te konsultohen institucionet kompetente dhe përgjegjëse duke ju dhënë mundësi që të ofrojnë komentet e tyre dhe mbi bazën e arsyeshme ris të njëjtat të inkorporohen në kuadër të projektligjit. E rëndësishme në këtë proces të hartimit të legjislacionit është edhe harmonizimi i projektligjit me Kushtetutën që është një obligim për të qenë në harmoni me Kushtetutën Projektligji. Përpos kësaj Projektligji i nënshtrohet edhe një vlerësimi të ndikimit buxhetor, me këtë tregohet saktë sa do jete kostoja e buxhetit për të implementuar projektligjin, kjo i mundëson që institucionet përgjegjëse të bëjnë planifikimin buxhetor për implementim te legjislacionit.

E rëndësishme dhe tejet me domethënie është edhe harmonizimi i projektligjit me direktivat e BE-së, kjo për faktin se Kosova është në fazën kur legjislacionin duhet ta ketë në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së dhe të bëjetranspozimin e direktivave të BE-së në legjislacionin e vendit. Kur e vlersojm si proces, mund te themi se është proces transparent, gjithëpërfshirës dhe i ndërtuar konform legjislacionit të BE-së që është edhe synim i Kosovës që të përafroj legjislacionin me atë të BE-së. Nga ky proces ne mund të konstatojmë se kemi një legjislacion i hartuar konform standardeve, i bazuar në vlerësim paraprak dhe mendim nga baza që janë institucionet që bëjnë zbatimin e tyre dhe me perspektiv sa i përket vlerave ndërkombëtare dhe atyre të BE-së.

3.Mbulimi i fushave të së drejtës civile me legjislacion përkatës

Me shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe hyrjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës në fuqi, kishin lindur dy obligime për shtetin e Kosovës, një ndryshimi i legjislacionit të së drejtës civile që i takonte ish sistemit juridik Jugosllav dhe ati Serb i cili gjente zbatim ende në kuadër të sistemit juridik dhe nën dy hartimi i legjislacionit përkatës për të mbuluar fushat e së drejtës civile e të cilat nuk kanë qenë të mbuluara me legjislacion përkatës. Kur i referohemi reformimit te sistemit juridik përkatësisht atyre që do të ndikonin në ngritjen e kapaciteteve në kuadër të marrëdhënieve juridiko civile, kemi storie te suksesit Ligjin mbi Noterinë, krijimi i sistemit të Noterisë në Kosovë është një reformim dhe avancim tejet i lartë sa i përket qasjes në drejtësi, ofrim të shërbimeve në afat sa më të arsyeshme kohor, kosto më të lirë me ndikim edhe në investimet e huaja, lehtësira në të bërit biznes dhe respektim të të drejtave të njeriut. “ Shërbimi i noterisë është shërbim juridik dhe publik

që e ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizik dhe juridik në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës’’¹⁶⁹

Formimi i sistemit të Noterisë është njëra ndër reformat më të suksesshme të Ministrisë së Drejtësisë i cili ka ndikim të drejtpërdrejt të qytetarët dhe bizneset, kjo mundëson që sistemi juridik i Kosovës të fillon të marrë atë formën se si do duhej të jetë. Duke pasur për bazë se planifikimi për hartimin e legjislacionit parashihet në kuadër të Strategjisë Legjislative, pas hyrjes shpalljes së pavarësisë dhe hyrjes së Kushtetutës në fuqi, Ministria e Drejtësisë kishte parapa në Strategjinë Legjislative për vitin 2009 ndër të tjerë edhe hartimin e Projektligjit për Detyrimet.¹⁷⁰ Ky projektligj për Detyrimet, do të zëvendësonte Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve të ish sistemit juridik jugosllav dhe përmes kësaj Ministria e Drejtësisë do të zëvendësonte këtë projektligj dhe një herit do të reformonte karshi ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike të drejtën e detyrimeve. Me përfshirjen e Ligjit për Detyrimet në strategjinë Legjislative, Ministria kishte filluar që të bëjë reformimin e legjislacionit të fushës së drejtës civile, e i cili ishte tejet i nevojshme për faktin se një pjesë ishte e ish sistemit juridik Jugosllav, Serb apo UNMIK-ut, dhe kishte fusha që nuk ishin të mbuluara me dispozita përkatëse konform ndryshimeve shoqërore që kishin ndodhur. Duke qenë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit për fushën e drejtësisë, Ministria e Drejtësisë edhe në Strategjinë Legjislative të vitit 2010 kishte parapa hartimin e projektligjeve ndër të tjera Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarrimit dhe Projektligji për Ndhimën Juridike Falas.¹⁷¹ Në kuadër të kësaj Strategjie kemi të planifikuar dhe paraparë një Projektligj tejet me rëndësi që i referohet fushës së drejtës civile asaj procedurale sic është Projektligji për Procedurën e Përmbarrimit. Nga ajo se çfarë ka qenë dhe çfarë është parapa në kuadër të Ligjit për Procedurën e Përmbarrimit mund të themi lirisht se ka qenë një reformë e thellë, kjo për faktin se përmes këtij ligji kemi një reformë të përgjithshme në fushën e përmbarrimit pasi me këtë Ligji për herë të parë themelohet sistemi i përmbarrimit privat. Prandaj me këtë ‘‘Ligj parashihet të rregullohet edhe kryerja e veprimtarisë së përmbarruesve privat.’’¹⁷²

Hartimi dhe miratimi i Ligjit për procedurën përmbarrimore është një reformë tejet e thellë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, kjo për faktin se përmes krijimit të sistemit të Përmbarrimit Privat synohet që të intervenohet në zvogëlimin e numrit të vendimeve gjyqësorë të cilët ishin mbetur pa u përmbarruar

¹⁶⁹Ligji Nr. 03/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti Iii / Nr. 42 / 25 Nëntor 2008). Shih nenin 2 par 1.

¹⁷⁰ Strategjia Legjislative Për Vitin 2009 (e aprovuar me datën 24.12.2008 dhe e plotësuar dhe ndryshuar me Vendimet e Qeverisë: nr. 02/56, nr. 07/57, nr. 03/61, nr. 02/67., 03/67, nr. 06/67, nr. 03/76).

¹⁷¹ Strategjia Legjislative për Vitin 2010 e miratuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/101 (datë 30.12.2009).

¹⁷²Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 3 / 31 Janar 2013, Prishtinë). Shih nenin 1 par 4.

më vite të tëra dhe kjo kishte dëmtuar jashtë mase bizneset, investimet e huaja dhe personat fizik duke ju pamundësuar që të disponojnë me kapitalin e tyre.

Projektligji për Ndhimën Juridike Falas është politik e Ministrisë së Drejtësisë që ka për qëllim një kategori të shoqërisë me kushte jo të mira ekonomike e cila e ka të pamundur të angazhoj avokat, ti mundësoj që në kontestet civile të angazhoj Avokat shpenzimet e te cilit do i bart buxheti i shtetit. Përmes kësaj politike, do të mundësohet qytetarëve që të kenë qasje në drejtësi si e drejt elementare dhe të kenë mundësi ti mbrojnë të drejtat e tyre nga marrëdhëniet juridiko civile në kuadër të proceseve gjyqësore. Duke dashur që të kemi më të qartë politiken e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me ndihmën juridike falas ‘ligj ka për qëllim të krijoj një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.’¹⁷³

Rregullimi i fushës së ndihmës juridike falas me Ligj, është dëshmi se synimet e Ministrisë së Drejtësisë janë të krijoj legjislacion që çdo qytetari ti mundëson qasje në drejtësi, mbrojtje të të drejtave, dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Krahas ndryshimit dhe reformimit të sistemit juridik përkatësisht legjislacionit të së drejtës civile, ishte i nevojshëm që të ketë reformim edhe legjislacioni procedural i së drejtës civile. Kjo ishte planifikuar nga Ministria e Drejtësisë që të reformohet Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore¹⁷⁴. Reformimi i këtij ligji kishte për qëllim që të eliminonte pengesat të cilat shkaktojnë vështirësi për qasje në drejtësi, tej zgjatje të procedurave, kosto të lartë financiare dhe eliminimin e barrierave që kanë refleksion në investimet e huaja dhe në lehtësirat e të bërit biznes.

4.Evolimi i Legjislacionit të së Drejtës Civile krahas avancimit të sistemit juridik të Kosovës

Pas vitit 2008 sistemi juridik i Kosovës ishte në fazën e reformimit konform obligimeve tash që kishte Kosova si shtet i ri. Reformimi i sistemit juridik ishte i fokusuar në reformimin e legjislacionit të së drejtës, konform standardeve ndërkombëtare, hartimin e legjislacionit të ri me të cilin do të mbulohen fusha të së drejtës e të cilat nuk kanë qenë të rregulluara me legjislacionin përkatës dhe inkorporimi në legjislacion i ndryshimeve shoqërore, sociale dhe ekonomike në vend. Krahas avancimit të sistemit juridik, ka pas refleksion edhe tek legjislacioni i së drejtës civile i cili ju është nënshtruar vlerësimit dhe mbi bazën e arsyesmeris së propozimeve konkrete e në harmoni me avancimin e këtij legjislacioni

¹⁷³Ligji Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës / Nr. 03 / 22 Shkurt 2012, Prishtinë). Shih nenin 1.

¹⁷⁴Strategjia Legjislative E Qeveris së Republikës së Kosovës 2011, Vendimi I Qeveris së Republikës së Kosovës nr. 02/05 datë 16.03.2011.

është filluar me plotësim ndryshimin. Në këtë fazë janë bërë edhe vlerësime, hulumtime, strategji për fusha të caktuara të së drejtës civile.

Në kuadër të së drejtës civile, sfida kryesore dhe problematike është pjesa e të drejtave pronësore në Kosovë. Të drejtat pronësore janë shumë komplekse dhe kërkojnë trajtim nga perspektiva të ndryshme për të rezultuar me një planifikim të duhur për zgjidhjen e tyre. Të drejtat pronësore në Kosovë, fillimisht kërkojnë të trajtohen nga perspektiva e legjislacionit të reformuar dhe përkatës për rregullimin e tyre, pas kësaj është aspekti gjinor në kuadër të drejtave pronësore që kërkon trajtim, nuk mund të mos trajtohet edhe nga aspekti i personave të zhvendosur nga lufta e fundit e Kosovës të cilët janë pronar të pronave në Kosovë, si dhe nga aspekti i të drejtave të njeriut.

Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA) me Bashkimin Evropian (BE), Kosovën e kishte obliguar që të nxjerr strategjinë kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë, përpos kësaj, Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë është edhe pjesë integrale e programit pesëvjeçar për reformë ekonomike dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim. "Programi kombëtar për zbatimin e MSA-së, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 10 mars 2016, parashikon hartimin e strategjisë sektoriale për të drejtat pronësore që do të sigurojë konsolidimin e infrastrukturës ligjore mbi të drejtat pronësore, në përputhje me politikat për treg të lirë dhe me synimin për nxitje të investimeve të huaja. SKDP gjithashtu është përfshirë edhe në konkluzionet e dy proceseve më të fundit të Dialogut për Stabilizim Asociim (DSA), në takimet sektoriale mbi drejtësinë, liritë dhe sigurinë (26-27 janar 2016) dhe në takimet për tregun e brendshëm, konkurrencën dhe mbrojtjen shëndetësore (02 shkurt 2016)."¹⁷⁵

Për të arritur që të hartohet sa më parë SKDP-ja, në vitin 2015, MD kishte filluar iniciativën për hartimin e SKDP-së duke u mbështetur edhe nga Programi i USAID-it për të Drejtat Pronësore. Për hartimin e SKDP-së ishin përfshirë të gjitha institucionet relevante, duke i dërguar zyrtarët më përgjegjës dhe kompetent në grupet punuese e të cilat janë të shumët që janë organizuar. Takimet, diskutimet, gjatë punës së hartimit të SKDP-së, kishin nxjerr një përfundim mbi bazën e konsensusit të anëtareve të grupit punues dhe arsyesmeris, SKDP do të ketë pesë objektiva kryesore dhe atë:

"Objektivi 1: Sigurimi i të drejtave pronësore përmes fuqizimit të infrastrukturës ligjore; Objektivi 2: Sigurimi i të drejtave pronësore përmes adresimit të informalitetit; Objektivi 3: Garantimi dhe realizimi i të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve jo shumicë; Objektivi 4: Garantimi dhe zbatim i të drejtave pronësore të grave; Objektivi 5: Përdorimi i të drejtave pronësore të sigurta për nxitjen e rritjes ekonomike."¹⁷⁶. Vendosija e këtyre Objektivave na jep dy kuptime,

¹⁷⁵Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë Qeveria e Republikës së Kosovës. Fq. 17

¹⁷⁶Po aty, Fq. 19.

fillimisht që në këto fusha të cilat janë vendosur në Objektiva ka pasur probleme, sfida e të cilat kanë qenë me refleksion direkt në të Drejtat pronësore në vend dhe së dyti, është vendosja e orientimit se ka duhet të shkoj Ministria e Drejtësisë dhe institucionet përgjegjëse që të eliminohen ato probleme, pengesa e të cilat janë me refleksion edhe në fusha tjera të së drejtës. Hartimi i kësaj strategjie i ka mundësuar Ministrisë së Drejtësisë që të ketë orientim të qartë se si do të qaset rregullimit të çështjeve pronësore në Kosovë.

Objektivi i parë i SKDP-së, i referohet sigurimit të drejtave pronësore përmes fuqizimit të infrastrukturën ligjore, ku përmes së cilës do të arrihet që një pjesë e legjislacionit të së drejtës civile të reformohet, ndryshohet që të jetë në funksion të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile përkatësisht atyre pronësore. Nga ajo se çfarë rrjedh nga Objektivi i parë i SKDP-së, behet e ditur se me fuqizimin e legjislacionit do të trajtohen këto fusha të së drejtave pronësore: ‘‘ Prona Publike; Toka urbane për ndërtim; Statusi i qiradhëniesve 99 vjeçare; Prona shtetërore dhe publike; Të drejtat pronësore të komunave; Të drejtat e shtetasve të huaj të kenë pronë’’¹⁷⁷

Objektivi i parë do në kuadër të strategjisë do të materializohet përmes ligjeve konkrete, të cilat Ministria e Drejtësisë do ti hartoj dhe më pas do të aprovohen nga Kuvendi. Në programin Legjislativ për Vitin 2017, Ministria e Drejtësisë kishte planifikuar që të hartoj Projektligjin për Pronën Publike dhe Projektligjin për Tokën Ndërtimore¹⁷⁸. Fushat që këto dy projektligje planifikoheshin të rregullonin, ishin komplekse prandaj nuk ishte arritur që të përfundohen në vitin 2017 dhe ishin bartur në programin Legjislativ për Vitin 2018¹⁷⁹

Objektivi i 4 i strategjisë, një pjesë e saj është adresuar duke nxjerr Udhëzim Administrativ (qrk) nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, ku ‘‘Qellim i këtij Udhëzimi Administrativ është të stimuloj regjistrimin e pronave të paluajtshme të përbashkëta në emër të dy bashkëshortëve në regjistrat publik’’¹⁸⁰. Kjo mundëson që të kemi masa afirmative në funksion të të drejtave pronësore të grave dhe barazisë gjinore. Përmes kësaj baze ligjore, grave ju mundësohet që të kenë një siguri juridike sa i përket të drejtave pronësore. Kjo do të ndihmoj edhe vlerësimin të shtetit të Kosovës që ti behet sa i përket të drejtave të njeriut, të drejtave për qasje në të drejtat pronësore, trashëgimore të grave, e të cilët nuk kanë qenë raporte edhe shumë të mira për Kosovën.

¹⁷⁷Po aty, Fq. 23-26

¹⁷⁸Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Vitin 2017, Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/125, datë 30.12.2016.

¹⁷⁹Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Vitin 2018, Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.03/20, datë 20.12.2017, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin nr. 21/20 të datës 20 Dhjetor 2017.

¹⁸⁰Udhëzim Administrativ (qrk) nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve (Gazeta Zyrtare e Kosovës Data e publikimit 05.05.2016). Shih nenin 1.

5.Nevoja për Kodifikimin e së Drejtës civile në Kosovë me qëllim të kompletimit të infrastrukturës ligjore

Nga vlerësimi i bërë, na del se fusha e së drejtës civile, nuk është e kompletuar me legjislacion përkatës përmes së cilit do të rregullohen marrëdhëniet juridiko civile mes subjekteve të së drejtës, përpos kësaj edhe aj legjislacion që ekziston, ka zbrastira ligjore që nuk mund të kualifikohet si i kompletuar konform reformave, kushteve që kërkohen. Nga të gjeturat, behet e ditur se Kosova duhet të filloj reformimin e sistemit të saj Juridik përkatësisht legjislacionin e së drejtës civile përmes së cilit do të rregullohen marrëdhëniet juridiko civile.

Duke pas për bazë se reformimi i legjislacionit të së drejtës civile ishte i domosdoshëm, është konsideruar se kjo reformë duhet të zgjerohet edhe më shumë duke u hartuar edhe Kodi Civil në të cilin do të përfshihet legjislacioni i së drejtës civile, përkatësisht Pjesa e Përgjithshme, E drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve, E Drejta Familjare dhe e Drejta Trashëgimore. Hartimi i Kodit Civil të Kosovës do ishte mundësi ideale e reformimit të legjislacionit të së drejtës civile për çka është vërtetuar me këtë hulumtim se është i nevojshëm dhe një herit fuzionimin e gjithë legjislacionit të së drejtës civile në një Kod të vetëm Civil

Hartimi i Kodit Civil kishte filluar në vitin 2014 nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE-së i cili ishte përgjegjës për hartimin e draftit të parë të Kodit Civil të Kosovës. Për hartimin e Draftit të Kodit Civil Qeveria e Republikës së Kosovës kishte themeluar Komisionin për e draftit të Kodit Civil¹⁸¹. Nga Ky projekt ishte hartuar drafti i pare i Kodit Civil i cili ju ishte dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë si draft i parë i cili ishte i gatshëm për të vendosur në diskutim me juristet për komente, sugjerime dhe vërejtje. Nga vlerësimi i bërë, ishte vërejtur se për tu finalizuar Kodi Civil duhet përsëri të ketë angazhim dhe për këtë ishte planifikuar edhe një Projekt i financuar nga Zyra e BE-së Faza 2 e Kodit Civil. Ky Projekt ka filluar me trajtimin e materies nen për nen të draftit të Kodit Civil duke e plotësuar me dispozita të reja me qëllim të kompletimit të legjislacionit për fushat që do ti përmbaj Kodi Civil i Kosovës. Baza e Draft Kodit Civil është tek Ligjet ekzistuese që rregullojnë të drejtat sendore, detyrim ore, familjare dhe trashëgimore.

Qeveria e Republikës së Kosovës kishte nxjerr Vendimin nr. 10/115 të datës 09.11.2016¹⁸² me të cilin autorizon Ministrinë e Drejtësisë që të procedojë me finalizimin e Kodit Civil. Me qëllim që të zbaton Vendimin e Qeveris së Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë me vendimin nr. 182/2016 të datës 28.12.2016¹⁸³ themeloi Grupin Punues për udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të hartimit

¹⁸¹Vendim Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 09/18, datë 11.03.2015.

¹⁸²Vendim Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 10/115, datë 09.11.2016.

¹⁸³Vendim Ministria e Drejtësisë, Vendim Nr. 182/116, datë 28.12.2016.

dhe finalizimit të Kodi Civil. ‘‘Në kuadër të grupit punues, janë themeluar edhe 4 nëngrupe tematike si: Nëngrupi tematik për hartimin e Pjesës së Përgjithshme dhe të Drejtës së Detyrimeve; Nëngrupi tematik për hartimin e të Drejtës së Pronësisë dhe të drejtave tjera sendore; Nëngrupi tematik për hartimin e të Drejtës Familjare dhe të Drejtës trashëgimore; dhe Nëngrupi tematik për hartimin e të Drejtës Ndërkombëtare Private’’¹⁸⁴.

Plotësim ndryshimet e bërë në draft Kodin Civil janë të bazuara në diskutimet, komentet, sugjerimet e anëtarëve të grupit punues dhe atyre jashtë grupit punues të cilët i kanë dërguar për tu inkorporuar në draft Kodin Civil. Inkorporomi dhe mos inkorporomi i propozimeve konkrete është bërë mbi bazën e arsyeshmeris nga ana e grupit punues i cili ka mandatin edhe të vlerësimit të ligjshmërisë, kushtetutshmërisë, harmonizimin me fusha tjera të së drejtës dhe atë të sistemit juridik të vendit.

Në bazëtë dinamikës së punës, Kodi Civil në vitin 2019 do të procedohet nga Ministria e Drejtësisë për në Qeveri dhe më pas në Kuvend për aprovim. Kodi civil do i përmbaj të gjitha dispozitat ligjore me te cilat do të rregullohen marrëdhëniet juridiko civile, si marrëdhënie tejet komplekse dhe te ndjeshme për faktin se të njëjtat kanë refleksion ekonomik, gjinor, te drejta të njeriut, integrim. Andaj rregullimi i marrëdhënieve juridiko civile përmes një Kodi Civil është një sukses i Ministrisë së Drejtësisë në kompletimin e Infrastrukturës ligjore. Kjo pasi gjer me tani, nuk e kemi pasur mirë të rregulluar këtë çështje, këtë e vërteton edhe hulumtimi që është pjesë e kësaj teme. Miratimi i Kodit Civil nga Kuvendi do të jetë avancim dhe reformim i sistemit juridik të Kosovës në çdo aspekt, fillimisht me atë të kompletimit me dispozita dhe së dyti harmonizimin e këtyre dispozitave me legjislacionin e BE-së, si një kusht për sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

¹⁸⁴ <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,94>.

KAPITULLI VII PARAFRIMI DHE HARMONIZIMI I LEGJISLACIONI I SË DREJTËS CIVILE ME STANDARTET NDERKOMBETARE

1.Mekanizmat institucional të Kosovës për përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

Rendësin dhe seriozitetin që ka procesi i përafrimit të legjislacionit të Kosovës me *Acquis Communautaire*, ka bërë që Kosova të krijoj mekanizmat e saj që ky proces të jetë i suksesshëm dhe të prodhojë efekte në kuptim të procesit të integritimit në BE. Edhe përafrimi i legjislacionit është i ndarë në disa faza e të cilat janë:

"Faza përgatitore: Kjo fazë nënkupton përgatitjen fillestare në përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis*, e cila përfshinë:

- Identifikimin e akteve juridike të BE-së që janë në fuqi (burimet primare, sekondare, si dhe burimeve të tjera të legjislacionit të BE-së);
- Identifikimin e legjislacionit ekzistues vendor që duhet të miratohet ose ndryshohet dhe që korrespondon me fushën përkatëse të legjislacionit të BE-së.

Faza analitike: Në këtë fazë bëhet përcaktimi i nivelit të përafrimit që duhet të arrihet, vlerësimi se çka është e nevojshme për arritjen e përafrimit, si dhe afati kohor se kur do të arrihet. Përcaktimi i prioriteteve në fazën analitike bazohet në interesat e Kosovës duke marrë parasysh:

- Kapacitetin administrativ për përafrim të legjislacionit; dhe
- Ndikimi në zhvillimin ekonomik që buron nga përafrimi i legjislacionit;

Po ashtu, këto prioritete bazohen edhe në marrëveshjet ndërkombëtare apo dokumentet strategjike, të tilla si Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim në mes të Kosovës dhe BE-së dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e saj apo plane të tjera shtetërore, përkthimi i akteve të domosdoshme juridike të BE-së në gjuhët zyrtare, si dhe përfshirja e tyre në Planin Kombëtar për Integrim, në përputhje me prioritetet e përcaktuara paraprakisht.

Faza e trans pozimit: nënkupton fazën e hartimit ligjor. Pra, rrjedhimisht trans pozimi duhet të bëhet në të njëjtën kohë kur bëhet hartimi i legjislacionit. Teknikat më të shpeshta të përafrimit ligjor të cilat përdoren në shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet aspiruese për integrim në BE, janë si në vijim:

- Trans pozimi ligjor me riformulim;
- Trans pozimi fjalë-për-fjalë (copy-paste);
- Trans pozimi me referencë;

Zbatimi: në këtë fazë duhet të merret parasysh që të bëhet jo vetëm miratimi i ligjeve të reja, amendamenteve të ligjeve ekzistuese në parlament ose akteve nënligjore në nivel ekzekutiv, por të sigurohet edhe aplikimi i tyre i përshtatshëm në praktikë, si dhe menaxhimi i efektit të tyre në infrastrukturën ekzistuese institucionale.

Ekzekutimi: pas miratimit të akteve juridike, nevojiten masat e domosdoshme të autoriteteve kompetente (p.sh., monitorimi, mbikëqyrja, kontrollet inspektive, dënimet, masat gjyqësore) për të siguruar që ligji po respektohet plotësisht dhe në mënyrën e duhur.

Në përgjithësi, implementimi i duhur i të gjitha këtyre fazave të cilat kontribuojnë në përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së bëhet jo vetëm për të zhvilluar kornizën ligjore të Kosovës në përputhje me kërkesat e saj, por edhe për të siguruar kushte administrative dhe të tjera të nevojshme për zbatimin efektiv të saj¹⁸⁵. Ajo që është në funksion të këtij procesi tejet me rëndësi për Kosovën, janë krijuar mekanizmat institucional, legjislativ dhe kuadro që do të jenë në funksion të këtij procesi.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të dikastereve të saj, ka edhe Ministrin e Integritimit Evropian, si mekanizëm me të rëndësishëm për procesin e integritimit në BE¹⁸⁶. Ajo që është me rëndësi të theksohet është fakti se Ministria e Integritimit është mekanizmi kryesor sa i përket procesit të integritimit përkatësisht atë të përafrimit të legjislacionit. Fushëveprimi dhe kompetenca e Ministrisë së Integritimit Evropian është: " bashkërendimi dhe monitorimi i procesit të integritimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, duke siguruar hartimin e politikave të integritimit, pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian, ndihmat financiare, informimin e publikut dhe ngritjen e kapaciteteve për këtë proces. Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së si dhe vlerëson pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me atë të drejtës së BE-së"¹⁸⁷. Nga kjo kuptojmë se Kosova ka një mekanizëm të nivelit të dikasterit Qeveritar i cili ka nëkompetencë koordinimin, monitorimin, këshillimin dhe raportimin për procesin e integritimit të Kosovës në BE dhe përafrimin e legjislacionit. Me këtë bëhet e ditur se për procesin e përafrimit të legjislacionit ka një mekanizëm që është kupola e këtij procesi më pas janë mekanizmat tjerë që duhet të koordinohen me këtë.

Duke e pa si tejet me rëndësi këtë proces, Qeveria e Republikës së Kosovës, kishte krijuar mekanizma nëqdo Ministri për të avancuar sa i përket procesit të integritimit të Kosovës për në BE. " Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave (më tutje: Departamenti) themelohet në kuadër të çdo Ministrie dhe vepron nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë përkatëse "¹⁸⁸.

¹⁸⁵<http://mei-ks.net/sq/korniza-ligjore-pr-prafrim>

¹⁸⁶Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, neni 18, par 1, nen paragrafi 1.16.

¹⁸⁷Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim, Nr.6/121, datë 22.04.2010.

¹⁸⁸Rregullore Nr.01/2011 për departamentet për integritim Evropian dhe koordinim të politikave në kuadër të Ministrive, Neni 2

Me këtë krijohet baza e procesit dhe koordinimit për procesin e integrimi edhe në nivel të Ministrive. Përmes kësaj Qeveria ka krijuar mekanizmin përkatës nëqdo Ministri pasi kjo mundëson që të kemi koordinim, bashkërendim që në bazë ku është planifikimi dhe realizimi i detyrave dhe përgjegjësi qeveritare në fushën e integritit dhe përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së. Ndër detyrat dhe përgjegjësit tjerë tëkëtyre departamenteve është edhe: "Ofrimi i mbështetjes Departamenteve Ligjore sa i përket përfshirjes së politikave të BE-së në legjislacionin vendor gjatë harmonizimit me Acquis, si dhe kujdeset që legjislacioni që kërkohet nga PVPE-ja të futet në Strategjinë Legjislative të Qeverisë"¹⁸⁹ Kjo përgjegjësi është në funksion të ngritjes së kapaciteteve në përafrimin e legjislacionit, kjo për faktin se ky Departament posedon profesionalizmin, përvojën dhe njohurit se çfarë është e nevojshme për përafrimin e legjislacionit

Nëse i referohemi krijimit të mekanizmave institucional që janë në funksion të procesit të integrimi në BE dhe përafrimin e legjislacionit, Kosova ka arritur që të ketë këto mekanizma si në nivel të Ministrisë dhe në nivel të Departamenteve në nivel të Ministrive, me ketëkuptojmë seriozitetin, përkushtimin dhe planifikimin e duhur nga institucionet e Kosovës për procesin e integritit të Kosovës për në BE. Përmes këtyre mekanizmave, mundësohet që të ketëkoordinim, planifikim, realizim dhe raportim tësaktë të punës dhe angazhimeve të institucioneve të Kosovës në procesin e integritit në BE.

Përpos mekanizmave institucional, Kosova ka të konsoliduar edhe mekanizmat që kanë të bëjnë me Kornizën Ligjore për Përafrim që mundësojnë të krijohen kushte dhe standarde që shpien drejt përafrimit të legjislacionit si njëri ndër kushtet për integrim në BE. Infrastruktura ligjore që i referohet përafrimit të legjislacionit fillimisht fillojmë me Rregulloren punës së qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011¹⁹⁰ e cila përcakton kushte dhe faza që janë në funksion të përafrimit tëlegjislacionit me *Acquis Communautaire*. Në këtë Rregullore është e rregulluar edhe pjesa e konsultimeve me publikun, ku " Para dorëzimit për shqyrtim në Qeveri, nga organi propozues ose nga një trup qeveritar, të koncept dokumenteve, memorandumeve shpjeguese, apo projekt aktet ligjore dhe nënligjore, planeve strategjike të ministrive ose strategji sektoriale, Organi i cili ka përgatitur materialin ("organi propozues") është përgjegjës për të siguruar që të gjitha organet e larta të administratës shtetërore, organet qendrore të administratës shtetërore, organet e pavarura të administratës shtetërore dhe organet tjera relevante, me të cilat qeveria është e obliguar të konsultohet në pajtim me Kushtetutën, apo puna e të cilave mund të ndikohet nga propozimi përkatës (projektligji, akti nënligjor apo politika), të kenë mundësi të komentojnë lidhur me propozimin". Përmes kësaj, Qeveria ka krijuar bazën ligjore ku ka obliguar institucionet që në rastet kur krijojnë projekt ligje,

¹⁸⁹Po aty neni 4, para 1, nen para 1.10.

¹⁹⁰Rregulloren punës së qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, neni 7, par 1.

projekt akte nënligjore, memorandumë shpjeguese të ofrojnë për komente, sugjerime, vërejtje institucioneve tjera që në njëformë kanë të bëjnë me politiken e propozuar, prandaj u ofrohet mundësia që të vlerësojnë dhe të komentojnë. Edhe sa i përket përafrimit të legjislacionit, çdo politik e propozuar nga çdo institucion i nënshtrohet këtij vlerësimi, ku kjo realizohet në " Ministrinë përkatëse për Integrim Evropian, për të siguruar që propozimi të jetë në përputhje me prioritetet e integritit në Bashkimin Evropian (BE) dhe që të jetë në përputhje me kërkesat e BE-së dhe *Acquis Communautaire*.¹⁹¹ Vlerësimin e politikave sa i përket përafrimit me *Acquis Communautaire* është dikasteri qeveritar Ministria e Integritit që e realizon dhe për këtë posedon mekanizmat e brendshëm. Me këtë behet e njohur se çdo politik Qeveritare kalon ka filtri i Ministrisë së Integritit ku vlerësohet përafrimi me *Acquis Communautaire* dhe jepen rekomandime, sugjerime dhe këshilla për avancimin e përafrimit të legjislacionit. Sa i përket *Acquis Communautaire*, një përgjegjësi i bartet edhe organit propozues, ku përcaktohet " Bën pajtueshmërinë fillestare me *Acquis Communautaire* "¹⁹² Kjo është një përgjegjësi që kanë edhe organet propozuese, ku me këtë dëshmohet se çështje e përafrimit të legjislacionit është politik shtetërore dhe është endarë në çdo institucion që ka të bëjë me një politik të re e të cilën duhet që të përafrohet me *Acquis Communautaire*. Institucioni sponsorizues i një projekt ligji para së të procedoj për miratim në Qeveri dhe Kuvend duhet që projektligjin ta dërgoj në Ministrinë e Integritit dhe të kërkojë që të lëshoj Opinion të Përputhshmërisë me *Acquis* të BE-së dhe ky është njëri ndër dokumentet që duhet të bashkëngjitet një projektligji kur të dërgohet për miratim në Qeveri¹⁹³. Nga kjo shohim se në kuadër të procesit të përafrimit është një mori mekanizma që funksionojnë për të realizuar këtë standard bazik për një orientim të qartë të Kosovës për në BE. Sa i përket përafrimit të legjislacionit, barre e madhe bie mbi organin propozues i cili " përgatit Deklaratën e përputhshmërisë dhe tabelat e përputhshmërisë me *Acquis* të BE-së "¹⁹⁴. Me këtë organ propozues duhet ta ketë të qartë se përafrimin e legjislacionit duhet që ta ketë parasysh gjatë hartimit të legjislacionit dhe në fund të gërshetohet me Deklaratën dhe tabelat e përputhshmërisë. Pra me "Tabelat e Përputhshmërisë dhe Deklaratën e Përputhshmërisë janë dokumente pune krahasuese, që pasqyrojnë shkallën e përputhshmërisë së një projektakti normativ vendor me *Acquis* të BE-së"¹⁹⁵. Këto dy dokumente mundësojnë që të kemi të njohur gjendjen faktike të projektligjit apo aktit tjetër se në çfarë mase është i përafër, kjo pasi përafrimi kërkon mekanizma që mundësojnë të gjenerojnë rezultate të mëdha që të jetë e mundur me pas të njohemi me përbindjet, rezultatet e që janë të rëndësishme në rrugëtimin integruar. Këto veprime të cekura e që i referohen deklaratës dhe tabelave

¹⁹¹Rregulloren punës së qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, neni 7, par 1, nen paragrafi 1.2.

¹⁹²Po aty, neni 39, para 1, nen paragrafi 1.3.

¹⁹³Rregullore Nr.13/2013 për shërbimin Ligjor Qeveritar, neni 14, Paragrafi 1, nen paragrafi 1.4

¹⁹⁴Udhëzim Administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, neni 30, paragrafi 1.

¹⁹⁵Po aty, neni 30, paragrafi 3

janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative si njëri nga mekanizmat e krijuar në fushën e legjislacionit për përafrimin e legjislacionit.

2.Partneriteti Evropian i Kosovës

Edhe gjatë periudhës së okupimit të Kosovës nga Serbia ishte orientimi drejt vlerave Evropiane. Këto vlera se pari ishin identifikuar dhe me pas synoheshin nga klasa politike e asaj kohe çdo here edhe me mbështetje tyre popullit. Vlerat Evropiane shifshin si një familje përplot te mira dhe Kosova duhet ti përket kësaj familje asaj te Bashkimit Evropian. Me te përfunduar okupimin, Kosova kishte filluar te orientohet drejt vlerave Evropiane dhe atë çdo here duke e konsideruar si një orientim te duhur për zhvillim ekonomik, strategjik dhe konform vlerave qe posedonte BE-ja. Edhe gjatë administrimit të Kosovës nga misioni i UNMIK-ut, konform atyre kompetencave qe kishin institucionet vendore orientimin e kishin bere te çart dhe atë drejt BE-se. Ajo qe duhet te theksohet pavarësisht pozitës se Kosovës ne aspektin politik, ne çdofazë te saj ka pasur ne plan çështjen e integritimeve evropiane dhe atë menjëherë pas vitit 1999 kur kishte përfunduar Lufta ne Kosove.

Për dallim prej shteteve tjera të Ballkanit perëndimor, Kosova kishte një problem të veçantë në raport të krijimit të partneritetit me BE-në, kjo për faktin se statusi i pazgjidhur ndërkombëtar ishte pengesë për hyrje në proceset dhe raportet kontraktuese me BE-në. Edhe për kundër këtij fakti, si BE-ja po ashtu edhe Kosova ishin në gjetjen e një zgjidhje që Kosova të krijoj raporte partneriteti me BE-në dhe të ketë të qartë rrugën e saj drejt BE-së. Ishte viti 2002 kur Kosova ishte bërë pjesë e Mekanizmit Përcjellës PSA, i cili në mandat kishte ofrimin e asistencës vendeve kandidate dhe atyre kandidate potenciale për procesin e integritimit në familjen e madhe të BE-së. Për herë të parë në samitin e Zagrebit në muajin nëntor të vitit 2000 Kosova ishte pjesë e agjendës ku është diskutuar për procese integruese në BE. Në këtë samit për herë të parë shtetet e rajonit u dakorduan që të punohet drejt procesit integrues përmes Procesit të Stabilizim Asocimit (PSA). Kosova që nga vitit 2002 u bë pjesë e PSA-së përmes Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asocimit (MPS).

Sa i përket orientimit të Ballkanit perëndimor pas vitit 2000 kishte disa dileme dhe paqartësi, mirëpo ishte samiti i BE-së i organizuar në Selanik në vitin 2003 në të cilin qartë u bë e ditur dhe e njohur për te gjithë se, e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është Bashkimi Evropian dhe vlerat që kjo familje ka brenda vetës¹⁹⁶. Pas këtij veprimi konkret sa i përket krijimit të partneritetit të Kosovës me BE-në ishte edhe hartimi i Planit të parë të veprimit në vitin 2002 për Partneritet Evropian (PVPE) për Kosovën

¹⁹⁶.Samiti për Ballkanin perëndimor, Deklaratë, Selanik, 21 Qershor 20013 10229/03 (press 163), <http://cespi.it/STOCCHIERO/dossierBalcani/dich-Solonicco.PDF>.

dhe më pas në vitin 2006¹⁹⁷. Në këtë plan kemi deshifrim dhe përcaktim të kushteve dhe standardeve për procesin integruar të Kosovës në BE. Për shtete kandidatë dhe ato potenciale ku përfitoj edhe Kosova dhe krijoj raporte të partneritetit me BE-në ishte edhe Instrumenti i Para-aderimit (IPA) i cili nga 1 janari 2007 zëvendëson të gjitha instrumentet ekzistuese, përmes së cilës ofrohej ndihma dhe asistencë shteteve kandidatë dhe atyre potenciale në plotësimin e kushteve dhe standardeve për procesin e integritimit në BE¹⁹⁸.

Ishte viti 1993 kur BE, kishte përcaktuar kushte dhe standarde specifike për shtetet që synonin familjen e Bashkimit Evropian, kjo për faktin se shtetet që ishin kandidatë dhe ato kandidatë potenciale, nuk kishin zhvillimin dhe standardet e BE-së, prandaj kërkohet një mobilizim i tyre në plotësimin e kushteve për të aderuar në BE. Këshilli Evropian në kuadër të kritereve të Kopenhagës, kishte vendosur kritere ekonomike, politike dhe ligjore.¹⁹⁹ Kriteret e vendosura nga Këshilli i Evropës, ishin shumë të rëndësishme për shtetet kandidatë dhe ato kandidatë potencialë për integrim në BE, këto i shërbenin si udhërrëfyes dhe me rëndësi ishte se sipas këtyre, angazhimi dhe puna e këtyre shteteve ishin të matshme, për faktin se kjo bëhej sipas kritereve të Kopenhagës.

Kriteret e Kopenhagës fillimisht kishin një ndarje në tri shtyllat kryesore atë Politike, ekonomike dhe Ligjore. Në kuadër të atyre Politike kishte nëndarje siç ishin: demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe liritë fundamentale të njeriut, si vlera universale. Te kriteri Ekonomik, nëndarjet ishin ekonomia funksionale, ekonomia e tregut, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe fusha tjera me rëndësi për zhvillimin ekonomik. Ndërsa tek pjesa e Ligjore, është adoptimi dhe inkorporimi i *Acquis Communautaire* në kuadër të legjislativës së shtetit, kjo është pjesa që çdo shtet i cili synon BE-në, duhet ta fillojë dhe ta përfundojë duke inkorporuar të gjithë *Acquis Communautaire* brenda legjislativës së vetë²⁰⁰. Edhe për kundër faktit se Kosova ka pasur një status specifik politik që i ka penguar rrugëtimin për në familjen e BE-së, çdo herë ka qenë kërkuar ndaj BE-së që të hynë në raporte të bashkëpunimit dhe partneritetit me qëllim të vendosjes së raporteve kontraktuese me BE-në për identifikimin dhe bërjen e qartë të rrugës së integritimit për në BE. Me këtë dua të bëj të njohur se pavarësisht pozitës politike të Kosovës, nga fillimi ka pasur parasysh Kriteret e Kopenhagës të cilat ka filluar që ti implementoj.

Në kuadër të kritereve të Kopenhagës, pjesa që i referohet përafritimit të legjislativës së Kosovës me atë të *Acquis Communautaire* ka qenë aktive nga viti 2006, kur me këtë janë marrë edhe Institucionet e

¹⁹⁷. Plani I Veprimit i Partneritetit Evropian 2006.

¹⁹⁸http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2006/1_210/1_21020060731en00820093.pdf

¹⁹⁹. HOWAK, Manfred: Human Rights 'Conditionality' in Relation to Entry to, and Full Participation in, the EU, in ALSTON, Philip with BUSTELO, Mara and HEENEN, James (ed): 'The EU and Human Rights' (pp.687-698) Oxford UP, 1999, fq.691

²⁰⁰. CREMONA, Marise: Variable Geometry and Setting Membership Conditionalities: A Viable Strategy?, fq. 4, <http://www.kas.org.za/Publications/SeminarReports/SAlIA/cremona.pdf>.

Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), çdoherë duke u bazuar dhe në lidhmëni me atë që ka përcaktuar Korniza Kushtetuese e Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes²⁰¹. Lidhur me përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të *Acquis Communautaire* po na behet e ditur që ka filluar shumë herët kur Kosova nuk ishte e pavarur dhe nuk kishte institucionet e saja, po nën administrimin e UNMIK-ut, ka shpreh vullnet dhe gatishmëri që njërin nga kriteret e procesit të integritit ta filloj e që është përafrimi i legjislacionit. Nga kjo periudhë e tutje kemi avancim të planifikimit dhe procesit të përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të *Acquis Communautaire*.

Partneriteti i Kosovës me BE-në, çdo ditë zhvillohej dhe konkretizohej, kjo ishte edhe në aspektin e ndihmës financiare që BE i dhuronte Kosovës për zhvillim dhe ngritje të kapaciteteve. E tillë ishte përfshirja e Kosovës në programin e Asistencës së Komunitetit për rindërtim, zhvillim dhe stabilizim (CARDS), i themeluar me Rregulloren e Këshillit (EC) 2666/2000²⁰². Kjo kishte mundësuar që Kosova të përfitoj fonde nga BE-ja me të cilat do të ndërtohen, zhvillohen dhe rindërtohen shumë projekte nga fusha e infrastrukturës, ekonomisë, legjislacionit dhe sfera tjera me të cilat do të ngritej niveli i mirëqenies në Kosovë. Këto fonde ishin me ndikim edhe në zhvillimin dhe plotësimin e kushteve dhe standardeve që Kosova kishte para vetes në rrugën drejt BE-së, një synim i popullit dhe shtetit të Kosovës.

Ishte viti 2007 kur Këshilli i Evropës përmes Rregullore të Këshillit (EC) No 1085/2006 kishte parapa Instrumentin e Para-aderimit (IPA) i cili i zëvendëson të gjitha instrumentet ekzistuese, me një fokus për mbështetjen e BE-së në procesin e para-aderimit, ku në rastin e Kosovës, fondet e IPAS-s do të gjejnë aplikim në harmonizimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*, zhvillimin social, ekonomik, territorial, infrastrukturor, zhvillim rajonal dhe njerëzor²⁰³. Me fondet e IPA-s, Kosova kishte një raport më të detajuar me BE-në në kuptim të partneritetit dhe kjo ndihmë ishte me rendësi për shumë projekte në Kosovë, pasi mundësoj të ketë zhvillim në disa fusha e të cilat arritën të jenë në kuadër të standardeve që kërkoheshin. Ajo që ishte me rendësi për Kosovën nga fondet e IPA-s, ka të bëjë me ndarjen e fondeve që i dedikohen direkt përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të *Acquis Communautaire*, prandaj kjo mund të kualifikohet si mekanizmi më me shumë rendësi në ofrimin e ndihmës nga BE për procesin e integritit të Kosovës në BE.

Me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, ishte bere e qartë se Kosova do ti takon familjes së madhe përplot vlera asaj të Bashkimit Evropian. Pas kësaj periudhe kërkohet të kishte qasje zyrtare dhe

²⁰¹UNMIK/REG/2001/9, Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, 15 maj 2001. "Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes do të jenë përgjegjëse për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave të tyre me standardet dhe normat evropiane dhe ndërkombëtare brenda të gjitha fushave të përgjegjësisë me qëllim të caktuar për lehtësimin e vendosjes së lidhjeve ekonomike, shoqërore dhe lidhjeve të tjera të popullit të Kosovës me popujt e tjerë evropianë dhe me vetëdije se respektimi i standardeve dhe i normave të tilla do të zërë vend qendror për zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin euroatlantik."

²⁰²http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/financial_assistance/cards/general/2666_00_en.pdf

²⁰³http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2006/1_210/1_21020060731en00820093.pdf

planifikuese për ne Bashkimin Evropian. Veprimet zyrtare dhe tejet të rëndësishme ishin ato të shprehjes së interesimit të Kosovës për BE dhe me pas negociimi për këtë interesim. Përvoja me BE-së dhe Kosovës në raportet e tyre kontraktuese kishte bërë që të kemi koordinim dhe planifikim edhe më të detajuar të raporteve BE – Kosovë me qëllim të vendosjes së Kushteve dhe standardeve për një proces të qartë të Kosovës drejt familjes së madhe të BE-së. Me shpalljen e pavarësisë, Kosova pas vitit 2008 ishte në pozitë më të mirë dhe më të favorshme karshi BE-së për procesin e integritimit.

Ishte e natyrshme që Kosova të kishte avancim drejt rrugës për bashkimin në familjen Evropiane, pasi kjo ishte kërkesë e kohës, për faktin se procesi i integritimit në vetë është planifikim, kushte dhe standarde, vlerësim, monitorim dhe gjitha këto kërkojnë Kohën e duhur, prandaj ishte viti 2015 kur Kosova me BE-në kishte nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit. Në këtë marrëveshje kontraktuale mes Kosovës dhe BE-së, janë përcaktuar mekanizmat dhe afatet për reformat që Kosova duhet të realizojë për të pas mundësi të kësaj të suksesshme rrugëtimi për në BE. Kushtet e përcaktuara në MSA, përfshin afate dhe standarde për të gjitha fushat që ndërlidhet puna e Qeverisë dhe Institucioneve të Kosovës. Edhe pse kjo marrëveshje është nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me BE-në, obligime në të cilat për të gjitha institucionet e Kosovës të cilat janë përgjegjëse. Pjesë e rëndësishme në kuadër të kësaj marrëveshjeje ju është kushtuar edhe përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të *Acquis Communautaire*.

Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit për Kosovën pjesë të veçantë i kishte kushtuar përafrimit të Ligjeve të Kosovës me *Acquis* e BE-së, në të cilën ishin vendosur kushte dhe standarde që Kosova duhet të ketë parasysh për të rrugëtuar sigurt drejt BE-së. ‘‘ Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis-in* e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet siç duhet.’’²⁰⁴ Nga kjo kuptojmë se çështja e përafrimit kualifikohet si e rëndësishme dhe vendoset në agjendë dhe ky proces do të fillojë në momentin e nënshkrimit të MSA-së dhe do të jetë proces gradual, fillimisht duke filluar me një pjesë të legjislacionit dhe me pas duke u shtrirë në tërë legjislacionin e vendit.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të *Acquis Communautaire* do të bëjnë pjesë edhe ai i Drejtësisë në të cilin bëjnë pjesë edhe ai i fushës së të Drejtës Civile i cili është i nevojshëm dhe i një rëndësie të madhe për procesin e integritimit të Kosovës në familjen e Bashkimit Evropian. ‘‘Në një fazë të hershme, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësorë të *acquis-it* të BE në fushën

²⁰⁴Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit ndërmjet Kosovës në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, neni 74, paragrafi 1

e Tregut të Brendshëm, dhe në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë, si dhe në fushat e lidhura me tregti. Në fazën e mëtejshme, Kosova duhet të përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis-it* të BE-së.²⁰⁵ Me këtë do të arrihet që të ketë një legjislacion të së drejtës civile në të cilin do të inkorporohet *Acquis Communautaire* dhedjo të jetë konform standardeve që më pas do të prodhojë efektin e plotësimit të standardeve për integrim të Kosovës në BE. Me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Kosovës u janë bërë të njohura kushtet, ku pa plotësimin e tyre nuk mund të ketë proces të integritit në BE. Prandaj institucionet e Kosovës me shumë përkushtim dhe seriozitet duhet që ta marrin Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe të plotësojnë kushtet dhe standardet e përcaktuara për të cilat ka negociuar dhe më pas i ka parapa në marrëveshje që në fund ka rezultuar me nënshkrimin e saj nga të dy palët.

Kur e vlerësojmë te kaluarën e Kosovës dhe historinë e saj, në çdo moment të saj, çdo here ka besuar në vlerat e BE-së, dhe çdo here ka pasur në plan të parë që Kosova duhet të jetë pjesë e vlerave të BE-së. E rëndësishme të cekët është edhe fakti se, lidhur me integrimin e Kosovës në BE kemi një lidhmëni, koordinim dhe vullnet të përgjithshëm edhe nga populli të cilët përkrahin dhe dëshirojnë që të jenë pjesë e vlerave të BE-së. Kjo i ka ndihmuar edhe mekanizmat shtetëror të Kosovës, për faktin se nuk ka pas asnjë kundërshtim nga populli sa i përket integritit të Kosovës për në BE. Pavarësisht pozitës së saj politike, Kosova çdo here ka qene kërkuese të krijoj raporte kontraktuese të mira me BE-në, duke marr edhe përgjegjësi për kushtet dhe standardet e përcaktuara për integrim në BE. Pavarësisht vullnetit, gatishmërisë për integrim të Kosovës në BE, nuk kemi rezultate te matshme sa i përket plotësimit të kushteve dhe standardeve ashtu siç kërkohen, kjo për faktin se institucionet e Kosovës nuk janë duke reflektuar karshi këtyre obligimeve, andaj nuk kemi edhe vlerësim pozitiv sa i përket rrugëtimit te Kosovës për në BE. Ato që nuk janë në harmoni dhe lidhmëni me kërkesat e BE-së, kanë të bëjnë me demokracinë, respektimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit, sistem të pavarur të drejtësisë, zhvillimin ekonomik dhe stabiliteti politik, fusha të cilat Kosova ka shumë punë për të bërë, para se të ketë vlerësim pozitiv dhe ti mundësohet integrimi në BE. Gjendja e tanishme në Kosovë sa i përket procesit të integritit të Kosovës për në BE, kërkon më shumë dinamik në planifikim të procesit, realizim të detyrave të pranuar nga BE, dhe llogaridhënie nga individ, institucione për çështjet që janë përgjegjës dhe ndërlidhen me procesin e integritit të Kosovës në BE. Ajo që është me rëndësi, procesi i integritit duhet të shikohet si mundësia e vetme për të cilën kërkohet angazhim dhe përkushtim kombëtar të shtetit të Kosovës.

²⁰⁵Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës në njëri anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, neni 74, paragrafi 3

3.Mardhenja juridiko-civile ne Kosove ne raport me politikat dhe standartet e BE-se

Legjislacioni i Kosovës para viteve 1999 nuk ishte i vlerësuar dhe nuk i kërkohej te ishte konform legjislacionit te Bashkimit evropiane. Kjo pasi Kosova së pari kishte probleme politike dhe mungesë te shtetësisë si një kusht bazik për procese tjera te rëndësishme qoftë edhe aji i integritimeve Evropiane. Ballafaqimi me çështje politike Kosovës i ka pamundësuar te ketënjë zhvillim dhe progres ne fushat tjera njera nder to edhe ajo e proceseve integruese te saj për në BE.

Legjislacioni i së drejtës civile ka pasur shkëputje te shumta nga një sistem ne tjetrin dhe nuk ka arrit te krijohet një kontinuitet qe me pas te i adaptoj edhe ndryshimet dhe standartet e kërkuara. Pas vitit 1999 orientimi i Kosovës ishte drejt shtet sis dhe me pas krijimi i mekanizmave shtetëror bashke edhe sistemin e tij juridik. Në vitin 2008 pas shpalljes se pavarësisë, Kosova ishte orientuar drejt vlerave me te larta shoqërore, politike, ekonomike dhe ato juridike te Bashkimit Evropian. Rruga drejt BE-se ishte dhe është një synim i shtetit të Kosovës çdo here ne përpjekje te vazhdueshme për plotësimin e kushteve dhe standardeve te kërkuara për ne BE.

Përpos kushteve tjera që kishte marr për sipër Kosova për procesin integrues të saj në BE, njeri ndër kushtet ishte edhe harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, si kusht për procesin e integritimeve në BE. Përmes këtij procesi shumë të rëndësishëm synohej që të kompletohej legjislacioni i Kosovës konform legjislacionit të BE-së si njeri ndër mekanizmat më të rëndësishëm për integritime Evropiane.

Qe nga paslufta kishte vërejtje sa i përket çështjeve nga marrëdhëniet juridiko civile, pasi nuk kishte bazë të mjaftueshme ligjore dhe mos funksionim të plotë të sistemit gjyqësor të vendit.

4.Harmonizimi i legjislacionit obligim i shteteve para anëtarësimit në BE, rasti i Kosovës

Njëri ndër kushtet bazë për integrim në Bashkimin Evropian është harmonizimi i plotë i legjislacionit të shteteve që aspirojnë BE-në dhe atë në detaje. Një situatë të tillë kanë pasur të gjitha shtetet që kanë aspiruar dhe kanë hy në Bashkimin evropian. Nga harmonizimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së, shtetet kanë shpreh dhe shprehin gatishmëri për tu ambientuar me sistemin juridik të BE-së nga i cili lindin të drejta dhe detyrime reciproke për të gjithë shtetasit e BE-së. Harmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së e mundëson që shtetet të fillojnë me plotësimin e standardeve tjera që janë të parapara për integrim në BE, e të cilat nuk janë të pakta për nga numri.

Kosova edhe gjatë okupimit edhe pas luftës edhe tani ka pasur dhe ka synim integrimin në Bashkimin evropian si një mekanizëm shumë të dobishëm për Kosovën që të jetë brenda saj. Përpos vullnetit për integrim në BE, Kosova menjëherë pas çlirimit ka ndërmarr veprime konkrete të cilat janë të parapara për integrim në BE. Veprimi i parë dhe kryesor nga institucionet ka qenë harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së. Lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit në Kosovë, bazë ligjore e parë ishte Korniza Kushtetuese e Kosovës, e cila parashihte kompetencën e Institucioneve e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së. “Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes do të jenë përgjegjëse për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave të tyre me standardet dhe normat evropiane dhe ndërkombëtare brenda të gjitha fushave të përgjegjësisë me qëllim të caktuar për lehtësimin e vendosjes së lidhjeve ekonomike, shoqërore dhe lidhjeve të tjera të popullit të Kosovës me popujt e tjerë evropianë dhe me vetëdije se respektimi i standardeve dhe i normave të tilla do të zërë vend qendror për zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin euroatlantik”.²⁰⁶ Është viti 2001 dhe orientimi i Kosovës ka qenë i qartë, drejt vlerave të BE-së, ku fillimi dhe baza për procesin e përafrimit me standarde ndërkombëtare dhe atyre evropiane tash më ishte vendosur në aktin më të lartë kushtetues të asaj kohe për Kosovën. Përcaktimi i obligimeve për IPVQ-të ishte obligim për planifikim, koordinim dhe fillim të procesit të përafrimit konform kapaciteteve dhe mundësive institucionale.

Ajo që është me shumë interes është fakti se Kosova krahas ndërtimit të sistemit juridik të saj, një rendësi e veçantë i ka kushtuar krijimit të mekanizmave institucional për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së si një parakusht për proceset tjera Integruese. Përafrimi i legjislacionit ishte një sfidë në vete për institucionet e përkohshmevetëqeverisëse të Kosovës pasi çdo gjë ishte e re dhe sfiduese po me një përkushtim ka arrit të filloj këtë proces. Për të filluar këtë proces fillimisht është krijuar një mekanizëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit Zyra për Proceset e Integritimit Evropian e cila ka pasur rrol koordinues mes institucioneve të Kosovës dhe atyre të BE-së sa i përket proceseve integruese të Kosovës për në BE. Ajo që është me rendësi për këtëperiudhë kohore është fakti se Kosova ka arrit të krijoj interesimin e saj për procesin e integritimeve në BE, ka arrit të krijoj mekanizmat që do udhëheqin me procesin e integritimit dhe atë të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Kosova çdo here me të ndryshuar statusin e saj politik, ka bere ndryshime dhe avancim edhe në proceset integruese, një përcaktim, orientim dhe realizim të qartë sa i përket integritimeve euro atlantike

²⁰⁶ Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, (Gazeta Zyrtare UNMIK 15 maj 2001). Shih Kreun 5. 7.

e ka bere edhe në Kushtetutën e vitit 2008, ku në preambulën e saj përcaktohet " Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë; Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike;"²⁰⁷ Më aktin më të lartë juridik dhe atë në preambulën e saj, Kosova ka bere të qartë se do të jetë pjesë e vlerave euro atlantike për të cilat do të punoj dhe krijoj kushte që të ketë integrim sa me te shpejt. Me nxjerrjen e Kushtetutës, Kosova kishte te gjitha atributet e shtetit, prandaj kishte marr obligime tani si shtet që të filloj rrugëtimin për ne procesin euro atlantik. Me shpalljen e pavarësisë dhe aprovimin e Kushtetutës, Kosova kishte krijuar të gjitha mekanizmat e saj shtetëror të cilat në njëformë apo tjetër janë përgjegjëse për procesin e integritit të Kosovës në BE. Duke pas të gjitha atributet e shtetit, Kosova në raport edhe me BE-në ishte ne pozitë tjetër sa i përket krijimit të raporteve kontraktuale dhe bashkëpunuese me qëllim të avancimit të procesit euro integrues. Ndryshimi i statusit politik, Kosovën e vendosi ne pozitë me te favorshme në çdo aspekt duke përfshi edhe atë integrues dhe orientues sa i perketë procesit euro integrues.

Pas vitit 2008 Kosova kishte filluar që të intensifikoj planifikimet dhe krijimin e mekanizmave për të krijuar raporte partneriteti dhe kontraktuese me BE-në, i gjithë angazhimi sa i perketë planifikimit, koordinimit dhe përcaktimit të qartë të kushteve për Kosovën në ketë fazë ishin përcaktuar në Marrëveshjen e stabilizim asociimit ndërmjet Kosovës, në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian dhe komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër i cili është nënshkruar në vitin 2015. Me ketë dokument për herë të parë Kosova ka diskutuar me BE-në dhe me pas kanë vendosur kushte dhe standarde brenda afateve te caktuara ku me plotësimin e këtyre, Kosovës i hapen dyert për integrim në familjen e BE-së. Ndër të tjera kushte në tështë parapa dhe janë përcaktuar kushtet sa i përketë përafrimit të legjislacionit të Kosovës me *Acquis* të BE-së, zbatimimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës. Atë që e përcakton kjo marrëveshje lidhur me përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *Acquis* të BE-së është përcaktuar që: " Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me *acquis-in* e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet siç duhet. Ky përafrim do të fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e *acquis-it* të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje deri në fund të periudhës transitore të përcaktuar në nenin 9. Në një fazë të hershme, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësore të *acquis-it* të BE në fushën e Tregut të Brendshëm, dhe në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë, si

²⁰⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008,

dhe në fushat e lidhura me tregti. Në fazën e mëtejshme, Kosova duhet të përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis-it* të BE-së. Përafrimi do të realizohet në bazë të një programi që do të dakordohet ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës. Kosova gjithashtu duhet të përcaktojë, në marrëveshje me Komisionin Evropian, modalitetet për monitorimin e zbatimit të përafrimit të legjislacionit dhe veprimet që duhet ndërmarrë për zbatimin e ligjit, duke përfshirë përpjekjet e Kosovës për të reformuar gjyqësorin e vet për të zbatuar kornizën e saj të përgjithshme ligjore.²⁰⁸ Ky është dokumenti bazë që Kosovën e obligon karshi kushteve të vendosura të realizoj përafrimin e legjislacionit si njëri ndër kushtet më tërëndësishme në procesin e integritimit në BE. Lidhur me përafrimin e legjislacionit tëfushës së Drejtësisë, kjo do të jetë nëfazën e hershme ku duhet të përafrohet legjislacioni dhe të plotësohet njëri ndër kushtet e kësaj marrëveshje. Nga kjo kuptojmë se legjislacioni aktual i fushës së të drejtës Civile qëështë në fuqi, duhet që të hyn nëfazën e plotësim ndryshimit me të cilën fillimisht do të reformohet dhe më pas do të përafrohet me *Acquis* të BE-së. Ndërsa legjislacioni që do të hartohet duhet që ta planifikohet që të bej përafrimin me *Acquis* të BE-së.

²⁰⁸Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës në njëren anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, neni 74.

KAPITULLI VIII EFEKT E REFORMIMIT TË SISTEMIT JURIDIK DHE LEGJISLACIONIT TË SË DREJTËS CIVILE NË KOSOVË

1.Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Kjo është pjesa e temës e cila në përmbajtje ka boshtin e hulumtimit për temën e cila na ofrohet përmes hulumtimit të realizuar me respondentët kompetent të cilët posedojnë njohurit e tyre e të cilat i kanë dhënë përmes përgjigjeve bë pyetësorin e këtij hulumtimi. E rëndësishme të ceket është se përmes këtij hulumtimi kemi arrit që të hymë në brendi të hulumtimit dhe të nxjerrim atë që është me interes për këtë hulumtim por me rendësi për sistemin juridik të Kosovës.

Në këtë kapitull kemi të prezantuara grafikonet me të dhënat e tyre që pasqyrojnë përgjigjet e dhëna në pyetësorin i cili është shtojcë e kësaj teme, këto përgjigje janë refleksion i punës, vlerësimit, përkushtimit të respondentëve të cilët janë profesionist në fushën e hartimit, zbatimit, monitorimit, aspektit shkencor të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile dhe kjo na krijon mundësin që të kemi të dhëna me shumë rendësi për hulumtimin që kanë të bëjnë me sistemin juridik të Kosovës me theks te veçantë legjislacioni i së drejtës Civile dhe efektet e reformimit të tyre. Tek kjo pjesë, ajo që është pjesë e çdo grafikonit në këtë kapitull, është analiza e të dhënave të çdo grafikoni nga e cila nxjerrim vlerësimin real për çdo pyetje dhe kjo mundëson që të krijohet konkluzioni fillimisht për çdo pyetje dhe më pas për tërë hulumtimin, duke dal me një konstatim të përgjithshëm.

Në kuadër të këtij kapitulli do të elaborohet në detaje qëllimi i hulumtimit si një element tejet me rendësi, nga i cili ne kuptojmë arsyen e hulumtimit dhe ato se q far derivojn nga ky hulumtim, si një përpyetje për të ofruar të dhëna të sakta e të cilat janë me interes për organet kompetente dhe përgjegjëse që të ndryshohen, reformohen, avancohen pjesët e identifikuar në këtë hulumtim. Për një saktësi të plotë të këtij hulumtimi është me interes edhe aspekti procedural i hulumtimit, i cili është me një rendësi të veçantë për këtë hulumtim.

Pjesë me rendësi për këtë kapitull dhe për mbarë këtë temë, janë efektet e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë. Ato të dhëna që i ka gjeneruar hulumtimi do të trajton dhe ceken e që kanë të bëjnë me efektet e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile në Kosovë. Në këtë pjesë do të shifen qartë dhe në mënyrë të saktë efektet e reformimit të këtyre dy fushave, pasi kjo është pjesa me më rendësi

2. Qëllimi dhe procedura e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar me qëllim të vlerësimit (testimit) të hipotezave të ngritura në këtë punim. Përmes këtij hulumtimi mundësohet që, përcaktimi i hipotezave të hyn në vlerësim nga e cila më pas na ofrohen të dhëna që do të na vërtetojnë apo nuk do të vërtetojnë hipotezën si një element me rëndësi të theksuar në këtë hulumtim. Barra e qëllimit të këtij hulumtimi bie fillimisht te vlerësimi i gjendjes aktuale, niveli i reformimit dhe avancimit në aspektin e standardeve ndërkombëtare dhe ajo që është me interes efektet nga reformimi, nga e cila mësojmë se qfar kemi ne mungesë dhe më pas cilat do të jenë efektet pozitive nëse do të kemi një sistem juridik dhe legjislacion të së drejtës civile të reformuar dhe avancuar ashtu sic është i nevojshëm. Në kuadër të kësaj teme, pjesa që i referohet hulumtimit është pjesa me më rëndësi për këtë temë, pasi kjo na mundëson që të ketë një temë të trajtuar përpos aspektit të bazuar në literaturë shkencore, raporte, analiza, legjislacion në fuqi edhe në hulumtim direkt duke shkuar në bazë dhe duke marrë informata nga burimi e të cilat mundësojnë që të kemi një temë të trajtuar mirë dhe me një përmbajtje nga e cila mundësohet të kenë institucionet të dhëna me interes.

Është e natyrshme që ky hulumtim e ka edhe aspektin procedural, si një komponent përmes së cilës është mundësuar të ketë një hulumtim i cili është i prezantuar në këtë kapitull. Ajo që është me interes është fakti se hulumtimi është kryer përmes pyetësorit që është shtojcë e kësaj teme, i cili ju është shpërndarë gjyqtarëve, avokatëve, profesorëve të drejtësisë, studentëve të drejtësisë, përmbartuesve privat, noterëve, ndërmjetësuesve, ndërmarrësve dhe të tjerëve që janë zyrtar ligjor, dhe përfaqësues të ndërmarrjeve. Pyetësi është punuar në DOC dhe i njëjti është shpërndarë përmes e-mailit dhe përmes e-mailit janë pranuar përgjigjet ku të gjitha janë fuzionuar në një faill të excell-it. Hulumtimi është bazuar në Pyetësor i cili përmban 30 pyetje përmes së cilave është arrit që të mbulohet hulumtimi dhe të nxjerrim përgjigjet që më pas na ka mundësuar që të nxjerrim konstatimet për hulumtimin.

3.Rikujtojmë se hipotezat e ngritura në këtë punim janë:

Në këtë punim trajtohen: shteti, sistemi juridik me theks te veqante legjislacioni i se Drejtes Civile dhe rendesia e reformimit te sistemit juridik dhe legjislacioni i se Drejtes Civile. Tema shtjellon shtetin, sistemin juridik te shtetit, fushen civile si pjese e sitemit juridik te shtetit. Krahas keti shqyrtimi identifikohet rendesia e reformimit te sistemit juridik dhe legjislacioni i se Drejtes Civile.

Rezultatet e pritura nga ky hulumtim do të ofrojnë të dhëna për sistemin juridik, teoritë për sistemin juridik, fusha e te drejtes civile, rendesia e reformimit te sistemit juridik dhe legjislacioni i se Drejtes Civile ne Kosove. Në këtë kontekst shtrohen edhe pyetjet kërkimore (hipotezat) si:

Hipoteza 1: Është esenciale dhe me impakt themelor reformini i sistemit juridik të Kosovës për te siguruar shtet te se drejtes?

Hipoteza 2: Sistemi juridik i Kosovës dhe legjislacioni i së Drejtës Civile është i reformuar dhe avancuar.

Hipoteza 3: Mardhenjet juridiko-civile nuk janë te zhvilluara dhe avancuara konform ndryshimeve shoqerore, ekonomike, sociale dhe sipas nevojave te investimeve dhe tregut?

4.Efektet e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë

Nga përmbajtja e temës, dhe ndarja e kapitujve mësohet se në kuadër të këtij hulumtimi me rendësi është identifikimi i efekteve të reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë. Përmes këtij hulumtimi është synuar që fillimisht të kemi një skenim sa i përket sistemit juridik në Kosovë dhe legjislacionit të së drejtës civile, kjo mundëson që të identifikojmë pengesat, zbrastirat, problemet dhe ato se qfar duhet të ndryshohet, reformohet dhe avancohet në kuadër të këtyre dy fushave. Përmes hulumtimit është synuar që të pranojmë përgjigje nëse do të kemi reformim të sistemit juridik dhe ati të legjislacionit, cilat do të jenë efektet, në cilat fusha do të ketë refleksion ky reformim, pasi dihen që raportet nga marrëdhëniet juridiko civile janë te një rëndësie të veçante për të gjitha fushat.

Nga ky hulumtim gjenerohen shumë të dhëna të cilat janë të një rëndësie të madhe, për faktin se fillimisht mundësojnë të ketë vlerësim real për gjendjen aktuale sa i përket sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile, na identifikon se në cilën pjesë më shumë e cilën më pak ka nevojë për intervenim përmes ndryshimeve dhe reformave dhe ajo që është me një rendësi është identifikimi i efekteve, ajo se q far arrihet

përmes një sistemi juridik dhe legjislacion të fushës së të drejtës civile të reformuar dhe konform standardeve ndërkombëtare. Identifikimi i efekteve konkrete është një material me shumë vlerë, për faktin se mund të shërbehen institucionet përkatëse më të, duke e pasur si pik referimi në të ardhmen.

Qoftë për shkencën, qoftë për praktiken po edhe për politik bërjen për reformimin e sistemit juridik dhe Legjislacionit të së drejtës civile, ky hulumtim na ka nxjerr disa efekte, që do ti cekim si në vijime:

- Rëndësia e reformimit dhe ndryshimeve tek Kushtetuta e Kosovës, legjislacionit si dhe përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, janë më shumë efekt dhe reflektim në reformimin e sistemit juridik në Kosovë. Me këtë kemi të qartë se reformimin e sistemit juridik që është i një rëndësie të veçantë duhet të behet përmes këtyre dy ndryshimeve;
- Zhvillim Ekonomik nëse shifet në korniza të përgjithshme, bie që është pjesë që kryesisht ndërlidhet me prodhimin, masat fiskale, përcaktimin e të hyrave etj që janë të shumta. Në përmbajtjen më të thellë shohim se, zhvillimi ekonomik është shumë i varur nga sundimi i ligjit, shteti i së drejtës dhe ajo që ndërlidhet direkt është reformimi i legjislacionit të së drejtës civile përmes së cilit rregullohen marrëdhëniet juridike nga marrëdhëniet juridiko civile që në fund rezultojnë me aspektin financiar.
- Nga ky hulumtim rezulton që të kemi përgjigje ku reformimi i legjislacionit të së drejtës civile është me efekt në zhvillimin ekonomik, ku kjo përgjigje është me përqindje të lartë dhe e ofruar nga respondentët që janë nga fusha e zbatimit, politik bërjes, ndërmarrësi, avokatisë etj. Me këtë kuptuam dhe më pas mund të konstatojmë se reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, prandaj me këtëkuptojmë sa është me rëndësi reformimi, avancimi i legjislacionit të së drejtës civile pasi është me ndikim në fushën më të rëndësishme në vend që është ai i zhvillimit ekonomik, prandaj çdo vonës në këtë reformë, ndikon në zhvillim ekonomik.
- Nga shumë raporte që i behën funksionimit të shtetit të Kosovës dhe sistemit të tij juridik, ka vërejtje nganjëherë edhe rekomandime sa i përket sundimit të ligjit në Kosovë. Sundimi i ligjit është sfida më e madhe me të cilën Kosova është duke u përballur pasi kjo është duke ndikuar në mos zhvillim të përgjithshëm në Kosovë. Nga ky hulumtim na rezulton se reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë ka ndikim dhe refleksion direkt në sundim të ligjit

në Kosovë. Me këtë ndikim mundësohet të kuptojmë një fakt se rëndësia e reformimit të legjislacionit të së drejtës civile është i nevojshëm dhe është kërkesë e kohës pasi hulumtimi ka gjeneruar të dhëna se nuk është i reformuar si dhe ndikim në një fushë që është me rëndësi jetike për zhvillimin e vendit sic është sundimi i ligjit. Sundimi i ligjit është njëri ndër kushtet që ka shteti dhe institucionet e Kosovës që ta kenë në funksion pasi nga kjo varet edhe zhvillimi i shtetit të Kosovës që deri me tani nuk është që ka shkuar mire çdogjë ashtu sic kanë qenë mundësit dhe nevojat, prandaj reformimin e legjislacionit të së drejtës civile duhet ta shohim si një mundësi që të kemi edhe sundim të ligjit në Kosovë.

- Mungesa e sistemit juridik dhe legjislacionit përkatës, ka pamundësuar që tani në Kosovë të kemi probleme pronësore të theksuara. Fati jo i mirë ishte për Kosovën që as një herë nuk ka pasur një sistem të saj juridik për ti trajtuar problemet pronësore dhe për të avancuar legjislacion përkatës në fuqi për të ardhur deri te eliminimi i problemeve pronësore në minimum dhe reformimin e tyre karshi standardevendërkombëtare dhe ndryshimeve shoqërore. Nga ajo që rezulton prej këtij hulumtimi, mësojmë se reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë, është me ndikim në zgjidhjen e problemeve pronësore. Kur i analizojmë këto të dhëna nga këndvështrimi i responentëve të këtij hulumtimi të cilët janë profesionist të fushës, mund të konstatojmë se efektet janë të një rëndësie të madhe nga reformimi i sistemit juridik dhe ati të legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë.
- Me shume ndikim në zhvillim, reformim dhe avancim për krijim të ambientit të përshtatshëm për investime të huaja është edhe sistemi juridik dhe legjislacioni i fushës së të drejtës civile në Kosovë. Sa i përket investimeve të huaja në Kosovë përpos kushteve financiare dhe fiskale që krijon Kosova me rëndësi të madhe janë edhe kushtet e përcaktuara në sistemin juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile, përmes së cilave sigurohet qasje në drejtësi, efikasitet i sistemit gjyqësor, eliminim të korrupsionit, zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe kontesteve brenda afateve ligjore dhe shumë çështje tjera ku do të sigurohet që Kosova është shtet i së drejtës dhe i përshtatshëm që investitorët e huaj ta shofin të sigurt investimin e kapitalit të tyre në Kosovë. Investimi i kapitalit të huaj në Kosovë ka qenë shpresa më e madhe përmes së cilës do të ketë ndikim në zhvillimin, ngritjen, avancimin e ekonomisë së Kosovës, prandaj qasja ndaj investimeve të huaja duhet të jetë shumë profesionale, serioze, dhe mirë e planifikuar në çdo fushë me qellim që të krijohet një ambient i përshtatshëm për investime. Për më shumë, nga ky hulumtim shohim se sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile ka një rëndësi të madhe

në krijimin e ambientit të përshtatshëm për investime të huaja, andaj reformimi, ndryshimi, avancimi i sistemit juridik dhe legjislacionit të fushës së të drejtës civile, duhet të jenë mirë të planifikuara, analizuara e në lidhmëni me krijimin e kushteve për një ambient të përshtatshëm për investimet e huaja në Kosovë, pasi kjo është me rëndësi jetike për zhvillimin e Kosovës dhe transformimin në një shtet me mirëqenie të mirë dhe i orientuar drejt vlerave më të mira universale të cilat i kanë përqafuar popujt e shteteve demokratike. Nga të cekurat dhe ato që ka gjeneruar hulumtimi, mund të konstatojmë fillimisht se nuk kemi legjislacion të së drejtës civile të reformuar në atë masë sa të jetë i përshtatshëm për krijimin e ambientit të përshtatshëm për investimet e huaja dhe së dyti është më interes vital reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë pasi do të ketë ndikim pozitiv në krijimin e ambientit të përshtatshëm për investime të huaja në Kosovë të cilat konsiderohen me shume rëndësi për zhvillimin e Kosovës në çdosferë të jetës.

- Nuk mund të mos jetë e pa trajtuar dhe analizuar edhe qasja më e mirë për qytetarët në drejtësi e cila ndërlidhet me reformimin e legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë, pasi kanë një lidhmëni direkt njëra me tjetrën. Për më shumë qasja në drejtësi është kategori Kushtetuese dhe e të drejtave të njeriut, andaj trajtimi i kësaj çështjeçdo here është i një rëndësie të veçantë dhe si obligim i sistemit juridik të Kosovës. Qasja në drejtësi dhe krijimi i kushteve sa më të lehta, është obligim që të krijohet nga sistemi juridik i vendit përmes mekanizmave ligjor dhe teknik. Nga hulumtimi i realizuar, na sjell të dhëna shumë me rëndësi, fillimisht në identifikimin dhe më pas në planifikim për ndryshim, kjo ngase reformimi i sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile është me ndikim direkt në zhvillimin, avancimin e qasjes në drejtësi për qytetarët e Kosovës. Kjo është tejet me rëndësi ngase identifikon se ku duhet te ketëreformë, ndryshim për të pasur një qasje të mirë dhe të mjaftueshme të qytetarëve të Kosovës në sistemin e drejtësisë. Përball këtyre të dhënave, na mundësohet që të konstatojmë se, qasja e qytetarëve të Kosovës në drejtësi është një e drejt e kualifikuar si kategori kushtetuese, prandaj kjo kërkon që të materializohet ne detaje në mekanizma përkatës si në legjislacion përkatës, aspekt teknik dhe informues që të ketë mundësi të kualifikohet se në Kosovë qasja në drejtësi është mirë e rregulluar, konform reformimit, ndryshimit të legjislacionit të së drejtës civile.
- Shteti dhe orientimi i popullit të Kosovës janë vlerat universale të botes demokratike të cilat karakterizohen me respektim të të drejtave të njeriut, lëvizjen e fuqisëpunëtore, njohurive, mallrave dhe kapitalit si dhe atë të ekonomisë së lirë të tregut si kusht për zhvillim dhe

mirëqenie në vend. Duhej pasur synim këto vlera është obligim i Kosovës që të ketë një ekonomi të zhvilluar duke e bazuar në zhvillim të ndërmarrësise dhe biznesit në vend, kjo pasi mundësojnë që të kenë ndikim në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Mirëpo për të pasur një zhvillim, reformim të duhur për tu konsideruar se do të ketë ndikim në ekonomin e vendit, ndërmarrësi dhe biznesi duhet të kenë një zhvillim në atë drejtim dhe masë që të konsiderohen stabile dhe të mbështetura nga shteti përmes mekanizmave përkatës. Për një zhvillim të ndërmarrësise dhe biznesit në Kosovë është me shumë rëndësi dhe efekt, reformimi i sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në vend, kjo për faktin se me këto ndryshime dhe reforma ndikohet direkt në krijim të kushteve më të mira dhe të përshtatshëm për lehtësira në biznes dhe ndërmarrësi. Nga përgjigjet e pranuar prej kuadrove që kanë të bëjnë me këtë, mësojmë se reformimi i sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë ka efekt direkt në lehtësira në krijimin dhe të bërit biznes si dhe ndërmarrësi si dy fusha me shumë rëndësi për zhvillimin ekonomik në Kosovë. Lidhmëni mes këtyre dhe të dhënat e gjeneruara nga hulumtimi mundësojnë që të ndërtohet konstatimi se sistemi i juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile janë bazë e çdo fushe tjetër, për faktin se këto mundësojnë të krijohet shteti i së drejtës përmes së cilit krijohen kushte dhe rregulla që kanë refleksion në lehtësirat e të bërit biznes dhe ndërmarrësi. Andaj ky efekt me kaq rëndësi ka edhe karakterin detyrues që të ketë reformim të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile për të pasur një ndërmarrësi dhe zhvillim të biznesit të suksesshëm.

- Qëllimi bazik i sistemit juridik dhe atë që përcakton legjislacioni i së drejtës civile është krijimi i rregullave ku përcaktohen kushtet dhe detyrimet e qytetarëve kur ata mes vete kanë të bëjnë me raporte nga marrëdhëniet juridiko civile. Përmes dispozitave ligjore që kanë karakter detyrues, shprehet vullneti i qytetarëve përmes përfaqësuesve të tyre në mekanizmat shtetëror që kanë për obligim krijimin, reformimin dhe zhvillimin e sistemit juridik në vend. Përpos kësaj sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile, krijon sigurinë juridike tek qytetarët se marrëdhëniet juridiko civile janë të rregulluara dhe për as një moment nuk do të vie në shprehje vullneti subjektiv i njerëzve, po marrëdhëniet e tyre juridiko civile do të rregullohen me norma konkrete. Andaj lidhmënia mes reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë dhe ndikimi pozitiv në krijimin e sigurisë juridike për qytetarët është shumë e madhe. Nga kjo fillimisht na lind konstatimi se nuk kemi një siguri të mirë juridike tek qytetarët për të drejtat e tyre, për faktin se nuk kemi një reformim të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile që qytetarët të kenë sigurinë juridike për të drejtat e tyre. Pas kësaj rëndësia e reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile është i një


rendësi të madhe, kjo pasi është me ndikim direkt në krijimin e sigurisë juridike. Siguria juridike është e një rëndësie të madhe, pasi kjo mundëson që qytetarët mbi bazën e sigurisë juridike që i mundëson sistemi juridik të kërkoj mbrojtjen apo kërkesën për të drejtat e tyre nga marrëdhëniet juridiko civile. Efekti i reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile mundëson që të ketë siguri juridike, besim në sistemin e drejtësisë, perceptim pozitiv për sistemin gjyqësor dhe fuqizim karshi proceseve të padrejta që ju shkaktohen nga të tjerët.

- Orientimi i shtetit të Kosovës që është i bazuar në vullnetin e popullit është i orientuar drejt integritit në BE, si një vlerë që mundëson respektim të drejtave të njeriut, barazi, zhvillim, prosperitet. Mirëpo procesi i integritit kërkon angazhim, punë dhe planifikim për plotësimin e kushteve që kërkohen në procesin integruar të Kosovës për në BE. Ndër kushtet më të rëndësishme dhe me më shumë ndikim është reformimi i sistemit juridik dhe legjislacionit duke pas parasysh standardet dhe direktivat e BE-së. Është më së e saktë se reformimi i sistemit Juridik dhe ati të legjislacionit të BE-së, është me ndikim direkt në plotësimin e kushteve dhe standardeve për procesin e Integritit të Kosovës për në BE si njëri ndër synimet më të mëdha të popullit dhe shtetit të Kosovës. Nga të cekurat dhe ato që ka gjeneruar hulumtimi, lirisht mund të konstatohet se reformimi i sistemit juridik dhe legjislacionit të fushës së të drejtës civile është me refleksion pozitiv në procesin e integritit të Kosovës për në BE, andaj sa më i madh të jetë reformimi i këtyre dy mekanizmave aq më afër do të jetë shteti dhe populli i Kosovës vlerave të BE-së.
- Duke qene rast i veçantë, Kosova historikisht nuk ka pasur mundësi te krijon trashëgimi dhe histori në ndërtimin e mekanizmave shtetëror dhe sistemin e saj juridik, por çdo here problem ka pasur lirin, pavarësinë dhe largimin e okupatoreve të cilët me çdo kusht kanë realizuar metoda për asimilim dhe imponim të kulturës, traditës dhe sistemin e tyre juridik. Fal përkushtimit dhe qëndrueshmërisë, kjo nuk ka ndodhur, pasi çdogjë e okupatorit është konsideruar dhe ka qene e dëmshme për popullin dhe Kosovën. Në fund të viteve 90 dhe me përfundimin e luftës, Kosova kishte filluar që të krijon identitetin e saj shtetëror dhe juridik të cilat çdo dit janë avancuar.
- Sistemi juridik i Kosovës pas përfundimit të luftës gjer me tani ka kaluar në shumë faza të reformimit, ndërtimit ku janë reflektuar mbetjet e ish sistemit, synimet e misionit të UNMIK-

ut dhepas shpalljes së pavarësisë përgjegjësia e institucioneve të Kosovës për ndërtim dhe reformim të sistemit juridik. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe aprovimin e Kushtetutës së Kosovës, kemi një etapë të re ku përgjegjësia drektë bie në Institucionet e Kosovës, që sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile të jenë në nivel të duhur për të pas efekt pozitiv në çdo fushë tjetër të jetës nga të cilat do të kishim zhvillim, progres, integrim dhe qëndrueshmëri. Për fat të keq, nuk kemi reflektim të mjaftueshëm të Shtetit të Kosovës që sistemi juridik të jetë në atë nivel për të siguruar Kosovës shtetin e së drejtës nga i cili varen të gjitha zhvillimet në çdosferë të jetës.

Duke par se çdo sferë e jetës, është direkt e ndërlidhur me sistemin juridik nga i cili buron shteti i së drejtës bën te kuptueshme se fokusi, angazhimi, planifikimi dhe çdogjë që kërkohet duhet te jete e përqendruar në ndërtimin, zhvillimin, reformimin e sistemit juridik dhe atë të legjislacionit të së drejtës civile. Nga ky hulumtim janë identifikuar dy fakte, sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile nuk është mjaft i zhvilluar dhe reformuar dhe së dyti reformimi i tyre është me rëndësi të veçante për zhvillimin e sferave me vitale te shtetit të Kosovës.

5. Analiza e të dhënave nga hulumtimi dhe paraqitja e tyre në grafikone




Ky hulumtim është realizuar me profesionist të fushës së të drejtës, duke dhënë mundësinë e dhënies së mendimit profesional të zyrtarëve të cilët zbatojnë, hartojnë, ligjërojnë dhe monitorojnë sistemin juridik dhe legjislativin e fushës së të drejtës civile siç janë: gjyqtarë, avokatë, profesorë të së drejtës, noterë, përmbaues privat, ndërmjetësues, studentë, ndërmarrës, ekspert të së drejtës etj., Gjithsej në këtë hulumtim përmes pyetjes së përcaktuar në grafikunin 1, janë pranuar 650 përgjigje.

Nga numri prej 650 respondentëve, numri më i madh i respondentëve është 154 gjyqtarë që është 24% i të gjithë respondentëve ndërsa më së paku 3% të respondentëve janë ndërmarrës me shifrën pjesëmarrëse 21. Në kategorinë e tjerë që janë në numër 62, në përqindje 10% të respondentëve të përgjithshëm e përbëjnë zyrtarë ligjor, praktikantë, përfaqësues ligjorë.

Përgjigjet e dhëna nga respondentët e grafikunin 1, janë bazë mbi të cilën është ndërtuar ky hulumtim dhe janë gjeneruar të dhënat që do të trajtohen në vijim. Nëse analizohet numri i respondentëve më i larti është ai i gjyqtarëve dhe avokatëve, po fakt është se edhe në numër janë më të shumtë gjyqtarët dhe avokatët në Kosovë në raport me kategoritë tjera të pjesëmarrësve të këtij hulumtimi. Numri i respondentëve nga profesionet e lira është i lartë në raport me numrin e tyre që janë të licencuar. Nga të dhënat që na gjeneron kjo pyetje përmes grafikunin 1, mund të konstatojmë se numri i respondentëve është i lartë dhe na mundëson që të kemi hulumtim gjithëpërfshirës dhe me një nivel të lartë të përgjigjeve profesionale. Kategoritë dhe numri i respondentëve në këtë hulumtim janë në relacion të

duhur me qëllimin e këti hulumtimi nga i cili do të sjellim risit sa i përket rendësis së reformimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile e që janë në funksion të shtetit të së drejtës i cili është bazë për funksionim të shtetit dhe fushave tjera që sigurojn zhvillim, integrim dhe mirëqenie. Andaj nga ky hulumtim përmes përberjes së repodentëve do të arrim që të kemi një hulumtim i cili do të siguron një rezultat objektiv dhe te dhënat do të jenë në funksion për mekanizmat shtetëror që ato pjes ku është e nevojshme të ketë ndryshim dhe reformim për të arritur deri tek një sistem juridik dhe legjislacion i së drejtës civile i kompletuar sic duhet të jetë.




Nga pyetja “ A duhet të ketë reforma të vazhdueshme sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë, për të pasur një shtet te se drejtës? ” nga respodentët janë dhënë këto përgjigje: 92% kanë deklaruar PO, 3% kanë deklaruar JO dhe 5% janë deklaruar se Nuk është i nevojshëm.

Përgjigjja PO me përqindje prej 92% është përgjigje me përqindje shumë të lartë dhe se duhet të ketë reforma të vazhdueshme sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë, për të pasur një shtet te se drejtës. Me këtë përqindje të kësaj përgjigje kuptohet se sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile duhet të reformohet në vazhdimësi për të qenë në funksion të shtetit të së drejtës një synim i shtetit të Republikës së Kosovës. Nga kjo përgjigje respodentët që jan në numër të madh bejn të njohur se në Kosovë nuk kemi shtet të së drejtës për faktin se e mbi 90% e konsiderojn se duhet të

ketë reformim të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile dhe kjo është dëshmi se ende duhet të ketë reform për një shtet të së drejtës.

Në përgjigjen e dhenë Jo kemi përqindje të ulët të respondentëve në krahasim me numrin e atyre respondentëve që kanë dhënë përgjigjen Po e të cilët janë në përqindje tejet më të lartë. Prandaj nuk mund të merret si përqindje e lartë e respondentëve ata që kanë dhënë mendimin me përgjigjen Jo në këtë pyetje. Kjo është përqindje simbolike dhe nuk mund të kualifikohet si mendim i shumicës së respondentëve dhe të jetë konkurrues me përqindjen e atyre që kanë dhënë përgjigjen Po. Në kuadër të mendimeve të respondentëve kemi edhe përgjigje që në përqindje është 5% e atyre që mendojnë se nuk është i nevojshëm reformimi i vazhdueshëm i sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile për një shtet të së drejtës. Me këtë kjo kategori e respondentëve, mendojnë se për një shtet të së drejtës nuk është e nevojshme që të ketë reformim të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile e që në aspektin praktik dhe teorik është e kundërta. Përmes kësaj përgjigje, kjo kategori e konsideron se Kosova është shtet i së drejtës dhe është i pa nevojshëm reformimi.

Përgjigja e dhen nga respondentët Po, është përgjigja që përfaqëson mendimin e shumicës së respondentëve dhe është objektive në atë që trajton në këtë pyetje. Kjo përgjigje korespondon edhe me gjendjen faktike për faktin se në Kosovë nuk kemi shtet të së drejtës ekskluzivisht pse nuk kemi reformim, avancim të sistemit juridik dhe atë të legjislacionit të së drejtës civile e që i referohet edhe cilësisë së legjislacionit, zbatimit dhe llogaridhënies. Nga të cekurat dhe ato që ofron ky grafik, mund të konstatohet se në vazhdimësi duhet të ketë reformim, ngritje të kapaciteteve dhe avancim të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile konform ndryshimeve dhe kërkesave shoqërore, ekonomike, politike dhe integruese.




Nga të dhënat që gjeneron grafikoni i pyetjes 2, na rrjedhin këto të dhëna: Të gjitha kategoritë e respodentëve, numrin më të lartë të përgjigjeve rreth 90% e kanë për përgjigjen PO dhe shumë më i ulët nga të gjithë respodentët për përgjigjet JO, që mesatarja 6% nuk është i nevojshëm nga 4%. Bazuar në këto statistika kjo tregon se është një mendim i përgjithshëm nga të gjithë respodentët me përqindje shumë të lartë që jep të kuptohet se kemi një mendim shumë të unifikuar nga të gjithë respodentët dhe kjo e bën të mundur që të kemi një konstatim që është se, sistemi juridik dhe ai i legjislacionit të së drejtës civile duhet të ketë reforma të vazhdueshme për të qenë në funksion të shtetit të së drejtës një vlerë që shteti i Republikës së Kosovës e pretendon. Nga të cekurat më lartë, lidhur me grafikonet 2, mund të konstatojmë se në vazhdimësi duhet të ketë reformim të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës civile për të pasur një shtet të së drejtës.

Kur i krahasojmë respodentet dhe përgjigjet e dhëna, kuptojmë se nuk mund të kualifikohet se në Kosovë ka shtet të së drejtës kjo për faktin se përqindja e lartë në përgjigjen Po, është indikator se të gjithë respodentët që janë nga fusha e gjyqësis, shkencës, avokatis, profesioneve të lira ndajnë të njëjtin mendim dhe atë në përqindje të lartë. Përpos kësaj, respodentët e venë rëndësinë të reformimit që duhet të jetë i vazhdueshëm nëse pretendohet shteti i së drejtës dhe kur analizohet sa është i reformuar sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile e që në realitet nuk është, na sjellin konstatimin se nuk kemi shtet të së drejtës.

Nga këto të dhëna që janë tejet me rëndësi, për faktin se kategoria e respodentëve janë tejet kompetent dhe profesional në këtë çështje përmes përgjigjeve të tyre, mendojmë se këto të dhëna sjellin dy çështje me rëndësi, fillimisht se nuk kemi shtet të së drejtës pasi nuk kemi reformim të duhur të sistemit juridik

dhe legjislacionit të së drejtës civile që do të mundësonin shtetin e së drejtës dhe së dyti baz për një shtet të së drejtës është reformimi, zhvillimi, avancimi i sistemit juridik dhe si pjesë e tij, legjislacioni i së drejtës civile. Reformimi i sistemit juridik fillimisht i referohet analizave dhe politikave të qarta për fusha të së drejtës, hartimin dhe reformimin e legjislacionit të fushave të së drejtës, zbatimin e legjislacionit dhe në fund monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit. Andaj ky studim mund të merret si referim që mekanizmat përkatës institucional në Kosovë, duhet të kenë parasysh që shteti i së drejtës ndërtohet dhe do të jetë funksional nëse do të arrijnë që të ketë analiza paraprake të politikave, reformim të vazhdueshëm të legjislacionit dhe zbatim i përcjellur me monitorim dhe vlerësim dhe atëherë mund të kualifikohet se Kosova është shtet i së drejtës.



Përgjigjet që ofrojnë respondentët në pyetjen “ Prej vitit 1999 deri në vitin 2008, kompetencë e kujt ishte konsolidimi i sistemit juridik në Kosovë? ”, japin këto përgjigje: Misioni i UNMIK-ut 53 % të pasuar nga përgjigja, UNMIK-u dhe Institucionet e përkohshme të Kosovës me 38% , ndërsa për përgjigjen Institucionet e përkohshme të Kosovës me 8% dhe përgjigja e fundit ende nuk kishte filluar ndërtimi i sistemit juridik me 1%.


Përgjigja me përqindje prej 53% tejkalon mendimin e gjysmës së respondentëve dhe mund të konstatohet si përgjigja me përqindje më të lartë dhe njehe rit të kualifikohet se është mendim më i unifikuar nga respondentët për pyetjen e 3. Përgjigja me përqindje prej 38% është pjesa tjetër e mendimit të respondentëve që përfaqësojnë një pjesë jo edhe të vogël të respondentëve që mund të konstatohet se përfaqësojnë një pjesë jo të vogël të respondentëve që kanë mendim të tillë për pyetjen 3. Për dy përgjigjet tjera nuk përfaqësojnë numër të madh të respondentëve dhe nuk mund të kualifikohen si përgjigje me përqindje të lartë të mendimit të respondentëve që të merren si bazë se kemi të bëjmë me mendim të shumicës së respondentëve dhe të kualifikohet si mendim me përqindje të lartë që përfaqëson mendim të unifikuar nga respondentët për pyetjen 3.

Kur analizohen këto të dhëna përgjegjësia kryesore bie tek Misioni i UNMIK-ut sa i përket konsolidimit të sistemit juridik në Kosovë pas vitit 1999. Por të dhënat na nxjerrin përgjegjës edhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse Qeveritare të asaj kohe dhe kualifikohen si bashkëpërgjegjëse me misionin e UNMIK-ut. Këto të dhëna që derivojn nga ky hulumtim për këtë çështje specifike duhet të analizohen në harmoni edhe me përgjegjësin kushtetuese dhe ligjore në atë kohë. Është e njohur se pas vitit 1999 me Kosovën në cdo aspekt ka qeveris, udhëheq, planifiku misioni i UNMIK-ut, prandaj edhe përgjigjet e dhëna në këtë pyetje për përgjigjen “Misioni i UNMIK-ut” janë reale dhe kanë bazën në kompetencën dhe përgjegjësin e misionit të UNMIK-ut në Kosovë, ku një gjë tjetër është të përcakton edhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 1244 ku përcaktohet rrolli dhe misioni i UNMIK-ut në Kosovë e i cili është përgjegjës për cdo fushë edhe për atë të ndërtimit, konsolidimit dhe zhvillimit të sistemit juridik në vend.

Edhe për kundër faktit se nga ky hulumtim përgjigjet e respondentëve na nxjerrin si bashkëpërgjegjëse misionin e UNMIK-ut se bashku me Institucionet e përkohshme të Kosovës, ku de jure në mënyrë direkte nuk mund të kualifikohet si e tillë për faktin se kompetencat dhe përgjegjësit e IPVQ-ve nuk kanë qenë të zgjeruara në atë masë sa të jenë përgjegjëse direkte për ndërtimin dhe konsolidimin e sistemit juridik, kur për këtë ka qenë përgjegjëse vetëm misioni i UNMIK-ut dhe nuk mund të bartet tek IPVQ-et. IPVQ-et mund të kenë përgjegjësin për ato pjesë për të cilat kanë qenë përgjegjëse e të cilat kanë qenë me refleksion direkt apo indirekt në konsolidimin dhe ndërtimin e sistemit juridik të vendit.

Sa i përket përgjegjësisë direkte për konsolidimin dhe ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës pas vitit 1999 deri në vitin 2008 është e misionit të UNMIK-ut, për faktin se sipas Rezolutes 1244 ka pasur këtë përgjegjësi dhe mision, ndërsa IPVQ-t mund të kenë përgjegjësi indirekte po asnjëherë duke e ndarë

përgjegjës in me misionin e UNMIK-ut, pasi ky i fundit ka pasur përgjegjës in direkte për të gjitha ato që i referohen konsolidimit, ndërtimit, zhvillimit, reformimit të sistemit juridik të Kosovës.




Nga të dhënat e cekura në këtë grafik, përgjigja Misioni i UNMIK-ut përfaqëson mendimin me përqindje më të lartë të responentëve dhe mund të kualifikohet si përgjigja më e unifikuar nga responentët për pyetjen 3 dhe nga kjo kuptohet se nga viti 1999 deri në vitin 2008, ishte Misioni i UNMIK-ut kompetent dhe përgjegjës për ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës.

Lidhur me përgjigjet e vlerësuara nga çdo kategori e responentëve, të gjithë responentët përqindjen më të lartë e kanë dhënë në përgjigjen Misioni i UNMIK-ut e pasuar me përqindje më të ulët për përgjigjen Misioni i UNMIK-ut dhe Institucionet e përkohshme të Kosovës. Përjashtimisht, kategoria e responentëve e Ekspertëve dhe të tjerët përqindje më të lartë ofrojnë për përgjigjen Misionin e UNMIK-ut dhe Institucionet e Kosovës.

Nëse merret mesatarja nga të gjithë respondentët në përgjigjet e tyre, përqindja më e lartë është për përgjigjen misioni i UNMIK-ut. Duke u bazuar në këtë përqindje dhe ato individuale të çdo kategorie të respondentëve për këtë përgjigje, mund të konstatojmë se nga viti 1999 deri në vitin 2008, ishte UNMIK-u ai që kishte kompetencë dhe përgjegjësi konsolidimin, ndërtimin, zhvillimin dhe reformimin e sistemit juridik në Kosovë. Përmes kësaj arrihet të jetë konstatuar një e vërtetë që gjer më tani nuk ka qenë edhe shumë e njohur dhe deshifruar, se UNMIK-u, ka qenë përgjegjës për ndërtimin e sistemit juridik të Kosovës nga viti 1999 deri në 2008.

Kategoriya e respondentëve janë profesionist të së drejtës si nga fusha e hartimit, zbatimit, shkencës juridike dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit, prandaj përgjigjet e tyre për këtë çështje të trajtuar në pyetjen 3 janë profesionale dhe objektive ku na gjenerojnë këto rezultat nga i cili ndërtohet edhe konstatimi se misioni i UNMIK-ut ishte përgjegjës nga viti 1999 deri në 2008 për sistemin juridik të Kosovës.

Kur analizohen përqindjet e larta në grafikun 3 dhe ato të çdo kategorie të respondentëve e në lidhmëni me përgjegjësit e misionit të UNMIK-ut të përcaktuara në rezolutën 1244, mendoj se përgjegjës kryesor për çdo gjë që ndërlidhet me konsolidimin, ndërtimin, zhvillimin dhe reformimin e sistemit juridik nga viti 1999 deri në vitin 2008 ka qenë misioni i UNMIK-ut dhe nga kjo përgjegjësi nuk mund të distancohet misioni i UNMIK-ut.




Te pyetja e parashtruar respondentëve: “Me shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008, reformimi i sistemit juridik të Republikës së Kosovës, ka filluar me”, përgjigja Miratimi i Kushtetutës së Kosovës me 81 % e pasuar nga përgjigja, Nxjerrjes së ligjeve të reja nga Kuvendi i Kosovës me 12%, Zëvendësimin të ligjeve të ish-sistemit juridik të Jugosllavisë dhe Serbisë me 4%, Zëvendësimin të rregulloreve të UNMIK-ut me Ligje të Republikës së Kosovës me 3% dhe në fund Asnjëra më lartë me 1%.

Kur i referohemi mendimit të respondentëve në kuptojm fillimisht se sistemi juridik në Kosovë nuk ishte i reformuar dhe i njëjti ishte ashtu siq ishte ndërtuar nga sistemet e shteteve okupatore të Kosovës nga ish sistemi Jugosllav dhe ai i UNMIK-ut si dhe fillimin e reformimit e konsiderojn se është me rastin e Miratimit të Kushtetutës së Kosovës dhe më pas me nxjerrjen e ligjeve të reja. Kjo është më së e sakt dhe kjo tregon se respondentet me përgjigjet e tyre janë në relacion edhe me aspektin teorik dhe praktik. Kjo për faktin se është e qartë se me miratimin e Kushtetutës së Kosovës në vitin 2008 është faza fillestare e reformimit të sistemit juridik dhe ndërtimit të tij nga vete shteti i Kosovës. Prandaj të dhënat që i gjeneron ky grafik janë tejet me rëndësi së behet një precizim i qartë se nga kur kemi fillim të reformimit të sistemit juridik dhe ndërtim nga vete mekanizmat e shtetit të Kosovës.

Me shpalljen e pavarësis së Kosovës në vitin 2008 Kosova për herë të parë në koordinim edhe me faktorin ndërkombëtar kishte shpallur mevetësin dhe nga ky moment kishte filluar që të ndërtohet si shtet së bashku me të gjitha mekanizmat shtetëror. Praktika dhe teoria e tregon se Kosova para vitit 2008 kishte të themeluar disa mekanizma shtetëror dhe për këtë kishte trashëgimi, mirëpo as një herë nga vete shteti dhe vullneti i popullit të Kosovës po nga shtetet që kishin okupuar apo administruar. Kosova kishte edhe sistemin juridik i cili kryesisht ishte i themeluar dhe zhvilluar nga shtetet okupatore dhe së fundmi nga Misioni i UNMIK-ut, por as një herë nga vet shteti i Kosovës së pavarur. Me nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës, ishte përcaktuar qartë forma e shtetit të Kosovës, qeverisja dhe sistemi i saj Juridik. Ajo qfar ishte e përcaktuar në Kushtetuten e Kosovës ishte në funksion të reformimit të sistemit të saj juridik që e kishte të hartuar paraprakisht nga sisteme okupuese të ish sistemit Jugosllav dhe këtij të fundit UNMIK-ut.

Duke pasur për bazë se përqindja më e lartë e përgjigjeve i referohet përgjigjes miratimit të Kushtetutës së Kosovës prej 81% dhe Nxjerrjes së ligjeve të reja nga Kuvendi i Kosovës me 12% që është përqindje shumë e lartë dhe është më shumë se gjysma e përqindjes totale, nga kjo mund të Konstatohet se ky është mendimi me përqindje më të lartë dhe më i unifikuar për pyetjen e parashtruar në këtë grafik.




ehet
shtet
o që

derivojnë nga grafikonet e pyetjes 4 mund të konstatojmë se pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008, reformimi i sistemit juridik kishte filluar me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nxjerrjes së ligjeve të reja nga Kuvendi i Kosovës. Nga kjo vërtetohet se sistemi juridik është i bazuar dhe ndërtuar në Kushtetutë dhe legjislacion i cili krijon, mbron dhe reformon sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

Nga të dhënat që gjeneron ky grafik, shifet se kemi të bëjmë me të dhëna që janë tejet me rëndësi për shkencën, praktiken dhe drejtësinë në Kosovë, kjo për faktin se përmes këtyre kemi mendim të responentëve në mënyrë të njëjtë që fillimisht e renditin miratimin e Kushtetutës si bazë për reformim dhe ndërtim të sistemit juridik. Me këtë ne kemi mendimin e të gjithë responentëve se sistemi juridik është mekanizëm që bazën e ka në Kushtetutë prandaj çdo gjë rreth sistemit juridik duhet të ketë bazën në Kushtetutë. Më pas kemi përgjigje që është tejet me rëndësi dhe në mënyrë kronologjike e mendura nga responentët se reformimin në aspektin praktik do ta ketë Kosova me nxjerrjen e ligjeve të reja të cilat do të jenë në harmoni të plotë me Kushtetutën e vendit dhe në funksion të reformimit, zhvillimit dhe reformimit të sistemit juridik. Nga të dhënat e grafikut nuk kemi përgjigje me numër të lartë të përqindjeve për pyetjet zëvendësimi të ligjeve të ish-sistemit juridik të Jugosllavisë dhe Serbisë dhe zëvendësimi të rregulloreve të UNMIK-ut me Ligje të Republikës së Kosovës. Me këto responentet nuk e konsiderojnë se reformimi i sistemit juridik bëhet përmes zëvendësimi të ligjeve të ish-sistemit juridik të Jugosllavisë, Serbisë dhe zëvendësimi të rregulloreve të UNMIK-ut me Ligje të Republikës së Kosovës. Kjo është në harmoni edhe me aspektin praktik për faktin se nuk mund të ketë reformim duke bërë vetëm nxjerrjen e ligjeve dhe zëvendësimin e tyre me ligje të reja, po baza e reformës është në atë që përcakton Kushtetuta e Kosovës e cila në detaje ka paraparë ndërtimin, kompetencën dhe fushëveprimtarin e mekanizmave shtetëror të cilët më pas janë në funksion të reformimit, ndërtimit dhe zhvillimit të sistemit juridik si një mekanizëm i shtetit të Kosovës.

Nga ajo që është cekur në këta dy grafikë përmes përgjigjeve të responentëve e në harmoni me arsyetimin shkencor, teorik dhe praktik, mendoj se sistemi juridik i Kosovës pas vitit 2008 e ka piken fillestare të ndërtimit, reformimit dhe orientimit të tij të qartë nga momenti i miratimit të Kushtetutës së Kosovës duke pasur më pas me nxjerrjen e ligjeve të reja të cilët kanë mbuluar fusha të pa mbuluara gjëra në atë kohë dhe zëvendësimin e ligjeve dhe rregulloreve nga ish sistemi juridik Jugosllav dhe ai i UNMIK-ut.




Përgjigjet e dhëna nga respondentët për pyetjen: “*Sa është i reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me standartet e BE-së?*”, na ofrohen përgjigje me këto përqindje si: Plotësisht 8%, Pjesërisht 60%, Pak 26% dhe Aspak 6%.

Nga vlerësimi i bërë përqindjeve në përgjigjet e dhëna nga respondentët, del se përgjigjja Pjesërisht ka përqindjen më të lartë, nga përgjigjja Pak me përqindje jo shumë të lartë, ndërsa dy përgjigjet tjera Plotësisht dhe Pak kanë përqindje shumë të ulët që nuk mund të merren si përqindje e mjaftueshme për t’u kualifikuar si mendim i shumicës së respondentëve. Përgjigjja Pjesërisht dhe Pak përfaqësojnë përqindjen më të lartë të mendimit të respondentëve dhe mund të kualifikohen përgjigje mbi të cilat do të ndërtohet mendimi përfundimtar për pyetjen në këtë grafik.

Orientimi i Kosovës është BE-ja si një vler ku gërshetohen vlerat e cdo fushe të jetës dhe asaj të drejtësisë, barazisë dhe të drejtave të njëriut. Duke pasur synim vlerat e BE-së, është e natyrshme që Kosova duhet të jetë në relacion me plotësimin e kushteve dhe standarteve që i ka të përcaktuara BE-ja për shtetet që synojn. Në kuadër të standarteve dhe kushteve një pjesë i referohet edhe sistemit juridik i cili duhet të jetë në harmoni me kushtet dhe standartet e BE-së për të pasur mundësi të kualifikohet si vend kandidat dhe kandidat potencial që në fund mu gershetu me të qenurit pjesë e BE-së me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që janë të përcaktuara për shtetet anëtare. Edhe pse ka pasur angazhime konkrete në funksion të reformimit, ndërtimit të sistemit juridik nga shteti i Kosovës konform standarteve të BE-së, për të qenë në relacion me kushtet që i kërkon BE-ja për shtete që synojn anëtarësimin, nga ky hulumtim na derivojnë rezultate se pjesërisht është i reformuar sistemi juridik i


Kosovës në pajtim me standartet e BE-së dhe kjo është 60 % e respondentëve. Nëse i analizojmë përqindjet e përgjigjies plotësisht që është 8 % dhe asaj Pjesërisht 60 % është një dallim tejet i madhe dhe kjo na orienton tek mendimi se kemi një përqindje shumë të ulët që mendojnë se sistemi juridik është i reformuar sipas standarteve të BE-së ndërsa kemi një përqindje tejet të madhe që mendojnë se pjesërisht është i reformuar sistemi juridik në pajtim me standartet e BE-së. Në krahasim me këto dy përgjigje, përgjigjia pak me 26 % është shumë që nuk mund të konsiderohet e ulët, për faktin se kemi ¼ e respondentëve që ndajnë një mendim se pak është i reformuar sistemi juridik në pajtim me standartet e BE-së.

Në relacion me të dhënat e këtij grafikoni e në harmoni me gjendjen faktike mendojmë se sistemi juridik i Kosovës është i orientuar drejt vlerave dhe standarteve të BE-së, për faktin se ky është synimi i shtetit dhe popullit të Kosovës. Sai i përket sistemit juridik nuk mund të kualifikohet se është në harmoni të plotë me standartet dhe kushtet e BE-së, kete po e dëshmon edhe rezultati i këtij grafikoni i në të cilin kemi përgjigje nga respondent profesional, përgjegjës dhe njohës të sistemit. Nga ajo që pasqyrohet me këtë hulumtim e në harmoni me gjendjen faktike, mendojmë se sistemi juridik i Kosovës këron ende reformim dhe zhvillim për tu kualifikuar pjesërisht i reformuar, andaj kërkohet ende kohë dhe angazhim që të jetë i reformuar që më pas të jetë në funksion të integritimit në BE.



Kur analizohen përqindjet individuale të çdo kategorie të respondentëve, na ofrohen të dhëna se përqindja më e lartë është për përgjigjen Pjesërisht, nga të gjithë respondentët e pasuar me përqindje mesatare për përgjigjen Pak dhe në minimum për dy përgjigjet tjera Plotësisht dhe Aspak.

Duke u bazuar në përqindjet që janë të cekura në grafikonin 5, përqindja më e lartë është për përgjigjen Pjesërisht dhe Pak, i cili mund të kualifikohet se përfaqëson mendimin e shumicës së respondentëve dhe mund të merret si mendim i unifikuar për këtë pyetje nga të gjithë respondentët. Nga kjo mund të konstatojmë se sistemi juridik i Kosovës kërkon ende reformim që të kualifikohet se është pjesërisht i reformuar në pajtim me standardet e BE-së. Dhe kjo është indikacion se sistemi juridik i Kosovës nuk është në harmoni të plotë me standardet e BE-së. Duke u bazuar në këtë konstatim dhe orientimet e shtetit të Kosovës për në BE, duhet që të kemi reformim të sistemit juridik të Kosovës me standardet e BE-së si një kusht për integrim të sigurt të Kosovës për në BE. I rëndësishëm është fakti se nga ky hulumtim përmes kësaj pyetjeje, kemi nxjerrur se sistemin juridik i Kosovës ende nuk mund të kualifikohet se është pjesërisht i reformuar sipas standardeve të BE-së, prandaj është shumë i nevojshëm angazhimi për reformim që më pas të jetë në funksion të integritit të Kosovës në BE.



Përqindjet e dhëna në pyetjen “ *Sa është i reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me legjislacionin e BE-së?*” responentët ofrojnë përgjigje me këto përqindje për përgjigjet e pyetjes 6: Plotësisht 7 %, Pjesërisht 58 %, Pak 29 dhe Aspak 6%.

Nga vlerësimi i bërë përqindjeve në përgjigjet e dhëna nga responentët, na del se përgjigja e pyetjes 6 Pjesërisht ka përqindje më të lartë e pasuar, nga përgjigja Pak me përqindje jo shumë të lartë, ndërsa dy përgjigjet tjera Plotësisht dhe Pak kanë përqindje shumë të ulët që nuk mund të merret si përqindje e mjaftueshme për t’u kualifikuar si mendim i shumicës së responentëve.


Përmes këtyre të dhënave responentet bejn te njohur dy çështje tejet me rendesi dhe atë, fillimisht se sistemi juridik i Kosovës nuk është në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe së dyti kjo është një obligim që duhet ta marrin me përkushtim institucionet kompetente dhe përgjegjëse që sistemi juridik të jetë në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së. Synimi i Kosovës drejt BE-së është i bazuar në kushte dhe standarte, njëri ndër ta është edhe harmonizimi dhe reformimi i sistemit juridik dhe legjislacionit me legjislacionin e BE-së. Harmonizimi i legjislacionit është kusht themeltar që Kosova ka në raport me rrugën drejt BE-së, prandaj këto të dhëna që i ka derivuar ky hulumtim jan indikacion shumë i mirë se Kosova ka ende punë dhe angazhim për reformim të sistemit të tij juridik dhe legjislacionin konform legjislacionit të BE-së.

Kosova duke mos pasur sistemin e vete në harmoni me legjislacionin e BE-së është bazë për mos të pasur një shtet të së drejtës, kjo për faktin se legjislacioni dhe standartet ndërkombëtare krijojn bazën e të qenurit shtet i së drejtës që është në funksion të zhvillimit dhe progresit në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Këto të dhëna qesin në sipërfaqe edhe një çështje tejet me rendësi e që i referohet angazhimeve të institucioneve të vendit drejt harmonizimit të sistemit juridik dhe legjislacionit të së drejtës, që sipas kësaj nuk i bie që kan arrit të kryejn punën e tyre edhe për kundër faktit se për këtë është kemi mekanizma institucional, strategji dhe dokumente tjera që kan për obligim të realizojn parafrimin e legjislacionit dhe sistemit juridik të vendit me legjislacionin e BE-së.

Reformimi i sistemit juridik konform legjislacionit të BE-së mundëson që Kosova të përqafoj vlerat universale të cilët do të jene me refleksion në cdo fushë të jetës duke mundësuar për to të këtë zhvillim, reformim dhe avancim. Kur i referohemi këti refleksioni pozitiv kemi parasysh se efektet do të vërehen në zhvillim ekonomik, shtet të së drejtës, mirëqenie, lehtësira në të bërit bizne dhe krijim të kushteve për investime te huaja që për të cilat Kosova ka shumë nevojë të këtë zhvillim në këto fusha.

Duke i analizuar në detaje të dhënat e cekura më lartë në këtë grafikon mendoj se Kosova është larg të pasurit një sistem juridik i cili brenda vetes ka të inkorporuar standartet dhe legjislacionin e BE-së, si vlera për të cilat Kosova synon tu bashkohet. Andaj Përgjigja Pjesërisht dhe përfaqësojnë përqindjen


më të lartë të mendimit të responentëve dhe mund të kualifikohen përgjigje mbi të cilat do të ndërtohet mendimi përfundimtar për pyetjen e 6 në këtë grafikon.




Kur analizohen përqindjet individuale të çdo kategorie të responentëve, na ofrohen të dhëna se përqindja më e lartë është për përgjigjen Pjesërisht nga të gjithë responentët e pasuar me përqindje mesatare për përgjigjen Pak dhe në minimum për dy përgjigjet tjera Plotësisht dhe Aspak. Duke u bazuar në përqindjet që janë të cekura në grafikonin 6, përqindja më e lartë është për përgjigjen Pjesërisht dhe Pak, i cili mund të kualifikohet se përfaqëson mendimin e shumicës së responentëve dhe mund të merret si mendim i unifikuar për pyetjen 6.

Nga kjo del përfundimi se sistemi juridik i Kosovës është pjesërisht i reformuar në pajtim me legjislacionin e BE-së. Dhe kjo është bazë se sistemi juridik i Kosovës që bën pjesë edhe Legjislacioni i së Drejtës Civile nuk është në harmoni me Legjislacionin e BE-së dhe duhet që të reformohet në atë drejtim që të jetë në harmoni me legjislacionin e BE-së sistemi juridik dhe Legjislacioni i së Drejtës Civile.


Nga ato që pasqyrohen në këta dy grafikone, mendoj se është e qartë dhe tejet e bazuar që sistemi Juridik i Kosovës kërkon ende reform dhe atë në mënyrë të vazhdueshme duke qene në relacion me legjislacionin e BE-së, si një kusht që duhet të plotësohet nga Kosova për rrugëtimin e saj drejt BE-së. Nëse i referohemi gjendjes faktike të reformimit të sistemit juridik në Kosovë në relacion me legjislacionin e BE-së e argumenton plotësisht rezultatin që kanë gjeneruar këta dy grafikona, kjo për faktin se sot në Kosovë nuk kemi ende një shtet të së drejtës të cilin e mundëson reformimi dhe zhvillimi i sistemit juridik konform vlerave dhe legjislacionit të BE-së. Për institucionet përgjegjëse këto të dhëna do të jenë indikator që duhet të merren dhe të jenë pik referimi për të ndryshuar gjendjen dhe të reformohet sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile për të qenë në funksion të ndërtimit të shtetit të së drejtës në Kosovë.



Përgjigjet e dhëna në pyetjen “*Sa është i konsoliduar legjislacioni që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë?*” janë pasqyruar në këta dy grafikone me këto përqindje: Plotësisht 5%, Pjesërisht 53%, Pak 33% dhe Aspak 9%. Edhe grafikoni 2 i pyetjes “*Sa është i konsoliduar legjislacioni që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë?*” ofron përqindjen e çdo kategorie të respondentëve për çdo përgjigje të dhënë për pyetjen 7.




Nga të gjithë kategoritë e responentëve përqindjen më të lartë e kanë përgjigjet Pjesërisht të pasuara me përgjigjen, Pak dhe në përqindje shumë të ulët për përgjigjen Plotësisht dhe Aspak. Duke u bazuar në përqindjet në përgjigjet e dhëna në pyetjen e parashtruar, përgjigja Pjesërisht është në përqindjen më të lartë dhe tejkalon 50% të shumës së përgjithshme dhe përgjigjja Pak është afër 35% të shumës totale. Nga përqindjet e analizuar në këtë grafik, kemi mendim të shumicës së responentëve se Pjesërisht apo Pak është i konsoliduar legjislacioni që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë. Të dhënat që i pasqyrojnë grafikonet e pyetjes 7, mund të konstatojmë se legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë pjesërisht është i konsoliduar, dhe kjo në të njëjtën kohë është bazë dhe arsye që duhet të ketë konsolidim Legjislacioni i së Drejtës Civile në kuadër të sistemit juridik të Kosovës.




Nga pyetja “A janë në harmoni me standartet ndërkombëtar, mbrojtja, zhvillimi, trajtimi i marrëdhënieve juridike-civile në Kosovë?”, rrjedhin këto përqindje për këto përgjigje: PO kemi 37% ndërsa për JO 63%. Nga këto të dhëna behet e njohur fillimisht se legjislacionin e së drejtës civile i cili ka për qëllim mbrojtjen, avancimin dhe trajtimin e marrëdhënieve juridiko civile nuk është në harmoni me standartet ndërkombëtare dhe kjo e pamundëson që të ketë trajtim dhe mbrojtje të mirë të marrëdhënieve juridike civile. Më pas kjo munges e mundëson që gjatë trajtimit të marrëdhënieve juridiko civile të kemi shumë shkelje që i referohen të drejtave të njeriut, të drejtave ligjore dhe atyre kushtetuese dhe qytetari nga marrëdhënia juridike e trajtuar të pëson shumë shkelje të cilat rrjedhin si rezultat i cilësis dhe mos harmonizimit të legjislacionit të së drejtës civile me standartet ndërkombëtare. Kur ju referohemi standarteve ndërkombëtare, kemi parasysh se të njëjtat janë nga fusha e të drejtave të njeriut, ndërtimi i shtetit të së drejtës, qasjes në drejtësi, krijim të siguris juridike si dhe shtet që bazohet në vlera unoiversale të cilat i ka përqafuar bota demokratike.

Përqindja tejet e lartë që tregon mendimin e responentëve të cilët janë zbatues, hartues, të së drejtës nga fusha e së drejtës civile, e tregon se ende Kosova nuk ka një sistem juridik dhe legjislacion i cili është në relacion me vlerat ndërkombëtare edhe pse për këtë ka obligim, mirëpo kjo nuk është realizuar ende pas 10 viteve shtet. Me kete kuptohet se sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile nuk është mirë i planifikuar dhe hartuar dhe kjo pamundëson që Kosova të ketë një rrugë të qartë të ndërtimit të sistemit të saj juridik.



Edhe grafikoni që pasqyron përqindjet e çdo kategorie të respondentëve për çdo përgjigje të pyetjes 8, përqindjen më të lartë merr përgjigja JO nga të gjithë respondentët. Nga përqindja e përgjigjes Jo, në raport me atë Po, është një dallim i theksuar dhe kjo ofron kuptimin se respondentët e kanë vlerësuar se marrëdhëniet juridike në Kosovë sa i përket mbrojtjes, zhvillimit, trajtimit nuk janë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe kjo është bazë që mbrojtja, zhvillimi dhe trajtimi i marrëdhënieve juridiko-civile duhet të harmonizohen me standardet ndërkombëtare.

Unë mendoj se përgjigjet individuale të respondentëve me një përqindje tejet të lartë për përgjigjen Jo, e argumenton dhe i krijon bazë grafikoni të parë të kësaj pyetje. Kjo për faktin se respondentet janë nga lëmi të ndryshme të së drejtës, prandaj një mendim i tyre i unifikuar për këtë pyetje me përgjigjen Jo e vërteton se me te vërtet marrëdhëniet juridiko – civile ende janë largë trajtimit, mbrojtjes konform standarteve ndërkombëtare. Nga kjo ne e nxjerrim edhe një fakt se sa shkelje lindin kur nuk kemi trajtim të marrëdhënieve juridiko civile konform standarteve ndërkombëtare dhe kjo krijon situata që qytetaret obligon të kërkojnë mbrojtje për këto shkelje që ju shkaktohen nga trajtimi i marrëdhënieve juridiko civile në institucionet përgjegjëse. Në mendoj se, nga të cekurat që na derivojnë prej këtyre grafikoneve, ne krijojmë përfundim se legjislacioni i së drejtës civile duhet të ketë reform, avancim dhe zhvillim cdo here duke u bazuar në ndryshimet shoqërore dhe inkorporimin e standarteve ndërkombëtare përmes së cilave krijohet siguria për trajtim dinitoz të marrëdhënieve juridiko civile duke eliminuar cdo shkelje që do të shkaktohej palëve.




Përgjigjet e respondentëve për pyetjen “ *Cila nga pjesët e degës së të drejtës civile ka nevojë për ndryshim dhe harmonizim të legjislacionit?*” janë: E Drejta Sendore 29%, E Drejta Pronësore 41%, E Drejta e Detyrimeve 12%, E Drejta Trashëgimore 10% dhe E Drejta Familjare 8%.

Kur i referohemi përberjes së kësaj pyetje kemi te bejm me dy elemente atë të ndryshimit dhe harmonizimin e legjislacionit nga degët e së drejtës civile që është i nevojshëm të ndryshohet dhe harmonizohet, kjo na ofron përgjigje tejet me rendësi se sa është i kompletuar legjislacioni i së drejtës civile në vend. Nga këto të dhëna ne kuptojm se për cdo fush të së drejtës civile është i nevojshëm të ketë ndryshim dhe harmonizim të legjislacionit, kjo për faktin se përqindjet që prezanton ky grafikon krijojnë mendimin se janë të nevojshme këto ndryshime. Kur ju referohem mendimeve për nevojën për ndryshime dhe reformim të legjislacionit na krijohet edhe një gjendje tjetër që ka të bëjë me efikasitetin e legjislacionit për momentin duke u bazuar në nevojën që qenka për ndryshim, prandaj kjo e tregon edhe atë pjesën e trajtimit dhe mbrojtjes së marrëdhënieve juridiko civile në Kosovë që nuk është e mirë dhe krijon situata që behen shkelje nga mos kompletimi dhe reformimi i legjislacionit të së drejtës civile.

Kur i referohemi ndryshimit dhe reformimit të legjislacionit të së drejtës civile në vend, nuk duhet të kemi parasysh dhe të presim vetëm atëher kur janë identifikuar zbrastira, paqartësi dhe mungesë të dispozitave përkatëse ligjore, po reformimi dhe ndryshimi i legjislacionit të së drejtës civile duhet të konsiderohet kategori dinamike dhe të behet cdo here ndryshimi dhe reformimi i legjislacionit të së drejtës civile konform ndryshimeve shoqërore, ekonomike, sociale dhe integrues. Ndryshimi dhe reformimi i legjislacionit të së drejtës civile i realizuar mbi bazën e planifikimit dhe analizës paraprake duke qenë në hap me ndryshimet e kohës nga cdo fushë është forma më e mirë e ndryshimeve dhe reformimit, kjo për faktin se nuk krijon mundësi të krijimit të situatave dhe rasteve të shkeljeve të të drejtave të palëve si rezultat i zbrastirave ligjore apo mos reformim konform ndryshimeve në fushat shoqërore me implikim në marrëdhëniet juridiko civile në vend.

Të dhënat e gjeneruara nga ky grafikon e argumentojn pjesën tjetër të hulumtimit që i referohet nevojës për ndryshime dhe reformim në sistemin juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile në Kosovë, andaj këto të dhëna duhet të merren si referencë që ndryshimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë duhet të behet duke pas për bazë ndryshimet shoqërore, ekonomike, sociale, integrues dhe cdo vlerë që është në funksion të jetës dhe mirëqenies në Kosovë.




Edhe në përgjigjet individuale të respodentëve, përqindjen më të lartë kanë përgjigjet E Drejta Pronësore, E Drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve, E Drejta Trashëgimore dhe E Drejta Familjare. Nga përgjigjet e dhëna në dy grafikonet e pyetjes 9, shihet se janë në harmoni me njëra-tjetrën për faktin se kemi përgjigje të njëjta për përgjigjet e pyetjes. Nga përqindja e dhënë nga çdo kategori e respodenteve për çdo përgjigje, kuptojmë se çdo pjesë e së drejtës Civile ka nevojë për ndryshim dhe harmonizim. Në bazë të përqindjes, nevojë më së shumti për ndryshim dhe harmonizim nga pjesët e së Drejtës Civile ka legjislacioni nga: E Drejta Pronësore, E Drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve, E Drejta Trashëgimore dhe E Drejta Familjare.

Edhe në praktikë, marrëdhëniet juridiko-pronësore janë më komplekse dhe më problematike për faktin se nuk ka një legjislacion të reformuar dhe harmonizuar i cili do t'u përgjigjej nevojave për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile në Kosovë. Problemet dhe sfidat e trajtimit të drejtave pronësore në Kosovë janë të shumta dhe këto krijojnë bazën që duhet të trajtohen me prioritet dhe të rregullohen në mënyrë të mirë për të eliminuar qfardo shkelje të të drejtave të njëriut. Në gjendje më të mirë nuk janë të rregulluara as të drejtat sendore me legjislacion përkatës që do të mundësonin që kjo fushë e së drejtës të jetë e rregulluar plotësisht. Të dhënat statistikore në këta grafikone janë në harmoni me gjendjen faktike edhe sa i përket tri fushave tjera, të cilat e kanë të nevojshëm reformimin dhe

harmonizimin e legjislacionit të tyre për t'u konsideruar se janë të rregulluara me legjislacion të kompletuar dhe reformuar.

Nga të dhënat e pasqyruara në këta grafikone dhe gjendja faktike që mbretëron, mendoj se legjislacioni i së Drejtës Pronësore, të Drejtës Sendore, të Drejtës së Detyrimeve, të Drejtës Trashëgimore si dhe ai i dhe ai i të Drejtës Familjare, është i nevojshëm që të ndryshohet, reformohet dhe harmonizohet në vazhdimësi duke qene kjo një kategori dinamike duke inkorporuar ndryshimet shoqërore, ekonomike, sociale dhe integruese, kjo pasi mundëson që të ketë trajtim të marëdhënieve juridiko civile duke u bazuar në vlera nga një shtet i së drejtës ku respektohen lirit dhe të drejtat e njëriut. Kjo do të arrin efektin dhe qëllimin që marrëdhëniet juridiko- civile të kenë rregullim dhe trajtim adekuat me dispozita përkatëse ligjore që do të mundësonin realizim, mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile duke eleminuar cdo shkelje eventuale.




Përgjigjet e dhëna në pyetjen “ A ekzistojnë zbrazëtira ligjore në legjislacionin e së drejtës civile ?”, ofrohen këto përqindje në këto përgjigje: Jo 4%, Po 96%, Nëse po, në cilën fushë të së drejtës E Drejta Pronësore 34 %, E Drejta Sendore 20%, E Drejta e Detyrimeve 18%, E Drejta Trashëgimore 17% dhe E Drejta Familjare 11%.

E rëndësishme të ceket është fakti se ky hulumtim na nxjerr në pah se në legjislacionin e së drejtës civile ekziston zbrastira ligjore duke pri me përqindje mëtë lartë pjesa e së drejtës pronësore. Me këtë konstatohet dhe argumentohet se e drejta pronësore edhe në aspektin praktik e ka dëshmuar se nuk është mjaft e mbuluar me dispozita përkatëse ligjore që do të mundësonin të këtë relaizim dhe mbrojtje juridike të të drejtave nga marëdhëniet juridiko pronësore. Me kete argumentohet edhe fakti tjetër se shumë probleme pronësore në Kosovë burimin e kanë në mungesën e dispozitave përkatëse ligjore dhe kjo krijon shkelje tek palët kur kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të tyre juridiko pronësore. Në gjendje jo të mirë sa i përket zbrastirave ligjore nuk janë as të drejtat tjera nga fusha e së drejtës civile, ngase përqindjet e tregojn se edhe tek ato të drejta kemi ubrastira ligjore e të cilat shkaktojnë shkelje të të drejtave nga marëdhëniet juridiko civile.

Zbrastirat ligjore të cekura në këtë grafik, e tregojn edhe mungesën e planifikimit, analizës dhe reformimit të legjislacionit me qëllim të eliminimit të zbrastirave ligjore në këto fusha të së drejtës civile. Ajo që duhet të vendoset në trajtim tek kjo pjesë ka të bëjë edhe me qasjen pasive ndaj ndryshimeve në Kosovë e të cilat kanë qenë me refleksion edhe në legjislacionin e së drejtës civile. Duke u bazuar se marëdhëniet juridiko civile janë marëdhënie njerëzore po të rregulluara me dispozita përkatëse ligjore, duhet të vlerësohen dhe konsiderohen cdo here si kategori dinamike që duhet të përcjellen me analiza dhe reformim të legjislacionit për të eliminuar zbrastirat dhe shkeljet e të drejtave pronësore, trashëgimore, familjare dhe ato nga marëdhënia detyrimore.

Unë mendoj se këto të dhëna të paraqitur në këtë grafik e pasqyrojnë në mënyrë më të mirë të gjendjen faktike dhe kësaj kur i shton faktin se kategoria e respondentëve është nga fusha të ndryshme të së drejtës dhe në fund kemi mendim nga kandëveshtrime të ndryshme e i cili është i njëjt nga të gjithë na krijojnë sigurinë që legjislacioni i cdo fushe të së drejtës civile duhet të ndryshohet dhe reformohet, për të qenë në funksion të kompletimit të sistemit juridik në vend.




Edhe në grafikonin ku pasqyrohen përqindjet individuale të çdo kategorie të respondentëve për çdo përgjigje, fillimisht kemi përqindje të ulët për përgjigjen Jo, ndërsa shumë të lartë për përgjigjen PO, ndërsa për përgjigjet për fushat e së drejtës me përqindje më të lartë është E Drejta Pronësore dhe vazhdon deri te E Drejta Familjare me diferenca mes tyre jo edhe shumë të larta.

Përqindjet e pasqyruara në këta dy grafikonë, na japin të kuptojmë se ekzistojnë zbrazëtira ligjore në legjislacionin e së drejtës civile dhe mendimi unanim i respondentëve është se më së shumti zbrazëtira ligjore ka te legjislacioni i së Drejtës Pronësore të pasuar nga E Drejta Sendore dhe E Drejta e Detyrimeve, ndërsa tek E Drejta Trashëgimore dhe E Drejta Familjare është përqindje jo edhe shumë e lartë. Nga këto përqindje të këto përgjigje mund të konstatojmë se duhet të ketë plotësim, ndryshim dhe reformim të legjislacionit tek ato fusha të së drejtës civile që cekën në këto grafikone për të eliminuar zbrazëtirën e dispozitave përkatëse që janë të nevojshme për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile.

Identifikimi i zbrazëtirave ligjore nga respondentët të fushat e së drejtës civile, jep të kuptohet se jo në mënyrën e duhur dhe të kompletuar janë të rregulluara marrëdhëniet juridiko-civile në Republikën e Kosovës dhe kjo qytetarëve iu pamundëson që t'i mbrojnë dhe kërkojnë të drejtat e tyre nga marrëdhëniet juridiko-civile.

Këto të dhëna nga ky grafikon duhet të trajtohen nga kandëveshtrimi shkencor, praktik dhe ai funksional, kjo për faktin se duke i trajtuar në këtë mënyre, arrim të kuptojm sa e kemi të zhvilluar shkencën juridiko civile në Kosovë, cfar cilësie të legjislacionit të së drejtës civile kemi dhe sa i plotëson standartet për të siguruar trajtim dh embrojtje të të drejtave nga marëdhenuiet juridiko civile. Ndërsa në aspektin funksional, në cfar funksioni do të kemi zbrastirat ligjore, në atë të shkeljeve të të drejtave të palëve dhe pamundësin e qasjes në drejtësi. Prandaj këto të dhëna nuk mund të trajtohen ndaras nga gjendja faktike në vend sa i përket mbrojtjes dhe trajtimit të marëdhenuieve juridiko civile në Kosovë, kjo për faktin se nga kjo gjendje që na gjenerojn këto përgjigje kuptojm se kemi shkelje të shumta për gjat trajtimit të marëdhenuieve juridiko civile në Kosovë dhe kjo është tejet shqetësuese për faktin se një gjendje e till nuk isha dashur të ekzistoj dhe të paktën jo kaq gjat pas konstituimit të shtetit të Kosovës.



Përgjigje nga respondentët kemi edhe në pyetjen “ *A ekziston duplikimi i dispozitave ligjore në legjislacionin e së drejtës civile?* ” dhe atë me këtë përqindje Jo 21, Po Nëse po, në cilën fushë të së drejtës 79%; E Drejta Pronësore 26%; E Drejta Sendore 24%; E Drejta e Detyrimeve 23%; E Drejta Trashëgimore 14% dhe E Drejta Familjare 13%.


Përmes kësaj pyetje respondentëve ju ofrohet mundësia që të shprehin mendimin e tyre të bazuar në ato që janë ballafaquar gjatë praktikës së zbatimit të legjislacionit të fushës së të Drejtës civile lidhur me ekzistimin e duplikimit të dispozitave ligjore. Nga ajo që na pasqyron ky grafikon është numër shumë i lartë i respondentëve që kanë mendimin se ekziston duplikim i dispozitave ligjore në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile. Kjo është tejet me rëndësi për faktin se kemi një konstatim nga respondentet se ekziston duplikimi, kjo është me rëndësi që këtë konstatim e kemi nga respondentët që vijnë nga fusha të ndryshme të sistemit të drejtësisë. Duke analizuar duplikimin e normave juridik me mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile shohim se në qfarë niveli janë mbrojtja e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile, kjo pasi gjatë trajtimit të këtyre të drejtave ka çdo herë hamendje, paqartësi dhe mos zbatim të sakt të dispozitave përkatëse ligjore për rastet konkrete nga marrëdhëniet juridiko civile. Anadaj me këtë behet e njohur se nuk mund të kemi mbrojtje, avancim dhe trajtim të mirë të marrëdhënieve juridiko civile, ku do të reflektohet ligjshmëria, mbrojtja e te

drejtave te njeriut, standartet nderkombetare qe mundesojn te ketë mbrojtje të të drejtave nga marëdhëniet juridiko civile në formën dhe mënyrën ligjore.

Kur ju referohemi përqindjes së përgjigjiev për cdo të drejtë, shihet se e Drejta Pronësore është ajo që ka më së shumti duplifikim të dispozitave ligjore. Kete qe e pasqyron për të drejtën pronësore ky grafikon është në relacion me gjendjen faktike sa i përket trajtimit të marëdhënieve pronësore juridike, kjo pasi praktiak dhe cilësia e trajtimit të marëdhënieve pronësoro juridike që nuk janë të nivelit të duhur sic ish dashur të jenë. Një situat të ngjashme kemi edhe tek e Drejta Sendore, tek të cilat ka duplifikim të dispozitave ligjore dhe nga kjo rrjedhimisht kemi ngecje dhe jo trajtim te mire ne praktik sa i përket këtyre te drejtave pasi kjo nuk e mundëson duke pasur duplifikim te dispozitave e te cilat ne zbatim nuk mundesojn te kete zbatim të sakt të së drejtës. Ajo që nuk është në gjendje të mirë është edhe E Drejta e Detyrimeve për të cilën ekziston përqindje e lartë e mendimeve se posedojn duplifikim të dispozitave. Duke pasur duplifikim, kemi te bejm me marëdhënie jo të mirë të rregullimit të marëdhënieve të detyrimev. Ajo që ka refleksion nga kjo gjendje është ndikimi në investime të huaja, siguri juridike në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, qasje në drejtësi dhe ekzekutim të kontratave. Ajo që duhet të theksohet është fakti se duke pasur duplifikim të dispozitave ligjore nga marëdhëniet e detyrimeve do të ketë refleksion në kualifikimin e mungesës se reformimit të sistemit juridik të Kosovës. Me përqindje më të ulët sa i përket duplifikimit të dispozitave në të Drejten Trashëgimore dhe atë në të Drejten Familjare, po edhe tek këto të drejta janë të theksuara edhe pse jo në atë numër sa janë tek te drejtat tjera në kuadër të fushës së të drejtës civile. Ekzistimi i duplifikimi të dispozitave ligjore tek këto dy të drejta, do të reflektojn në krijimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave familjare dhe ato trashëgimore e të cilat janë tejet me rendësi për zhvillimin e familjes, dhe qarkullimin juridik të të drejtave trashëgimore.

Duke u bazuar në ato që ka gjeneruar kjo pyetje të pasqyruara në ketë grafikon e ne harmoni dhe analiz me gjendjen faktike në sistemin juridik, mendoj seekzistimi i duplifikimit të dispozitave juridike në legjislacionin e së drejtës civile ka efekt negativ në sigurin juridike dhe cilësin e gjykimeve kur ju referohemi mbrojtjes së të drejtave nga marëdhënievet juridiko civile, tek qasja në drejtësi që është një e drejt thelbësore dhe ajo që është tejet me rendësi krijimi i shtetit të së drejtës. Pra me duplifikim të dispozitave ligjore tregon se nuk kemi një sistem juridik të reformuar nga i cili janë eliminuar cdo paqartësi, duplifikim, zbrastir që do të mundësonte të kemi një shtet të së drejtës dhe në funksion të së drejtës për qytetarët e vendit. Kjo situat e krijuar me duplifikim, është indikacion që do duhet të jetë referim për institucionet që të ketë reformim dhe avancim të sistemit juridik duke eliminuar duplifikimin.


**Respodentet dhe pergjigjet e dhena ne pyetjen
11**



Në çdo përgjigje të çdo kategorie të respodentëve pasqyrohet mendimi se për përgjigjen Jo nga të gjithë respodentët kemi përqindje shumë të ulët, ndërsa për përgjigjen Po, kemi përqindje shumë të lartë dhe e specifikuar në fushat e së drejtës siç ceken më lart me përqindje më të lartë për Të Drejtën Pronësore të pasuar nga E Drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve, e Drejta Trashëgimore dhe ajo Familjare.

Nga të dhënat e pasqyruara në këta grafikon, fillimisht bëhet e njohur se në legjislacionin e së Drejtës Civile kemi duplikim të dispozitave ligjore dhe kjo brenda legjislacionit të fushës dhe atë mes fushave të së drejtës civile. Duplikimi i dispozitave ligjore fillimisht krijon paqartësi dhe pasiguri juridike për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile. Duplikimi i dispozitave është e vështirë edhe për zbatuesit e legjislacionit kjo për faktin se marrëdhëniet juridiko-civile duhet të jenë të përcaktuara qartë me dispozita ligjore që në rastet e zbatimit të dispozitave ligjore mos të ketë hamendje, por aplikim të saktë të dispozitës përkatëse ligjore për të drejtën përkatëse nga marrëdhëniet juridiko-civile. Këto të dhëna në këtë grafikon na pasqyrojnë gjendjen me reale, kjo pasi nga të gjithë respodentët kemi mendime përafërsisht të njëjta dhe kjo e tregon se mendimi për duplikim është unanimit dhe pasqyron mendimin e përgjithshëm objektiv lidhur me këtë çështje.

Të dhënat që i pasqyron ky grafik, na ben te njohur se nga të gjithë respondentet kemi mendime përafërsisht të njëjta dhe kur kësaj i shton faktin se respondentet janë nga fusha të ndryshme të së drejtës na bene të kemi të dhëna tejet të sakta për këtë poyetje që janë pasqyruar në këtë grafik. Nga këto të cekura mendoj se këto të dhëna nga kyjo kategori e respondentëve për shkencën, praktiken, politikberjen jan me rendësi nga të cilat mund të trajtohen duke rregulluar ato që janë cekur si duplifikime.



Mendim nga respondentët të pasqyruara në përgjigjet e dhëna në këta grafik, kemi edhe për pyetjen: *“A ekzistojnë dispozita të paqarta në legjislacionin e së drejtës civile?”*, ku për përgjigjen JO 8%; PO, Nëse po, në cilën fushë të së drejtës 92%, E Drejta Pronësore 74%; E Drejta Sendore 65%; E Drejta e Detyrimeve 59%; E Drejta Trashëgimore 39% dhe E Drejta Familjare 31%. Edhe përgjigjet individuale të çdo kategorie të respondentëve pasqyrojnë mendimin se ekzistojnë dispozita të paqarta në legjislacionin e së drejtës civile duke i dhëne përqindje më të lartë dhe më të ulët përgjigjeve siç ceken në grafikonet për pyetjen 12.

Te pasurit dispozita të paqarta në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile krijon munges të siguris juridike në trajtimin e marëdhënieve juridiko civile e të cilat janë tejet të shumta dhe me nje rendësi të madhe për zhvillimin ekonomiko sociale në vend. Duke pasur dispozita të paqarta, ndikon drejtpërdrejt në krijimin e hamendsis te qytetarët se marëdhëniet e caktuara juridike nga fusha juridiko Civile a

mund të mbrohen në kuadër të sistemit gjyqësor të vendit. Kjo hamendesi për qytetarët si rezultat i paqartësive në legjislacion mund tu shkaktoj dëme qytetarëve në realizimin dhe mbrojtjen e marëdhënieve juridiko civile.

Paqartësit në dispozitat e legjislacionit të së drejtës civile, kanë efekt edhe tek institucionet dhe zyrtarët përgjegjës që zbatojnë këtë legjislacion, kjo në veçanti i referohet sistemit gjyqësor që kjo ju krijon situatë tejet komplekse, për faktin se gjykimi i rasteve nga marëdhëniet juridiko civile, kërkon përshtatje me normën konkrete. Te qenurit norma të paqarta gjyqëtarit i krojon shumë probleme në zbatimin e saj, kjo pasi gjyqtari duhet që të jetë i sakt dhe tejet profesional në zbatimin e normës konkrete për kontestin përkatës. Duke pasur norma të paqarta mundëson që mos të ketë zbatim të së drejtës, gjykim në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi dhe krijim të besimit në sistemin gjyqësor si një segment tejet me rendësi. Nga ato që i ka gjeneruar ky grafik dhe gjendjes faktike që është prezent në sistemin gjyqësor dhe institucionet tjera zbatuese të legjislacionit të së drejtës civile, mund të konstatojmë se nuk kemi një legjislacion të qartë, preciz dhe të sakt, po kryesisht ka paqartësi dhe nuk mundëson të ketë zbatim të sakt dhe konkret për kontestet dhe kërkesat e ngritura nga palët. Andaj nga këto të cekura, mendoj se këto të dhëna duhet të jenë pikë referimi për institucionet përgjegjëse dhe kompetente që të eliminojnë paqartësinë në dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi nga e drejta civile dhe gjatë hartimit të legjislacionit të kenë parasysh që mos të mbeten dispozita të paqarta pasi këto nuk mund të zbatohen më pas nuk kemi shtet të së drejtës i cili do të mundëson qytetarëve të Kosovës mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre nga marëdhëniet juridiko civile. Eliminimi i paqartësive në dispozitat e legjislacionit të së drejtës civile është kusht që duhet të plotësohet nga Kosova para se të fillojë procesin e integritimit dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare që do të siguronin investimet e huaja në Kosovë dhe lehtësira në të bërit biznes. Kjo gjendje sa i përket legjislacionit duhet të shifet si detyrë që duhet të kryhet nga institucionet përgjegjëse.

Kur ju referohemi fushave të së drejtës civile, ajo që më së shumti rezulton nga ky hulumtim se ka paqartësi janë dispozitat ligjore të së Drejtës Pronësore me 74%. Kjo përqindje është tejet e lartë dhe tregon se ky legjislacion ka probleme serioze sa i përket paqartësive. Paqartësit në legjislacionin e kësaj fushe të së drejtës civile, rezulton me probleme praktike sa i përket trajtimit, mbrojtjes, kërkesave dhe gjykimit për të drejtat pronësore. Kur ju referohemi në aspektin praktik problemeve pronësore në Kosovë e argumenton këtë përqindje të mendimit të respondentëve në këtë hulumtim që kanë dhënë lidhur me paqartësit që ka ky legjislacion. Nëse ju referohemi problemeve, sfidave, vështërsive, dhe shumë qka tjetër tek marëdhëniet pronësore në Kosovë të njëjtat janë tejet të pa zhvilluara dhe të pa reformuara karshi kërkesave dhe reformave në sfera tjera të jetës shoqërore në Kosovë. Nga kjo që


gjenron ky hulumtim për këtë, na del se një kontribut për marrëdhëniet pronësore në Kosovë sic janë në Kosovë japin kontribut paqartësisë e dispozitave ligjore të kësaj fushe. Andaj për të pasur marrëdhënie juridik pronësore të rregulluara mirë në Kosovë, duhet që të eliminohen paqartësitë në dispozitat ligjore që i referohen kësaj kategorie dhe të këtë reformim të tyre duke qenë në hap me zhvillimet dhe reformat në sferat tjera shoqërore.

Gjendje të njëjtë kemi edhe tek dispozitat përkatëse ligjore që i referohen të Drejtës Sendore me përqindje 65%. Nga kjo shifet se edhe te Drejtat Sendore ka paqartësi në dispozitat përkatëse ligjore që i rregullojnë këto të drejta. Duke mos i pasur të qarta këtodispozita ligjore, refleksioni është direkt në kërkesat, mbrojtjet e të drejtave sendore si pjesë tejet me rëndësi në marrëdhëniet juridiko civile. Andaj këto të dhëna në këtë hulumtim duhet të shikohen si arsyetim për të konstatuar se legjislacionin që i rregullon të drejtat sendore nuk është i qartë dhe i kuptueshëm për të pasur mundësi të zbatohet sakt dhe në mënyrë të drejtë. Nga kjo që potencohet nuk mund të kemi mendim ndryshe pos që të këtë vlerësim real të këtij legjislacioni dhe të eliminohen në tërësi cdo paqartësi, për të pasur një legjislacion që do të ishte në funksion të shtetit të së drejtës me fokus mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave nga marrëdhëniet juridikiko civile.

Kur ju referohemi paqartësive në dispozitat e legjislacionit, nuk mbeten anash edhe ato të së Drejtës së Detyrimeve, ku përqindjet e respondentëve janë 59%. Kjo është shuëm tejet e lartë dhe tregon se gjendja në këtë legjislacion nuk është e mirë dhe niveli i paqartësive në dispozita është tejet serioz dhe krijon urgjentisht eliminimin e tyre. Në pasuritë në kuadër të sistemit juridik, dispozita të paqarta, kjo nuk mundëson që të kualifikohet se kemi sistem juridik të reformuar dhe të avancuar, por me defekte si rezultat i paqartësive në kuadër të dispozitave ligjore. Ajo që është prezent në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet detyimore, me bind se edhe këtë legjislacion duhet që të vlerësohet në detaje dhe të eliminohen këto paqartësi që nuk mundësojnë mbrojtje dhe avancim të marrëdhënieve detyimore mes subjekteve të së drejtës.


Paqartësi shifet se ka edhe në dispozitat e legjislacionit të së Drejtës Trashëgimore ku mendimi i respondentëve është 39% dhe në atë të së Drejtës Familjare me përqindje të respondentëve 31%. Në këto të drejta nuk mund të kualifikohet se ka nivel të lartë të paqartësive, këtë e dëshmojnë edhe përqindjet e përgjigjive të respondentëve që nuk janë të larta. Po si do që të këtë kemi mendim se edhe në këto të drejta ka dhe të njëjtat nuk mund të kualifikohet se nuk kanë refleksion në mbrojtjen e të drejtave trashëgimore dhe familjare. Andaj në kuadër të vlersimit dhe ndryshimit për eliminim të dispozitave të paqarta në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile, duhet që të nënshtrohet edhe ai i të Drejtës Trashëgimore dhe asaj Familjare.

**Respodentet dhe pergjigjet e dhena ne pyetjen
12**



Pas këtyre përgjigjeve mund të konstatojmë se, kemi të dhëna me përqindje të lartë dhe dalluese dhe më këtë kuptojmë se në legjislacionin e së drejtës civile ekzistojnë dispozita të paqarta në legjislacionin e së drejtës civile dhe kjo është bazë që legjislacioni i së drejtës civile duhet të vlerësohet dhe të eliminohen dispozitat e paqarta, kjo për faktin se eliminimi i dispozitave të paqarta në legjislacionin e së drejtës civile, do të mundësojë zbatuesve që në rastet kur vendosin për të drejtat nga marrëdhëniet juridiko-civile mos të kenë situatë që të aplikojnë dispozitë që nuk është e përshtatshme për rastin konkret nga marrëdhëniet juridiko-civile.

Në këtë grafikun, na paraqiten mendimet e cdo kategorie të respodentëve lidhur me pyetjen “A ekzistojnë dispozita të paqarta në legjislacionin e së drejtës civile?”, nga të dhënat që na gjeneron ky grafikun, kuptojmë se të gjithë respodentet kanë mendim të unifikuar sa i përket përgjigjeve. Nga kjo behet e njohur se të gjithë respodentet kanë mendim të njejtë sa i përket ekzistimit të paqartësive në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile. Një mendim i tillë është tejet real dhe shumë mirë i argumentuar për faktin se kategoria e respodentëve është tejet mikse dhe nga fusha të ndryshme të së drejtës, andaj mendimi që rrjedh nga këta është i bazuar në praktikë dhe nga fusha të ndryshme, prandaj këto të dhëna janë tejet me rëndësi dhe shumë reale që pasqyrojnë gjendjen faktike. Këto të dhëna duhet të shifin si shumë të rëndësishme dhe mbi bazën e tyre të ketë analizë, vlerësim dhe më pas plotësim ndryshim të legjislacionit të së drejtës civile me qëllim të eliminimit të paqartësive, reformimit dhe avancimit për të qenën në hap me ndryshimet shoqërore dhe vlerat universale.




Responentët me përqindje dalluese kanë dhënë përgjigje edhe në pyetjen: “A ekzistojnë norma kundërthënëse (çështje të njëjta rregullohen në mënyrë të ndryshme) në legjislacionin e së drejtës civile?”, për JO 17%; PO Nëse po, në mes te cilit legjislacion 83%; E Drejta Pronësore 94%; E Drejta Sendore 87%; E Drejta e Detyrimeve 68%; E Drejta Trashëgimore 47% dhe E Drejta Familjare 40%.

Duke ju referuar këtyre të dhënave që i gjeneron ky grafik, ne kuptojmë se në legjislacionin e së drejtës civile përpos paqartësive janë prezent edhe norma kundërthënëse mes vete dhe kjo e bën legjislacionin tejet problematik që të zbatohet. Duke pasur dispozita kundërthënëse fillimisht për palët dhe ato subjekte të së drejtës që mendojnë ti kërkojnë apo mbrojnë të drejtat e tyre nga marëdhëniet juridiko civile ju krijon hamendje dhe mos siguri juridike gjeqë është tejet shqetësuese për të drejtat e qytetarit. Me një gjendje të tillë në legjislacionin e së drejtës civile, problemet vazhdojnë tek organet zbatuese të këti legjislacioni që janë gjykatat, avokatia, noteria, përmbarimi privat dhe ndërmjetësimi. Problemi në zbatim është tejet serioz kur ekzistojnë dispozita kur një çështje e njëjtë rregullohet në mënyra të ndryshme si rezultat i normave juridike kundërthënëse mes vete. Në këto situata është tejet problematike të përcaktohet qartë norma juridike që është relevante për situatën dhe kontestin përkatës, kjo pasi në çdo moment çdo vendimmarrje mund të ankimohej dhe të jetë me bazë duke u bazuar në dispozita tjera që i referohen kësaj çështje dhe kontesti përkatës.

Nga ato përqindje që i referohen përgjigjive të respondentëve, kuptojmë se më së shumti dispozitë kundërthënëse ka e Drejta Pronësore dhe ajo Sendore dhe kjo është një arsye pse të drejtat pronësore dhe sendore në Kosovë janë në gjendje jo të mirë dhe aspak të rregulluara konform ndryshimeve shoqërore, ekonomike dhe sociale. Duke pasur një legjislacion me probleme të ndryshme që ky hulumtim e ka deshifruar, nuk mund të ketë rregullim të mirë të drejtave pronësore dhe ajre sendore. Kur shifen të gjitha këto defekte në legjislacionin e së drejtës civile dhe për këtë periudhë shumë të gjatë, kuptojmë në qfarë mënyre dhe si janë trajtuar këto të drejta dhe si kanë rezultuar tek te drejtat e qytetarëve. Një situatë jo e mirë sa i përket të pasurit norma kundërthënëse është edhe tek legjislacioni i të drejtës së Detyrimeve. Është tejet me rëndësi që të ketë dispozita të qarta, precize dhe korrekte në të drejtën e Detyrimeve, pasi kjo mundëson që të ketë siguri juridike gjatë fazës së krijimit të marrëdhënieve kontraktuese me pas gjatë trajtimit të tyre dhe në fund kur ato bëhen kontestuese. Përqindje jo shumë të lartë nga përgjigjet e respondentëve, sa i përket të pasurit norma kundërthënëse është tek legjislacioni i së Drejtës Trashëgimore dhe atë të së drejtës Familjare. Edhe në praktikë, nuk ekzistojnë probleme, vështërsi, sfida tek këto të drejta nga dispozitat kundërthënëse dhe kjo e tregon se legjislacioni i këtyre të drejtave nuk i ka problemet e të pasurit norma kundërthënëse sic janë tek të drejtat tjera të elaboruara më lartë.

Kur ju referohemi këtyre të dhënave dhe asaj që na prezantohet nga gjendja faktike, unë konstatoj se nuk posedon Kosova legjislacionin i cili nuk ka brenda vetes dispozita të paqarta, e të cilat kanë refleksion direkt në trajtimin dhe vendosjen për të drejtat nga marrëdhëniet juridiko civile. Duke pasur refleksion direkt në vendimmarrje, efekti shtrihet edhe te cilësia e vendimmarrjes dhe respektimi i të drejtave të njeriut gjatë mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile. Nga kjo situatë, unë mendoj se duhet të delet duke bërë vlerësimin e legjislacionit dhe eliminimit të çdo paqartësie, duplikimit, në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile.




Edhe në grafikonin ku pasqyrohen përqindjet në përgjigjet individuale të çdo kategorie të respondentëve, mësojmë se përqindje shumë të lartë ka përgjigja PO Nëse po, në mes te cilit legjislacion, e specifikuar me përqindje më të lartë për të Drejtën Pronësore, E Drejta Sendore, E Drejta e Detyrimeve, E Drejta Trashëgimore dhe E Drejta Familjare.

Nga të dhënat që pasqyrohen në këta grafikonë lidhur me pyetjen “A ekzistojnë norma kundërthënëse (çështje të njëjta rregullohen në mënyrë të ndryshme) në legjislacionin e së drejtës civile?”, derivon një mendim unanimit se në legjislacionin e së drejtës civile ekzistojnë norma kundërthënëse që për një çështje e njëjtë rregullohet dhe parashihet në mënyra të ndryshme.


Të qenurit fakt kjo çështje, është tejet e dëmshme për zbatuesit e legjislacionit të së drejtës civile, për faktin se marrëdhëniet juridiko-civile gjatë mbrojtjes së tyre janë të parapara në mënyra të ndryshme në kuadër të dispozitave ligjore. Kjo për zbatuesit, mbrojtësit juridik krijon hamendje gjatë aplikimit të normës përkatëse për të drejtën përkatëse nga marrëdhëniet juridiko-civile.

Këto të dhëna në këta grafikonë, janë bazë që të konstatojmë se legjislacioni i së drejtës civile të vlerësohet dhe të eliminohen normat kundërthënëse për të eliminuar situatën që një çështje e njëjtë të rregullohet në mënyrë të ndryshme. Për asnjë moment nuk duhet që sistemi juridik i Republikës së Kosovës të lejojë që legjislacioni i së drejtës civile të përmbajë dispozita kundërthënëse mes vete që në mënyra të ndryshme parashohin rregullimin e një çështje nga marrëdhëniet juridiko-civile, andaj kjo duhet të jetë në prioritet të hartuesve të legjislacionit që të bëjnë plotësim ndryshimin e legjislacionit me qëllim të eliminimit të të gjeturave nga pyetja 13 e këtij pyetësi.



Në pyetjen e parashtruar respondentëve “Sa e vështirëson realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile mungesa e dispozitave përkatëse apo kolozioni i ligjeve?”, ofrohen këto përgjigje me këtë përqindje: Plotësisht 37%; Pjesërisht 52%; Pak 10%; Aspak 2%.

Përqindjet plotësisht dhe ajo pjesërisht të gjeneruara në këtë grafikun të cilat janë të dhëna tejet korrekte dhe profesionale për faktin se vin nga respondent që i përkasin praktikës, shkencës dhe atyre që pranojnë shërbime. Duke u ndërlidhur me pyetjet dhe përgjigjet e cekura më lartë, ku na figurojnë se kemi dispozita ligjore të paqarta dhe tani na behet e njohur se kur kemi një situatë të tillë e vështërsojnë realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile. Është përqindje e madhe e respondentëve që ofrojnë përgjigje për plotësisht dhe atë pjesërisht dhe nga kjo na del gjendja se tek ato dispozita ku ka mungesë të dispozitave përkatëse apo kolizion të ligjeve vështërsohet realizimi i të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile. Kjo është e natyrshme dhe tejet korrekte, për faktin se cdo e drejtë që pretendohet e njëjta duhet të jetë e përcaktuar në dispozitë përkatëse ligjore dhe atë qartë dhe tejet preciz duke eliminuar cdo herë paqartësit, duplikimin dhe kolizionin. Unë mendoj se cdo të drejtë nga marrëdhëniet juridiko-civile duhet të përcaktohet dhe të jetë e parapar në kuadër të dispozitave përkatëse legjor, nuk mund të kualifikohet si e drejtë nëse nuk është e parapar si kategori ligjore.




Edhe në përgjigjet individuale të çdo kategorie të respondentëve, përmes grafikunit të dytë pasqyrohen përqindjet më të larta për përgjigjet Pjesërisht, Plotësisht, Pak dhe Aspak. Përgjigja Pjesërisht ka

përqindjen më të lartë e pasuar, nga përgjigja Plotësisht dhe këto përgjigje për këtë pyetje me këtë përqindje mundësojnë që të krijohet mendimi i përgjithshëm nga të gjithë kategoritë e respondentëve se mungesa e dispozitave përkatëse apo kolizioni i ligjeve në mënyrë të theksuar e vështirëson realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile.

Këto përgjigje që përfaqësojnë mendimin e respondentëve e të cilët janë zyrtarët përgjegjës që merren me hartimin, zbatimin, monitorimin e legjislacionit, na mundësojnë që të konstatojmë se marrëdhëniet juridiko-civile duhet të jenë të rregulluara me dispozita përkatëse ligjore dhe mos të kenë kolizion mes ligjeve. Kjo mundëson që marrëdhëniet juridiko-civile duhet të jenë të specifikuara në kuadër të dispozitave përkatëse ligjore që kur trajtohen marrëdhëniet juridiko-civile të gjejnë mbrojtje dhe trajtim të duhur e të bazuar në dispozita përkatëse.

Kur i analizojmë në detaje këto të dhëna nga ky grafik dhe në harmoni me kategoritë e respondentëve që vin nga profesione të ndryshme të fushës së drejtësisë kuptojmë se mendimet ngajshme kanë të gjithë respondentët që vin nga profesione të ndryshme të së drejtës. Dhe kjo e bart vlerën e vet shkencore dhe juridike për faktin se gjykimi për istemin juridik dhe për legjislacionin dhe ato që janë sfida janë të njohura për të gjithë prandaj këto të dhëna që derivojnë nga kjo pyetje kanë bazë në praktikë, shkencë dhe tek ata që pranojnë shërbime prej sistemit të drejtësisë.



Përgjigjet për pyetjen “*Legjislacioni aktual i së drejtës civile mundëson në mënyrë efikase*” derivon këto përqindje për këto përgjigje: Qasje në Drejtësi 46%: Gjykim të Drejtë 18%: Të drejtën në Pronë 12% dhe Barazi të Palëve 24%.


Ajo që na e nxjerr në shesh kjo pyetje është ajo se qfar është legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë dhe qfar mund të ofroj për qytetarët e Kosovës. Nga të dhënat kuptojm se ky legjislacion më së shumti ofron qasje në drejtësi edhe kjo nuk ka një përqindje të knaqëshme, mirëpo nuk është e tëra që isha dashur të ofroj ky legjislacion. Përqondje tejet të ulët është për gjykimin e drejtë që mundëson ky legjislacion. Kjo është tejet problematike dhe shqetësuese për faktin se kur një legjislacion nuk siguron gjykim të drejt atëher nuk mund të llogaritet se kemi të bejm me legjislacion që është në funksion të së drejtës. Kjo përqindje tejet e ulët është indikacion se këtë legjislacion nuk e kemi në atë nivel që siguron gjykim të drejt, kjo situat është e ndërlidhur me vendimmarrjen pasi gjykimi i drejt e siguron një vendimmarrje objektive dhe të bazuar në legjislacion përkatës në fuqi. Nga situata që mbretëron në Kosovë e gjeneruar përmes këti hulumtimi nuk mund të konsiderohet se ka legjislacion që është në funksion të së drejtës dhe mbrojtjes së qytetarit për marëdhenuiet juridiko civile që ai ka.

Një situat jo e mirë është edhe tek pjesa që i referohet të drejtës në pronë, duke mos e siguruar legjislacioni i së drejtës civile qasjen në pron, mund të konstatohet se nuk posedon Kosova legjislacion të kompletuar sa i përket mbrojtjes, trajtimit dhe qasjes në të drejtat pronësore. Kjo qfar na theksohet me kete hulumtim na është në relacion me gjendjen faktike sa i përket trajtimit dhe problemeve pronësore në Kosovë e të cilat janë tejet të theksuara dhe shumë komplekse pa as një reform dhe avancim brenda tyre. Mungesa në të drejtat pronësore në Kosovë është një mangësi që ka reflektim direkt në zhvillimin ekonomik, disponeshmerin me pronën, qarkullimin juridik dhe atë ekonomik të pronës. Lehtësira në investimet e huaja dhe të bërit biznes. Andaj reflektimi i kësaj është tejet i gjerë dhe me shumë ndikim për Kosovën.

Në kuadër të trajtimit të marëdhënieve juridiko pronësore është tejet me rendësi Barazia e palëve, nga kjo rrjedhin të drejtat, obligimet dhe mundësia e zgjidhjes alternative e problemeve nga marëdhëniet juridiko civile. Duke mos pasur mundësi që palët të jenë të barabarta, kjo krijon pabarazi e cila nuk mundëson trajtim, mbrojtje dhe vendosje meritore. Të qenurit të barabart palët është kusht bazik që palët duhet që ta ken, për të pasur mundësi më tutje të këtë gjykim të drejt.

Një gjendje jo e mirë në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile dhe ides se si do të duhet të jetë, më shtyn që të mendoj se kjo gjendje e legjislacionit të së drejtës civile duht që të ndryshoj për të pasur refleksion në barazin e palëve, qasje në drejtësi, gjykim të drejtë dhe të drejtën në pronë. Ndryshimi i kësaj behet duke bërë vlerësim real të gjendjes së legjislacionit, duke pas për bazë edhe problemet

praktike me propozime konkrete se ku duhet të behen ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit për të eliminuar këto mangësi që janë tejet të dëmshme.



Edhe nga përgjigjet individuale të çdo kategorie të responentëve të pasqyruara përmes grafikorit bëhet e ditur se përqindjen më të lartë kanë përgjigjet Qasje në Drejtësi të pasuara me Barazi të Palëve, Gjykim të Drejtë dhe në fund Të drejtën në Pronë.


Nëse shohim përqindjet, përqindje të lartë ka përgjigja Qasje në Drejtësi dhe kjo jep kuptim se legjislacioni aktual i së drejtës civile mundëson një gjë të tillë, e pasuar me Barazi të Palëve që në përqindje nuk është edhe shumë e lartë që të mundëson të krijohet një mendim i përgjithshëm se legjislacioni aktual i së drejtës civile mundëson një gjë të tillë.

Në bazë të përqindjeve për përgjigjen Gjykim të Drejtë dhe Të Drejtën në pronë nuk janë shifra të mjaftueshme që të krijohet mendimi i përgjithshëm se mesatarisht legjislacioni aktual i së drejtës civile mundëson në mënyrë efikase Gjykim të drejtë dhe Të Drejtën në pronë.

Përqindjet e ulëta në përgjigjet Gjykim të Drejtë dhe të Drejtën në pronë, janë indikacion që legjislacioni aktual i së drejtës civile nuk e mundëson një gjë të tillë dhe kjo është tejet serioze, kjo për

faktin se legjislacioni aktual i së drejtës civile duhet të mundësojë në mënyrë efikase të gjitha këto si: Qasje në Drejtësi, Gjykim të Drejtë, Të drejtën në Pronë dhe Barazi të Palëve.

Pa i trajtuar dhe mundësuar këto, nuk mund të kualifikohet se legjislacioni aktual i së drejtës civile është i kompletuar dhe mundëson mbrojtje të të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile. Nga këto përqindje të përgjigjeve konstatohet se legjislacioni aktual i së drejtës civile nuk mundëson në mënyrë të duhur çështje për të cilat është i krijuar dhe pikërisht është fakt se ky legjislacion duhet të vlerësohet dhe të bëhet plotësim ndryshimi duke mundësuar që të ketë gjykim të drejtë dhe të drejtën në pronë në mënyrë efikase që qytetari të ketë mundësi t'i mbroj të drejtat e tij nga marrëdhëniet juridiko-civile në mënyrë efikase sipas legjislacionit përkatës në fuqi e i cili i garanton një gjë të tillë. Legjislacioni i së drejtës civile duhet që të arrij qëllimin për të cilin krijohet duke filluar qysh nga qasja në drejtësi, gjykim të drejtë, të drejtën në Pronë dhe barazi të palëve.



Pyetja “ *Sistemi Juridik në Kosovë mund të reformohet me:* ”, merr këto përqindje nga responentët për këto përgjigje: Ndryshimin e Kushtetutës 17%; Ndryshimin e Legjislacionit 36%; Përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së 15%, Pushimin e së funksionuarit të legjislacionit të ish-sistemit


jugosllav dhe atij të UNMIK-ut 2%; Zbatimin e Legjislacionit aktual 4%; Reformimin e sistemit gjyqësor 12%; Ngritjen e kapaciteteve në zbatim të legjislacionit 6% dhe Monitorimin e zbatimit të legjislacionit 8%.

Ate që e pasqyron ky grafik, është tejet me rëndësi nga se përmes këtyre të dhënave na ben te njohur se sistemi juridik i Kosovës është i nevojshëm të reformohet dhe sipas këtyre të dhënave ky mund të behet përmes ndryshimit të legjislacionit si përgjigjia që ka përqindjen më të lartë nga respondentët. Ndërsa përgjigjet tjera nuk kanë marr përqindje të mjaftueshmë të respondentëve për tu konsideruar se jan me rëndësi në reformimin e sistemit juridik të Kosovës. Atë që e pasqyron ky grafik e ne veqanti atë që i referohet ndryshimit të legjislacionit mund të merret pik referimi se ku duhet të jetë koncentrimi për reformim të sistemit juridik të Kosovës.

Keto te dhëna sa i përket reformimit të sistemit juridik që është nga ndryshimi i legjislacionit jan në relacion edhe me aspektin praktik dhe funksional, kjo për faktin se sistemin juridik e përben legjislacioni që është në fuqi i cili zbatohet, prandaj edhe reformimi dhe ndryshimi varen direkt nga ndryshimi i legjislacionit. Duke ndryshuar legjislacionin, vije deri të reformimi i sistemit juridik i cili më pas mundëson krijimin e shtetit të së drejtës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë dhe ato që i ka gjeneruar ky grafik, konstatohet se fokusi dhe objektivi duhet që të jetë ndryshimi dhe reformimi i sistemit juridik për të reflektuar te reformimi i sistemit juridik. Përpos kësaj, nuk mund të konstatohet se ne menyre direkte do të kenë ndikim në reformim të sistemit juridik po në mënyre indirekte mund të ndikojn në reformimin të sistemit juridik edhe ndryshimet Kushtetuese, Përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së, Pushimin e së funksionuari të legjislacionit të ish-sistemit jugosllav dhe atij të UNMIK-ut; Zbatimin e Legjislacionit aktual; Reformimin e sistemit gjyqësor; Ngritjen e kapaciteteve në zbatim të legjislacionit dhe Monitorimin e zbatimit të legjislacionit.

Duke pasur për baz faktin se sistemi juridik është kategori dinamike, mendoj se në reformimin, ndryshimin e sistemit juridik, kan refleksion të gjitha veprimet reformuese që i referohen së drejtës. Refleksioni fillon te ndryshimet e legjislacionit, zbatimi, monitorimi, dhe cdo veprim me qëllim të krijimit të shtetit të së drejtës. Ajo që është me rëndësi dhe refleksion direkt është reformimi i legjislacionit i cili mundëson të ketë reformim dhe ndryshim të sistemit juridik me qellim të krijimit të shtetit të së drejtës, prandaj Kosova mund të ketë reformim te sistemi juridik por cdo herë duke qenë në hap me reformat dhe ndryshimet në cdo fush dhe cdo aspekt, duke absorbuar ndryshimet shoqërore dhe vlerat universale.




Edhe në përgjigjet individuale të çdo kategorie të responentëve, përqindjen më të lartë kemi për këto përgjigje: Ndryshimin e Legjislacionit, Zbatimin e Legjislacionit aktual, Reformimin e sistemit gjyqësor, Monitorimin e zbatimit të legjislacionit, Ndryshimin e Kushtetutës, Përdorimin e legjislacionit me atë të BE-së, Pushimin e së funksionari të legjislacionit të ish-sistemit jugosllav dhe atij të UNMIK-ut dhe Ngritjen e kapaciteteve në zbatim të legjislacionit, ky listim është i bërë në mënyrë hiarkike nga më e larta tek më e ulëta dhe të njëjtat duhet që të shikohen si përgjigje nga kategori të ndryshme të responentëve.

Nga analiza dhe vlerësimi i përqindjeve në këta grafikone të pyetjes 16, konstatojmë se sistemi Juridik në Kosovë mund të reformohet me ndryshimin e legjislacionit si mendimi më i përgjithshëm dhe me përqindje më të lartë, më pas është me Ndryshimin e Kushtetutës e pasuar me Përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe Monitorimin e zbatimit të legjislacionit, si dhe tjerat siç cekën në grafikone. Për një ndryshim të sistemit juridik në vend, të gjitha pikat e parapara në përgjigjet e kësaj pyetjeje janë të nevojshme dhe të dobishme, për faktin se sistemi juridik gjatë ndryshimit duhet të trajtohet dhe të merren për bazë të gjitha ato që janë të parapara në këto përgjigje. Andaj kurdo që do të ketë ndryshim të sistemit juridik, duhet të kemi parasysh të gjitha këto fusha.

Ajo që është me rëndësi të konstatohet është se përgjigjet individual të kategoris së ndryshme të responentëve, janë të njëjta dhe në harmoni me atë që është e pasqyruar në garfikonin e parë të kësaj pyetje. Prandaj kjo na ben të njohur se mendimi i responentëve është unanim dhe përfaqëson mendimin

e njejt të tyre mendryshime jo edhe shumë të mëdha. Unë mendoj se në këtë pyetje kemi të bejm me përgjigje që respondentet posedojn mendim të njejt edhe pse vin nga fusha të ndryshme të së drejtës, po të analizuarit e tyre është i njejt dhe pasqyrojn mendim të unifikuar.




Pyetja e parashtruar respondentëve “ *Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet shoqërore në Kosovë?* ” ofron këto përgjigje nga respondentët: Plotësisht 4%; Pjesërisht 62%; Pak 26%; Aspak 6%. Edhe te grafikoni ku pasqyrohen përgjigjet individuale për çdo kategori të respondentëve, përqindje më të lartë merr përgjigja Pjesërisht dhe Pak, ndërsa më të ulët Plotësisht dhe Aspak.

Ndryshimet shoqërore janë ato ndryshime që i paraorin cdo fushe, për faktin se shoqëria cdo herë është në lëvizje dhe reformim brenda vetes, prandaj kjo edhe reflekton me kërkesën për ndryshim, reformim të cdo fushe. Në gjendje të njejt jan edhe ndryshimet shoqërore të karakterit nga marëdhëniet civile të cilat më pas kan refleksion direkt në legjislacionin e së drejtës civile. Ajo që duhet të jetë e njohur është fakti se, ndryshimet shoqërore, cdo herë janë një hap përpara rregullimit me legjislacion përkatës, kjo është e mundur pasi dukurit shoqërore janë kategori dinamike që ndryshimet janë të theksuara cdo ditë.

Duke ju referuar këtyre të dhënave, ne mund të konstatojm se legjislacionin e së drejtës civile nuk e kemi në harmoni me ndryshimet shoqërore. Ate që pasqyron ky hulumtim për këtë pyetje, legjislacioni i së drejtës civile është pjesërisht në harmoni me ndryshimet shoqëror, nërsa shumë pak plotësisht. Duke qenë pjesërisht, behet e njohur se legjislacioni i së drejtës civile nuk i ka të inkorporuara brenda vetes ndryshimet shoqërore të cilat janë të arsyeshme që të rregullohen dhe përcaktohen qartë me dispozita përkatëse në legjislacionin e së drejtës civile. Është obligim i sistemit juridik që të vlerësoj ato ndryshime shoqërore e të cilat duhet që të marrin karakter juridik, te trajtohen dhe të inkorporohen duke qene pjes e ligjislacionit të së drejtës civile dhe më pas e sistemit juridik. Vlerësimi me koh i ndryshimeve shoqërore mundëson që të eliminohen zbrastirat juridike, krijimin e situatave jo të mira mes njerëzve, ndikim në mos zhvillim të fushave tjera po të cilat varen nga legjislacioni i së drejtës civile.


Nga këto që na pasqyrohen dhe asaj që mbretëron në praktik, unë mendoj se në Kosovë nuk trajtohen me koh ndryshimet shoqërore duke i analizuar nga kandëveshtrimi i nevojës për rregullim të tyre me dispozita përkatëse ligjore. Duke mos i trajtuar me koh këto ndryshime shoqërore, në Kosovë kemi legjislacion të së drejtës civile i cili është prapa cdo here dhe nuk mund të rregulloj qartë dukuri shoqërore të cilat kërkojnë të kenë trajtim ligjor. Ajo që është obligim i shtetit dhe sistemit juridik, është të përcjellurit, analizimi, vlerësimi dhe më pas kandëveshtrimi i rregullimit të raporteve shoqërore e të cilat është enevojshme që të jen të normuara. Duke qene ne hap me ndryshimet shoqërore, mundëson që të krojohet një sistem juridik që do të plotësonte nevojat për një shtet të së drejtës.



Të bazuar në përqindjet e përgjigjive të dhëna nga respondentët dhe profesionalizmin e respondentëve, mund të konstatohet se legjislacioni i të drejtës civile nuk është në harmoni të mjaftueshme me ndryshimet shoqërore në Kosovë, kjo për faktin se këtë e argumenton përgjigja e dhënë nga respondentët Pjesërisht e cila bart përqindjen më të lartë prej 62% dhe nga kjo kuptohet se ka ende hapësirë që legjislacioni i së drejtës civile duhet të jetë në harmoni me ndryshimet shoqërore. Një përqindje jo edhe e vogël, mendojnë se legjislacioni i të drejtës civile Pak është në harmoni me ndryshimet shoqërore në Kosovë. Nga të cekurat më lart si dhe faktin se legjislacioni i së drejtës civile duhet që të monitorojë në vazhdimësi ndryshimet shoqërore dhe të njëjta mbi bazën e arsyesh mërisë dhe interesit të përgjithshëm duhet të parashihen si norma juridike në kuadër të sistemit juridik përkatësisht në legjislacionin e së drejtës civile.

Legjislacioni i së drejtës civile do të konsiderohet se është i kompletuar pos tjerash edhe kur ka të inkorporuara ndryshimet shoqërore e të cilat janë të karakterit nga marrëdhëniet juridiko-civile. Qëllimi kryesor i plotësim ndryshimit të legjislacionit dhe hartimit të legjislacionit të ri është që marrëdhëniet shoqërore të lindura apo ndryshuara e që kanë karakter nga marrëdhëniet juridiko-civile e mbi bazën e arsyeshmërisë juridike e në harmoni me interesin e përgjithshëm të parashihen si dispozita përkatëse.

Ato që i ka gjeneruar ky grafik janë tejet të dhëna me rendësi, duke u nisur nga fakti se kategoria e respondentëve është kategori që mbulojnë të drejtën nga këndvështrime të ndryshme si: zbatimin e legjislacionit, monitorimin e zbatimit, hartimin e legjislacionit, shkencën juridike dhe kur nga kjo kategori e respondentëve na rrjedhin këto të dhëna për këtë pyetje, ne kemi të dhëna objektive, korrekte, profesionale dhe të bazuara direkt nga praktika. Prandaj kjo mundëson që ato që i ka gjeneruar ky grafik të konsiderohen si të dhëna shumë profesionale e të cilat kanë bazë në realitet dhe praktik. Duke pasur për baz seriozitetin e këtyre të dhënave, unë mendoj se të njëjtat duhen të merren si të dhëna tejet me rendësi dhe pik referimi për ndryshime të legjislacionit me qëllim të përafrimit me ndryshimet shoqërore.




Për pyetjen “ *Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet ekonomike në Kosovë?*”, nga respondentet janë pranuar këto përgjigje, Plotësisht 3%;Pjesërisht 54%; Pak 34% dhe Aspak 9%. Edhe përgjigjet individuale të çdo kategorie të respondentëve, krijojnë përqindje të lartë për përgjigjen Pjesërisht të pasuara me Pak ndërsa shumë të ulëta Aspak dhe Plotësisht.

Cdo herë me ndryshimet, eformimin e legjislacionit të së drejtës civile, synohet në përpikmeri të rregullohen raportet shoqërore me karakter juridiko civil, kjo kalon në disa faza dhe duke marr për baz shumë faktor dhe fusha tjera të cilat kanë lidhmëni me marrëdhëniet juridiko civile. Në rregullimin e marrëdhënieve juridiko civile është i pandashëm faktori social, tregtar, ekonomik, integrues të cilat kanë refleksion direkt dhe të njëjtat duhen të merren për baz cdo her kur rregullohen marrëdhëniet juridiko civile. Të rëndësishme janë të gjitha, mirëpo për nga hiarkia për nga rëndësia është aspekti ekonomik kur synohet të rregullohen marrëdhëniet juridiko civile. Kjo për faktin se marrëdhëniet juridiko civile në fund cdo herë kanë karakter ekonomik – financiar. Prandaj është faktori me shumë rëndësi ai ekonomik që duhet të analizohet, vlerësohet gjat rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile, pasi këto marrëdhënie duhen që të jenë në relacion me faktorin ekonomik, ndryshimet dhe reformat ekonomike.

Ate që e gjeneron ky grafik, nuk janë të dhëna të mira sa i përket përcjelljes dhe inkorporimit të ndryshimeve ekonomike në Kosovë dhe inkorporimin e tyre në legjislacionin e së drejtës civile. Duke e nxjerrur se pjesërisht dhe pak është në harmoni legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë me ndryshimet ekonomike është indikacion se nuk kemi legjislacion që është në hap me kërkesat e tregut dhe ndryshimet ekonomike. Duke e pasur një gjendje të tillë, mund të konstatohet se ky është njëri ndër faktorët që nuk ka zbatim të mirë të legjislacionit që mbulon fushën e së drejtës civile në Kosovë dhe as që prodhon efekte juridike. Nga ato që kam trajtuar në këtë hulumtim, ndërtoj mendimin se legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë i mungon komponenta me e rëndësishme ajo ekonomike, kjo duke filluar nga faza e hartimit të legjislacionit ku nuk kemi vlerësim të sakt të implikimit financiar të legjislacionit, impaktit në praktik i aspektit ekonomik dhe financiar, harmonizimin me sistemin ekonomik dhe vlerësimin e ndryshimeve ekonomike dhe inkorporimin e tyre brenda legjislacionit për të pasur një legjislacion që i përgjigjet kërkesave shoqërore dhe atyre të tregut. Këto të dhëna, mendoj se duhet të konsiderohen si reflektim për institucionet përgjegjëse që duhet të kenë analiza më të detajzuara të aspektit ekonomik dhe financiar në raport me legjislacionin e së drejtës civile dhe të qenurit në hap me ndryshimet duke i inkorporuar në kuadër të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet juridiko civile në Kosovë. Kjo ngase aspekti ekonomik - financiar i legjislacionit është pjesa më e

rëndësishme e legjislacionit që ndërlidhet me zbatimin, efikasitetin, ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drjtave të njëriut.




Nga të dhënat që gjenerojnë këta grafikone të bazuara në përgjigjet e dhëna nga respodentët, konstatohet se Legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë nuk është në harmoni me ndryshimet ekonomike në vend. Dhe nga kjo krijohet baza dhe arsyeja që legjislacioni i së drejtës civile duhet të pësojë plotësim ndryshime i cili duhet të jetë në harmoni të plotë me ndryshimet ekonomike.

Kjo për faktin se, në kuadër të ndryshimeve shoqërore, ndryshimi ekonomik dhe financiar janë baza kryesore që gjatë hartimit të legjislacionit duhet të jenë parasysh. Janë fakte shumë të rëndësishme ndryshimet ekonomike e të cilat duhet të gërshetohen edhe në legjislacionin e së drejtës civile që hartuesi t'i ketë parasysh gjatë hartimit dhe plotësim ndryshimit të legjislacionit.

Ate që prezantojnë respodentët është pasqyrim i gjendjes reale të legjislacionit të së drejtës civile, kjo pasi respodentët janë gjyqtar, avokat, noter, profesor, ndërmarrës e të cilët direkt ballafaqohen me legjislacionin e së drejtës civile dhe aspektin ekonomik – financiar të legjislacionit të së drejtës civile. Ato që i prezantojnë këta respodent, janë të bazuara dhe bartin përgjegjësin profesionale dhe zyrtare të respodentëve, prandaj lirisht mund të merren si të dhëna të sakta, objektive dhe të cilat burojnë nga praktika. Me këtë që pasqyrohet, mendoj se legjislacioni duhet të jetë konform zhvillimit ekonomik, kjo për faktin se çdo ligj bart kosto të caktuar për zbatim, prandaj ndryshimet në legjislacion duhet të jenë konform ndryshimeve ekonomike në vend. Mospërshtatja e këtyre elementeve është bazë që

legjislacioni mos të ketë zbatim të duhur në praktikë, kjo për faktin se ekonomia e vendit përcakton edhe zbatimin dhe sundimin e ligjit e përmes së cilave synohet krijimi i shtetit të së drejtës në Kosovë.




Responentet janë treguar profesional edhe në përgjigjet e dhëna në pyetjen: “*Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet sociale në Kosovë?*”, ku përgjigja Plotësisht ka 3%;Pjesërisht 52%; Pak 34% dhe Aspak 11%. Edhe nga përgjigjet e dhëna në mënyrë individuale të çdo kategorie të responentëve kuptojmë se nga të gjithë është mendimi me përqindje të lartë për përgjigjen Pjesërisht dhe Pak, ndërsa me përqindje shumë më të ulët janë përgjigjet Plotësisht dhe Aspak.

Nga kjo që potencohet prej responenteve për këtë pyetje, fillimisht ne bejmë të njohur se legjislacioni aktual nuk është në linjë me ndryshimet sociale në Kosovë. Kjo mungesë e bene legjislacionin e së drejtës civile jo të kompletuar për faktin se nuk janë të përcjellura dhe të analizuar ndryshimet sociale dhe më pas ato të arsyeshmet të inkorporuara në legjislacion. Ndryshimet sociale janë evidente në çdo moment në Kosovë, pasi të njëjtat janë kategori dinamike ku shoqëria i krijon duke qenë vete dinamike, prandaj këto duhet që të vlerësohen si të rëndësishme që dihet të jenë pjesë e sistemit juridik të vendit.

Ndryshimet sociale janë determinuese për zhvillimin e shoqëris, ngritjen e vërdijes, standartin e jetës dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm, prandaj janë me rëndësi të dihen dhe legjislacioni të ketë parasysh gjatë reformimit. Kur ju referohemi përqindjeve të gjeneruara nga ky grafik, na del se pjesërisht apo

pak është në harmoni legjislacionin e së drejtës civile me ndryshimet sociale që ndodhin në Kosovë. Ky vlerësim është tejet i ulët dhe tregon se duhet angazhim më i madh dhe veprime konkrete në harmonizim të legjislacionit të së drejtës civile me ndryshimet sociale. Lidhur me këtë pyetje të parashtruar në këtë hulumtim, unë mendoj se ndryshimet sociale janë kategori shumë dinamike në Kosovë dhe nga një herë është vështirë të përcjellen dhe monitorohen për nga shpejtësia e ndryshimit dhe numri i madh i tyre, po këto ndryshime e tregojnë aktivitetin dhe vullnetin e qytetarëve për zhvillim dhe reformim të marrëdhënieve njerëzore. Përpos kësaj, atë që e konsideroj të arsyeshme që duhet të jetë aktive është që kur hartohet legjislacioni i fushës së së drejtës civile, të merren për bazë ndryshimet sociale dhe të njëjtat të jenë të inkorporuara në këtë legjislacion duke siguruar një legjislacion përmes së cilit me pas shtetin e së drejtës i cili është vlera më e mirë, përmes së cilës sigurohet e drejta barazia, korrektësia e shumë vlera tjera që mundësojnë një mirëqenie për qytetarët.




Mendimi i respondentëve për këtë pyetje i pasqyruar në përqindjet e këtyre grafikoneve, krijon mendim me përqindje të lartë se legjislacioni i së drejtës civile Pjesërisht apo Pak është në harmoni me ndryshimet sociale në Kosovë. Nga kjo ndërtohet konstatimi se legjislacioni duhet të ketë ndryshime dhe të jetë në harmoni të plotë me ndryshimet sociale në Kosovë.

Kete që kanë pasqyruar respondentët është ajo që duhet të kihehet parasysh që legjislacioni të jetë i hartuar konform kushteve sociale të vendit, për faktin se mbi këtë bazë kemi një legjislacion që është

konform atyre kushteve sociale të vendit dhe mundëson që në praktikë të gjejë zbatim duke mos u penguar nga aspekti social.

Ate që duhet ta konstatojm fillimisht si te rëndësishme është fakti se respondentet janë vin nga fusha të ndryshme dhe mendimi i tyre është gjithëpërfshirës i cili mundëson të krijohet një pasqyrim real, objektiv dhe profesional. Prandaj këto të dhëna, unë i konsideroj si tejet me rëndësi dhe mendoj se gjatë hartimit të legjislacionit duhet t'u kushtohet rëndësi aspektit ekonomik, social, integrues dhe këto të gërshetohen në kuadër të dispozitave përkatëse që më pas të kemi një legjislacion i cili do të jetë i zbatueshëm dhe të prodhoj efekt juridik për atë se për çfarë është hartuar. Përpos kësaj, aspekti socila mendoj se është indikator kryesor nga i cili varet zhvillimi, rënia dhe reforma ne cdo fush, kjo ngase nëse shifen ne detaje cdo marëdhënie shoqërore ka elemente sociale, prandaj duhet trajtuar me prioritet dhe profesionalizëm këto të dhëna konkrete nga kategori të ndryshme të respondentëve sepse jan te dhëna tejet me rëndësi.



Pyetja e këtij hulumtimi e parashtruar te respondentët është: *“Reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë do të ketë ndikim pozitiv në:”* nga e cila derivojnë këto përgjigje: Zhvillim Ekonomik 83%; sundim të ligjit 73%, zgjidhjen e problemeve pronësore 90%; krijim të ambientit të përshtatshëm për investime të huaja 98%; qasje më të mirë për qytetarët në drejtësi 70%; lehtësira në të bërit biznes dhe ndërmarrësi 96%; krijim të sigurisë juridike për qytetarët 99% dhe Integrim të Kosovës për në BE

Edhe grafikoni që pasqyron përgjigjet individuale të çdo kategorie të respondentëve, ofron të njëjtën përqindje për çdo pyetje siç është e cekur në grafikonin ku pasqyrohen përqindjet e përgjithshme të përgjigjeve.

Të dhënat që derivojnë këta grafikone na bëjnë të njohur një fakt se reformimi i Legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë ka ndikim të jashtëzakonshëm në fusha më të rëndësishme në Kosovë. Zhvillimi Ekonomik siç ceket në nivelin e lartë të përqindjeve të përgjigjeve individuale është fusha në të cilën ka ndikim të drejtpërdrejt reformimi i legjislacionit, kjo për faktin se marrëdhëniet juridiko-civile çdoherë kanë karakter ekonomik.

Reformimi i legjislacionit me reflektim të lartë në zhvillimin ekonomik është evident për faktin se nuk mund të ketë zhvillim ekonomik nëse nuk do të ketë legjislacion nga fusha e së drejtës civile i cili është në harmoni me nevojat që ndikojnë në zhvillim ekonomik. Ndikimi tjetër në Sundim të ligjit është efekti tjetër në një fushë shumë me rëndësi siç është sundimi i ligjit, nga i cili varet zhvillimi i çdo fushe tjetër. Kjo për faktin se sundimi i ligjit është baza e çdo fushe tjetër, kjo pasi mundëson që të krijojë siguri juridike, qasje në drejtësi dhe trajtim të barabartë para ligjit. Andaj nga ajo se çfarë na derivojnë përgjigjet e dhëna, kuptojmë se reformimi i legjislacionit të fushës civile është bazë për sundim të ligjit në Kosovë.


Jemi dëshmitar të asaj se problemet pronësore në Kosovë janë të larta dhe ato të trashëguara nga ish-sistemi dhe jo të rregulluara tani nga sistemi jonë juridik. Nga përgjigjet e pranuar, kuptuam se reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë ka refleksion në Zgjidhjen e problemeve pronësore në Kosovë. Ky është një fakt shumë më rëndësi pasi problemet pronësore janë probleme që janë shumë evidente në Kosovë dhe këto kërkojnë trajtim dhe rregullim më të mirë në vend. Me këtë kuptojmë se ende nuk kemi legjislacion të reformuar i cili do jetë i përshtatshëm për zgjidhjen e problemeve pronësore që nuk janë edhe të vogla.

Zhvillimi ekonomik në Kosovë shpresën e ka te investimet e huaja në vend, për të krijuar një ambient të përshtatshëm për investime të huaja, kryesorja është sundimi i ligjit dhe reformimi i legjislacionit në funksion të kësaj. Prandaj, të dhënat e gjeneruara nga kjo pyetje na japin përgjigje se reformimi i legjislacionit është me rëndësi të veçantë për krijimin e ambientit të përshtatshëm për investime të huaja. Krijimi i ambientit të përshtatshëm për investime të huaja në Kosovë është direkt i ndërlidhur me reformimin e sistemit juridik dhe legjislacionit që i mundëson krijim të sigurisë juridike për kapitalin që investohet në Kosovë. Reformimi i legjislacionit të së drejtës civile me ndikim në qasjen më të mirë për qytetarët në drejtësi është me rëndësi të madhe kjo për faktin se është ndër elementet

kryesore për qytetarët që të kenë qasje në drejtësi për të realizuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre nga marrëdhënia juridiko-civile. Krijimi i kushteve sa më të mira për qasje në drejtësi është krijim i mundësisë që të vije deri te realizimi dhe mbrojtja më e mirë dhe e shpejt e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile.

Lehtësira në të bërit biznes dhe ndërmarrësi është fusha tjetër me shumë ndikim në zhvillimin e ekonomisë në vend. Andaj, kur kjo varet nga reformimi i legjislacionit të së drejtës civile është indikacion se këtë legjislacion nuk e kemi në atë masë sa të kualifikohet se është i reformuar. Krijimi i kushteve për lehtësirat në biznes përmes reformimit të legjislacionit është bazë që fillimisht duhet të ketë reformim të legjislacionit dhe në kuadër të reformimit të jenë parasysh që të krijohen kushte për këtë fushë. Krijim të sigurisë juridike për qytetarët është një çështje që varet nga reformimi i legjislacionit të së drejtës civile. Siguria juridike është bazë që varen çdo fushë tjetër dhe i mundëson qytetarëve të jenë të sigurtë për qarkullimin e tyre ekonomik, juridik. Synim i Kosovës është Integrimi për në BE si i vetëm orientim drejt vlerave universale të shoqërisë siç janë ato në kuadër të BE-së. Kur edhe nga ky hulumtim na del se legjislacioni i së drejtës civile qenka me ndikim për procesin e integrimi të Kosovës, e rrit tej mase përkushtimin që duhet të kemi në raport me plotësimin e standardeve për në BE.

Nga ato që i kanë gjeneruar grafikonet e pyetjes 20, na mundëson të konstatojmë se legjislacioni i së drejtës civile është me ndikim tejet të lartë në fushat më të rëndësishme të shoqërisë nga të cilat varet direkt ndërtimi dhe zhvillimi i shtetit si dhe mirëqenia e qytetarëve të Kosovës. Kjo e jep edhe kuptimin se sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile është me refleksion tejet të gjerë për Republikën e Kosovës, prandaj trajtimi i tyre duhet të bëhet me përkushtim.




Përgjigjet e pranuar nga pyetja: *“Sa do të ketë ndikim ndryshimi i legjislacionit të së drejtës civile në zgjidhjen e lëndëve nga marrëdhëniet juridiko civile në gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor?”* janë përgjigje si Plotësisht 53%; Pjesërisht 36%; Pak 9%; Aspak 2%.

Kontestet nga marrëdhëniet juridiko civile që trajtohen në kuadër të sistemit Gjyqësor në Kosovë, janë në numër të shumtë dhe ajo që është me rëndësi procedurat gjyqësore janë të zgjatura tej mase, përtej asaj që është e përcaktuar në kuadër të legjislacionit përkatës në fuqi. Mesatarja e zgjidhjes së një kontesti nga marrëdhëniet juridiko pronësore në Kosovë është 6 vite duke përfshi edhe ankesat në instancat e gjyqësorit. Duke marr për bazë të drejtat e palës, rëndësinë zgjidhjes së Kontesteve në afat sa më të shpejt, qarkullueshmerin juridike dhe ekonomike të marrëdhënieve juridiko civile, zgjatja e afateve është tejet e dëmshme për qytetarin e Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat dhe ato që na i gjeneron ky grafik, na bejn të njohur faktin se ndryshimi, reformimi i legjislacionit të së drejtës civile është me ndikim dhe refleksion direkt në zgjidhjen e lëndëve nga marrëdhëniet juridiko civile në gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor. Kjo e ben të njohur se zgjatja e madhe e afateve përzgjidhjen e këtyre lëndëve qenka problem për faktin se nuk kemi një ndryshim, reformim të legjislacionit të së drejtës civil i cili do të mundësonte një zgjidhje të shpejt të lëndëve në gjykata nga marrëdhëniet juridiko civile.

Unë mendoj se me ndryshimin, reformimin e legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë, do të ketë refleksion direkt në krijimin e kushteve, standarteve për trajtim më efikas të lëndëve në gjykata nga marrëdhëniet juridiko civile dhe vendosjen për to nga gjykata brenda afateve të përcaktuara ligjore e jo sic ndodh tani të kete stërzgjatje të trajtimit të lëndëve në gjykata që në fund i hum edhe qëllimi pse është kërkuar që lënda përkatëse të trajtohet dhe vendoset nga gjykata. Duke parë këtë situatë tejet komplekse dhe problematike për sistemin juridik të vendit, mendimi i respondentëve për këtë pyetje isha dashur të merret pikë referimi dhe të ketë ndryshim, reformim të legjislacionit të së drejtës civile me qëllim të krijimit të kushteve dhe mundësisë që lëndët të trajtohen dhe vendosen në afat sa më të arsyeshëm kohor duke mos u zgjatur dhe në fund duke hum qëllimi pse është kërkuar gjykim për atë lëndë.




Edhe në përgjigjet individuale të responentëve kemi përqindje të lartë për përgjigjet të renditura në këtë formë nga përqindjet më të larta Plotësisht, Pjesërisht, Pak, Aspak. Nga përgjigjet e pranura në këtë pyetje të pasqyruara në këta grafikone, kuptojmë se reformimi i legjislacionit të së drejtës civile ka ndikim direkt në zgjidhjen e lëndëve nga marrëdhëniet juridiko-civile në gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Me këtë fillimisht na bejn të njohur responentët se nuk kemi legjislacion të kompletuar konform asaj që kërkohet për zgjidhjen e lëndëve nga gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor. Këtë e dëshmon edhe aspekti praktik i zgjidhjeve të lëndëve brenda afatit të përcaktuar ligjor, kjo kur dihet se zgjidhja e një lënde nga marrëdhëniet juridiko-civile zgjasin përtej asaj që është e përcaktuar në legjislacion. Kjo është edhe një dëshmi se duhet të ketë reformim të legjislacionit që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet zgjidhja e lëndëve brenda afatit të përcaktuar ligjor.

I bazuar në atë që kan dhenë përgjigjie responentët dhe përqindjen e cdo njëres si dhe gjendjen faktike, mendoj fillimisht se kemi të bejm me te dhëna shumë profesionale, objektive dhe të cilat kanë burim në praktik, kjo pasi kategorin e responentëve e kemi nga sistemi gjyqësor, universiteti, profesionet e lira, ndërmarrësia, dhe zbatimi i legjislacionit, prandaj duhet vlersuar si shumë të dobishme në funksion të ndërtimit të sistemit juridik me qellim të krijimit të shtetit të së drejtës që është vler ku do të gjen mbrojtje, trajtim dhe siguri qytetari i Kosovës. Për nga rëndësia që kan, mendoj se këto të dhëna do të jen pik nisje e analizës, vlerësimit për fillim të ndryshimit të legjislacionit nga marrëdhëniet juridiko civile me qellim të zgjidhjes së lëndëve nga këto marrëdhënie brenda afateve ligjore e të cilat nuk janë të gjata për dallim nga aspekti praktik që janë tejet të zgjatura, prandaj këto duhet eliminuar.

Grafiku Nr. 22 Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me investimet e huaja në Republikën e Kosovës?




Pak 41%, Pjesërisht 40%, As pak 16%, Plotësisht 3%, janë përqindjet e përgjigjeve të dhëna nga pyetja: *“Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me investimet e huaja në Republikën e Kosovës”*. Edhe te përgjigjet individuale të çdo kategorie të respondentëve, përqindjen më të madhe marrin përgjigjet Pak dhe Pjesërisht, ndërsa Aspak dhe Plotësisht në përqindje tejet të ulët në raport me dy përgjigjet tjera.

Përgjigjet Pak dhe Pjesërisht që kanë më së shumti përqindje nga respondentët, janë indikator më real që pasqyrojnë këtë situatë që ka të bëjë me pyetjen e parashtruar. Me këtë fillimisht behet e njohur se lidhur me krijimin e kushteve për investimet e huaja në Kosovë nuk kemi politikë të qarta shtetërore dhe nga kjo mungojnë edhe mekanizmat përkatës që janë legjislacioni, zbatimi i legjislacionit, qasja në mekanizma përkatës etj. Ate se si e pasqyrojnë ky grafik situatën, është në disproporcion me atë që kërkojnë investimet e huaja në Kosovë, të cilat kërkojnë standard në çdo fushë për faktin se investimin e kapitalit investitorët e huaj e planifikojnë ta kenë të sigurt në çdo aspekt, prandaj sistemi juridik i Kosovës edhe nuk është i gatshëm që të krijojë kushte për investime të huaja në Kosovë.

Ajo që lejohet për këtë rast të konstatohet është se, Kosova nuk ka politikë të qarta të cilat do të krijojnë një sistem juridik i cili do të plotësonte kushtet për investime të huaja duke qenë të sigurta dhe të suksesshme. Përpos kësaj, me këtë mund të konstatohet se mungesa e investimeve të huaja në Kosovë gjë më tani, qenka si rezultat i mungesave të politikave të qarta që krijojnë mekanizma që do të krijojnë ambientin e përshtatshëm për investime. Lidhur me këtë, unë mendoj se Kosova, ka shancën e fundit ku do të kishte mundësi ta bazonte zhvillimin dhe prosperitetin e saj, ajo është investimet e

huaja në Kosovë, prandaj angazhimi, serioziteti dhe përkushtimi për politika të qarta karshi kësaj çështje duhet të jetë prioritet i mekanizmave përkatës institucional.




Investimet e huaja në Kosovë janë të një rëndësie të veçantë, prandaj edhe politikat dhe reformimi i sistemit juridik duhet të jenë në harmoni me investimet e huaja. Është shumë me rëndësi që në fazën e hartimit të politikave të trajtohen dhe më pas të përfshihen kushte që do të krijojnë ambient të përshtatshëm për investime të huaja në Kosovë.

Kur kemi trajtim dhe përcaktim në kuadër të politikave, atëherë ato barten edhe në dispozita përkatëse ligjore dhe mundësojnë që të ketë reformim në funksion të kushteve dhe ambientit të përshtatshëm për investime të huaja në Kosovë. Nga përgjigjet e pranura prej respondentëve të cilët vin nga fusha të ndryshme, konstatojmë se nuk ka politika të qarta për reformim të sistemit juridik në vend për të qenë në funksion të ambientit dhe kushteve për investime të huaja në Kosovë, kryesisht përgjigjet janë pak dhe pjesërisht që i bie se duhet të ketë reformim për të arritur të një gjendje e duhur për të qenë në funksion të ambientit të përshtatshëm për investimet e huaja në Kosovë.

Përgjigjet e dhëna për këtë pyetje, i vlerësoj si shumë të rëndësishme, fillimisht se vin nga respondentet që njohurit, përvoja dhe aspekti praktik i tyre është tejet i lart dhe ju mundëson që të kenë njohuri në detaje për këtë fushë, prandaj këto të dhëna janë tejet objektive dhe me bazë në gjendjen faktike. Përpos kësaj, këto do të ishin me rëndësi për mekanizmat përkatës institucional që mbi bazën e tyre të

planifikojn ndryshimin dhe reformën në sistem juridik me qëllim të krijimit të kushteve për investime të huaja në Kosovë.




Nga pyetja: “Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës që mundësojnë qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut për qytetarët e Republikës së Kosovës?” janë pranuar këto përgjigje me këtë përqindje: Pjesërisht 50%; Pak 36%; Aspak 10% dhe Plotësisht 4%.

Qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut janë dy mekanizma shumë të rëndësishëm për faktin se, mundësojnë që qytetarët të kërkojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre në rastet kur ato janë rrezikohen apo cenohen. Nga ato që i prezanton ky grafik, pak dhe pjesërisht Kosova posedon politika të qarta që i referohen reformimit të sistemit juridik të Kosovës ku do të mundësohej qasja në drejtësi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Këto çdo herë duhet të konsiderohen se duhet që të jenë pjesë përbërëse e sistemit juridik në vend dhe të përcjellin ndryshimet në sistemin juridik duke e freskuar me elemente për qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut.


Une fillimisht e vlerësoj se është kohë e gjatë që Kosova ka sistemin e saj juridik dhe në kuadër të saj nuk posedon politika të qarta që i referohen ngritjes së kapaciteteve për qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Kjo për faktin se, mungesa e tyre ka krijuar mos siguri juridike, trajtim jo ligjor, shkelje të të drejtave të njeriut dhe mos trajtim të mirë dhe barabart të qytetarëve. Kjo do të faturohet

shtetit dhe sistemit juridik të Kosovës, se nuk ka qenë në hap me ato që janë kërkuar për tu inkorporuar në kuadër të sistemit juridik në vend.




Nga këto të dhëna që i derivojnë këta grafikone, ofrohet një mendim unanim nga responentët se pjesërisht apo pak ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës nga i cili do të mundësohet qasja në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut për qytetarët e Republikës së Kosovës. Nga kjo kuptojmë se ende nuk kemi sistem juridik në atë nivel që të mund të konsiderohet në atë nivel për të mundësuar qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Përgjigjet e responentëve janë bazë shumë e madhe se në këtë aspekt duhet të ketë reformim për të qenë në pozitë ku do të kemi qasje në drejtësi si njëra ndër të drejtat themelore dhe më pas mbrojtjen e të drejtave të njeriut si vlera të shoqërisë për barazi dhe drejtësi.

Të dhënat në grafikone janë bazë që të konstatojmë se reformimi i sistemit juridik dhe ai i legjislativitetit të së drejtës civile për të ngritur kapacitetin në kuadër të sistemit juridik. Reformimi i sistemit juridik ka dy drejtimi, fillimisht eliminimin e zbrastirave dhe më pas inkorporimin e vlerave të cilat Kosova nuk i ka pasur as një herë të inkorporuara në sistemin e saj juridik. Përgjigje Pjesërisht është ajo që më së shumti ka përqindje nga responentet, e cila përfaqëson mendimin unanim të responentëve të këtij hulumtimi.




Nga pyetja: “Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me ndryshimet shoqërore, ekonomike, integruese në Republikën e Kosovës?” janë gjeneruar këto përgjigje me këtë përqindje Pjesërisht 46%; Pak 42%; Aspak 10% dhe Plotësisht 2%. Një përqindje të njëjte kemi edhe në grafi konin ku pasqyrohen përqindjet individuale të çdo kategorie të respodentëve për çdo përgjigje. Ku më së shumti kanë përqindje përgjigjet Pjesërisht dhe Pak ndërsa dy tjera përqindje shumë të vogël. Ky grafik na sjell te dhëna tejet me rendesi dhe ben te njohur se pjesërisht apo pak ka politika të qarta në aspektin ekonomik, sjoqëror hde integrues që janë në funksion të reformimit të sistemit juridik. Me kete duhet që të kuptojm një fakt i cili është se, Kosova duhet që të ketë politika më të qarta, konkrete ne funksion të ndërtimit të sistemit juridik në Kosovë.



Kjo situatë e bazuar në këto të dhëna, mundëson që të konstatojmë se duhet të ketë më shumë angazhim në krijimin e politikave e të cilat më pas do të materializohen në legjislacion apo mekanizma tjerë përkatës të cilët do të jenë në funksion të ndryshimeve shoqërore, ekonomike dhe integruese. Nuk mund të ketë reformim të sistemit juridik të vendit nëse nuk kemi politika të qarta të cilat gjatë hartimit duhet të kenë parasysh se si do të kenë refleksion karshi ndryshimeve shoqërore. Ndryshimet shoqërore, ekonomike, dhe integruese janë kategori dinamike të cilat çdo ditë pësojnë ndryshime dhe të njëjtat duhet të jenë të vlerësuara përmes hartimit të politikave e përmes së cilave do të ketë ndikim edhe në reformimin dhe rregullimin e sistemit juridik.

Kur shohim këto të dhëna nga respondentet e cdo kategorie, shihet se përqindjen më të madhe e ka përgjigjia Pjesërisht e pasuar nga ajo Pak e që janë përgjigjet që më së shumti janë të dhëna nga respondentët. Nga këto konstatojm se respondentet edhe individualisht kanë dhënë mendimin sic është i pasqyruar në grafikunin 1 të kësaj pyetje.



Pyetja: “Sa ka Politika të qarta sa i përket reformimit të Legjislacionit të së Drejtës Civile në Kosovë?” ka gjeneruar këto përgjigje me këtë përqindje: Pjesërisht 46%; Pak 39%; Aspak 11%, Plotësisht 4%.


Për të pasur reformim të legjislacionit të së Drejtës civile në vazhdimësi duhet që të ketë analizim të dukurive shoqërore, zbatimin të legjislacionit të së drejtës civile, vështirësitë, zbrazëtitrat dhe të gjitha këto duhet që të reflektojnë në hartimin e politikave të qarta që më pas ato të materializohen në

reformim të legjislacionit të së drejtës civile. Nuk mund të ketë reformim të legjislacionit të së drejtës civile nëse paraprakisht nuk kemi hartim të politikave të qarta dhe të bazuara në nevoja dhe synim për reformim.

Në kuadër të hartimit të politikave është faza e ndarë kur analizohen të dhënat, problemet, sfidat dhe synimet se ku do të arrihet, më pas bëhet konkretizimi i tyre në mekanizma të cilët do të bëjnë implementimin e politikave, njëri ndër mekanizmat është edhe reformimi i legjislacionit përmes plotësim ndryshimit. Të dhënat në kuadër të grafikoneve të pyetjes 25 janë bazë që të krijohet konstatimi se pjesërisht apo fare pak ekzistojnë politika të qarta të cilat ndikojnë në reformimin e legjislacionit të së Drejtës Civile në Kosovë.


Nëse bazohemi në atë se qfar është nxjerrur nga ky hulumtim dhe gjendja faktike e legjislacionit të së drejtës civile, mund të konstatohet se nuk është një legjislacion që është në relacion me kërkesat dhe ndryshimet që kanë ndodhur në fushat me të cilat ka ndërlidhmeri ky legjislacion e i cili duhet të jetë në harmoni. Ajo se qfar na sjell ky grafikoni e ben e njohur se mungojnë politikat e qarta nga mekanizmat përkatës në Kosovë për reformim të legjislacionit të së drejtës civile. Kur mungojnë politikat, mungon planifikimi, analiza e problemit, synimet dhe objektivat se ku do të duhet që të jetë dhe qfar duhet të rregulloj legjislacioni i së drejtës civile.

Karshi kësaj situatë, mendoj se është tejte problemeatike mungesa e politikave të qarta dhe nga kjo rezulton se nuk kemi legjislacion cilëson nga fusha e të drejtës civile dhe kjo krijon probleme dhe moszhvillim në fusha tjera me të cilat ka lidhmeri. Andaj sugjerimi im është që mekanizmat përkatës në Kosovë, të kenë qasje proaktive në raport me krijimin e politikave të qarta ku do të rezulton me legjislacion të së drejtës civile të kompletuar dhe në harmoni me fushat me të cilat ka lidhmëni.



Një pasqyrim të tillë kemi edhe te grafikoni ku pasqyrohen përgjigjet me përqindje individuale të çdo kategorie të respondentëve, ku me përqindje më të lartë është përgjigja Pjesërisht e pasuar nga përgjigja Pak, më pas Aspak dhe në fund Plotësisht. Edhe këto të dhëna individuale janë një dëshmi se mendimi për këtë pyetje edhe nga kategorit e ndryshme të respondentëve është i njëjt dhe është në harmoni me të dhënat e grafikoni 1 të kësaj pyetje

Ajo që mund të konstatohet nga këto të dhëna është fakti se, identifikimi i problemit, vlersimi real dhe orientimi ka duhet që të shkohet për reformim të sistemit juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile, janë këto të dhëna të respondentëve. Nga të cilat mësojm se, për të pasur reformim të legjislacionit të së drejtës civile, fokusi duhet që të jetë në hartimin e politikave të qarta për këtë fush, duke u bazuar në faktoret që janë relevant. Përvoja, profesionalizmi dhe ballafaqimi me probleme nga marrëdhëniet juridiko civile, u jep të drejt këtyre respondentëve që me mendimet e tyre të jenë prezent ne hartimin e politikave në këtë fush, duke e synuar cdo here një legjislacion që eliminon problemet dhe synon zhvillimin dhe avancimin e marrëdhënieve juridiko civile.




Nga pyetja: “Sa e ka lehtësuar qasjen në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës krijimi i sistemit të noterisë, përmbartimit privat dhe ndërmjetësimi?” e parashtruar respondentëve pranojnë këto përgjigje me këtë përqindje: Plotësisht 47%; Pjesërisht 39%; Pak 10%; Aspak 4%. Ajo qfar është reformuar, ndryshuar dhe avancuar është e natyrshme që do të reflekton pozitivisht, siq janë këto shërbime të cekura në këtë grafikoni. Prandaj ky është një shmbull se si ka sukses kur do të ketë reforma

në një fush dhe ato janë evidente edhe tek mendimi i profesionistëve të fushave të ndryshme sic janë të përfshirë në këtë hulumtim.


Duke u referuar këtyre të dhënave në këtë grafik, fillimisht mësojm një fakt që, shteti është ai që duhet të krijoj politika për fushën e drejtësisë në mënyr dinamike dhe ato duhet që të materializohen në mënyr profesionale dhe më pas do të ketë reflektimpozitiv. Së dyti, mësojm se një reformim në një pjes të politikave në fushën emarëdhënieve juridiko civile, ka rezultua dhe është konstatuar si e suksesshme. Me këtë duhet që të konstatojm se, pa pasur reformim përmes ndryshimeve në legjislacionin e së drejtës civile, nuk mund të kemi marëdhënie juridiko civile që janë të rregulluara konform ndryshimeve shoqërore e të clat është e nevojshme që të ken rregullim ligjor dhe të përfshihen në rregullimin e marëdhënieve juridiko civile në kuadër të sistemit juridik të Kosovës.

Ate se qfar prezantohet në këtë grafik, mendimi im është që në rastet kur ka analiz të mirëfillt, vlerësim profesiona, dhe synim për zhvillim dhe avancim të sistemit juridik, nuk mungon sukcesi, kete e dëshmon reforma në kuadër të sistemit juridik dhe legjislacionin e së drejtës civile, duke i funksionalizuar sistemin e Noteris, Përmbarrimin privat dhe Ndërmjetësimin. Nga ato që kanë rezultuar pas funksionalizimit të këtyre, mund të konstatohet se janë historia e suksesit e Ministris së Drejtësisë që i kanë dhuruar sistemit juridik të Kosovës. Prandaj ky është shembulli se si mund të kete sukses, kur është synim zhvillimi dhe avancimi i sistemit juridik me qëllim të krijimit të shtetit të së drejtës në Kosovë.



Përgjigjet Plotësisht dhe Pjesërisht janë përgjigjet që edhe në përgjigjet individuale të respondentëve janë me përqindje më të lartë, ndërsa dy përgjigjet tjera kanë përqindje shumë të ulët. Është me rëndësi që edhe mendimi individual i kategorive të ndryshme të respondentëve i pasqyruar në këtë grafik, pasqyron mendimin se sistemi i Noteris, Përmbarrimit privat dhe ai i Ndërmjetësimit është politik e mirë dhe në funksion të avancimit dhe reformimit të sistemit juridik në Kosovë.

Krijimi i sistemit të noterisë, përmbarrimit privat dhe ndërmjetësimit është reforma konkrete që Ministria e Drejtësisë ka bërë në kuadër të sistemit juridik të vendit. Dhe nga përqindja e përgjigjeve kuptojmë se krijimi i sistemit të noterisë, përmbarrimit privat vlerësohet shumë pozitivisht dhe plotësisht e ka lehtësuar qasjen në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës. Nga kjo fillimisht kuptojmë se reformimi i sistemit juridik në drejtim të lehtësimit të qasjes në drejtësi për qytetarët vlerësohet pozitivisht dhe shihet se ka arritur ndikimin pozitiv. Andaj, kjo duhet të jetë shembull se sistemi duhet t'i ndjek ndryshimet shoqërore, ekonomike, sociale dhe të reformoj sistemin dhe legjislacionin e së drejtës civile për faktin se ka nevojë dhe më pas do të ketë ndikim pozitiv. Me këtë që është pasqyruar në grafikonet e pyetjes 26 mund të konstatojmë se, plotësisht e kanë lehtësuar qasjen në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës krijimi i sistemit të noterisë, përmbarrimit privat dhe ndërmjetësimit dhe kjo është shembull se si reforma në një fushë do të ketë ndikim pozitiv dhe do të mirëpritet nga qytetarët e vendit.




Përgjigjet në pyetjen: “A duhet të ketë reformim të sistemit gjyqësor të Kosovës për mbrojtje më efektive të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile?” gjenerohen këto përgjigje me këto përqindje: Jo 9%; Po Nëse Po, në cilët fusha 91%; Legjislacionin që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor 92%; Rritjen e numrit të gjyqtarëve 90%; Përmirësimin e kushteve të punës 54%; Ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve 78%. Nëse i analizojmë përgjegjësit dhe kompetencat e çdo kategorie të respondentëve, çdo jëra ka të bëjë direkt apo indirekt me mbrojtjen, avancimin, e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile dhe të dhënat që i gjenon ky grafik janë dëshmi se në çfarë aspekti këta i vlersojnë dhe ku e konsiderojnë se qëndron problemi.

Unë mendoj se, duke pasur këto përgjigje nga 50% deri në 90% të respondentëve është baza më e mirë që mund të konsiderohet se ku duhet të ketë reformim dhe në cilat fusha për të pasur mbrojtje më efektive të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile. Reformimi i legjislacionit që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor; rritjen e numrit të gjyqtarëve; përmirësimin e kushteve të punës dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve janë fusha që direkt kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko civile. Për të pasur mbrojtje, avancim të marrëdhënieve juridiko civile është shumë e natyrshme që duhet të ketë organizim të mirëfillt të sistemit gjyqësor dhe numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të pasur mundësi të trajtohen në kohë dhe pa vonës marrëdhëniet juridiko civile. Me rëndësi janë edhe kushtet për sistemin gjyqësor të Kosovës dhe ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve në trajtimin profesional, objektiv të marrëdhënieve juridiko civile në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës.

Duke u konsideruar nga respondentët se duhet të ketë reformim në legjislacionin që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor; rritjen e numrit të gjyqtarëve; përmirësimin e kushteve të punës dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve është konstatim se vetë këto fusha nuk janë të reformuara dhe avancuara dhe këto kanë refleksione në shumë fusha tjera dhe ndërtim të sistemit juridik të Kosovës konform asaj që kërkohet për tu konsideruar i kompletuar. Prandaj këto të dhëna, duhet që të jenë pikë referimi për reforma, ndryshime në kuadër të sistemit juridik të Kosovës.


Responentet dhe pergjigjet e dhena ne pyetjen

27




Edhe në përgjigjet individuale të responentëve, kemi përgjigje ku pasqyrohet përqindja e njëjtë si në grafikun e parë ku pasqyrohen përgjigjet e përgjithshme. Përmes përqindjes së përgjigjeve kuptohet se përqindje shumë e ulët e responentëve janë të mendimit se nuk ka nevojë të ketë reformim të sistemit gjyqësor të Kosovës për të pasur mbrojtje më efektive të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile. Ndërsa, një përqindje prej 90% kanë mendimin se duhet të ketë reformim të sistemit gjyqësor dhe atë përmes reformimit të Legjislacionit që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor ku kemi përqindje të lartë për ketë përgjigje e pasuar nga rritja e numrit të gjyqtarëve, më pas ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe përmirësimin e kushteve të punës.

Përmes kësaj behet e njohur nga cdo kategori e responentëve se sistemi gjyqësor nuk është i reformuar, andaj duhet të ndodhë kjo në afat sa më të arsyeshëm përmes mekanizmave të përcaktuar në përgjigjet e kësaj pyetjeje. Përpos kësaj, responentet ofrojnë përgjigje që mund të konstatohet se sistemi gjyqësor duhet që të reformohet por duke i reformuar pjesët e saj vitale siç janë legjislacioni, ngritja e numrit të gjyqtarëve, kushteve të punës dhe trajnimet, me qëllim që të kemi mbrojtje më efektive të të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile.



Nga pyetja: “A duhet dispozitat juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë të bashkohen në një Kod Civil të Kosovës?” kemi këto përgjigje me këto përqindje: Po 69%; Jo 17%; Nuk ka nevojë 14%. Nga vlersimi i bere këaj pyetje prej responentëve të pasqyruara në këtë grafikon mund të konstatojm se Kodi civil i Kosovës është i nevojshëm dhe duhet që të të gjitha dispozitat juridike që duhet të rregullojn marëdhëniet juridiko civile të jenë në kuadër të Kodit Civil.


Përfshirja e dispozitave juridike që rregullojn marëdhëniet juridiko civile në Kod civil është kërkes e kohës dhe njëherit është avancim i legjislacionit, për faktin se në Kod Civil kemi lidhmenin mes të drejtave që e përbijn fushën e së drejtës civile, është më praktik për zbatuesit si dhe për nga rëndësia juridike është vler për sistemin juridik të Kosovës. Prandaj hartimi i Kodit Civil në Kosovë nuk është me urgjenc, po i njëjti duhet që të jetë mirë i analizuar dhe të hartohet duke mbuluar fushën civile.




Një pasqyrim të tillë kemi edhe nga përgjigjet individuale të respondentëve që mbi 60% të respondentëve mendojnë se dispozitat juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë të bashkohen në Kod Civil.

Fuzionimi i dispozitave juridike nga marrëdhëniet juridiko-civile në Kod Civil fillimisht shihet nga ky hulumtim se është mendimi i shumicës së respondentëve, më pas kjo do të jetë në aspektin praktik më i lehtë për t'u përdorur nga zbatuesit. Hartimi i Kodit Civil në Kosovë është një mundësi e mirë që dispozitave përkatëse t'u bëhet një vlerësim dhe konsolidim që më pas të parashihen në kuadër të Kodit Civil të Kosovës.

Nga mendimet e respondentëve të pasqyruara në grafikonet, konstatohet se dispozitat juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë duhet të bashkohen në një Kod Civil të Kosovës i cili tashmë është në fazën e punës nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe së shpejti pritet që të ketë Kosova Kodin e saj Civil. Mendimi i respondentëve shifet se është në re




Pyetja: “Në hartimin e politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile, sa janë të përfshirë gjyqtarët, profesorët, avokatet, noterët, ndërmarrësit, përmblyesit privat, studentët, ekspertet e së drejtës?” derivon këto përqindje në këto përgjigje: Pjesërisht 54%; Pak 31%; Plotësisht 9%; Aspak 6%.



Nga këto të dhëna që i derivojnë këta grafikun për këtë pyetje, kemi mendim unanimit se mbi gjysma e respondentëve mendojnë se Pjesërisht janë të përfshirë në hartimin e politikave dhe legjislacionit të së drejtës civile gjyqtarët, profesorët, avokatët, noterët, ndërmarrësit, përmbanuesit privat, studentët, ekspertët e së drejtës ndërsa, përqindje të ulëta janë përgjigjet tjera.


Përfshirja pjesërisht e këtyre kuadrove, konsideroj se është mungesë e planifikimit të duhur për hartimin e legjislacionit dhe politikave në fushën e së drejtës civile. Nga të dhënat mund të konstatojmë se pamjaftueshëm janë të përfshirë në hartimin e politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile: gjyqtarët, profesorët, avokatët, noterët, ndërmarrësit, përmbanuesit privat, studentët, ekspertët e së drejtës dhe kjo duhet të jetë bazë që në të ardhmen këta kuadro të përfshihen në këtë proces shumë më rëndësi për sistemin juridik të vendit.

Grafiku Nr. 30 Kush duhet të përfshihet në reformimin e legjislacionit të së drejtës civile?



Pyetja: “Kush duhet të përfshihet në reformimin e legjislacionit të së drejtës civile?” ofron këto përqindje për këto përgjigje: Gjyqtar 90%, Avokat 79%, Profesor i së drejtës 66%, Noter 39%, Përmbaues Privat 37%, Ndërmjetësues 19%, Student 29%, Ndërmarrës 38%, Ekspert i së drejtës 65%, Tjetër 40%.

Responentet dhe përgjigjet e dhena ne pyetjen 30



Nga të dhënat e këtyre grafikoneve për këtë pyetje, konstatojmë se në procesin e reformimit të legjislacionit të së drejtës civile duhet që të jenë të përfshira të gjitha kuadrot që janë përfshirë në kuadër të kësaj pyetje. Kjo për faktin se, këta kuadro një pjesë është nga fusha e zbatimit, një pjesë nga aspekti akademik, ndërsa një pjesë tjetër që reformimi i legjislacionit do t'i ndikoj në zhvillim dhe krijim të standardeve më të larta. Prandaj, gjatë procesit të reformimit, çdoherë duhet të jenë të angazhuar me mendimin e tyre kuadrot e cekur në këtë pyetje, kjo e bën që legjislacioni të jetë i reformuar dhe të arrin qëllimin për të cilin është hartuar.

6.PERFUNDIME

Nga analizimi i të dhënave të gjeneruara nga faza e hulumtimit gjegjësisht nga hulumtimi me anketa (pyetëtori) mund të nxjerrën konkluzionet si në vijim:

- Territori i Kosovës çdo herë ka qenë i okupuar nga okupator të ndryshëm, prandaj as një herë nuk ka pasur sistemin e saj juridik të ndërtuar mbi bazën e vlerave, po çdo here në territorin e Kosovës është implementuar sistemi juridik i shteteve që kanë okupuar Kosovën dhe ky ka qenë obligativ për qytetarët e Kosovës. Kjo situatë e ka pamundësuar që Kosova të ketë traditë dhe trashëgimi të sistemit të saj juridik;
- Mungesa e sistemit juridik në Kosovë dhe kundërshtimi i sistemeve juridike të shteteve okupatore, ka bërë që të zhvillohet shumë e drejta zakonore e të cilën e kanë implementuar qytetarët e Kosovës në rregullimin e marrëdhënieve juridiko civile;
- Sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë nuk janë të kompletuara kjo për faktin se nuk janë të reformuara ashtu siç kërkohet për tu konsideruar të kompletuara. Mos reformimi i sistemit juridik dhe ati të legjislacionit të së drejtës Civile është me ndikim edhe në krijimin e shtetit të së drejtës, prandaj kjo e ka pamundësuar që në Kosovë të kemi shtet të së drejtës funksional dhe në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të saj;
- Dilemat se kush ishte kompetent për të konsoliduar sistemin juridik të Kosovës pas vitit 1999 ju është dhënë përgjigje. E cila rezulton se nga viti 1999 deri në vitin 2008 kompetencë për të konsoliduar i sistemin juridik në Kosovë e kishte Misioni i UNMIK-ut. Ishte Misioni i UNMIK-ut ai i cili bart përgjegjësin për mos funksionim dhe konsolidim të sistemit Juridik në vend, kjo për faktin se ky mision ishte autoriteti kryesor në Kosovë sa i përket sistemit juridik;
- Kosova në çdo aspekt kishte trashëgimi ani pse jo vete të krijuara po kryesisht nga shtetet okupatore dhe misionet nga të cilat është administruar. Reformimi dhe ndërtimi i sistemit juridik në drejtim të kompletimit pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 kishte filluar me Miratimin e Kushtetutës së Kosovës si një akt me të cilin ishin vendosur themelet e shtetit dhe sistemit juridik të Kosovës;

- Vlerë të cilës synon ti bashkohet Kosova është Bashkimi Evropian, për të arrit deri në këtë pikë, Kosovës i kërkohet që të plotësoj disa kushte dhe standarde përmes së cilave Kosova do të bëhet pjesë e vlerave të BE-së. Ndër kushtet që kërkohet të plotësohen nga Kosova për në BE është edhe reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me standardet dhe legjislacionin e BE-së. Nga hulumtimi ajo që del është se Kosova pjesërisht e ka të reformuar sistemin e saj juridik me standardet dhe legjislacionin e BE-së;
- Për marrëdhëniet juridiko civile janë me rëndësi; mbrojtja, zhvillimi dhe trajtimi duke qene te bazuara ne vlerat dhe standardet ndërkombëtare. Në Kosovë mbrojtja, zhvillimi dhe trajtimi i marrëdhënieve juridiko civile nuk është i bazuar në vlera dhe standarde ndërkombëtare;
- E Drejta Sendore, E Drejta Pronësore, E Drejta e Detyrimeve, E Drejta Trashëgimore dhe E Drejta Familjare si pjesë të së drejtës civile e kanë nevojshme ndryshim dhe harmonizim e legjislacionit të tyre;
- Hulumtimi na ofron të dhëna sa i përket legjislacionit të së drejtës civile në të cilin: ekzistojnë zbrazëtira ligjore, ka duplikim të dispozitave ligjore, dispozita të paqarta dhe dispozita kundërrhënëse çështje të njëjta që rregullohen në mënyrë të ndryshme;
- Sa i përket Legjislacionit aktual të së drejtës civile i njëjti në mënyrë të plotë dhe efikase nuk mundëson qytetarëve të Kosovës Qasje në Drejtësi, Gjykim të Drejtë, Të drejtën në Pronë dhe Barazinë e Palëve, a në fakt këto janë të drejtat themelore që qytetarët kanë nevojë tu siguroj legjislacioni aktual i së drejtës civile si legjislacion bazë që mundëson mbrojtjen e marrëdhënieve juridiko civile;
- Barra kryesore sipas hulumtimit sa i përket reformimit të sistemit Juridik në Kosovë është ndryshimi i Legjislacionit. Përmes ndryshimit të legjislacionit do të arrihet reformimi i sistemit juridik në vend;
- Është e nevojshme që legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë të jetë në harmoni edhe me disa ndryshime dhe reforma në disa fusha tjera siç janë ndryshimet shoqërore, ndryshimet ekonomike; ndryshimet sociale. Hulumtimi ofron të dhëna se legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë Pjesërisht është në harmo me këto ndryshime e të cilat janë determinues për reformimin dhe ndryshimin e legjislacionit të së drejtës civile;

- Në Kosovë Zhvillim Ekonomik , Sundim të ligjit, Zgjidhjen e problemeve pronësore, Krijimin e ambientit të përshtatshëm për investime të huaja, Qasje më të mirë për qytetarët në drejtësi, Lehtësira në të bërit biznes dhe ndërmarrësi, Krijim të sigurisë juridike për qytetarët, dhe Integrim të Kosovës për në BE janë shumë të varura dhe të bazuara në Reformimin e legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë. Me këtë kuptohet një fakt se të gjitha këto fusha me rendësi vitale për vendin janë të varura nga reformimi i legjislacionit të së drejtës civile;
- Sistemi gjyqësor në vend sfidë kryesore ka numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura nga marrëdhëniet juridiko civile. Nga ky hulumtim kuptojmë se zgjidhja e lëndëve nga marrëdhëniet juridiko civile në gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor është e bazuar dhe ndërlidhet me ndryshimet e legjislacionit të së drejtës civile, kjo për faktin se Plotësisht ndërlidhet ndryshimet e legjislacionit;
- Në kuadër të përfundimeve është edhe ky se në Kosovë pjesërisht apo pak fare ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik me refleksion direkt në: krijimin e kushteve për investimet e huaja, qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut, ndryshimet shoqërore, ekonomike, integruese dhe reformimit të Legjislacionit të së Drejtës Civile;
- Reforma e bere në kuadër të sistemit juridik në vend sa i përketë krijimit të sistemit të noterisë, përmbartimit privat dhe ndërmjetësisimit është shembulli më i mirë se si një reformë ka ndikim direkt tek mbrojtja e të drejtave, siç ka pasur kjo reformë në krijimin e lehtësirave në qasje në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës;
- Legjislacionin që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor, Rritja e numrit te gjyqtarëve, Përmirësimin e kushteve të punës, Ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve, janë fushat të cilat sistemi gjyqësor i Kosovës nuk i ka në nivelin e duhur për tu konsideruar i reformuar dhe kompletuar;
- Pjesërisht apo fare pak gjyqtarët, profesorët, avokatet, noterët, ndërmarrësit, përmbartuesit privat, studentet, ekspertet e së drejtës, janë të përfshirë në hartimin e politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile;

7.REKOMANDIME

Nga analizimi i të dhënave të gjeneruara nga faza e hulumtimit gjegjësisht nga hulumtimi me anketa (pyetëtori) mund të nxjerrën këto rekomandime si në vijim:

- Të identifikohet i gjithë legjislacioni në fuqi që gjen zbatim në Kosovë, nga fusha e së drejtës civile dhe të identifikohen cilat janë të ish sistemit Juridik të Jugosllavisë, Serbisë dhe Misionit të UNMIK-ut. Kjo mundëson që fillimisht të kemi një pasqyrë të qartë se cilat ligje gjejnë zbatim në Kosovë po nuk janë të sistemit juridik të Kosovës;
- Zëvendësimin me legjislacion të Kosovës dhe pushimin e së funksionuarit të të gjitha ligjeve dhe akteve tjera të sistemit juridik të Jugosllaves, Serbisë dhe misionit të UNMIK-ut për fushën e së drejtës Civile;
- Në vazhdimësi të ketë ndryshim dhe reformim të legjislacionit të fushës së të drejtës civile me qëllim që të jetë në funksion të ndërtimit, forcimit të shtetit të së drejtës në Kosovë?
- Vlerësim të fushës së të drejtës civile me qëllim të identifikimit të pjesëve të saj që nuk janë të mbuluara me dispozita përkatëse ligjore e të cilat do të ishin në funksion të kompletimit të legjislacionit të fushës së drejtës civile dhe sistemit juridik për fushën e së drejtës civile;
- Reformimi dhe ndryshimet në kuadër të sistemit juridik të Kosovës ndër të tjera duhet të kenë parasysh dhe të jenë të fokusuar edhe në inkorporimin brenda vetes të standardeve dhe legjislacionin e BE-së, kjo për faktin se me këtë kemi respektim të agjendës Evropiane që Kosova ka para vetes me qëllimin përfundimtar që të bëhet pjesë e vlerave të BE-së;
- Është me interes që për sistemin juridik të Kosovës të kemi konsolidim të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile, me këtë do të kemi një pasqyrë të qartë për këtë legjislacion përmes së cilës do të ketë refleksion në reformimin, hartimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni nga mekanizmat përkatës të shtetit të Kosovës;
- Edhe pse synim i Kosovës është BE-ja dhe për këtë kërkohet implementim të standardeve, Kosova duhet të ketë parasysh edhe mekanizmat, instrumentet tjera e për të cilat ka obligim për tu konsideruar se është implementues dhe përkrahës i vlerave universale. Andaj në kuadër

të sistemit juridik dhe legjislacionit përkatës duhet të inkorporohen standarde ndërkombëtar me qëllim të zhvillimit, avancimit dhe mbrojtjes së marrëdhënieve juridike-civile në Kosovë.

- I nevojshëm dhe me shumë rëndësi për sistemin juridik në Kosovë është ndryshimi, reformimi dhe avancimi i legjislacionit të së Drejtës Sendore dhe të Drejtës Pronësore, kjo për faktin se problemet pronësore të trashëguara nga ish sistemet dhe mungesa e çart e politikave dhe legjislacionit për kohë të gjatë për trajtimin e tyre, ka bërë që problemet pronësore në Kosovë të jenë të pa rregulluara përmes legjislacionit përkatës dhe kjo ka mundësuar që të drejtat pronësore mos të mbrohen dhe fitohen nga qytetarët e Kosovës;
- Me shumë interes për mbrojtjen e marrëdhënieve juridiko civile dhe zbatuesit është që të ketë eliminime të zbrazëtirave ligjore në legjislacionin e së drejtës civile, me theks te veçante atë të së Drejtës Pronësore, të Drejtës Sendore dhe atë të së Drejtës së Detyrimeve, me këtë mundësohet që të ketë mbrojtje më efektive të marrëdhënieve juridiko civile dhe avancim me qëllim të përcjelljes së trendeve të zhvillimit të marrëdhënieve juridiko civile si rezultat i ndryshimeve ekonomike dhe sociale;
- Për të eliminuar paqartësitë tek zbatuesit e legjislacionit të fushës së të drejtës civile dhe qartësimin e plotë për ata që kanë nevojë për mbrojtjen apo që kërkojnë të drejtat e tyre nga marrëdhëniet juridiko civile duhet që të eliminohen duplikimet e dispozitave ligjore në legjislacionin e së drejtës civile. Kjo është e nevojshme që të bëhet brenda legjislacionit të një fushe të së drejtës civile dhe atë brenda fushave të së drejtës civile. Kjo do të krijonte mundësi të qartë të zbatimit të legjislacionit nga fusha e së drejtës civile duke eliminuar dilemat me rastin e referimit dhe interpretimit të dispozitës përkatëse ligjore.
- Gjatë fazës së hartimit të legjislacionit të fushës së të drejtës civile, përkatësisht hartimit të normave konkrete, të njëjtat duhet të jenë të sakta, qarta, precize , me qëllim të eliminimit të paqartësive në dispozita përkatëse ligjore. Kjo do të ketë refleksion në interpretimin e normës dhe përshtatjen e saj rastit konkret.
- Në kuadër të legjislacionit të së drejtës civile nuk mungojnë norma kundërthënëse (çështje të njëjta rregullohen në mënyrë të ndryshme), andaj është me interes që fillimisht të identifikohen dhe më pas të eliminohen këto kundërthënie, kjo me të vetmin qëllim që të kemi përcaktim të

qartë të dispozitave ligjore e jo në kundërshtim njëra me tjetrën qoftë brenda një ligji apo ndërmjet ligjeve, ngase kjo krijon mos siguri juridike..

- Në kuadër të reformimit të legjislacionit të fushës së të drejtës civile dhe zbatimin e ti, ndër të tjera duhet ti kushtohet rendësi pjesëve që do të kishin refleksion pozitiv në avancimin, zhvillimin, reformimin dispozitave ligjore që i referohen Qasjes në Drejtësi, Gjykimit të Drejtë, Të drejtën në Pronë dhe Barazin e Palëve.
- Baz e reformimit përmes plotësim ndryshimit të legjislacionit të fushës së të drejtës civile janë ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe sociale në vend. Reformimi i këtij legjislacioni duhet që të ketë në fokus ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe sociale në vend, kjo për faktin se këto ndryshime cdo herë duhet që ti paraprin ndryshimeve dhe reformimit të legjislacionit në fushën e të drejtës civile. Inkorporimi i këtyre ndryshimeve mbi bazën e analizës dhe arsyesh mërisë, mundëson që të ketë legjislacion i cili është në kohen e duhur për njerëzit e duhur dhe i rezistueshëm ndaj kohës.
- Të gjitha progreset, zhvillimet, avancimet në çdo fushë janë të ndërlidhura me sundimin e së drejtës dhe shtetin e së drejtës, ku sigurohet një legjislacion përmes së cilit krijohet ambient i përshtatshëm për zhvillim. Andaj është me rendësi vitale krijimi i shtetit të së drejtës dhe reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë pasi kjo do të ketë refleksion të madhe pozitiv në: Zhvillim Ekonomik, Sundim të ligjit, Zgjidhjen e problemeve pronësore, Krijim të ambientit të përshtatshëm për investime të huaja, qasje më të mirë për qytetarët në drejtësi, lehtësira në të bërit biznes dhe ndërmarrësi, krijim të sigurisë juridike për qytetarët dhe Integrim të Kosovës për në BE. Prandaj krijimin e shtetit të së drejtës dhe reformimin e legjislacionit duhet të shiqohen me shumë kujdes për faktin se fushat me te rëndësishme në Kosovë varen nga këto reforma dhe ndryshime pozitive.
- Ndryshimet, reformat, nuk duhet te anashkalohen edhe tek pjesa që i referohet qasjes në drejtësi dhe drejtësi përmes sistemit gjyqësor për marrëdhëniet juridiko pronësore brenda afateve të arsyeshme, por duke mos e prishur cilësinë e gjykimit por as duke mos rezultuar në humbjen e të drejtave si rezultat i stërzgjatjeve të proceseve gjyqësore për kontestet nga marrëdhëniet juridiko civile.
- Është me interes dhe shumë e nevojshme që të ketë politika të qarta, shumë mirë të planifikuara dhe analizuara konform rrethanave shoqërore, ekonomike, politike, sociale gjatë hartimit të politikave të qarta në reformimin dhe avancimin e sistemit juridik të Kosovës i cili më pas do

të kishte refleksion pozitiv për fushën e investimeve të huaja, qasje në drejtësi, mbrojtje të të drejtave të njeriut, dhe proceset integruese të Kosovës. Është baza ku përcaktohet suksesi dhe dështimi i shtetit tek hartimi i politikave të qarta të cilat më pas kanalizohen në mekanizma që mundësojnë zhvillim, barazi, drejtësi.

- Nuk mund të ketë sukses vetëm nëse kemi politika të qarta për çdo fushe me rendësi dhe interes për Kosovën, as legjislacion të avancuar të fushës së të drejtës civile, nëse nuk do ta kemi një sistem gjyqësor efikas, pavarur dhe profesional që punën e bazon në Kushtetutë dhe legjislacion përkatës. Për të arrit në stadin që të kemi një Gjyqësor të pavarur, profesional i njëjti duhet që të reformohet në detaje që më pas i njëjti me qene në gjendje ti mbroj të drejtat nga marrëdhëniet juridiko civile. Për një reformim të mirëfilltë të sistemit gjyqësor, fokusi duhet të jetë në reformimin e : Legjislacionit që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor, Rritjen e numrit te gjyqtarëve, Përmirësimin e kushteve të punës në gjykata, Ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe ndërtimin e mekanizmit te vlerësimit dhe diciplinimit.
- Është i nevojshëm për ata që zbatojnë, hartojnë dhe implementoj legjislacionin e së drejtës civile, i njëjti të jetë i bashkuar në një Kod Civil të Kosovës. Kjo mundëson që të ketë avancim legjislacioni i së drejtës civile materiale dhe një herit është shumë praktike për zbatuesit.
- Mund të konsiderohet i mirë, reformuar, suksesshëm legjislacioni i së drejtës civile nëse gjatë hartimit janë konsultuar dhe është respektuar mendimi i arsyeshëm i Gjyqtarëve, Avokatëve, Profesorëve të drejtësisë, Noterët, Përmbauesit Privat, Ndërmjetësuesit, Studentet, Ndërmarrësit dhe Ekspertet e së drejtës. Andaj rekomandohet që në mënyrë aktive këto profesione të jenë të angazhuara në hartimin e legjislacionit, kjo për faktin se do të kemi një legjislacion të fushës së të drejtës civile i cili në vete përmban eliminimin e pengesave të zbatimit, aspektin shkencor, ndikimin ekonomik dhe biznes or, me këtë formë do të kemi legjislacion të kompletuar i cili do ti rezistoj kohës.

8.B I B L O G R A F I A

A. Literaturë shkencore

- Abdulla Aliu, E drejta Civile, Universiteti i Prishtinës " Hasan Prishtina" Prishtinë 2013, p - 322
- Arsim Bajrami, Aspekti kushtetues dhe politik te mëvetësisë se Kosovës, Prishtinë 1996, p - 254
- Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës se Kosovës, Kolegji AAB, Prishtinë 2014, p- 31
- Blagojević, Slobodan, Sistematizacija prava – njen osnov I cilj, Pravno misao, Sarajeve, 1980, p-11-12
- Bobcev, Stefan, Istorija na Bulgarskoto pravo, Burgas, 1993, p,
- Borislav, Blagojevic T., Razvoj naslednog prava, Arhiv za pravne i drustvene nauke, Beograd, nr.1-2/ 1986, p-167
- Carbonnier, Jean, Droit Civil, 1 - Introduction, les Personnes, Themis, Paris, 1982, p – 111
- Chevallier Jean & Beach Louis, 1975, p. 4,Droit civil, Paris, 1979, Sirey, p-4
- Const, Periphanakis, Les sources du droit en science comparative et notions de droit civil ompare, 1964, Athenes, p-
- Dimitar, Georgiev Pop, Razvoj gradjanskog prava, Beograd, nr.1-2/1986, P-127
- E Drejta Kushtetuese – Demokraci, Duamel, Oliver, 1993, SHKUP, Logos, fq 18
- E Drejta Private, Galgano, Francesco, Tiranë, Universiteti "Luarasi" Tiranë, 2006, p. 36
- Ejup, Statovci, Ca çështje mbi burimet e së drejtës civile dhe mbi rregullimin e disa marrëdhënieve civile - juridike në KSA të Kosovës, Përparimi, Prishtinë, nr.3/1976, p- 315
- Fatmir, Fehmiu, Ndarja e kompetencave legjislativ midis Federatës e RS e KSA dhe projektamandamentet kushtetuese, Ndarja e kompetencave legjislativ midis Federatës e RS e KSA dhe projektamandamentet kushtetuese, 1988, p-56
- Gams, Andreja, Hyrje në të Drejtën Civile, Universiteti i Kosovës në Prishtinë, Prishtinë 1986, p-61
- Hetemi, Mehdi, E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik, Prishtine 2002, p – 22 – 23
- Hyrje në të Drejtën, Berisha, Prof. Dr. Fejzulla, Universiteti ""Haxhi Zeka" Fakulteti Juridik Pejë 2013

- Kryeziu, Prof. Dr. Kadri, E Drejta Romake, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" Fakulteti Juridik, Prizren, 2017, p- 19
- Larroument, Christian, Droit Civil - Introduction a l'etude du droit prive, Tome I, Paris, 1984, p- 121
- Luarasi Aleks, Historia e Shtetit dhe e se Drejtës në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë 2001, p -231
- M, Durunton, Cours de Droit Francais, Tome I, Paris, 1834, p-20
- Michel, Miaille, Une introduction critique au droit, Paris, 1982, p-
- Milanoviq, Obradoviq, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1919 – 1941, Prishtinë, 1981, p-108
- Rene, David, Les grands systemes de droit civil contemporains, Deloz, Paris, 1982, p – 106
- Rexhepi, Bashkim Selmani Bekim, E Drejta Romake ndikimi i saj ne sistemet e se drejtës bashkëkohore, Instituti Ndërkombëtar për Hulumtime Shkencore, Ferizaj 2014, p – 68
- Salihu, Kurtesh, Lindja, zhvillimi pozitativ dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavi, 1984, p-47
- Salihu, Kurtesh, E Drejta Kushtetuese, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Botimi i trete. Prishtinë (2002)
- Statovci, Prof. dr. Ejup, Marrëdhëniet Pronësore Juridike në Sendet e Paluajtshme në KSA të Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2009, p- 110-111
- Tedeschi, Guido, Le centenaire de la Mejele, Revue internationale de droit compare, Paris, Nr.1/1969, p- 127
- Éeill, Alex & Terre, Francois, Droit civil, Introduction Generale, Paris, publisher Dalloz, 1979, p – 244
- Ahtisari, Marti, Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, Prishtinë, 2 shkurt 2007, Neni 1, par 1.1
- Fromont, Michel, Profesor i merituar, Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës, Tiranë (2009)

B. Legjislacioni

- Gazeta zyrtare e KSAK nr. 6/69, Ligji kushtetues i KSA të Kosovës
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS , LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS, Prishtinë 2004

- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 16 / 19 QERSHOR 2012, PRISHTINË, LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE, Prishtinë, 2012
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 79 / 24 GUSHT 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës, LIGJI Nr. 03/L-199 për Gjykatat, 2010, neni 22, paragrafi 1, nenparagrafi 1.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE, 2009
- Kuvendi i Kosovës, Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008,
- Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kaçanik, 7 shtator 1990, neni 1, 2,3
- Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 2002/ 4 për hipotekat, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 2002, neni 1, par 1.1
- Kuvendi i Kosovës, Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës (konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në federatë (konfederatë), Prishtine, 2 Korrik 1990, pika 1
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 102, paragrafi 1,2,3
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Procesverbal nga seanca e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur, 9 prill 2008
- Nations, United, Rezoluta 1244, Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e vet të 4011-të,1999
- Slushbeni list FNRJ nr.32/68,
- UNMIK ,Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 2001, Kreu 9.1.26, pjesa 1
- UNMIK ,RREGULLORE NR. 1999/10 PËR SHFUQIZIMIN E LEGJISLACIONIT DISKRIMINUES LIDHUR ME ÇËSHTJET BANESORE DHE TË DREJTAT MBI PRONËN, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 1999, neni 1
- UNMIK ,RREGULLORE NR. 2001/9 PËR KORNIZËN KUSHTETUESE TË VETËQEVERISJES SË PËRKOHSHME NË KOSOVË, Gazeta Zyrtare, UNMIK, p-1
- UNMIK ,Rregulloren nr. 1999/6 për rekomandimet mbi strukturën dhe administrimin e shërbimit të gjyqësisë dhe të prokurorisë, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 1999, neni 1, 5
- UNMIK, RREGULLORE NR. 1999/1 PËR AUTORIZIMET E ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME NË KOSOVË, Gazeta Zyrtare UNMIK, 25 qershor 1999, Neni 1,par,1.1
- UNMIK, Rregullore nr. 2001/32 për themelimin e zyrës së regjistrimit të pengut, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 2001, neni 1, paragrafi 1.2

- UNMIK, RREGULLORE NR. 2001/9 PËR KORNIZËN KUSHTETUESE TË VETËQEVERISJES SË PËRKOHSHME NË KOSOVË, Gazeta Zyrtare, UNMIK,2001
- UNMIK, RREGULLORE NR. 2001/9 PËR KORNIZËN KUSHTETUESE TË VETËQEVERISJES SË PËRKOHSHME NË KOSOVË, Gazeta Zyrtare, UNMIK,2001, Kreu 9,9.1.44
- UNMIK, Rregulloren NR. 1999/23 për themelimin e drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 1999, neni 1
- UNMIK, Rregulloren Nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë UNMIK, Misioni i Kombeve te bashkuara në Kosovë, http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A1999regs/RA1999_24.htm, 12.12.1999
- UNMIK, Rregullorja 2001/5 për Pengun, Gazeta Zyrtare, 2001
- UNMIK, Rregullores nr. 2000/15 për themelimin e departamentit administrativ të drejtësisë, Gazeta Zyrtare, UNMIK, 2000, neni 1, paragrafi 1.2
- UNMIK,, Rregullore nr. 2001/17 mbi regjistrimin e kontratave për shitblerjen e patundshmërive në zonat e veçanta gjeografike të Kosovës, Gazeta Zyrtare, UNMIK, neni 1, par 1.1
- www.wikipedia.org, <https://sq.wikipedia.org/wiki/Jugosllavia>, 2017, muaji 7, dita 31
- <http://www.unmikonline.org/Documents/Res1244ENG.pdf>,

9.SHTOJCA

Pyetësori

Qëllimi i këtij hulumtimi është nxjerrja e rezultateve mbi qëndrimet e zbatuesve, hartuesve dhe stafit akademik lidhur më Sistemin juridik të Kosovës me theks te veçantë legjislacioni i së Drejtës Civile dhe efektet e reformimit të tyre. Rezultatet e këtij hulumtimi do të përdoren për qëllime akademike dhe si bazë që të konsultohen gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile në Kosovë. Dëshiroj t'ju falënderoj për bashkëpunimin dhe pa diskutim të marr përsipër ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave!

PYETËSOR

PËR SISTEMIN JURIDIK TË KOSOVËS ME THEKS TË VEÇANTË LEGJISLACIONI I SË DREJTËS CIVILE DHE EFEKTET E REFORMIMIT TË TYRE

1. **Pozita juaj?**

- A. Gjyqtar
- B. Avokat
- C. Profesor i së drejtës
- D. Noter
- E. Përmbarues Privat
- F. Ndërmjetësues
- G. Student
- H. Ndërmarrës
- I. Ekspert i së drejtës
- J. Tjetër: _____

2.A duhet të ketë reforma te vazhdueshme sistemi juridik dhe legjislacioni i së drejtës civile në Kosovë, për të pasur një shtet te se drejtës?

- A. Po
- B. Jo
- C. Nuk është i nevojshëm

3. Prej vitit 1999 deri në vitin 2008, kompetencë e kujt ishte konsolidimi i sistemit juridik në Kosovë?

- A. Misioni i UNMIK-ut
- B. Institucionet e përkohshme të Kosovës
- C. UNMIK dhe Institucionet e përkohshme të Kosovës
- D. Ende nuk kishte filluar ndërtimi i sistemit juridik të Kosovës

4. Me shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008, reformimi i sistemit juridik të Republikës së Kosovës, ka filluar me?

- A. Miratimit të Kushtetutës së Kosovës
- B. Nxjerrjes së ligjeve të reja nga Kuvendi i Kosovës
- C. Zëvendësimit të ligjeve të ish-sistemit juridik të Jugosllavisë dhe Serbisë me Ligje të Republikës së Kosovës
- D. Zëvendësimit të rregulloreve të UNMIK-ut me Ligje të Republikës së Kosovës
- E. Asnjëra më lart

5. Sa është i reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me standartet e BE-së?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

6. Sa është i reformuar sistemi juridik i Kosovës në pajtim me legjislacionin e BE-së?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

7. Sa është i konsoliduar legjislacioni që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. As pak

8. A janë në harmoni me standardet ndërkombëtare, mbrojtja, zhvillimi, trajtimi i marrëdhënieve juridike-civile në Kosovë?

A. Po

B. Jo

9. Cila nga pjesët e degës së të drejtës civile ka nevojë për ndryshim dhe harmonizim të legjislacionit?

A. E Drejta Sendore

B. E Drejta Pronësore

C. E Drejta e Detyrimeve

D. E Drejta Trashëgimore

E. E Drejta Familjare

10. A ekzistojnë zbrazëtira ligjore në legjislacionin e së drejtës civile?

A. Jo

B. Po Nëse PO, në cilën fushë të së drejtës:

A. E Drejta Sendore

B. E Drejta Pronësore

C. E Drejta e Detyrimeve

D. E Drejta Trashëgimore

E. E Drejta Familjare.

11. A ekziston duplikimi i dispozitave ligjore në legjislacionin e së drejtës civile?

A. Jo

B. Po Nëse PO, në cilën fushë të së drejtës:

A. E Drejta Sendore

B. E Drejta Pronësore

C. E Drejta e Detyrimeve

D. E Drejta Trashëgimore

E. E Drejta Familjare

12. A ekzistojnë dispozita të paqarta në legjislacionin e së drejtës civile?

- A. Jo
- B. Po Nëse PO, në cilën fushë të së drejtës:

- A. E Drejta Sendore
- B. E Drejta Pronësore
- C. E Drejta e Detyrimeve
- D. E Drejta Trashëgimore
- E. E Drejta Familjare

13.A ekzistojnë norma kundërthënëse (çështje të njejta rregullohen në mënyrë të ndryshme) në legjislacionin e së drejtës civile?

- A. Jo
- B. Po Nëse PO në mes të cilit legjislacion

- A. E Drejta Sendore
- B. E Drejta Pronësore
- C. E Drejta e Detyrimeve
- D. E Drejta Trashëgimore
- E. E Drejta Familjare

14. Sa e vështirëson realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile mungesa e dispozitave përkatëse apo kolozioni i ligjeve?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

15. Legjislacioni aktual i së drejtës civile mundëson në mënyrë efikase?

- A. Qasje në drejtësi
- B. Gjykim të drejtë
- C. Të drejtën në pronë
- D. Barazi të palëve

16. Sistemi Juridik në Kosovë mund të reformohet me:

- A. Ndryshimin e Kushtetutës
- B. Ndryshimin e Legjislacionit
- C. Përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së

- D. Pushimin e së funksionuarit të legjislacionit të ish-sistemit juridik Jugosllav dhe atij të UNMIK-ut
- E. Zbatim të legjislacionit aktual
- F. Reformimin e sistemit gjyqësor
- G. Ngritjen e kapaciteteve në zbatim të legjislacionit
- H. Monitorimin e zbatimit të legjislacionit.

17. Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet shoqërore në Kosovë?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

18. Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet ekonomike në Kosovë?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

19. Sa është legjislacioni i të drejtës civile në harmoni me ndryshimet sociale në Kosovë?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

20. Reformimi i legjislacionit të së drejtës civile në Kosovë do të ketë ndikim pozitiv në:

- A. Zhvillim ekonomik
- B. Sundim të ligjit
- C. Zgjidhjen e problemeve pronësore
- D. Krijim të ambientit të përshtatshëm për investime të huaja
- E. Qasje më të mirë për qytetarët në drejtësi
- F. Lehtësira në të bërit biznes dhe ndërmarrësi

G. Krijim të sigurisë juridike për qytetarët

H. Integrim të Kosovës për në BE

21. Sa do të ketë ndikim ndryshimi i legjislacionit të së drejtës civile në zgjidhjen e lëndëve nga marrëdhëniet juridiko civile në gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor?

A. Plotësisht

B. Pjesërisht

C. Pak

D. Aspak

:

22. Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me investimet e huaja në Republikën e Kosovës?

A. Plotësisht

B. Pjesërisht

C. Pak

D. Aspak

23. Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës që mundësojnë qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të njëriut për qytetarët e Republikës së Kosovës?

A. Plotësisht

B. Pjesërisht

C. Pak

D. Aspak

24. Sa ka politika të qarta për reformimin e sistemit juridik të Kosovës konform nevojave që kanë të bëjnë me ndryshimet shoqërore, ekonomike, integruese në Republikën e Kosovës?

A. Plotësisht

B. Pjesërisht

C. Pak

D. Aspak

25. Sa ka Politika të qarta sa i përket reformimit të Legjislacionit të së Drejtës Civile në Kosovë?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

26.Sa e ka lehtësuar qasjen në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës krijimi i sistemit të noterisë, përmbartimit privat dhe ndërmjetësimit?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak
- D. Aspak

27.A duhet të ketë reformim të sistemit gjyqësor të Kosovës për mbrojtje më efektive të drejtave nga marrëdhëniet juridiko-civile?

- A. Jo
- B. Po Nëse PO, në cilat fusha:
 - A. Legjislacionin që rregullon organizimin e sistemit gjyqësor
 - B. Rritjen e numrit të gjyqtarëve
 - C. Përmirësimin e kushteve të punës
 - D. Ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve.

28.A duhet dispozitat juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile në Kosovë të bashkohen në një Kod Civil të Kosovës?

- A. Po
- B. Jo
- C. Nuk ka nevojë

29.Në hartimin e politikave dhe legjislacionit për fushën e së drejtës civile, sa janë të përfshirë: gjyqtarët; profesorët; avokatët; noterët; ndërmarrësit; përmbartuesit privat; studentët; ekspertët e së drejtës?

- A. Plotësisht
- B. Pjesërisht
- C. Pak

D. Aspak

30.Kush duhet të përfshihet në reformimin e legjislacionit të së drejtës civile?

A. Gjyqtar

B. Avokat

C. Profesor i Drejtësisë

D. Noter

E. Përmbarues Privat

D. Ndërmjetësues

E. Student

F. Ndërmarrës

G. Ekspert i së drejtës

H. Tjetër: _____

Koment:
